MAL BERISHA

HERMAN BERNSTEIN

Ambasador i ShBA – ve
në Mbretërinë Shqiptare
1930 – 1933

HERMAN BERNSTEIN

MAL BERISHA

HERMAN BERNSTEIN

Ambasador i ShBA – ve
në Mbretërinë Shqiptare
1930 – 1933

Botues: Bardhyl Musai
Redaktor Letrar: Albana Deda (Ndoja)
Ballina: Ina Musai
Konsulente: Dr. Xhoana Papakostandini
Arti grafik: Rigers Popa

©Mal Berisha, 2017
Botuar nga EduAlba
www.Malberisha.com

ISBN 978-9928-121-73-8

Kushtuar: Donikës, Erionit, Kreshnikut, Kreuzes dhe...Andrës së bukur

Përmbajtja

Hyrje

Pjesa e parë: HERMAN BERNSTEIN NË SHQIPËRI

Pushteti i butë i "Enciklopedisë Bernstein"

Kontaktet e para shqiptaro - amerikane

Marrëdhëniet diplomatike shqiptaro - amerikane

Herman Bernsteini, figurë që lidh tre kombe

Emërimi i Herman Bernsteinit si ministër fuqiplotë në Shqipëri

Instituti i kërkimeve hebraike YIVO në New York

Gëzim në qarqet hebraike – amerikane

Tirana, siç e shihte Herman Bernstein nga dritarja e zyrës së tij

Respekt i veçantë i Bernsteinit për Shqipërinë

Dita e falënderimeve festohet edhe në Tiranë, e Enjte, 27 nëntor 1930

Toleranca fetare në Shqipëri e përshkruar nga Bernsteini

200-vjetori i lindjes së G. Washingtonit festohet edhe në Tiranë

Kujdesi i Ambasadorit Bernstein për arsimin në Mbretërinë Shqiptare

Bernsteini, mik i madh i kulturës shqiptare

Bernstein, mjeshtër i analizave diplomatike

Përse shqiptarët e kanë humbur besimin tek italianët?

Viti i Musolinit

Raport i bisedës së Herman Bernsteinit me diplomatët e huaj

Historia e Mbretit Zog I

Puna e Bernsteinit për njohjen e historisë së hebrejve në Shqipëri

Një krahasim i Shqipërisë së asaj kohe me Meksikën antisemitiste

Fundi i misionit të Bernsteinit në Shqipëri

Ministri Bernstein po largohet nga Shqipëria

Bernsteini ruan miqësinë me shqiptarët edhe pas largimit

Pas largimit nga Shqipëria përsëri Bernsteini i shërben Shqipërisë
Bernsteini i survejuar nga Italia fashiste
Vdekja e Herman Bernsteinit
Nderim për këtë njeri të madh

Pjesa e dytë: HERMAN BERNSTEINI PARA ARDHJES NË SHQIPËRI
Bernsteini, poet dhe shkrimtar
Libri me tregime "Në portën e Izraelit", histori hebrejsh
Letërsia ruse dhe kontributi i Herman Bernsteinit në njohjen e saj në botën anglofone
Bernsteini kritik letrar
Herman Bernsteini dhe Leonid Andrejevi (1871 – 1919)
Bernsteini gazetar i famshëm investigativ.
Revolucioni i tetorit dhe telegramet "Willy - Nicky"
"Të famshmit e kohës sonë", botuar në vitin 1924
"A mund të shmangim luftën"?
Herman Bernsteini, mik personal i Albert Ajnshtainit
Njohja e historisë së hebrejve në Shqipëri, diçka më e gjerë se sa studimi i jetës së Herman Bernsteinit
Epilog: Takim me Boaz Nash, stërnipin e Herman Bernsteinit
Mbyllje
Shënime

Hyrje

Ky libër është vijim i një pune shumëvjeçare për të paraqitur me çdo mundësi kontributin e shumë figurave të ndritura perëndimore në dobi të popullit tonë. Në këtë rast është Ambasadori Amerikan Herman Bernstein *në Mbretërinë Shqiptare, 1930 - 1933* dhe bashkë me të aktet heroike të shqiptarëve, të cilët morën në mbrojtje hebrejtë shqiptarë, si dhe një numër hebrejsh refugjatë, që largoheshin nga përndjekja naziste.

Mirënjohje për aktin e pashembullt të Madhërisë së Tij, Mbretit Zogu I, i cili zhvilloi dhe forcoi një miqësi të ngushtë me Ambasadorin Bernstein dhe si rrjedhojë urdhëroi misionet konsullore shqiptare të lëshonin viza për ata njerëz në dëshpërim. Ai e ktheu Shqipërinë e vogël në strehë të sigurt e bujare për ta. Trashëgimia e kësaj vepre tepër humane ndihet edhe sot në dobi të diplomacisë shqiptare.

Për të ardhur deri te përfundimi i këtij libri, është dashur ndihma dhe bashkëpunimi i shumë personaliteteve dhe institucioneve, të cilët dua t'i falënderoj përzemërsisht. Së pari, dua të falënderoj *YIVO Institute of Jewish Research,* New York, që më mundësoi shfrytëzimin e gjithë arkivës së ambasadorit Herman Bernstein. Në veçanti, falënderoj prof. dr. Jonathan Brent, drejtor i këtij institucioni dhe zonjën Fruma Mohrer, shefe e arkivës së Institutit. Falënderoj prof. John Freely nga Universiteti Bosphorus në Stamboll, i cili më njohu fillimisht me çështjen hebraike, si dhe Sir Noel Malcolm nga "*All Souls College*" në Oxford, për përkujdesjen në metodologjinë e këtij libri.

Po ashtu, i jam mirënjohës dr. Elez Biberajt në VOA, Washington, për ndihmesën me pasqyrën e arkivës së YIVO - s, botuar prej tij në gazetën Dielli, si dhe historianit Ilir Ikonomi për materialet e ofruara.

Dr. Xhoana Papakostandini, ish-kolege diplomate e talentuar në Londër, meriton falënderime për konsulencën e ofruar në çdo hap të hartimit të këtij libri, sikundër edhe prof. Simon Schama i Universitetit Columbia në New York, rrëfimtari më i mirë i historisë së Izraelit në BBC, për inkurajimin e pashembullt.

Studiuesi dhe diplomati Bejtullah Destani, Drejtor i Institutit të Studimeve Shqiptare në Londër, meriton mirënjohje të veçantë për këshillat e vyera, ndërsa tanimë i ndjeri dr. Robert Elsie, në Berlin, për materialet e zgjedhura në arkivën e tij të Historisë së Shqipërisë.

Me respekt dua të nderoj të ndjerën prof. Scarlett Epstein, e mbijetuar e Hollokaustit në Shqipëri, fotografin e saj Andy Lee në Londër, si dhe zonjën Gabby Glassman nga Pinner Sinagogue.

I jam mirënjohës gazetarëve Petrit Kuçana, Arben Manaj, Fatmir Terziu në Londër, Ndrekë Gjini në Irlandë, Rudina Hoxha në Tiranë, poetit Visar Zhiti**,** David Hosaflook nga Instituti i Studimeve Shqiptare – Protestante në Tiranë, për pasqyrimin e veprimtarive mbi këtë figurë. Falenderoj gjithashtu profesorët Ferit Duka, Nevila Nika, si dhe zonjën Anila Kadia për materialet arkivore, që më kanë ofruar bujarisht.

Ndërkohë u jam mirënjohës veçanërisht katër ish-kolegëve ambasadorë të akredituar në Oborrin e St. James, kur shërbeja atje dhe pikërisht, z. Mathew Barzun nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, z. Daniel Taub nga Shteti i Izraelit, znj. Asta Skaisgirytė-Liauškienė nga Lituania dhe z. Lirim Greiçevci nga Kosova, me të cilët e promovuam figurën e Herman Bernsteinit në Londër.

Versione të përmbledhura nga përmbajtja e këtij libri janë prezantuar para audiencave të ndryshme në Londër, New York, Boston, Gjenevë, Prishtinë e Tiranë. Me këtë rast dua të falënderoj Ambasadën Amerikane në Londër, për mundësinë që më dha për të prezantuar këtë figurë dhe nëpërmet të tij vetë Shqipërinë, në paraqitjen e bërë në auditoriumin e saj para trupit diplomatik të akredituar në Londër. Nje falenderim i veçantë shkon për Wiener Library në Londër, e cila është biblioteka më e madhe hebraike në Europë si dhe për Ambasadën Britanike në Tiranë dhe ish-ambasadorin Nicholas Cannon për prezantimet e po kësaj natyre të bëra në mjediset e tyre.

Mirënjohje dhe falenderime shkojnë edhe për gazetarin legjendar amerikan Christopher Lyden nga Radio NPR *në Boston,* si dhe Kennedy School of Government, për mundësinë që më kanë dhënë për prezantimin e figurës së Herman Bernsteinit në auditorin e tyre Starr. Po kaq falenderoj Akademinë Diplomatike në Prishtinë.

Një falënderim shkon për Bibliotekën Publike në New York, Bibliotekën e Universitetit Yale në New Haven, Connecticut, SHBA, British Library në Londër, Geneva School of Diplomacy në Zvicër, Federatën Pan – Shqiptare Vatra në New York, veçanërisht kryetarit dr. Gjon Buçaj, nënkryetarit z. Agim Rexha, si dhe për anëtaren e bordit të Federatës zonjën Marjana Bulku.

Falënderoj zonjën Adelina Shehu (Hoxha) për punën e imët që ka bërë për korrektimin e librit në fazën e parë, prof. Bardhyl Musai për ndihmesën gjatë procesit të botimit, znj. Ina Musai për punën me pasion për paraqitjen grafike të librit.

Në fund, por jo për nga rëndësia, falënderoj familjen time, djemtë Erionin dhe Kreshnikun, që janë dhe sponsorë të librit, zonjën time, Donikën, e cila më është gjetur pranë në netët pa gjumë, që ka kërkuar përgatitja e këtij libri dhe librave të tjerë para tij.

Pjesa e parë

HERMAN BERNSTEIN NË SHQIPËRI

Tirana, gjatë këtyre tre viteve e gjysmë, ishte për mua Vendi vëzhgues më magjepsës. Aty mësova se përkundër asaj që Shqipërisë i referohen si njëra prej zonave më të rrezikshme të Europës, shqiptarët vetë janë njerëz paqedashës, ndërsa politika e qeverisë së tyre është pa diskutim një politikë paqësore në Ballkan. Kam vizituar praktikisht çdo pjesë të Shqipërisë, prej nga mësova ta njihja dhe ta doja popullin shqiptar, thjeshtësia, vërtetësia në veprime, mikpritja dhe shpirtmirësia e të cilit kanë lënë gjurmë të pashlyeshme tek unë.

Pushteti i butë i "Enciklopedisë Bernstein"[1]

Kuptimi i mbiemrit Bernstein është "*qelibar*" dhe vjen nga gjuha gjermane. Ka shumë njerëz të njohur që mbajnë këtë mbiemër. Kjo nuk do të thotë se ata rrjedhin të gjithë nga e njëjta familje, por, kur kërkon të njohësh njërin prej tyre, nuk mund të mos biesh në gjurmët e dhjetra të tjerëve.

Mbiemrin Bernstein[2] mund ta gjesh sot te njerëz, të cilët kontribuojnë në sfera të ndryshme të dijes e të jetës. Kështu, mund të përmendim Leonard Bernstein[3], muzikantin e famshëm, dirigjentin e veprave të Bethovenit.

Po ashtu, regjisorin e filmave Elmer Bernstein[4] , apo regjisorin tjetër Adam Bernstein[5]. Ky mbiemër shumë i njohur në botën hebraike, e jo vetëm, është mbajtur nga shkrimtarë, filozofë, muzikantë, poetë, gazetarë, shkencëtarë, sportistë, aktorë, udhëtarë, linguistë, komentatorë, e njerëz nga thuajse çdo fushë e jetës.

Ky fakt i ka bërë akoma më interesante vitet e studimeve rreth Herman Bernsteinit, pasi gjatë hulumtimeve kam qenë disi "*i detyruar*" të njihem edhe me shumë Bernsteinë të tjerë.

Kështu, hulumtimet rreth Herman Bernsteinit kanë qenë për mua një lloj lundrimi në një oqean dijesh, që prek tërthorazi jo vetëm botën hebraike në të katër anët e saj, por edhe skajet e vetë kulturës dhe historisë së kohërave tona.

Studimi i jetës së Herman Bernsteinit përbën në vetvete një sipërmarrje shumëplanëshe. Është i rrallë dhe i admirueshëm fakti se sa shumë mund të bëjë njeriu gjatë një jete jo aq të gjatë, sa ajo e tij.

Sa udhëtime të gjata ndërkontinentale, në kushtet e lëvizjes së ngadalshme të kohës, sa artikuj gazetash, sa ngjarje të përshkruara drejtpërdrejt nga terreni ku ndodhnin, sa vepra letrare të shkruara, sa polemika të publikuara, sa përkthime veprash në disa gjuhë, rusisht, anglisht, gjermanisht, frëngjisht, hebraisht, polonisht, madje edhe esperanto janë dashur?!

Ai ka botuar katërmbëdhjetë vepra e fatmirësisht të gjitha mund të gjenden lehtësisht të ribotuara sot. Veprat e përkthyera nga Bernsteini janë shtatëmbëdhjetë, të gjitha kryevepra të autorëve të mëdhenj.

Megjithëse zanafilla e këtij studimi ishte periudha e jetës së Herman Bernsteinit në Shqipëri (1930 – 1933), densiteti i jetës së tij paraprirëse intelektuale përfshiu me interes një pjesë të madhe të punës sime. Prandaj, ashtu si në rastin e studimit të jetës së

amerikanit Charles Telford Erickson[6], që i kushtoi jetën Shqipërisë, apo në ato të udhëtarëve të "*The National Geographic Magazine*"[7], që e paraqitën Shqipërinë me tërë bukuritë e saj dhe gjithashtu, si në rastin e studimit të "Racave dhe Feve në Europë" si raca më e vjetër dhe më e bukur në kontinent[8], po kështu, shkrimet e udhëtarëve britanikë në trojet shqiptare[9], që e përshkruajnë Shqipërinë dhe shqiptarët me nota ekzotike, edhe në jetën e Herman Bernsteinit[10], në përmbledhjen e parë dhe në këtë të tashmen, ndjej se ndikimi i gjithë atyre aspekteve, që plotësojnë njohjen e figurave të mëdha, apo një periudhe historike, ka qenë shumë i madh. Të ndash me lexuesin disa prej atyre përjetimeve që të sjell hulumtimi në jetën dhe veprën e figurave të tilla, është diçka magjike, diçka që e pasuron jetën e një studiuesi, i jep kuptim punës së tij.

Hulumtimet mbi jetën e Herman Bernsteinit më kanë drejtuar te disa fakte shumë interesante. Ai ishte mik i tre presidentëve amerikanë: Theodore Roosevelt, Woodrow Wilson dhe Herbert Hoover.

Ai kishte pasur kontakte me njerëzit më të shquar të botës si: me Leon Tolstoin, Leo Trockin, August Rodin, Leon Andrejev, George Bernard Shaw, Sheik Ul Islam, Sigmund Freud, Aleksandër Moisiu dhe, mbi të gjithë, ai kishte miqësi personale me Albert Ainshtajnin.

Një personalitet i tillë, për mua, në kontekstin shqiptar, është promovim i Shqipërisë, pasi përfaqëson dikë që ka përmasa universale. Ky është edhe qëllimi, misioni i veprës sime: Të zbulohet Shqipëria dhe shqiptarët, siç e kanë parë njerëz të tillë të mëdhenj.

Kjo është pjesë e asaj që bota sot e quan *"Pushteti i butë"* i kombeve të vegjël, në marrëdhëniet ndërkombëtare. Bota enciklopedike e emrave të shquar të kulturës njerëzore të ofruar nga personalitete me origjinë hebreje, me mbiemrin Bernstein është diçka që na bën nder, sa në planin human të fjalës, aq edhe në atë kombëtar. Pikërisht këtë kam pasur parasysh, kur kam shkruar këtë libër për Herman Bernsteinin modelin e intelektualit të dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit të njëzetë, njeriut që i "*këndoi*" Shqipërisë, lavdisë së saj antike, Skënderbeut, konsolidimit të shtetit të pavarur shqiptar, tolerancës fetare, virtyteve tona, besës dhe mikpritjes shqiptare.

Për të ardhur deri te vepra dhe jeta e Herman Bernsteinit, do na duhet të ndalemi në disa etapa të mëparshme të jetës së tij, derisa të krijojmë idenë e plotë se përse Presidenti Herbert Hoover caktoi në Shqipëri si përfaqësues të tij një nga njerëzit me përvojën më të pasur, me një emër të madh në gazetari, politikë, art e kulturë, një intelektual *par excellence*, një luftëtar të paepur të një çështjeje të madhe, jo vetëm për një komb, por për tërë njerëzimin: Hebraizmin.

Kontaktet e para shqiptaro - amerikane

Historia e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane duket se fillon përpara krijimit të vetë shtetit shqiptar. Gjurmët e para të vëmendjes amerikane ndaj historisë së kombit shqiptar i gjejmë te Poema e Longfellout "*Përrallat e Bujtinës ndanë Udhës*", në të cilën i këndohet heroit tonë Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Përkthimi i kësaj vepre është bërë nga Fan Noli (1916):

Nga Kështjella shpejt ka rënë
Flamuri me gjysmë-hënë
Edhe populli shikon
Që në vent të tij valon
Flamur' i Skënderit n'erë
Shkab' e Zezë me dy krerë.
Dhe një thirrje lart u ngrit,
Se çdo zemër e çdo shpirt
U mërzit nga Turku i lik,
Që e bëri atë Krujë
Zi, murtajë dhe rrëmujë.
Ay zë me gas me bujë
Q'oshëtin nga bregu n'breg
është: "Rrofsh, o Skanderbeg![11]

Më pas fillojnë të duken dallëndyshet e para të pranisë shqiptare në SHBA. Në një studim me titull "*Përpjekjet shqiptare*[12]*",* të kryer nga Universiteti i Harvardit nën drejtimin e dr. M.W. Royse, editori kombëtar i Studimeve Social - Etnike) dhe dr. Frank Manuel, në bashkëpunim me patriotë shqiptarë si Qerim Panariti[13] (ish-President i Vatrës) dhe Vangjel Misho, konstatohen fillimet e vendosjes së shqiptarëve në Amerikë. Sipas këtij studimi, i pari shqiptar që shkeli në *Tokën e Re* mbërriti aty nga viti 1876, për t'u larguar më pas në Argjentinë.

Provë e parë e mbrritjes së shqiptarëve në Amerikë është një prift i quajtur Nikolla Kristoferi nga fshati Katund i Korçës, i cili u vendos në Massachusetts, në vitin 1886. Ai

udhëtonte shpesh në Shqipëri dhe çdo here në kthim merrte dikë me vete për ta vendosur në Amerikë. Kështu, emigrimi i shqiptarëve drejt SHBA-ve filloi të intensifikohej në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit XIX dhe fillimin e shekullit XX.

Megjithatë, në fund të shekullit XIX, mendohet të mos ketë pasur më shumë se 42 shqiptarë në Amerikë, çka është një numër tejet i vogël për t'u marrë në konsideratë qoftë edhe si një bashkësi. Përkeqësimi i gjendjes nën Perandorinë Osmane dhe mundësitë e mëdha që ofronte Amerika u bënë shumë shpejt të njohura prej atyre që emigruan atje. Natyrisht kolonia më e madhe e vendosur në Amerikë ishte ajo e emigrantëve korçarë të vendosur në New England, Westchester e Boston, në shtetin Massachusetts. Toka përtej Diellit po bëhej gjithnjë dhe më tërheqëse.

Një ndër veçoritë e emigracionit shqiptar në SHBA ka të bëjë me përkohshmërinë e tij. Emigrantët dëshironin të ktheheshin përsëri në atdhe, pasi të kishin bërë ca para. Ndjenja patriotike e shfaqur pikërisht në atë vlug të ringjalljes së dëshirës për pavarësinë e vendit e bashkë me të dashuria për gjuhën, traditat e zakonet ishte krejt unike. Ajo që binte në sy ishte edhe dëshira për të ruajtur të papërzier gjakun dhe familjen. Prandaj shohim se ata ktheheshin në atdhe për t'u martuar, për të lindur fëmijë dhe shtuar familjen shqiptare, sa në njerën anë, po aq edhe në anën tjetër të oqeanit.

Zhvillimi ekonomik dhe transformimi nën ndikimin e këtij emigracioni në zonën e Korçës është i tillë, që e bëri atë një qytet krejt të ndryshëm nga të tjerët. Ai dallohej për kulturën, sjelljet, tregtinë, shkollat, muzikën, fenë, aq sa mund të konsiderohej një pjesë jo vetëm më e zhvilluar, por shumë e shkëputur nga pjesa tjetër e vendit. Ndikimi ishte i dyanshëm. Ishin ata një pjesë e këtyre emigrantëve që krijuan në Amerikë organizatën më të vjetër (që ekziston akoma) Federatën Pan-Shqiptare Vatra, si dhe organin e saj gazetën "*Dielli*". Siç dihet ajo luajti një rol të jashtëzakonshëm në përshpejtimin e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë dhe ruajtjen e shtetit shqiptar. Ndërkohë, ata që u kthyen që andej, si motrat Qiriazi, kompozitori Koço Kota, gazetari Sotir Peçi (botuesi i gazetës së parë në gjuhën shqipe në SHBA në vitin 1908 dhe që më pas u bë Ministër i Arsimit në vitin 1920) e sa e sa të tjerë, i dhanë trajtë tjetër mënyrës se si veprohej e krijohej në Shqipërinë e asaj kohe.

Në studimin e përmendur gjejmë këtë vlerësim për shqiptarët emigrantë në Amerikë:

> Të punojmë sa më shumë që të mundemi, të shpenzojmë sa më pak që të mundemi dhe ta dërgojmë pjesën tjetër në Shqipëri. Ky ishte në ditët e para Trinitriti ynë i Shenjtë.

Sigurisht, Amerika deri në vitin 1917 nuk ishte një shtet që dominonte në politikën ndërkombëtare. Ajo u bë e tillë me fuqizimin e jashtëzakoshëm ekonomik. Me dërgimin e trupave ushtarake amerikane në Europë, për herë të parë në historinë e saj, me 26 nëntor 1917, ajo tregoi se tanimë ishte edhe një fuqi ushtarake që mund të vendoste fatet e luftrave këtej oqeanit. Ky ishte edhe vendimi më i guximshëm që presidenti Wilson

kishte marrë deri atëherë nga zyra ovale. Ai asnjëherë nuk e përmendi mundësinë e zbarkimit ushtarak në Europë, pasi shkonte totalisht kundër tij në planin e brendshëm politik, por befasoi botën me vendimin e tij të guximshëm. “Ky zbarkim përcaktoi fatin e Luftës së Madhe në Europë”.[14]

Ndërkohë që emigrantët shqiptarë shkonin e vinin përtej oqeanit, në Shqipëri u shfaqën banorët e parë amerikanë. Ungjillorët. Ata arritën në Korçë në fillim të viteve 1900 dhe bashkëpunuan me motrat Qiriazi dhe familjen Cilka. Ishin kenedët që u bënë shumë të njohur në atë qytet.

Në Korçë Shoqëria Biblike kishte kohë që e kishte filluar veprimtarinë e saj. Aty përdorej Bibla e përkthyer në gjuhën shqipe me iniciativën e Robert Pinkertonit nga Shoqëria Britanike Biblike shkruar më 28 gusht 1816. Në vitin 1855 Konstandin Kristoforidhi, Aleksandër Thomson dhe Shoqëria Biblike publikuan Biblën e plotë në shqip, në dialektin gegë. Kjo ndodhi për herë të parë në historinë tonë çka e bëri librin e shenjtë të përdorej nga shqiptarët dhe ndihmoi në identifikimin e tyre bazuar në një gjuhë të përbashkët. Më 23 Tetor 1891 Gjerasim dhe Sevasti Qiriazi themeluan të parën shkollë për vajza në Shqipëri, e cila kishte modelin e shkollave të tilla protestante të hapura nën Perandorinë Osmane që nga viti 1800. Më 14 nëntor 1892 Gjerasim Qiriazi me ndihmën e bashkëpunëtorëve të tij themeluan Vllazërinë Evangjelike me qëllimin e vetëm që të zhvillonin dhe përhapnin gjuhën shqipe dhe njohuritë rreth Biblës. E tillë ishte gjendja në Korçën e asaj kohe, kur në vitin 1908 arriti edhe familja prej pesë anëtarësh e Charles Telford Ericksonit.

Ata nuk qëndruan aty, për shkak se gjetën një Korçë shumë më të zhvilluar nga ajo që përfytyronin. Ata ishin në kërkim të një vendi më të pazhvilluar, i cili, siç thotë Ericksoni të plotësonte një standard tjetër, atë që ai më vonë e përshkruan kështu:

> Nëse do të kërkoja një vend, ku të mos kishte asnjë prej elementeve të jetës së rehatshme, kurrë nuk do të kisha gjetur një vend më të mirë se Shqipëria.[15]

Ndikimi i këtij amerikani në historinë e Shqipërisë tashmë është bërë i njohur dhe nuk do të ndalemi aty, por ngjizja, vendosja e themeleve, hapja e udhës së një marrëdhënieje të kombit më të varfër e më të vuajtur të Europës me kombin më të madh dhe më të fuqishëm të globit, që po formësohej, është një rast unik që vlen për t’u studiuar me shumë vëmendje dhe respekt. Ashtu si kish bërë Longfellow me poemën “*Skënderbeg*” disa dhjetëvjeçarë më parë dhe siç do të bënte Bernsteini më pas edhe Ericksoni i kushtoi heroit tonë poemën e mëposhtme:

Skënderbeg[16]

Ti dorën nuk e zgjate drejt skeptrit njollagjak,
As i trishtë nuk kërkove të shprishurën kurorë,
Përballë i dole që vetë të merrje hak,
Ndaj atij tirani djemrrëmbyes e idhnak,
Që dheun tënd kishte shtënë në dorë.

I flake tej nderet e pafundme imperiale,
Dhe lavdinë ndër vite të fituar,
Të mbroje folenë e vendit tënd, trazuar,
Si shqipe-shqiptare gjokszbuluar,
Prej morisë së pafund të shigjetave, i sulmuar.

U zhveshe nga një fe që të kishte ndarë,
Nga shtëpia, babai, nëna dhe altari,
Dhe varrose një dashuri,
Tinëzare, por të bukur, tretur, ëmbëlsi,
Për at' dhe, fe e truall që t' la i pari.

Si dikur Zoti yt, drejt vdekjes t'i shkove,
Ndërsa bota krejt e qetë të kundronte,
Pa luajtur qoftë dhe gishtin për shpëtim,
Pa rrahur një herë duart për tëndin guxim,
Kur kombit tënd si shi gjaku i kullonte.

Shpirt martir, eja prapë dhe hakmerru!
Nga pluhuri ngrije atë flamur, në lartësi!
Bëhu edhe një herë për ne, frymëzim,
Për Kryqin e Ndritur deri në amshim,
Dhe pamjes së largët të Lirisë, silli përjetësi!

Si do të zhvilloheshin ato marrëdhënie, çfarë roli do të luante politika amerikane, në fillim në ruajtjen e integritetit dhe pavarësisë së shtetit shqiptar, në Paris 1919, dhe më pas në zhvillimin e tij ekonomik e arsimor, do ta shohim në vijim të këtij libri.

Për të njohur më mirë Herman Bernsteinin diplomat, do të na duhet të kthehemi në retrospektivë, në një pjesë të dytë të librit, për të parë etapat e mëparshme të jetës së tij. Pas kësaj do të kuptojmë plotësisht vendimin e presidentit Herbert Hoover i cili e emëroi atë në Shqipëri. Pra ai caktoi si përfaqësues të tij një nga njerëzit me përvojën më të

pasur, me emër të madh në gazetari, politikë, art e kulturë, një intelektual *par excellence*, luftëtar i paepur i një çështjeje të madhe, jo vetëm për një komb, por për tërë njerëzimin: hebraizmin.

Tek e fundit, përse një hebre lituanezo – amerikan, kaq i famshëm për polemikat e tij me njërin nga njerëzit më të fuqishëm të botës, industrialistin Henry Ford rreth çështjes hebraike dhe antisemitizmit do të caktohej në Shqipëri? Si është e mundur që në Shqipërinë e vogël dhe aq pa peshë në politikën globale do t'i shërbente Amerikës gazetari që mbuloi Revolucionin e Tetorit e sa e sa ngjarje të mëdha që i kishin ndodhur njerëzimit në fillim të shekullit të njëzetë deri në vitin 1930, kur ai filloi punë si Ministër Fuqiplotë i SHBA-ve në Tiranë? Për të pasur një ide më të gjerë dhe kontekstin e marrëdhënieve komplekse me SHBA-të le t'i kthehemi vetë historisë së marrëdhënieve diplomatike midis vendit tonë dhe atij vendi të madh.

"Në emër të Presidentit Bush dhe në emër të popullit amerikan, kam ardhur në mes Jush për t'ju thënë se liria jep rezultate. Më në fund ju jeni të lirë të thoni atë qe dëshironi. Më në fund ju jeni të lirë të pohoni atë që dëshironi. Më në fund ju jeni të lirë të zjidhni udhëheqësit tuaj dhe më në fund ju jeni të lirë të ushtroni besimin tuaj. Shqipëria ka vendosur të bashkohet me botën e kombeve të tjera të lira. Shqipëria ka vendosur të marrë pjesë në ndërtimin e një Europe të lirë dhe të bashkuar. Shqiptarët kanë vendosur të bashkohen me popujt e lirë kudo".[17]

Vështrim i shkurtër i marrëdhënieve diplomatike shqiptaro – amerikane nga fillimi i tyre deri sot

Marrëdhëniet diplomatike midis Shqipërisë dhe Amerikës fillojnë zyrtarisht në dhjetor të vitit 1922, kur ministri i parë amerikan erdhi në Tiranë. Megjithatë, në kuptimin informal të fjalës ato marrëdhënie mund të konsiderohet se kishin filluar që në kohën e Konferencës së Paqes në Paris, kur Presidenti Wilson këmbënguli fort për ruajtjen e sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Shqipërisë, aq shumë të rrezikuar atë kohë nga shpërbërja, për shkak të lakmive të fqinjve dhe qëndrimeve të fuqive të mëdha të kohës. Është koha kur Presidenti Wilson botoi deklaratën e tij në France Press[18], 24 prill 1919, në të cilën i priste udhën coptimit të Shqipërisë nga fuqitë europiane. Që nga ky moment mund të thuhet se Shqipëria hyri në agjendën diplomatike të SHBA-ve.

Fred Wiliams[19], ambasadori amerikan në Athinë, që mbulonte edhe Malin e Zi, e vizitoi Shqipërinë në vitin 1914 dhe shkroi për të me shumë nderim e keqardhje. Më vonë, në shenjë proteste ai dha dorëheqjen nga posti i ministrit në Athinë.

I pari ministër ose ambasador amerikan në Tiranë ishte Ulysses Grant Smith, i cili u emërua më 22 shtator 1922 dhe shërbeu deri më 8 shkurt 1925. Ai paraqiti letrat kredenciale më datën 4 dhjetor 1922 dhe shërbeu nën administratën e Presidentit Charles Harding. Pas tij vjen Charles Hart, që ushtroi këtë funksion nga 1 gushti 1925 deri më 13 dhjetor 1928. Pas një pauze përfaqësimi të lartë, atë e zëvendëson Herman Bernstein, i cili e mori detyrën më 17 shkurt 1930. Ky i fundit i paraqiti letrat kredenciale te Mbreti Zog më 28 prill 1930 dhe u largua nga posti më 24 shtator 1933. Ai u pasua nga Post Wheeler, i cili u emërua më datën 26 gusht të vitit 1933, paraqiti kredencialet më 28 nëntor të po atij viti dhe u largua nga posti më 1 nëntor të vitit 1934 (Ai ishte një diplomat karriere, i cili kishte shërbyer në vende të rëndësishme si Japonia, Britania e Madhe, Shën Petërburgu në Rusinë cariste, Stokholm, Paraguaj dhe Shqipëri. Njihet gjithashtu edhe për shkrime minore bashkë me të shoqen Hellie Ermenie Rives.).

Pas tij vjen Hugh Gladney Grant, i emëruar më datën 9 gusht 1935, me letra kredenciale të paraqitura më datën 8 nëntor 1935. Ai e përfundoi misionin më 27 shtator të vitit 1939, për shkak të pushtimit italo-fashist të Shqipërisë.[20] Ai ishte një diplomat harvardian jashtëzakonisht i mprehtë dhe i aftë, Prej tij kemi një trashëgimi të jashtëzakonshme dëshmish mbi pushtimin italian të Shqipërisë. Intrigat para këtij akti

dhe pas tij. Raporti i dorëzuar nga ai në Departamentin e Shtetit është dokumenti më autentik, që shpjegon se si ndodhi pushtimi i Shqipërisë. Kjo dëshmi është sjellë kohët e fundit në një botim të mrekullueshëm nga historiani dhe gazetari ynë tashmë shumë i njohur, Ilir Ikonomi, në librin "*Pushtimi*".[21]

Marrëdhëniet diplomatike me SHBA-të përjetuan periudhën më të gjatë të ndërprerjes së tyre me ndonjë shtet në botë e kjo zgjati deri më datën 15 Mars 1991 kur Christopher Hill[22] u vendos në Tiranë si i ngarkuar me punë. Më 1 tetor të atij viti u hap Ambasada Amerikane në Tiranë. Në fakt deri në atë kohë të gjithë përfaqësuesit amerikanë, qoftë para apo pas luftës thirreshin ambasadorë por nuk kishin as tituj as detyra të tilla zyrtare dhe vetë përfaqësia ishte Legatë dhe jo Ambasadë. Me ardhjen e William Edvin Ryerson, përfaqësia u ngrit në nivel ambasade dhe ai shënon emërimin e parë në nivel ambasadori të SHBA-ve në Tiranë. Ai përcolli periudhën e tranzicionit të hershëm të Shqipërisë nga komunizmi në demokraci.

Marrëdhëniet dypalëshe shënojnë një hop të ri të paparë ndonjëherë me vizitën më mbresëlënëse deri në atë kohë, në sheshin Skënderbej, të Sekretarit të Shtetit Bejker më 23 qershor të vitit 1991. Në atë ditë, Sekretari Bejker nëpërmjet përkthimit elokuent të gazetarit legjendar të Zërit të Amerikës, dr. Elez Biberaj iu adresua një turme që mendohet të ketë qenë afro 300.000 vetë:

> Në emër të Presidentit Bush dhe në emër të popullit amerikan, kam ardhur në mes jush për t'ju thënë se liria jep rezultate. Më në fund ju jeni të lirë të thoni atë që dëshironi. Më në fund ju jeni të lirë të pohoni atë që dëshironi. Më në fund ju jeni të lirë të zgjidhni udhëheqësit tuaj dhe më në fund ju jeni të lirë të ushtroni besimin tuaj. Shqipëria ka vendosur të bashkohet me botën e kombeve të tjera të lira. Shqipëria ka vendosur të marrë pjesë në ndërtimin e një Europe të lirë dhe të bashkuar. Shqiptarët kanë vendosur të bashkohen me popujt e lirë kudo.[23]

Më pas në Shqipëri erdhën njëri pas tjetrit ambasadorët Joseph Edward Lake, Marisa Lino, Joseph Limpreht[24], James Franklin Jeffrey, Marcie B. Ries, John L. Withers, Alexandër Arvizu. Në kohën kur u shkrua ky libër Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i SHBA-ve ishte z. Donald Lu.

Kjo listë ambasadorësh jep një pasqyrë serioze të vëmendjes së SHBA-ve ndaj Shqipërisë. Marrëdhëniet me SHBA-të kulmojnë me vizitën historike të Presidentit të SHBA-ve në Tiranë, George W. Bush, i cili "vulosi" anëtarësimin e Shqipërisë në NATO dhe njohjen e pavarësisë së Kosovës, vepër e shumëpritur prej tërë shqiptarëve.

Për t'u theksuar është fakti se Ambasada e SHBA-ve në Tiranë, e inaguruar më datën 27 nëntor 1930[25], është e para ndërtesë në historinë e Amerikës e ndërtuar enkas për ambasadë. Ajo përfshihet në historinë e selive diplomatike të ndërtuara më vonë në shumë vende tjera të botës dhe shquhet si pioniere e këtyre ambasadave për arkitekturën dhe funksionalitetin e saj.

Inaugurimi i saj bëhet pikërisht nga ambasadori Herman Bernstein. Ardhja e një figure kaq të lartë, portreti i të cilit do të shpaloset në këtë libër, duhet të ketë qenë e lidhur me disa arsye, të cilat do të shtjellohen në vijim.

Emërimi i Herman Bernsteinit në postin e Ambasadorit përbën një ndër nderimet më të mëdha që shteti dhe qeveria Amerikane i kanë bërë shtetit shqiptar të kohës. Po ashtu, hebrejtë e Amerikës ndjejnë se ky ishte një vlerësim për ta. Pas ardhjes në Shqipëri shohim se si vetë Bernsteini e vlerëson Shqipërinë dhe shqiptarët dhe vlerësimet e tij janë aq të larta sa sot Pavarësisht distancës kohore ndjehemi krenar për trashëgiminë e tij.

Herman Bernstein, figurë që lidh tre kombe...

Bernsteini hebre... 2

E kam ndjerë si detyrë nderi të ndriçoj ndërlidhjet e bashkësisë hebraike me Shqipërinë nëpërmjet një pune, e cila kap një hark kohor prej më se dy dhjetëvjeçarësh. Në përpjekjet e mia si hulumtues, diplomat, udhëtar, studiues kam ndjerë nevojën e jam munduar ta bëj sa më të njohur këtë histori.

Njeriu i parë që më foli për historitë e hebrejve në Shqipëri ishte John Freely, një amerikano- irlandez, profesor matematike i Universitetit Bosphorus në Stamboll, i cili shkruante libra historie. E takova në fillimin e viteve '90, gjatë shërbimit tim si konsull i Shqipërisë në atë qytet. Ai më tregoi historinë fantastike të Mesias së Rremë (The Lost *Messiah*), Sabbatai Zevi, i cili vdiq në Shqipëri në vitin 1676. Me kalimin e viteve u dhashë shumë pas historisë së hebrejve në Shqipëri, gjë që më bënte të ndihesha krenar për atë çfarë kishte bërë populli ynë gjatë periudhës më të vështirë të historisë për dy palët, edhe për shqiptarët, edhe për hebrejtë, sidomos gjatë periudhës së pushtimit fashist dhe nazist.

As pogrome, as urrejtje, as persekutim, asnjë lloj diskriminimi kundër hebrejve nuk ishte regjistruar në Shqipëri, jo vetëm gjatë kohës së Holokaustit, por as në periudha më të hershme. Edhe pse jemi komb i vogël, kemi një histori të veçantë. Mënyra se si jemi sjellë ndaj hebrejve, dhe jo vetëm ndaj tyre, përgjatë kohërave, përbën një fakt historik me të cilin mund të krenohemi.

Kjo është dhe një ndër arsyet që më çuan të thelloja studimet e mia mbi jetën e Herman Bernsteinit. Duke qenë hebre, ai la një trashëgimi të jashtëzakonshme rreth historisë së pranisë hebraike në Shqipëri, që sipas meje përbën pjesën më tërheqëse në këtë kurs studimor.

Gjithsesi identiteti hebraik i Bernsteinit nuk mund të veçohet nga kontributi i tij si përfaqësues i një kombi të madh, atij amerikan. Vetëm dhjetë vite para se Bernsteini të emërohej në Shqipëri, vendin tonë e kishte mbrojtur Presidenti Wilson. Bernsteini kishte njohje personale me Presidentin Wilson, që kur ai ishte guvernator i New Jersit. Madje, ai kishte organizuar edhe takime të tij me gazetarët më të famshëm të Amerikës në fushatën elektorale të vitit 1912.[26]

Bernstein amerikan... 3

Një ndër veçoritë që duhen vënë në pah më shumë është se ai ishte një mik i ngushtë edhe i Presidentit Hoover. Siç do të shohim, ai kishte kontribuar shumë në zgjedhjen e këtij Presidenti duke mbuluar si gazetar për shtypin amerikan ngjarje të cilat kanë tronditur njerëzimin, siç është revolucioni i sovjetëve. Fjala e tij pati peshë të madhe në zgjedhjen e këtij burri të madh në krye të Shtëpisë së Bardhë, sidomos me botimin e librit *"Njeriu që e solli Amerikën në Botë".*[27]

Së dyti, nga urimet që Bernsteini mori me rastin e emërimit në Shqipëri, do të shohim qartë se ai kishte një ndikim të jashtëzakonshëm te lobi hebraik në SHBA, i cili ka luajtur përherë një rol shumë të rëndësishëm në zgjedhjen e presidentëve amerikanë, të paktën prej asaj periudhe. Duhet thënë se Amerika e atëhershme nuk ishte ajo e sotmja, ku respektohen të drejtat e bashkësive të ndryshme. Gjurmët e antisemitizmit në Europë kishin filluar të shfaqeshin dukshëm. Edhe Amerika vetë, edhe pse vend i formuar nga emigrantët, ka dhënë shembuj që nuk e bëjnë të ndihet mirë në raport me hebrejtë e asaj kohe. Një ndër rastet fatkeqe që e ilustron këtë më mirë është ai i anijes St. Louis.

> Më datën 13 maj 1939, anija transatlantike gjermane e quajtur St. Louis lundroi nga Hamburgu i Gjermanisë drejt Havanës së Kubës. Në anije gjendeshin 937 pasagjerë. Pothuajse të tërë ishin hebrej që po iknin nga Rajhu i Tretë, thuajse të gjithë shtetas gjermanë, disa prej të cilëve nga Europa Lindore, kurse të tjerët

ishin zyrtarisht “pa shtetësi”. Shumica e pasagjerëve hebrej kishin kërkuar vizë amerikane dhe kishin planifikuar të qëndronin në Kubë vetëm deri sa t’u jepej e drejta për të hyrë në Shtetet e Bashkuara. Ndërkohë që anija St.Louis lundronte, kishte shenja se ndryshimi i kushteve politike në Kubë mund të pengonte zbarkimin. Departamenti i Shtetit, Konsullata Amerikane në Havanë dhe disa organizata hebraike në Amerikë ishin në dijeni të situatës. Pasi iu afruan brigjeve amerikane në Florida dhe qëndruan për disa ditë, më datën 6 qershor 1939 ata u kthyen mbrapsht në Europë me anije të vogla drejt vendeve të ndryshme si Franca, Britania dhe vende tjera. Nëse nuk dihet fati i çdo individi të asaj anijeje, fati i hebrejve në vendet europiane deri në fund të luftës së Dytë Botërore tashmë dihet.[28]

Edhe vende të tjera me prirje më të pakta antisemitiste nuk kanë qenë gjithsesi kaq dashamirëse ndaj hebrejve, siç ka ndodhur me Shqipërinë. Mjafton të shihet historia e hebrejve në Angli që të kuptojmë sjelljen e tyre ndaj hebrejve.[29]

Bernsteini, mik i popullit shqiptar 4

Presidenti Hoover, kishte një lidhje shpirtërore me Shqipërinë që në kohën kur ishte sekretar i Tregtisë në Presidencën e presidentit Harding dhe kishte dhënë një donacion prej 10.000 dollarësh amerikanë[30] për Shkollën Bujqësore të Kavajës në kushte anonimati. Ky fakt është zbuluar pas vdekjes së tij dhe të vetë marrësit të donacionit në vitin 1967. Këto marrëdhënie kishin në mes një amerikan tjetër, Charles Telford Erickson, i cili kaloi një pjesë të madhe të jetës së tij në Shqipëri. Vetë Herbert Hoover, ishte një ndër padronët[31] e Shkollës Bujqësore të Kavajës, ndërtuar në vitin 1926.

Bernsteini ishte i njohur si mbrojtës i paepur i çështjes së hebraizmit dhe ndërtimit të një shteti izraelit bashkë me njerëz të shquar nga fora hebraike në botë, përfshirë edhe Ajnshtainin. Ai mendonte të hapte një korridor mbrojtës për hebrejtë e Europës të kërcënuar nga nazizmi, duke i vendosur ata në një masë të caktuar diku në Ultësirën Perëndimore të Shqipërisë.[32] Ky projekt del në pah nga diskutimet e tij me vetë Mbretin Zog dhe trajtohet gjerësisht edhe në këtë libër.[33]

Bernsteini i çmoi lart traditat e mrekullueshme shqiptare, tolerancën fetare, besën shqiptare, hebrejtë dhe trajtimin e tyre. Në këtë kuptim libri do të merret me pesë vitet e fundit të jetës së tij 1930 - 1935, dhe më pas me veprën e tij të shumanëshme, letrare, intelektuale, gazetarinë, librat, përkthimet, polemikat publike, udhëtimet, lidhjet me njerëzit më të famshëm të kohës së vet.

Emërimi i Herman Bernsteinit si Ministër Fuqiplotë në Mbretërinë Shqiptare

Studimi i jetës së Herman Bernsteinit do të ndahet në dy faza. Në pjesën e parë të këtij libri do të trajtojmë periudhën e emërimit dhe ushtrimit të detyrës së tij si Ministër Fuqiplotë në Mbretërinë Shqiptare. Kjo pjesë e jetës së tij është shumë e rëndësishme për ne shqiptarët, për shkak se nëpërmjet të veprimtarisë së tij në Tiranë do të mësojmë disa të vërteta të rëndësishme të vetë ekzistencës së shtetit tonë në atë periudhë. Kjo pjesë do të dëshmojë se çfarë rëndësie kishte ky emërim për Shqipërinë, për Vatrën në Boston dhe për vetë lobin hebraik në SHBA-të e asaj kohe. Më tej ajo do të na japë një tablo shumë të qartë të rëndësisë që kishin marrëdhëniet midis vendit tonë dhe SHBA-ve në atë kohë, frymën miqësore që ekzistonte dhe sa lart e ngriti atë frymë Bernsteini, sa lart i çmoi ai traditat e mrekullueshme shqiptare, tolerancën fetare, besën shqiptare, hebrejtë dhe trajtimin e tyre. Pra, në një kuptim libri do të merret me pesë vitet e fundit të jetës së tij 1930-1935, dhe më pas me veprën e tij të shumanshme pararendëse, letrare, intelektuale, gazetarinë, librat, përkthimet, polemikat publike, udhëtimet, lidhjet me njerëzit më të famshëm të kohës së vet.

Biografia e Bernsteinit mund të gjendet lehtë në enciklopedinë hebraike, në internet apo në arkiva të tjera. Por ndoshta më e mira do të ishte të sillnim para lexuesit se si e ka përshkruar jetën e tij gazeta Dielli e Bostonit, organ i Federatës Pan – Shqiptare të Amerikës, Vatra, më 30 mars 1930. Vatra, e cila kishte vepruar si "*qeveri shqiptare në mërgim*", e priti emërimin e tij me gëzim të veçantë, siç vihet re nga njoftimi i botuar për në gazetën "*Dielli*"[34]:

Ministri i ri i Amerikës

Herman Bernstein lindi më 21 shtator 1876 në Vladislavov sipas rusishtes, Neustadt – Schirmwindt, në gjermanisht, ose Naishtot në hebraisht, në atë kohë një vend në kufirin midis Gjermanisë dhe Rusisë, sot territor lituanez.

Ai është i biri i David dhe Marie Bernsteinit. Në moshën 6-vjeçare prindërit e tij lëvizën në Mohilev mbi lumin Dnjepër, sot territor Bjellorus. Në vitin 1893 emigroi bashkë me familjen në Shtetet e Bashkuara ku kreu edhe studimet.

Bernsteini filloi të botonte artikuj nëpër gazeta që në vitin 1900. Ai shkruajti për "New York Evening Post", "The Nation", "The Independent", dhe "Ainslee's Magazine".[35] Ai

themeloi gazetën “The New London Day”, u bë botues i “The Jewish Tribune” dhe asaj “Jewish Daily Bulletin”. Si korrespondent i “New York Times”, Bernsteini udhëtoi rregullisht në Europë. Në vitin 1915 shkoi në Europë për të parë në terren situatën e hebrejve në zonat e luftës. Më pas ai mbuloi si gazetar Revolucionin Socialist të Tetorit të vitit 1917 për gazetën amerikane “New York Herald”, çka e çoi atë drejt Siberisë dhe Japonisë me forcat amerikane të ekspeditave. Ai hartoi artikuj mbi Konferencën e Paqes në Paris në vitin 1919, për të njejtën gazetë.

Gjatë udhëtimeve Bernsteini mori intervista nga disa prej njerëzve më të shquar të Europës, përfshirë Kontin Witt, Metchenikoff, Bergson, August Rodin, G.B Shaw, Tolstoin dhe mblodhi materialin e librit “Me mendjendriturit” botuar në vitin 1912.

Në kohën e Luftës së Përbotshme puna e tij në gazetarinë amerikane pati rëndësi të veçantë. Pasi bëri një studim mbi gjendjen e popullit izraelit në shtetet ku bëhej lufta më 1915-1916, ai u dërgua në Rusi më 1917 prej gazetës “The New York Herald”, që të përshkruajë revolucionin. Në këtë mënyrë ai përshkroi përmbysjen e absolutizmit carist dhe themelimin e qeverisë së sovjetëve.

Duke përfituar nga hapja e arkivave të kohës së regjimit të qeverisë provizore të Rusisë, ai gjeti një korrespondencë të gjatë të letërkëmbimit mes Kaiserit të Prusisë dhe Carit të Rusisë, në kohën e luftës ruso - japoneze. Ky zbulim shkaktoi një bujë të përgjithshme për shkak të natyrës së tyre komplotuese e tepër konspirative. Gjithashtu e njejta gazetë e dërgoi në Japoni, Siberi dhe Çekosllavaki. Në vitet 1918 dhe 1919 ai ishte korrespondent i veçantë në Konferencën e Paqes në Paris. Më 1920 - 1921 The New York Times e ngarkoi të mbulonte shtetet e reja që dolën nga Traktati i Versajës.

Bernsteini ka shkruar një libër vjershash me titull “Fluturimi i Kohës” (1889) një vëllim përrallash të shkurtëra “Në Portën e Izraelit”(1902) dhe shumë të tjera. Në vitin 1928 shkroi librin “Njeriu që e solli Amerikën në Botë – Herbert Hoover”. Bernsteini ka përkthyer vepra të Tolstoit, Gorkit, Andrejevit, Çehovit e të tjerë. Ai është edhe polemist i madh i çështjes hebraike kundër Henri Fordit.

DIELLI

EKSELENCA E TIJ MINISTRI I RI I AMERIKES NE SHQIPERI

5 Foto Faqja ballore e gazetës “Dielli” e cila njofton emërimin e Herman Bernsteinit në Tiranë

6 Herman Bernstein në portën e Legatës Amerikane në Tiranë, 1931

Arkiva e INSTITUTIT Të KËRKIMEVE Hebraike YIVO Institute of Jewish Research përmban 23 milionë tituj, ku përfshihen koleksione zanore, arti dhe teatri dhe regjistrime personale, fotografi dhe filma, dorëshkrime, ditare, kujtime, korrespendencë personale etj. Libraria YIVO ka rreth 400.000 vëllime në të gjitha gjuhët europiane dhe përmban koleksionin më të madh të librave, pamfleteve dhe gazetave, në gjuhën hebraike, në botë. Ajo është e vetmja arkivë dhe bibliotekë e paraluftës që i ka mbijetuar Holokaustit. Në këtë arkivë gjendet koleksioni i Herman Bernsteinit, i cili përbën një pjesë të mirë të lëndës së parë të këtij libri.

Instituti i Kërkimeve Hebraike YIVO në New York

Vepra e Herman Bernsteinit gjendet në arkivën e Institutit të Hulumtimeve Hebraike YIVO, në New York. YIVO është një institut hulumtimesh, qendër e lartë edukative, organizatë kulturore, bibliotekë e njohur në tërë botën dhe një arkivë me pasuri të jashtëzakonëshme. Misioni i saj është të ruajë, studiojë, përhapë dhe përjetësojë dijenitë mbi historinë dhe kulturën e hebrejvë lindorë, kudo që ata gjenden sot. Ajo është themeluar në Berlin dhe në Vilnus, Lituani në vitin 1925, quhej fillimisht Instituti Hebraik Shkencor. Hapjen e saj e mbështetën intelektualët më të shquar, përfshirë Ajnshtainin dhe Sigmund Freud- in. Ajo ishte vendosur në Vilnus nga viti 1925, derisa u detyrua nga Lufta e Dytë Botërore të zhvendosej në New York. Aty e ka qendrën që nga vitit 1940. Arkiva bashkë me bibliotekën e YIVO-s përfaqësojnë koleksionin e vetëm dhe më të madhin në botë me materiale të qytetërimit hebraik të Europës Lindore. Ajo pret mbi 5.000 vizitorë, e-maila dhe kërkesa telefonike në vit. Arkiva e YIVO-s përmban 23 milionë artikuj, ku përfshihen koleksione zanore, arti dhe teatri dhe regjistrime personale, fotografi dhe filma, dorëshkrime, ditare, kujtime, korrespondencë personale dhe shumë më shumë.

Libraria YIVO ka rreth 400.000 vëllime në të gjitha gjuhët europiane, përfshirë edhe shqipen, dhe përmban koleksionin më të madh të librave, pamfleteve dhe gazetave në gjuhën hebraike, në botë. Ajo është e vetmja arkivë dhe bibliotekë e paraluftës që i ka mbijetuar Holokaustit. Materialet që gjenden aty ishin plaçkitur prej nazistëve, por disa i shpëtuan luftës dhe u kthyen tek YIVO. Libra dhe dokumente të tjera u gjetën disa dhjetëvjeçarë më vonë në Lituani. Në vitin 2015, YIVO njoftoi nisjen e një projekti 7-vjeçar për digjitalizimin e miliona faqeve të dokumenteve dhe librave. Enciklopedia free – online YIVO është më e madhja në botë me mbi 180.000 vizitorë në vit. Në këtë arkivë gjendet koleksioni i Herman Bernsteinit, i cili përbën një pjesë të mirë të lëndës së parë të këtij libri.

Për hartimin e këtij libri janë shfrytëzuar materiale nga arkiva e Departamentit të Shtetit Amerikan, arkiva e Shtetit Shqiptar, Bibliotekat Publike si ajo e New Yorkut dhe British Library. Gjithsesi, baza e dokumentacionit mbetet arkiva e YIVO-s. Dëshirën për të hartuar një lloj bibliografie të materialeve të YIVO-s e "*shuajti*" një dokument i botuar në gazetën "Dielli", nga intelektuali i shquar shqiptaro – amerikan, gazetari i njohur i Zërit të Amerikës dhe studiuesi e politologu i njohur dr. Elez Biberaj[36]. Në një shkrim me titull "Koleksioni i Herman Bernsteinit për Shqipërinë[37]", dr. Elez Biberaj shkruan**:**

> Ky koleksion përfaqëson një burim të vlefshëm për studiuesit e interesuar për zhvillimet e Shqipërisë në fillimin e viteve 1930. Ai është relativisht i pasur dhe përbëhet nga tetëmbëdhjetë dosje të vendosura në katalogë, sipas subjekteve që përmbajnë. Ai përmban informacion interesant mbi aktivitetin e Bernsteinit në Shqipëri, marrëdhëniet e tij me shumë shqiptarë, intervista me burrështetas dhe një dorëshkrim bibliografik për Mbretin Zog si dhe informacion tjetër përkatës. Ambasadori Bernstein duket se ka qenë shumë i interesuar rreth Shqipërisë dhe historisë së saj. Ai shkroi disa artikuj për luftën e shqiptarëve për mbijetesë në një vend sovran. Gjatë qëndrimit të tij në Shqipëri ai u bë një figurë shumë e njohur dhe mik i ngushtë i shumë shqiptarëve përfshirë Mbretin Zog, Faik dhe Mehmet Konicën. Kjo është reflektuar në shumë shkëmbime që ai kishte me vëllezërit Konica..

Sipas një artikulli në gazetën Vatra (Tiranë) më 19 shtator 1933, ambasadori Bernstein ka bërë një hulumtim për heroin kombëtar Skënderbeg, i cili përmban 25 faqe testament[38]. Ai përmban ideologjinë e tij të përgjithshme për shtetin dhe këshillën që i dha djalit të tij në kohën kur ai vdiq (Dosje nr. 760). I njëjti artikull na zbulon se biri i ambasadorit, David Bernstein, kishte shkruar një baladë mbi Skënderbeun, ndërsa vajzat e tij Dorothy Nash dhe Violet Wilhelm shërbyen si mësuese të thjeshta pa pagesë në Shkollën Teknike Shqiptare. Për më tepër, znj. Nash ka përkthyer nga gjermanishtja në anglisht novelën e Fabian Barcatës bazuar në një temë të jetës shqiptare, me titull "*Lule".*[39]

Koleksioni përmban edhe përkthimin në anglisht të bërë nga Dorothy Nash dhe vetë Herman Bernsteini, të veprës dramatike të shkruar prej Aleksandër Moisiut në vitin 1931, të dramës së quajtur "*I burgosuri*" vepër në 94 faqe (Dosja nr. 971).

Shkolla teknike shqiptare, e cila ishte organizuar prej Kryqit të Kuq Amerikan, luajti një rol të rëndësishëm në përgatitjen e kuadrove shqiptarë. Aty gjendet informacion i rëndësishëm rreth aktiviteteve të instituteve, siç janë Instituti Amerikano – Shqiptar (Dosjet nr.668 – 691). Baza e korrespondencës së Bernsteinit (Dosjet nr. 758-59) kanë të bëjnë me funksionet sociale dhe nuk kanw aq shumë të bëjnë me Shqipërinë. Aty gjendet një letër e shkruar me dorë nga at Gjergj Fishta, dërguar Bernsteinit bashkë me një kopje të Kanunit të Lekë Dukagjinit, vepër e at Shtjefën Gjeçovit (Dosja nr. 758). Aty gjendet edhe një letër e 10 marsit 1934 dërguar nga Kol Kuga[40]. Midis të tjerave, Kuga e njofton Bernsteinin se në dhjetor të vitit 1933, Mbreti Zog kishte dërguar tremijë franga ari për peshkopin Fan Noli, kundërshtari i tij i jetës, pasi që, sipas Kugës:

> ….Noli kishte rënë papritmas i sëmurë nga pneumonia e dyfishtë në Boston, ndërkohë që nuk kishte asnjë grosh në xhep. Ai i dërgoi një telegram kishës në Shqipëri dhe ishte refuzuar (Peshkopi Visarion thotë se ai kurrë nuk e ka marrë atë telegram). Më pas ai i adresohet qeverisë por nuk mori përgjigje. Ishte vetë

> Mbreti Zog që i dërgoi atij tremijë franga ari. Kuptohet që pranimi nga ana e Nolit i kësaj shume i tërboi shqiptarët e Amerikës deri në atë masë sa, refuzuan t'i paguanin rrogën që merrte nga kisha. Noli i dërgoi një telegram at Vasil Markut të Korçës, ku i shpjegonte nevojën e jashtëzakonshme, në të cilën kishte rënë dhe i kërkonte menjëherë ndihmë Parlamentit Shqiptar, që t'i lidhte një pension.

Në një kopje të telegramit, at Marku thotë se Mbreti ishte gati të tejkalonte çdo kufi për të ndihmuar Nolin. "Mbreti dëshiron që Noli të kthehet në atdhe por kjo mund të bëhet vetëm në formën e një kërkese të parashtruar nga Noli dhe jo si një ofertë e dhënë nga Mbreti." (Dosja nr. 758).

Në dosjen nr. 760 gjenden një seri gazetash mbi marrëdhëniet e jashtme të Shqipërisë, disa prej të cilave të shkruara nga vetë ambasadori Bernstein. Aty gjendet një raport mbi peligrinazhin e tij në kishën e Gjon Vladimirit në Elbasan dhe një fjalim i kryepeshkopit Visarion si dhe një shkrim i gazetës "Dielli" për emërimin e Bernsteinit. Veç asaj, aty gjendet edhe një dokument i vjetër në turqisht, i cili flet për bashkësinë hebraike në shekullin e shtatëmbëdhjetë. Dokumenti sqaron se në Elbasan nuk kishte hebrej të vendosur si banorë, por vetëm si tregtarë që jetonin aty përkohësisht.

Me përkeqësimin e pozicionit të hebrejve dhe ardhjen në fuqi të Hitlerit, Bernsteini mori përsipër të bisedonte me Mbretin Zog çështjen e vendosjes së një numri të madh hebrejsh si emigrantë në Shqipëri. Si rezultat i këtyre diskutimeve, në qershor të vitit 1933 ai u dërgoi një ftesë zyrtare biznesmenëve hebrej të vendoseshin në Shqipëri dhe u premtoi "të ndihmonte me çdo mjet sipërmarrjet tregtare të ndërmarra nga të ardhurit e rinj, të tillë[41]". Më datën 29 gusht 1934, një zyrtar shqiptar në një dokument të nënshkruar e informon Bernsteinin rreth mundësisë së vendosjes së hebrejve në Shqipëri.

Koleksioni i Bernsteinit përmban informacion të rëndësishëm mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me Italinë dhe varësinë e saj kronike nga ndihmat e huaja. Në një letër të datës 28 maj 1930 H.T. Fultz, i cili drejtonte Shkollën Teknike, i raporton ambasadorit të sapoemëruar në Shqipëri, një memorandum marrëveshjeje për ndihmat që i ofronte Italia Shqipërisë dhe një bisedë që kishte bërë me një ministër shqiptar të paidentifikuar. Ai përmend bisedën shumë miqësore që ministri kishte pasur me të dhe që i kishte thënë se Shqipëria i kishte jetike ndihmat e huaja dhe se, tani për tani, e vetmja ndihmë që merrte Shqipëria, vinte nga Italia.

Aty gjendet edhe një raport konfidencial i datës 3 shtator 1930, i ambasadorit Bernstein pas një vizite në shtëpinë e dr. Terenc Toçit, i cili hedh edhe më shumë dritë mbi varësinë e Shqipërisë nga Italia. Ai thotë se Shqipëria është në prag të shkatërrimit dhe se është shumë kritik ndaj Zogut, i cili i ka orentuar marrëdhëniet vetëm drejt Italisë, duke injoruar Greqinë dhe Jugosllavinë dhe se "*Mbreti është i rrethuar nga dhjetë ose dymbëdhjetë vetë që e keqorientojnë atë"*.

Një prej dokumenteve më të rëndësishme të koleksionit është një material në shtatë

faqe, i cili përmban intervistën që Mbreti Zog i ka dhënë gazetarit amerikan Powell[42].

Intervista duhet të jetë dhënë në fillimin e vitit 1931. Në këtë intervistë Mbreti Zog shpreh pikpamjet e tij për ekonominë shqiptare, bujqësinë, si dhe marrëdhëniet e vështira të Tiranës me Beogradin dhe Athinën. Në lidhje me Athinën, Mbreti shënon tri çështje kryesore:

- Fyerjet greke ndaj shpalljes së pavarësisë së Kishës Autoqefale Shqiptare, të Kishës Kombëtare Ortodokse të Shqipërisë.
- Dështimin e qeverisë së Greqisë për të hapur shkolla në zonat e minoritetit që jeton në Greqi
- Çështjen e pasurive tokësore të shqiptarëve në Greqi, të cilat janë shpronësuar pa asnjë kompensim.

Mbreti Zog në lidhje me këtë shton:

> Situata e minoritetit shqiptar në Greqi është e vajtueshme. Atje nuk ka qoftë edhe një shkollë të vetme për minoritetin shqiptar të Greqisë. Ministri i Jashtëm grek në përgjigje të demarshit tonë në Athinë thotë se në Greqi nuk ka shqiptarë, pasi ata janë të gjithë turq.
> Shqipëria dhe Greqia kanë shumë arsye të kultivojnë marrëdhënie më të mira. Këto të dyja janë kombet më të vjetra ballkanike. Asnjëri prej këtyre dy kombeve nuk janë sllavë as latinë. Interesat e tyre janë të përbashkëta dhe ato shkojnë paralel me njëra- tjetrën. Kjo pikë është theksuar në mënyrë të përsëritur prej udhëheqësve të lëvizjes kombëtare shqiptare në fund të shekullit të 19-të dhe të shek 20-të.

Duke u kthyer te marrëdhëniet me Beogradin, Mbreti Zog akuzon Jugosllavinë për shtyrjen e Shqipërisë drejt një aleance me Italinë, duke nxitur Dukagjinin që të ngrihen në revoltë në vitin 1926.

Në një dokument të shkruar nga Sir Robert Hodgson, ambasadori Britanik në Shqipëri në atë kohë, në një bisedë me Bernsteinin shpreh një ide të njejtë me atë të Mbretit Zog:

> Jugosllavët janë vërtet përgjegjës pse Mbreti Zog u kthye nga ata. Ata besonin se meqenëse e ndihmuan Zogun të kthehej në Shqipëri nga Beogradi, do të kishin kontroll absolut mbi mbretin dhe e bënë këtë aq hapur, sa praktikisht e detyruan të binte në krahët e italianëve.[43]

Duke u kthyer tek intervista e Mbretit Zog me gazetarin Powell, Mbreti Zog kritikon shumë ashpër qëndrimet jugosllave ndaj një trajtimi çnjerëzor të shqiptarëve. Ai deklaron:

> Qeveria jugosllave po bën gjithçka për çkombtarizimin e rajoneve të populluara

> prej shqiptarësh që prej kohësh, që nuk mbahen mend. Popullata shqiptare është shpërngulur nga Kosova në Kroaci dhe gjetkë, ndërsa malazezë dhe sllavë të tjerë janë sjellë dhe vendosur në fshatra, të cilat janë krejtësisht të banuara nga popullsi shqiptare paralel me vijën e kufirit mes Shqipërisë dhe Kosovës, me qëllim prishjen e strukturës etnike krejt shqiptare të asaj ane. Për 700.000 shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi nuk ekziston qoftë edhe një shkollë e vetme, ku të mësohet gjuha shqipe. Por, në fakt, të gjitha këto nuk janë asgjë po të krahasohen me barbarizmat, që ushtrohen ndaj shqiptarëve. Raportet nuk pushojnë së sjelluri informacion rreth masakrave dhe persekutimit. Thënë thjesht, kjo është një politikë shfarosëse. (Dosja nr. 750).

Në një dokument tjetër pa datë, Mbreti Zog pranon hapur natyrën e marrëdhënieve me Italinë. Ai paralajmëron se një krisje e thellë midis Tiranës dhe Romës është krejt e mundshme për shkak se "midis Musolinit dhe meje jo gjithmonë gjërat janë të bazuara në logjikë, por gjithashtu në ndjenjë. Në Amerikë, për shembull, Presidenti zgjidhet nga populli, dhe e merr pushtetin nga populli. Prandaj në punën e tij ai është i varur nga populli dhe i duhet të bëjë atë që don populli me logjikë dhe kujdes. Musolini nuk e ka marrë pushtetin nga populli, prandaj edhe i merr vendimet pa pyetur anëtarët e kabinetit të tij. Po kështu bëj edhe unë. Kështu që ne i marrim vendimet jo bazuar në logjikë dhe kujdes, por bazuar në impulse dhe ndjenjë. Në kushte të tilla një trazirë midis Italisë dhe Shqipërisë është krejt e mundshme.". (Dosja 760)

Pas një pike kritike midis Italisë dhe Shqipërisë, Tirana tentoi t'i rregullonte marrëdhëniet me Beogradin, në mënyrë që të lehtësonte sado pak varësinë nga Roma. Në një letër të datës 1 dhjetor 1933, dërguar nga Mehmet Konica, ky i fundit e informon ambasadorin Bernstein për përfundimet e një traktati tregtar të lidhur me Beogradin dhe marrëdhëniet e ngushta midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë (Dosja 750).

Në një letër tjetër të datës 25 shtator 1934, Mehmet Konica vë re pakënaqësinë në lidhje me përmirësimin e marrëdhënieve midis Tiranës dhe Beogradit dhe presionin, që Italia ushtron ndaj Shqipërisë, e cila kulmoi me arritjen e Flotës italiane në Durrës. Qeveria shqiptare, sipas Konicës, ishte e vendosur t'i rezistonte presionit Italian.

Flota ishte vendosur në Gjirin e Durrësit ndërkohë që trupat qeveritare ishin vënë në gatishmëri në kodrat e Rrashbullit. Qeveria e Tiranës deklaroi se nuk hynte në asnjë negociatë me italianët. Konica zbulon gjithashtu se në ditën e arritjes së flotës italiane, në veri të Shqipërisë ishte përgatitur të shpërthente një kryengritje. Italianët hodhën shuma të mëdha parash për shuarjen e kryengritjes (Dosja nr 750).

Koleksioni i Bernsteinit përmban edhe një jetëshkrim të Ahmet Zogut, shkruar në një letër të hollë si cipë qepe. Ai përbëhet nga 14 kapituj dhe titullohet: "Jeta e Mbretit Zog, ashtu siç e tregon ai në vetën e tretë" dhe përfshin jetën e tij që nga fëmijëria, studimet në Konstandinopojë e deri në kohën, kur ai e rrëfen jetën para ambasadorit Bernstein.

Në dosjen nr. 829 (prej 255 faqesh) jepet një përshkrim me komente i Kanunit të Lekë

Dukagjinit, si dhe marrëdhëniet midis të krishterëve dhe paganëve në Shqipëri.

Në mbyllje aty gjendet një koleksion fotografish shumë të bukura të Aleksandër Mosiut, Avni Rustemit, Hasan Prishtinës, Bajram Currit, Beqir Valterit, Fan Nolit, Luigj Bumçit, at Gjergj Fishtës, një kongresi në Trieste në vitin 1913, foto të Mbretit me Bernsteinin dhe anëtarë të kabinetit të tij qeveritar.

Në dosjen nr. 938 gjendet një zarf me fotot e plota të ekspeditës arkeologjike italiane. Këto duhen hulumtuar nga arkeologët tanë si një dëshmi mjaft e rëndësishme të gërmimeve të bëra në atë kohë.[44]

Kjo panoramë e materialeve të Herman Bernsteinit në arkivën e YIVO-s, përbën edhe pjesën, e cila i kushtohet jetës së tij si diplomat amerikan në Tiranë, veprimtarisë dhe përshtypjeve të tij për popullin shqiptar. Ato përshtypje ai i ka shprehur gjatë qëndrimit në vendin tonë dhe pasi u largua.



7 Gjatë prezantimit të jetës së Herman Bernstein në YIVO Institute of Jewish Research në New York, 14 dhjetor 2014.

Herman Bernsteini është i pari udhëheqës hebre që ndërmerr rrugën e diplomacisë. Me përjashtime të rralla, vetëm individë të pasur mund të emëroheshin për rangje ambasadoriale. Edhe pse Shqipëria është gati sa New Hampshire dhe Vermonti, emërimi i Bernsteinit është një vlerësim shumë i madh politik, që i është dhënë dikujt, pjestar e kësaj bashkësie, në historinë e Amerikës.

Gëzim në qarqet hebraike – amerikane

Emërimi i Bernsteinit në Shqipëri ka pasur jehonë shumë pozitive në qarqet hebraike të Shteteve të Bashkuara. Si një figurë shumë e njohur e hebraizmit, një emërim i tillë u mirëprit në mënyrë masive. Në të vërtetë, parë nga këndvështrimi ynë, emërimi i tij ishte një propagandë shumë e madhe për Shqipërinë, e cila shquhej për miqësinë me SHBA-të. Komentet, shkrimet, telegramet, letrat e dërguara vetë atij, por edhe të vendosura në faqet e shtypit amerikan, i kanë bërë një nder shumë të madh Shqipërisë së asaj kohe.

Për të pasur një ide më të qartë mbi reagimin hebraik në SHBA për emërimin e Herman Bernsteinit si Ministër Fuqiplotë në Shqipëri, le të shohim se si e trajton atë një nga kronikat më të mëdha hebraike në SHBA.

> Emërimi Ministër Fuqiplotë i z. Bernstein ka sjellë reagim shumë pozitiv në botën hebraike të SHBA - ve" - Jewish Criterion.[45]

Po ashtu, gjenden materiale se si shumë hebrej të shquar, të pasur dhe me ndikim në Amerikën e asaj kohe, e mbështetën emërimin e tij:

1. Herman Bernsteinit i është ofruar posti i Ministrit në Legatën Amerikane në Tiranë nga Presidenti Herbert Hoover. Botuesihebraik do të jetë në udhëtim për në mbretërinë e vogël në buzë të Adriatikut diku nga pranvera. Lajmi se Herman Bernstein, një prej emrave më popullorë në gazetarinë ndërkombëtare do të përfaqësojë Amerikën si diplomat në një vend të huaj, ka ngjallur ndjenja të mira anë e mbanë.
2. Domethënia e kësaj zgjedhjeje e tejkalon së tepërmi rëndësinë politike të një posti diplomatik. Kjo përbën një zhvendosje të pikëpamjes zyrtare të Washingtonit, sepse Bernsteini është i pari hebre rus, i lindur dhe i edukuar në Rusi, që i bëhet një nder i tillë.[46]
3. Ka pasur edhe ambasadorë të tjerë hebrej, pa dyshim. Në administratat e tjera republikane apo demokrate, posti i ambasadorit konsiderohej një post për hebrejtë. Strauses, Morgenthaux dhe Elkus janë provë e pamohueshme se nuk ka paragjykime raciale në shërbimin diplomatik amerikan. Presidenti Hoover është megjithatë i pari President Amerikan, i cili ka emëruar brenda një mandati në zyrë tre hebrej për të përfaqësuar SHBA-në jashtë vendit. Zgjedhja

> e Gugenheimit dhe Ratschevskit, respektivisht në Kubë dhe Çekosllovaki, përbën një kënaqësi të përgjithshme në botën hebraike të Amerikës, e pranuar tashmë si realitet. Të dy këta zotërinj janë njerëz të rëndësishëm në fushën e financave dhe kanë pasur ndikim të madh në politikën amerikane për shumë vite. Kontaktet e tyre hebraike, megjithatë kanë qenë sa për sy e faqe dhe interesi i tyre në çështjet hebraike ka qenë i natyrës filantropike.[47]

Herman Bernsteini është i pari udhëheqës hebre që ndërmerr rrugën e diplomacisë. Le të mos harrojmë gjithashtu se Herman Bernsteini është i pari përfaqësues i hebrejve intelektualë të Amerikës që ka depërtuar në botën politike dhe një prej të paktëve udhëheqës kulturorë amerikanë që është zgjedhur për një nder të tillë.

Me përjashtime të rralla, vetëm përsonazhe të pasur konsideroheshin për rangje ambasadoriale. Këtu, përsëri Herman Bernsteini përbën përjashtim me librin e tij "Herbert Hoover, njeriu që e solli Amerikën në botë", shkruar në vitin 1928. Këta tituj librash thjesht vendosin gurët më të rëndësishëm të punës së tij letrare dhe japin prova të ndershmërisë dhe guximit të këtij shkrimtari, i cili ka fuqinë e çuditshme të vëzhgimit si karakteristikë të tij mbizotëruese.

Edhe pse Shqipëria është gati sa New Hampshire dhe Vermonti,[48] emërimi i Bernsteinit, për aq sa bota hebraike është e interesuar, është nderi më domethenës politik që i është dhënë dikujt nga kjo bashkësi në historinë e Amerikës.

Duke studiuar për Herman Bernsteinin për shumë vite, kam parë përparimin e pandryshueshëm të karrierës së tij si një autor dhe si udhëheqës. Biografia e tij është e njohur shumë mirë në botën hebraike të Amerikës. Faza prej gazetari e jetës së tij përfshin disa shkrime të bujshme në fushën e medies së shkruar amerikane. Ajo që Northcliffe e përshkruan si "skupin më të bujshëm" të luftës, ishte vënia në gjetja dhe publikimi në vitin 1917 prej tij i një serie telegramesh, të cilat ishin shkëmbyer midis ish-Kaizerit dhe Carit të fundit, duke zbuluar faktin se dy autokratët kishin diskutuar një rifigurim të fuqive të botës në dëm të Britanisë së Madhe dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Përveç përfaqësimit në kohë të ndryshme të gazetave NewYork Times, New Herlad, York Sun, The New York American dhe Seven Arts Feature Syndicate si korrespendent i posaçëm europian, z. Bernstein ka dhënë prova si themelues gazetash duke ngritur The New York Day, e cila përbën një standard të ri në fushën e gazetarisë së shkruar në Jidish. Duhet thënë gjithashtu se z. Bernstein ka mbajtur gjithmonë marrëdhënie të ngushta dhe ka shfaqur interes të veçantë në shtypin anglo-jidish, duke drejtuar shtypin amerikano-hebraik për një kohë të gjatë, ndërsa gazetën Jidish Tribune, që nga viti 1923, deri në vitin 1929. Veprimtaria e tij letrare është shumëplanëshe për t'u përmendur në detaje. Ai ka përkthyer

dhe përshtatur drama të shkruara nga dramaturgët më të shquar rusë dhe gjermanë. Shumë prej këtyre dramave janë botuar në formë librash dhe shumë të tjera janë përgatitur për botim.

Herman Bernsteini ka publikuar gjithashtu disa libra ndër të cilët "The Flight of Time" (Fluturimi i kohës, libër me poema), "In the Gates of Israel" (Në portat e Izraelit, histori të shkurtra), "Contrite Hearts" (Zemra të penduara, novelë), "Celebrities of Our Time" (Njerëz të shquar të kohëve tona), "The Road to Peace" (Rruga drejt paqes, dy vëllime intervistash), "The History of a Lie" (Historia e një gënjeshtre, ekspozim i të ashtuquajturës "Protokolli i Pleqësisë së Zionit) dhe "Herbert Hoover, Njeriu që e solli Amerikën në Botë". Sa i takon shërbimit publik, Herman Bernsteini ka pjesën e tij në çfarëdo lloj ngjarjeje, që lidhet me komunitetin hebraik të kohës së vet.

Ka pak njerëz të cilët të pretendojnë se kanë formimin kulturor të Ministrit të ri që shkon në Shqipëri. Me të vërtetë nuk ka njeri të kohës së tij që të ketë pasur kontakte me një numër kaq të madh njerëzish të dorës së parë të shkencës, politikës, artit sa Herman Bernstein.

Posti ministerial të cilin Herman Bernsteini do të ketë në një vend të vogël si Shqipëria, ndoshta kurrë nuk do ta vendosë në qendër të vëmendjes së politikës botërore, duke marrë parasysh faktin se kryeqyteti shqiptar është vetëm disa orë larg nga qyteti fatal i Sarajevës. Mund të ketë keqardhje në shumë qarqe pse Bernsteini nuk është zgjedhur për të përfaqësuar Amerikën në Çekosllovaki , duke pasur parasysh miqësinë e tij personale me Benes dhe Masaryk, të cilët do e kishin mbajtur atë si njeriun e logjikshëm, për të ushqyer ndjenjat e mira midis Shteteve të Bashkuara dhe Republikës së Çekisë. E megjithatë emërimi i Herman Bernsteinit do të pritet më gëzim të sinqertë në të gjithë Amerikën, sepse ky emërim shënon përfundimisht ardhjen në vendin që i takon një emigranti hebre nga Rusia, për më tepër që karriera diplomatike e z. Bernstein sa po fillon. Me siguri që do të dëgjojmë edhe më shumë prej tij në të ardhmen.[49]

Pra shohim që hebrejtë e Amerikës e konsideruan si nder i madh, që po iu bëhej me emërimin e Bernsteinit, Ministër Amerikan në një Mbretëri të një vendi europian. Kështu vijojnë konsideratat me ente të tjera botuese dhe individë të ndryshëm në tërë Amerikën.

Alfred Cohen, Botues i B'nai B'rith Magazine[50]

Kjo është një revistë shumë prestigjoze e hebrejve. Drejtuesi i revistës i drejtohet Bernsteinit me fjalët më të përzemërta për emërimin e tij në Shqipëri si Ministër dhe i uron që hyrja në karrierën diplomatike t'i hapë rrugë të reja për pozita më të larta në

jetën e tij. Në letrën, botuar më datën 4 shkurt 1930 në këtë gazetë kombëtare të përmuajshme në Cincinnati ai shkruan:

> Unë u takoj atyre pak njerëzve në këtë vend që e dinë se ku gjendet Shqipëria. Gjeografia ime e përshkruan atë si vend piktoresk, vend i egër i banuar prej një populli luftarak. Çfarë shërbimi të mrekullueshëm do t'i bëni njerëzimit duke civilizuar vendin dhe duke i edukuar njerëzit. Nëse do të udhëtoja në Europë, unë sigurisht që do përfitoja nga ai rast që t'ju vizitoj.

Më poshtë autori i letrës i kërkon Bernsteinit që të vazhdojë bashkëpunimin dhe t'i dërgojë artikuj nga Shqipëria, të cilët do të ishin me interes sidomos nëse kanë lidhje me historinë e hebrejve në atë vend. Pastaj ai i kërkon leje që të vendoset në skenë një dramë gjermane e përkthyer në anglisht nga Bernsteini, të cilit i kërkohet e drejta e autorit, pasi drama ishte pritur me entuziazëm shumë të madh nga Yidish Art Theater.

Leon Savage Këshilltar juridik, New York

Në letrën e tij përshëndetet emërimi i Bernsteinit në detyrën e lartë të Ministrit Amerikan në Shqipëri dhe thuhet se zgjedhja që ka bërë Presidenti është për t'u përshëndetur, po të mbahet parasysh se Bernsteini është personi që i shkon aq shumë detyrës së vështirë të përfaqësimit të Amerikës në një vend të një rajoni të vështirë, siç është Gadishulli Ballkanik.

> Që nga Tirana ju do të kujdeseni edhe për stabilitetin e atij rajoni...
> Nuk dua ta teproj me lëvdata, por më lejoni t'u them se i njoh dijenitë tuaja për politikën ndërkombëtare. Prezantimi që ju do t'i bëni parimeve të idealizmit amerikan nuk do t'i shërbejnë vetëm Shqipërisë, por edhe vetë lindjes, paqes në botë dhe në veçanti Ballkanit, një rajon i njohur për trazirat e përhershme.

Zyra e Rabinit Samuel Schulman, Temple Emanu-El, New York [51]

Rabini Schulman e uron Bernsteinin në emër të komunitetit të hebrejve, që ai përfaqëson në New York City, duke përshëndetur njëkohësisht edhe presidentin Hoover për vendimin që ka marrë, për të caktuar një njeri me aq emër të madh në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe një përfaqësues të shquar të hebrejve të Amerikës. Ky është pikërisht shpërblim për veprën e shquar të Bernsteinit nga ana e presidentit.

> Një njohje e tillë ka ardhur prej shkrimeve tuaja dhe ne mezi presim miratimin e Senatit amerikan. (Leonard Aberman, 31 janar 1930.)

Charles Schwager, New York[52]

Si një nga përfaqësuesit e njërës prej kompanive më të mëdha të sigurimeve, Schwager i shkruan Bernsteinit se si admirues personal i tij, sapo ka mësuar me gëzim të madh për emërimin në Shqipëri. Ai thotë se, ndonëse nuk është poet, emërimin e Bernsteinit në Tiranë do ta përshendeste me vargje. Vjersha e tij ka një formë thuajse si bejtet në shqip, me shumë kuptim, me një rimë dhe metrikë të rregullt:

Sjellja jote njerëzore kujt'do i bie në sy,
Prandaj Herbert Hooveri të zgjodhi ty.
Pozita jote si Ministër në Tiranë do nderuar,
Dhe ky nderim s'do ketë kurrë të mbaruar.

Me përshëndetje sioniste,
Charles Schwanger, 8 shkurt 1930

Henry Van Dyke, Princeton

I dashur z. Bernstein,
Ishte kënaqësi e veçantë të merrja letrën tuaj të datës 12 dhjetor. E di që ju po shkoni i fortë në Shqipëri. Jam i lumtur që mora miratimin tuaj dhe komentin e shkurtër që bëtë për çmimin Nobel për Letërsi.
I kujtoj me kënaqësi librat tuaj mbi jetën hebraike. Ato janë plot me të vërteta, të cilat përfshijnë edhe të mirat edhe të këqijat në natyrën tonë të përzier dhe ndërluftuese njerëzore.
Ju uroj suksese në detyrën e re si diplomat dhe në misionin tuaj.

Henry Van Dyke[53] 30 dhjetor 1930

Bernsteini e ruan korrespondencën me Van Dyke edhe gjatë misionit në Tiranë. Ai i shkruan në prill të vitit 1931 nga Legata Amerikane në Tiranë, duke i thënë se sa shpesh i kujton miqtë e tij në Amerikë dhe se sa mirënjohës është ndaj atyre që i dhanë mbështetje për të fituar besimin e presidentit Hoover për emërimin e tij në këtë post.

Ai po ashtu i dërgon një libër këtij kolosi të kulturës amerikane me titull "*Mendimet e Arta*". Ndërkohë, Bernsteini i flet atij për një ngatërresë midis Theodore Drajzerit dhe Sinclair Lewis, të cilët kishin botuar të dy materiale me të njejtën përmbajtje, në një shkrim me rreth 3000 fjalë. Bernsteini i gjykon ata duke thënë se të dy kanë përdorur të njëjtat mjete propagandistike sovjetike.[54]

The New York Times, gazeta më prestigjoze dhe më e madhe në botë, i shkruan

Bernsteinit më 8 shkurt 1931[55] për emërimin e tij në Shqipëri. Gazeta i drejtohet me një kompliment për njohuritë e Bernsteinit rreth Lindjes së Afërme dhe shprehet besimplotë si ai do të ketë sukses në detyrën e tij të re.

Ai merr gjithashtu letra urimesh nga Federata e Hebrejve Polakë në Amerikë, nga dr. Mordecai Soltes, edukator dhe anëtar i Bordit Kombëtar për Mirëqënien e Hebrejve, dr. Seymour F. Wilhelm, Organizata e Hebrejve Rumunë të Amerikës, avokati i shquar i kohës në New York, Nathan Natelson etj.

Darkë e lobit hebraik në New York për nder të emërimit të Herman Bernsteinit në Mbretërinë Shqiptare

Herman Bernsteini, gazetari i mirënjohur dhe autori i shumë librave ishte natën e kaluar mysafir në një darkë të shtruar në Hotelin Astor për të nderuar emërimin e tij nga ana e presidentit Herbert Hoover, si Ministër Fuqiplotë në Shqipëri. Shumë hebrej të njohur si filantropë, drejtues organizatash civile dhe lokale ishin të pranishëm. Otto A. Rosalsky e drejtoi mbrëmjen dhe ngriti dollitë e rastit.[56]

...Në anën tjetër të atij Mali gjendet Kruja, vend i Skënderbeut, Gjergj Kastrioti, i cili luftoi për pavarësinë e shqiptarëve në shekullin e pesëmbëdhjetë. Ai nuk ishte vetëm ushtar i madh dhe çlirimitar, por, po të gjykojmë nga testamenti i të birit të tij, ishte edhe një burrë shteti i mençur dhe parashikues. Që populli i tij e nderon atë si perëndi, mund të mësohet edhe nga fakti se edhe pas 400 vjetësh pas vdekjes shumë shqiptarë ende veshin rroba të zeza në shenjë zie për heroin e tyre kombëtar.

Tirana, siç e shihte Herman Bernstein nga dritarja e zyrës së Tij [57]

Bernsteini e filloi punën si Ministër Fuqiplotë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës me

vrullin e një njeriu me shumë përvojë dhe entuziazëm. Pa hyrë në elementet e punës së tij të përditshme, të rutinës së shërbimit diplomatik, le të shohim se si e përshkruante ai Tiranën e atyre viteve, për të kuptuar se sa shumë i gëzohej ai punës që bënte.

Në një parathënie të botuesit të artikullit "Tirana siç e shoh nga dritarja e zyrës sime" thuhet se *"kur presidenti Hoover emëroi Herman Bernsteinin si Ministër Amerikan në Shqipëri, shumë lexues të tij thanë: Çfarë duhet të jetë ai vend? Si është ai vend? Zoti Bernstein, të cilit Shoqata jonë Pen i detyrohet kaq shumë për historitë e tij brilante dhe artikujt gazetareskë, na ka dërguar këtë përshkrim të këndshëm të Shqipërisë, që provon se Herman Bernsteini diplomat, nuk e ka vënë në hije Bernsteinin shkrimtar. Ne e botojmë këtë artikull si kortezi të "The American Foreign Service Association"*[58] *me titull*

"Shqipëria një vend magjepsës"

Nga dritarja e Legatës së re Amerikane në Tiranë, njeriut i shfaqet një pamje magjepsëse dhe e çuditshme tek e cila sheh një pikturë të jetës shqiptare në tërë ngjyrat dhe format e saj të larmishme. Për kopshtin e Legatës përkujdeset një kopshtar shqiptar, i cili thotë se ka punuar në pallatin e vjetër të Sulltanit në Konstandinopojë, si dhe një ish oficer rus i arratisur për të shpëtuar nga dhuna bolshevike. Ky ka shërbyer me forcat e Vrangelit dhe pastaj ka ardhur në Shqipëri me një ushtri të vogël të drejtuar nga Ahmet Zogu, kur ai u kthye në fuqi pas mërgimit të tij në Beograd. Pak më tutje, tek porta e Legatës qëndron shtëpiza e dy kafazëve të Legatës, Sulejmanit dhe Rasimit, të dy shqiptarë të cilët kanë kaluar disa vite në SHBA. Sulejmani, veçanërisht, ndihet me fat, jo vetëm se punon në Legatën Amerikane, por edhe se është babai krenar i pesë djemve. Vajzat kërkojnë pajë, kur martohen në Shqipëri, ndërsa djemtë pajën e mbajnë te prindërit.

Përpara portës së Legatës tani është rruga që të çon nga Durrësi në Elbasan dhe Korçë. Durrësi, buzë Adriatikut është porti më i rëndësishëm i Shqipërisë. Qyteti, tani i vogël, një herë e një kohë ka qenë qendër tregtare që lidhte Perëndimin me Lindjen. I ndërtuar rreth 700 vite përpara erës së re, Durrësi i njohur në të kaluarën si Durrahium dëshmoi skena të lavdisë, beteja të përgjakshme, konflikte midis ushtrive të Qezarit e Pompeut dhe të Kryqëtarëve, në rrugën e tyre drejt Tokës së Shenjtë. Besohet se atje, gjithashtu, në brigjet e Adriatikut Shën Pali predikoi krishtërimin.

Rruga e re e Elbasanit që po mbaron tani, të çon në Korçë, një prej qyteteve më të përparuara dhe më moderne të Shqipërisë. Kjo vjen për shkak të ndikimit të shqiptarëve, të cilët kanë emigruar në SHBA dhe që kthehen në Korçë, pasi të kenë siguruar pasuri materiale të konsiderueshme dhe të kenë përfituar mënyrën dhe zakonet e Amerikës. Disa kthehen për vizita në vendin e tyre të lindjes dhe sjellin me vete konceptet amerikane të biznesit, metodat e kultivimit të tokës dhe një standard më të lartë jetese, i cili është prezantuar gradualisht në atë zonë.

Për vite të tëra Korça ka marrë sasira të mira parash nga shqiparo-amerikanët. Kjo është arsyeja pse Amerika është kaq popullore në Shqipëri. Shqipëria është po ashtu mirënjohëse Presidentit Wilson për mbrojtjen që ai i bëri Shqipërisë në një moment kritik të jetës së saj, në Konferencën e Paqes në Paris. Arsye të tjera të mirënjohjes shqiptare ndaj Amerikës janë shkollat amerikane në Tiranë dhe Kavajë, të drejtuara nga Kryqi i Kuq Amerikan dhe Fondacioni i Lindjes së Afërt. Lufta kundër malarjes është ndërmarrë nga Fondacioni Rockefeller.

Përtej rrugës së Elbasanit, nga dritarja jonë ballore, mund të shohësh një fushë të gjerë, baraka, ushtarë që shpojnë në tokë, kuaj, lopë, dele, që kullosin – skena të ushtrimeve ushtarake të përziera me idile pastorale të paqes. Disa herë dëgjoj kërcitjen e një mitralozi që jehon në male dhe, fill pas, dëgjoj barinjtë, duke luajtur pjesë melodioze me fyejt e tyre ose fshatarë, duke kënduar këngë orientale, kur kalërojnë kuajt e tyre të vegjël, apo edhe gomerët. Aty këtu shoh shtëpitë e reja të zyrtarëve dhe fisnikëve shqiptarë të shpërndara. Disa prej legatave do të ngrihen në anën tjetër të Legatës Amerikane. Në një distancë të shkurtër shoh kodrën, në të cilën do të ndërtohet së shpejti një pallat i ri i Nanës Mbretëreshë.

Pasi kthehem përsëri te dritaret në të djathtë, shoh krejt qytetin e Tiranës. Ai është kryeqyteti i Shqipërisë, i emëruar pas Teheranit rreth 300 vjet më parë. Shoh tufat e deleve të bardha e të zeza, buajt, lopët, selvitë, xhamitë, minaret e bardha, të holla e të larta. Pastaj vjen pallati modest i Nanës Mbretëreshë dhe i pesë princeshave, motrave të Mbretit Zog. Më tej gjendet burgu i ri, ndërtesat edhe më madhështore ministeriale, dhe Bashkia në qendër të Tiranës; pallati i vjetër i Mbretit Zog, i vetmi Mbret në Europë, i cili është ngritur në fuqi si i biri i një çifligari të njohur malësor, që luftoi për vendin e tij në moshë të re, e më pas mbajti postin e Ministrit të Brendshëm, Kryeministrit, Presidentit dhe që në vitin 1928 shpallet Mbret prej Asamblesë Kushtetuese.

Udhëheqësi i Bijve të Shqipes, siç thirren shqiptarët, është një djalë i gjatë, i hollë, inteligjent, 36-vjeçar. Ai mbahet me dinjitet të lartë e prapëseprapë me një thjeshtësi mbresëlënëse dhe të përmbajtur. Dritat e Tiranës shndrisin gëzueshëm në mbrëmje dhe e bëjnë kryeqytetin të duket shumë më i madh se ç'është në të vërtetë. Në ditët e festave kombëtare rrugët, Kulla e Sahatit dhe minaretë dekorohen me flamuj kombëtarë kuq e zi dhe me shumë ndriçues elektrikë shumëngjyrësh.

Nga dritarja e pasme shoh Alpet e purpurta shqiptare. Në të rënë të diellit shndrit maja e Malit të Dajtit, të mbuluar me dëborë. Shpeshherë shoh aeroplanë që kalojnë mbi kokën tonë. Shoh shqiponja tek fluturojnë, borë majë malesh, gjethnajën e gjelbër në fund të malit. Në kopshtin tonë trëndafilat çelin që në dhjetor.

Rreth e rrotull, shoh disa shtëpi të ulëta të mbuluara me tjegulla të kuqe si në

ngjyrë ari, të vendosura në mënyra të lezetshme nën hijen e një reje, që po bie mbi mal dhe herë pas here ylberë të ndritshëm shumëngjyrësh që harkojnë Malin e Dajtit.

Në anën tjetër të atij mali gjendet Kruja, vend i Skënderbeut, Gjergj Kastrioti, i cili luftoi për pavarësinë e shqiptarëve në shekullin e pesëmbëdhjetë. Për shumë vjet ai qëndroi fitimtar ndaj turqve. Skënderbeu është përshkruar në veprën e Longfellowt, "Përrallat e bujtinës ndanë udhës". Ai nuk ishte vetëm ushtar i madh dhe çlirimitar por po të gjykojmë nga testamenti i të birit të tij ishte edhe një burrë shteti i mençur dhe parashikues. Që populli i tij e nderon atë si perëndi, mund të vërtetohet edhe nga fakti që edhe pas 400 vjetësh, pas vdekjes së tij, shumë shqiptarë ende veshin rroba të zeza në shenjë zie për heroin e tyre kombëtar.

Nga dritarja në të majtë shoh rrugën gropa-gropa të Elbasanit, Rruga famshme romake Via Egmatia, e cila në ditët e hershme të kohës së Krishtërimit të çonte nga Durrësi në Selanik. Shoh në faqen e kodrës një teqe bektashinjsh të braktisur, e rrethuar me pemë. Poshtë saj është një kasolle që tani përdoret si kafe për romët. Ata kërcejnë, këndojnë dhe luajnë me zë të lartë të çuditshëm, shpesh duke kaluar tërë natën e gjatë, sidomos gjatë muajve të verës dhe vjeshtës. Shumë burra e gra që kalojnë në Rrugën e Elbasanit janë zhelanë dhe këmbëzbathur. Nganjehërë ata veshin kostume të qendisura hijshëm me ornamente të bukura dhe shenja të këndshme. Ka raste, kur shoh ndonjë grua që mban djepin me fëmijë kokë - mbuluar. Herë tjetër shoh tek kalon aty pari një grua me duvak hipur në gomar që mban fëmijën e vet në krahë dhe një çadër të hapur në dorën tjetër, jo për t'u mbrojtur nga shiu, apo dielli i fortë përvëlues, por si një shenjë dalluese e myslimanëve shqiptarë. Shoh një procesion të gjatë gomerësh, kuajsh, mushkash, buajsh, qesh, veçanërisht të enjteve, kur fshatarët përreth vijnë në tregun e Tiranës. Kafshët janë të vogla dhe të liga; gratë dhe burrat janë të hajshëm, të drejtë, me sy që iu lexohet vuajtja, që rrallë qeshin, shpesh tek këndojnë vajtueshëm me zërat, që iu ngjasin zileve, hoxha i gjatë që kalon hypur në një gomar me këmbët që i varen dhe shkunden me ritmin e ecjes së tij, gati deri në tokë. Njerëzit, ndonëse supersticiozë, prapëseprapë nuk njohin konflikte që të kenë ndodhur në Shqipëri. Krerët e myslimanëve, katolikëve dhe orthodoksëve jetojnë në harmoni dhe ndjekësit e tyre falen në vendet e lutjeve të njeri-tjetrit.

Jashtë dritareve të Legatës shoh një Tiranë që po rritet, kryeqytetin e njerëzve të shqipes që po përftojnë format moderne, njerëz që adaptojnë mënyrat përparimtare të perëndimit, që iu vijnë nga jashtë. Vendi mban një pozitë të rëndësishme në Adriatik. Në Shqipëri edhe Lindja edhe Perëndimi i rrudhin krahët, si në pak vende të tjera. Gratë shqiptare mbahen nën kujdes të madh prej burrave. Një grua që udhëton e vetme është e sigurtë, kudo që të shkojë në

> Shqipëri. Nuk ka burrë që të ndihet i kërcënuar nga hakmarrja, nëse është i shoqëruar nga një grua. Mikpritja proverbiale dhe sensi i nderit nuk janë përkeqësuar në procesin e marshimit të shpejtë të vendit drejt modernizimit.
>
> Turistët, vëzhgues të skenave të habitshme dhe shumë të bukura të kostumeve të veçanta, të gjitha të ndryshme nga njëra-tjetra, do të zbulojnë këtë tokë të panjohur europiane. Nëse ata e vonojnë vizitën e tyre në Shqipëri, atëherë do jetë tepër vonë. Shumë prej gjërave më të magjishme të Shqipërisë janë në zhdukje, duke i hapur udhën veshjeve pa përmbajtje të jetës moderne. [59]

Çdokush që e lexon këtë artikull të shkruar nga ky diplomat kupton se si thuajse e njejta histori e njohjes, propagandimit dhe tërheqjes së vizitorëve të huaj në Shqipëri vazhdon edhe sot. Viteve të fundit është folur shumë për kompani të huaja, të cilat dëshirojnë të investojnë në Shqipëri, sidomos në turizëm. Ideja se ata do të tërheqin vizitorë drejt Shqipërisë, duke e konsideruar atë *"Cepin e fundit të pazbuluar të Europës Juglindore",* besojmë *se* ka qenë synimi kryesor i ambasadorit amerikan Herman Bernstein, përkrah shumë gjërave të tjera që ai bënte për Shqipërinë dhe marrëdhëniet e vendit të tij të adoptuar, Amerikën, me vendin tonë. Shqipëria ka ndryshuar aq shumë e megjithatë, koncepti i Bernsteinit për ta bërë atë tërheqëse mbetet edhe sot një detyrë parësore e diplomacisë shqiptare.



8 Bernstein në ditën e paraqitjes së letrave kredenciale tek Mbreti shqiptar, Zogu i I – rë.

9 Bernstein i përcjellur nga Mbreti Zog.

10 Mbreti Zog përcjell Ambasadorin Bernstein pas dorëzimit të letrave kredenciale

Respekt i veçantë i Bernsteinit për Shqipërinë

Respekti i Herman Bernsteinit për Shqipërinë nuk shfaqej vetëm në punët e tij zyrtare dhe detyrimet, që kishte në postin e numrit një të Ambasadës Amerikane në Tiranë. Ai e shpreh këtë edhe në jetën e tij private. Në telegramin e mëposhtëm, dërguar Departamentit të Shtetit vihet re një akt i rrallë, ndoshta edhe i vetmi, një precedent siç e quajnë atë, kur një fëmijë kryediplomati të martohet në mjediset e Ambasadës së një vendi tjetër. Dhëndrri ishte francez, ndërsa ceremonia drejtohej nga kryetari i Bashkisë së Kryeqytetit, ku është e akredituar Legata, pra në Tiranë.

Vajza e Herman Bernsteinit martohet në Legatën Amerikane në Tiranë [60]



11 Familja Bernstein ne Tiranë. Në mes Joicy e vogël e cila kur u shkrua ky libër jetonte në Virginia, ShBA.



12 Zonja Sofie Bernstein 13 Vajzat e Bernsteinit Dorothy dhe Violet 14 Bernstein me të birin Davidin

.

Dorothy Jean Bernstein, vajza e Herman Bernsteinit, Ministër Amerikan në Shqipëri, gazetar dhe botues i njohur, u martua të dielën me Actius Nash, student mjekësie në një universitet francez. Ceremonia do të mbahet në mjediset e Legatës Amerikane dhe shënon një precedent të rrallë në këtë drejtim. Rexhep Jella, Kryebashkiaku i Tiranës do të udhëheqë ceremoninë.

Kam zgjedhur këtë Ditë të Falënderimeve për t'ia kushtuar Legatës së Re Amerikane në Tiranë. Fakti që Shtetet e Bashkuara kanë ndërtuar këtë Legatë tregon qartë, nga njëra anë, besimin që ato kanë dhe, nga ana tjetër, simpatinë dhe interesin ndaj Pavarësisë së Shqipërisë, populli i së cilës ka luftuar dhe punuar me kaq kurajë për pavarësinë kombëtare që nga ditët e heroit të tyre të shkëlqyeshëm kombëtar, Skënderbeut. Ky është një vend i vogël, shumë i bukur, i popullluar prej një race të lashtë e të guximshme.

Dita e falënderimeve festohet edhe në Tiranë
E enjte, 27 nëntor 1930

Bernsteini në vitin e parë të punës së tij në Mbretërinë Shqiptare, pati fatin të inauguronte Legatën e Shteteve të Bashkuara në Tiranë, e cila ka një vlerë të jashtëzakonshme historike. Në atë festë inaguruese mori pjesë edhe Madhëria i Tij, Mbretit Zog i I. Bernsteini foli me pasionin dhe elokuencën e tij për Shqipërinë dhe marrëdhëniet midis dy vendeve. Atë ditë të enjte të Ditës së Falënderimeve të datës 27 nëntor 1930 ai iu drejtua pjesëmarrësve me një fjalim shumë të bukur:

> Në këtë ditë Falenderimesh, gjej rastin të kujtoj me një ndjenjë të thellë mirënjohjeje arritjet e jashtëzakonshme humanitare të Presidentit tonë, i cili në bashkëpunim me burra të tjerë shtetesh largpamës, si brenda, ashtu edhe jashtë vendit, ka punuar me kaq shumë zell dhe zgjuarsi për përparimin e mirëkuptimin midis kombeve në rrugën drejt një paqeje të qëndrueshme. Ndërsa është e vështirë të thuhet se shpirti i luftës është çmobilizuar midis shteteve, po aq e vërtetë është se në çdo komb mbi këtë tokë elementet, të cilët orvaten dhe punojnë për paqen janë gjithnjë në rritje edhe në numër edhe në ndikim. Burra e gra të të gjitha kombeve, parashikojnë dhe vlerësojnë bekimin e paqes, jo vetëm si një perceptim të madh moral abstrakt, por edhe si një përparësi për zhvillimin e dobishëm të individëve dhe kombeve dhe që veprojnë me arsye, fuqishëm dhe pa frikë, për fuqizimin e instrumenteve përfitues të paqes. Ata janë arkitektët e vërtetë të një të ardhmeje më të lumtur, veçanërisht për gjeneratat që vijnë, një e ardhme e shpresës, në vend të dëshpërimit të errët, një e ardhme konstruktive e

bashkëpunimit fqinjësor, e cila sigurisht që nxit zhvillimin kulturor dhe material të mirëqenies në vend, zbut dyshimin e ndërsjelltë dhe frikën, e cila më pas ushqen shkatërrimin moral dhe rënien e shpejtë ekonomike.

Për fat të mirë, duket se ka shenja të pagabueshme të progresit në këtë udhëtim drejt paqes. Kam zgjedhur këtë Ditë të Falënderimeve për t'ia kushtuar Legatës së Re Amerikane në Tiranë. Kjo është e para Legatë e ndërtuar nga Qeveria Amerikane në tokë të huaj nga fondet e siguruara prej Porter Billit, për ndërtimin e Ambasadave Amerikane, Legatave dhe Konsullatave në vende të ndryshme.

Fakti që Shtetet e Bashkuara kanë ndërtuar këtë Legatë tregon qartë, nga njëra anë, besimin që ato kanë dhe, nga ana tjetër, simpatinë dhe interesin ndaj pavarësisë së Shqipërisë, populli i së cilës ka luftuar dhe punuar me kaq kurajë për pavarësinë kombëtare, që nga ditët e heroit të tyre të shkëlqyeshëm kombëtar, Skënderbeu.

Ky është një vend i vogël, shumë i bukur, i populluar prej një race të lashtë e të guximshme. Dihet shumë pak për Shqipërinë. Për fat të keq, shumë informacione jo miqësore e çorientuese qarkullojnë jashtë vendit. Pavarësia e Shqipërisë, e cila do të festohet nesër, është e dashur për çdo shqiptar. Rendi dhe qetësia, të vendosura nën drejtimin e mençur të Madhërisë së Tij, Mbretit Zog, kanë shtruar rrugën për zhvillimin dhe përparimin e vendit. Në një atmosferë paqeje dhe mirëkuptimi fqinjësor populli shqiptar mund ta bëjë vendin e tij të begatuar nëpërmjet vendosmërisë dhe punës së vështirë e të harmonizuar.

Lumturia kombëtare, këtu dhe kudo tjetër mund të arrihet nëpërmjet paqes, rendit të brendshëm, zhvillimit kulturor dhe material dhe mirëqënies së siguruar prej punës së palodhur.

I dëshiroj Shqipërisë bekimet e lumturisë kombëtare me gjithë zemër. [61]

Në një dokument pasues të raportit të dhënë për Departamentin e Shtetit, Legata Amerikane në Tiranë, pasi raporton fjalimin e Ministrit Bernstein, shkruan edhe për rëndësinë që Madhëria e Tij, Mbreti Zog i kishte kushtuar hapjes së Legatës me pjesëmarrjen e tij personale. Kjo gjë shënonte në fakt dy ngjarje.

E para, ishte selia e parë amerikane e ndërtuar jashtë Amerikës dhe e dyta pjesëmarrja për herë të parë e Mbretit në një ceremoni të organizuar nga një Legatë e huaj në selinë e saj. Kjo tregon se sa të rëndësishme po bëheheshin marrëdhëniet me Amerikën për Mbretin dhe qeverinë e tij. Fjalimi ishte në fakt një kombinacion i përshëndetjes së presidentit Hoover në Ditën e Falënderimeve dhe opinioneve të vetë Ministrit Bernstein. Në po të njejtin raport përmendet ndihmesa e organizmave amerikane të mbështetura nga Fondacioni i Lindjes së Afërt, Fondacioni që financonte Shkollën Bujqësore të Kavajës, sot Shkolla Bujqësore Charles Telford Erickson, Kryqin e Kuq Amerikan dhe Fondacionin Rockefeller, i cili luftonte malarjen në Shqipëri.

Në këtë ceremoni bie në sy edhe fjalimi i Ministrit Britanik në Tiranë, Sir Robert

Hodgson, i cili ishte edhe Dekani i Trupit Diplomatik në Tiranë. Ai nënvizon faktin se sa shumë kishte bërë Amerika për paqen në botë dhe nevojën e krijimit të një klime paqësore në botë. Në atë natë inagurimi, ku merrnin pjesë rreth 150 vetë, mbajti një fjalim edhe kryetari i Bashkisë së Tiranës të asaj kohë, zoti Rexhep Jella,[62] i cili përmendi ndihmën amerikane për Shqipërinë dhe shqiptarët.[63]

Vetëm një ditë më vonë, 28 nëntor 1930, gazeta New York Times boton një artikull informativ lidhur me inaugurimin e kësaj ambasade.

Është e qartë se ishte autoriteti i Bernsteinit dhe lidhjet e tij me shtypin amerikan, që e bënte atë të kishte atë kredi, sa të botonte artikuj edhe për ngjarje që mund të konsiderohen mjaft periferike. Ai kishte gjetur një element që përbënte lajm:

> Legata Amerikane në Tiranë u inagurua nga Ministri Amerikan Herman Bernstein në praninë e Mbretit Zog, kabinetit të tij ministror, trupit diplomatik të akredituar në Tiranë si dhe miqve të Ambasadës. Kjo ishte vizita e parë që Mbreti Zog bënte në ndonjë Ambasadë. Legata Amerikane në Tiranë është e para në botë e ndërtuar nga qeveria Amerikane me atë që quhet American Goverment Under Porter Bill, - thuhet në artikullin e gazetës New York Times.

Po kjo gazetë e përcakton këtë ngjarje si: "*"Ngjarja më piktoreske e ndodhur kohëve të fundit në Ballkan.".*

Inaugurimi i Legatës Amerikane në Tiranë raportohet edhe në Departamentin e Shtetit, një ditë pas ngjarjes me një kabllogram në të cilin thuhet:

> Në ditën e festës amerikane të Falënderimeve, më datën 27 nëntor 1930, Legata e Re Amerikane në Tiranë u inagurua prej Ministrit Herman Bernstein, në prani të Mbretit Zog I, anëtarëve të Qeverisë së tij dhe trupit diplomatik, si dhe bashkësisë së vogël amerikane në Shqipëri.
>
> Legata e re ndodhet në dalje të qytetit, në rrugën e Elbasanit, rreth një çerek milje larg nga qendra e Tiranës. Ndërtesat shohin nga jug-perëndimi, në drejtim të një vargu kodrash të mrekullueshme mbi njërën prej të cilave do të ngrihej pak kohë më pas Pallati Mbretëror i Zogut.
>
> Legata amerikane është e para ndërtesë vërtet moderne në Tiranë. Populli aty ka treguar kërshëri të madhe për komfortin që mbart ajo, përfshirë sistemin e ngrohjes dhe frigoriferët elektrikë. Për më tepër, ngritja e kësaj ndërtese ka inkurajuar edhe shtete të tjera të bëjnë të njejtën gjë, si Britania, Italia dhe Franca, të planifikojnë për ndërtimin e Legatave të tyre.[64]

dalëngadalë arka e Shenjtit bëri tre rrotullime rreth kishës në krahët e njerëzve. Ata që patën mundësi ta preknin arkën ishin më të lumturit por shumë prej tyre nuk arritën. Të krishterë dhe muhamedanë njëlloj ishin aq të lumtur që kishin arritur ta bënin këtë. Ata ndjenin se kishin siguruar shëndetin dhe fatin e mirë të paktën për një vit deri sa të vinte procesioni tjetër. Ata ishin aq të sigurt tani, sa në mendjet e tyre do të mbretëronte shëndeti dhe fati.

Toleranca fetare në Shqipëri e përshkruar nga Bernsteini

Një ndër cilësitë fisnike që Bernsteini vë re te shqiptarët është toleranca fetare, bashkëjetesa në paqe dhe mirëkuptim, madje kremtimi i përbashkët i njerëzve me përkatësi të ndryshme fetare në një qendër kulti. Askush më mirë se Bernsteini nuk do ta përshkruante dhe ta ilustronte këtë fakt në Ditën e Shën Gjon Vladimirit në fshatin Shijon në Elbasan.

Peligrinazh i Herman Bernsteinit te Manastiri i Shën Gjon Vladimirit

Më 5 qershor 1931, Ministri Bernstein bën një peligrinazh në Kishën e Shën Gjon Vladimirit në Elbasan. I gjithë peligrinazhi përshkruhet në një raport të dhënë Departamentit të Shtetit nga vetë Ambasadori. Ky material jep shumë informacion të asaj kohe për Kishën Orthodokse Shqiptare, për bashkëjetesën fetare, paragjykimet e bestytnitë. Kreu i Kishës Autoqefale të Shqipërisë, Visarioni, është në qendër të këtij informacioni. Për fat të keq këtë personalitet të kishës e shohim më vonë në përbërjen e grupit shqiptar që shkoi në Romë dhe i dorëzoi kurorën mbretërore Viktor Emanuelit të Tretë.[65]

Ky shkrim ka rëndësi të madhe për të parë se sa thellë në kohë shkon harmonia fetare midis shqiptarëve dhe a është një dukuri që u kultivua pas kthimit të Shqipërisë në një vend ateist, apo ishte në ADN-në tonë. Ajo që Bernsteini përshkruan në këtë material

vërteton të dytën, prandaj edhe njohja me këtë shkrim të tij është e rëndësishme. Ka shumë teoricienë të kohës sonë, të cilët e lidhin harmoninë tonë fetare me faktin që për rreth 23 vjet Shqipëria u bë vendi i vetëm ateist në botë. Sipas apologjejve të kësaj teorie, ndjenjat fetare u zhdukën dhe kjo solli harmoninë fetare. Përshkrimi i Bernsteinit, në kohën kur ushtrimi i besimit fetar në Shqipëri ishte më i lirë se kurrë, vërteton të kundërtën. Manastiri gjendet në dalje të Elbasanit, sapo merr rruga e vjetër Elbasan – Krrabë – Tiranë, në të djathtë. Ai gjendet në fshatin Shijon, i cili duhet ta ketë marrë emrin pas shkurtimit të emrit Shën Joan. Ja si përshkruhet nga Legata Amerikane pelegrinazhi tek Kisha e Shën Gjon Vladimirit:

Ministri Bernstein mori një ftesë nga Kryepeshkopi Visarion, Kreu i Kishës Ortodokse, për të vajtur te Manastiri i Shën Gjon Vladimirit në Elbasan[66] në ditën e festës së Shenjtit. Bernsteini e përshkruan atë udhëtim dhe pelegrinazh si më poshtë: [67]

> Më 5 qershor në orën shtatë të mëngjesit kortezhi u nis nga Tirana për te Manastiri. Ata morën rrugën e re nëpër Qafën e Krrabës, rrugë e cila kalon pranë Legatës Amerikane. Grupi përbëhej nga vetë Bernsteini, Ministri Jugosllav Djonovitch, i ngarkuari me punë i Çekosllavakisë dr. Vokatch, zoti dhe zonja Voukotitch nga Legata Jugosllave, z. Ristitch, po nga ajo legatë, atasheu i shtypit z. Plamenac dhe dragomani i Legatës Amerikane z.Kuqali.
>
> Rruga në Qafë të Krrabës ende nuk kishte përfunduar në atë ditë të pestë të qershorit. Në krye të malit ne ecëm nja pesë kilometra për t'u takuar me makinat, të cilat na prisnin në anën tjetër. Arkimandridi Zdruli, i ngarkuar nga Visarioni na priste aty. Pasi shkëmbyem përshëndetjet e rastit, hipëm nëpër makina dhe pas tridhjetë minutash ishim në Manastirin e Shën Gjon Vladimirit. Dukej se ishim pak vonë. Kryepeshkopi Visarion, i cili po e drejtonte meshën kishte filluar të këndonte psallmet e tija. Ai kishte pritur pak për ne që të arrinim, por i kishte humbur shpresat. Psallmet ishin të bukura, të shoqëruara me gjeste, të cilat është vështirë t'i përsëritësh.
>
> Peshkopi kishte një pamje madhështore në veshjen e tij të artë peshkopale. Ai mbante rripa të artë dhe breza të dekoruara me xhevahire fetare. Tre xhevahirë të mëdhenj i vareshin në gjoks dhe në kësulë. Ata reflektonin në dritën e mijëra qirinjve të ndezur, duke e bërë kurorën edhe më fantastike. Ai vazhdoi me psallmet, duke predikuar si më poshtë:
>
> Ky Shenjt që ka bërë mrekullira është një sllav. Ai ka lindur në fshatin Vladimir afër Krajës në kufirin e sotëm midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Në atë kohë nuk kishte dallime midis serbëve, çekosllovakëve, bullgarëve a sllavëve të tjerë. Sllavët në atë kohë ishin vëtëm sllavë, kudo që të gjendeshin. Ky shenjtor sllav na donte dhe na do ne edhe sot. Prirja e tij për bamirësinë, dëshira për të jetuar, sipas udhëzimeve të Zotit, si dhe dashuria për vendin tonë na ka vëllazëruar me sllavët. Ai ishte përgjegjës për një aleancë shpirtërore të formuar midis nesh, shqiptarëve

dhe sllavëve dhe kjo aleancë është forcuar prej faktit se edhe në Jugosllavi ka një grua shqiptare shenjtore. Ajo shenjtore quhet Maika Angelika[68]. Shenjtorja Majka Angelika ishte princeshë e një dinastie sunduese në Shkodër. Ajo u martua me një princ dalmat dhe, kur mbeti e ve, mori në dorë qeverisjen e një province midis Kroacisë dhe Sllovenisë. Sundimi i saj ishte aq i drejtë dhe bujar, saqë shtetasit e saj njëzëri e konsakruan shenjtore të vendit të tyre, pas vdekjes. Trupi i saj gjendet në Manastirin Ortodoks të Maika Angelikas në Vrushkaja Gora në Slloveni dhe dita e saj e celebrimit është në stinën e verës. Mijëra e mijëra njerëz shkojnë atje çdo vit, për t'ju lutur shenjtores shqiptare me aq devocion, sa edhe ne për Shën Gjon Vladimirin.

Për më tepër, fëmijët e mi të dashur, Shën Gjon Vladimiri ishte një princ sundimtar këtu në këtë botë. Ai ishte dhëndrri i Mbretit të Ohrit dhe jetoi një jetë të pastër, një jetë të shenjtë, jetën e Ungjillit. Për këtë arsye të afërmit e gruas së tij e vranë atë në mënyrë të tmerrshme. Ata i zunë pritë, kur ai po shëtiste në një ishull të vogël në Liqenin e Prespës. Ndërsa u kapërthye me vrasësit pa pasur asnjeri që ta ndihmonte, iu tha atyre:

"*Përse kaq tradhëtisht o njerëzit e gruas sime? Atëherë vazhdoni! Pritmani kokën*!"

Ai i mbylli sytë dhe i zgjati duart përpara dhe, pasi armiku ia preu kokën shenjtit, koka i ra në duart e tija dhe e mbajti vetë atë. Kjo ka ndodhur gati një mijë vjet më parë. Ai u shenjtërua. Me kokën në duart e veta, Shën Gjoni i hipi kalit dhe kalëroi drejt e këtu dhe kërkoi t'i ngrihej Manastiri. Këtu ishte vendi, ku ai vinte për gjah, kur ishte princ dhe po këtu është dheu, ku deshi t'i prehej shpirti.

Shën Gjoni ka bërë mrekullira dhe ende bën. Disa muaj më parë ai u shfaq në gjumin e një kujdestari - roje dhe i kërkoi t'i kryente një punë. Ishte një pasdite, kur roja po ia merrte një sy gjumë. Ai u zgjua dhe kuptoi se shenjti i kishte kërkuar të zgjohej dhe t'u binte këmbanave, sepse Kryepeshkopi po i ofrohej Manastirit. Roja nuk e dinte se unë do të vija, derisa e mori vesh prej shejtit. Ndërsa po i binte këmbanës, unë u shfaqa te dera e Manastirit.

Dhe përsëri gjatë këtij viti shenjti ka kërkuar të bëja diçka për të. Personi me të cilën kishte folur shenjti nuk e kishte kryer detyrën. Kjo moskryerje detyre e tërboi shenjtin aq shumë, saqë u bë e domosdosme të hapnim arkën, në të cilin pushon trupi i tij. E çfarë të shihja!! Shenjti ishte tërbuar aq shumë, sa ishte mbledhur kutullaç në arkivolin e tij. U bënë shumë shërbime për ta qetësuar. Dhe mezi na i pranoi lutjet që i bëmë. Nuk më takon mua të jap detaje, por nëpërmjet ndihmesës dhe këshillës së tij, Shën Gjoni më ruajti gjatë këtij viti prej shumë problemeve dhe ngacmimeve, si dhe mbrojti Kishën Orthodokse Autoqefale Shqiptare prej rrënimit. Shumë përpjekje e luftëra për ta larguar trupin e tij nga ky Manastir kanë dështuar. Jugosllavët thonë se meqenëse Shën

Gjoni është sllav ai është shenjti i tyre, prandaj duhet të shkojë atje. Peshkopi i Ohrit erdhi këtu disa vite të shkuara dhe deshi që menjëherë ta merrte trupin e tij dhe ta dërgonte në Ohër. Ai nuk arriti ta merrte, sepse vetë shenjti nuk pranoi të ikte. Janë edhe katolikët, të cilët shumë herë deshën ta hiqnin që këtej, por nuk ia dolën. Disa qindra vjet të shkuara ata mundën ta ngarkonin arkivolin në një mushkë dhe e filluan udhëtimin drejt Romës. Mirëpo, kur karvani i mushkave arriti te kanioni fill poshtë Manastirit, mushka që mbante arkivolin me trupin e Shën Gjonit u rrëzua përtokë dhe ngordhi sikur i kishte rënë pika. Trupi i shenjtit u kthye menjëherë në kishë.

Nuk ka dyshim në fuqinë e mrekullueshme të Shën Gjonit, të dashur fëmijët e mi. Kjo turmë e madhe njerëzish që është mbledhur këtu përfshin njerëz nga pjesët më të largëta të Shqipërisë. Ajo që është më kuptimplotë është se gjysma e kësaj grigje janë muhamedanë, të cilët i besojnë shenjtit dhe i luten atij. Shën Gjoni i do këta myslimanë, sepse ai nuk bën dallime fetare. Për atë janë të njejtit njerëz sikur atëherë, kur ai jetonte 900 vjet më parë, atëherë kur të tërë ishin të krishterë, atëherë kur muhamedanët, as që kishin dëgjuar për fenë që kanë sot."

Gjestet e Kryepeshkopit ishin kaq dramatike dhe patetike, sa besimtarët filluan të derdhnin lot. Ai ishte aq mjeshtër, sa edhe vetë u përlot. Gjatë predikimit të tij mbretëronte heshtja. Sytë e audiencës ishin ngulur tek ai. Psallmja mbaroi dhe tani fillonte ceremonia për procesionin e trupit të Shën Gjonit rreth e rreth kishës. Arkivoli në të cilin mendohej se ishin eshtrat e shenjtit ishin të kyçura në një varr të ndërtuar dhe të mbyllur brenda altarit. Ky varr kishte edhe një të çarë ose vrimë, në të cilën besimtarët mund të lëshonin para. Dera në këtë varr ishte e kyçur me më shumë se një dryn dhe ishte vulosur me stampa prej dylli, prej tre autoriteteve të ndryshme klerike. Mua m'u duk se kjo situatë nuk ishte e harmonizuar me atë që sapo tha Kryepeshkopi. Ai i tregoi audiencës se Shën Gjoni nuk la që eshtrat e tij të hiqeshin prej atij vendi e përsëri varri ishte i siguruar dhe i kyçur. Sidoqoftë, tani varri do të hapej, ndërsa arkivoli do të nxirrej jashtë për procesionin.

Ndërsa Kryepeshkopi qëndroi drejt përballë derës së mesme të altarit, dy priftërinj u shfaqën në dy anët, kurse një civil qëndroi përballë. Të tre ata i dorëzuan një çelës Kryepeshkopit dhe një vulë tek varri. Kur civili e dorëzoi çelësin dhe vulën e tij tek Visarioni, atij iu dha letra e mbështjellë dhe e bekuar për shërbimin e bukur, që kishte ofruar ndaj shenjtit për një vit të tërë, qëkurse ai ishte zgjedhur të ishte roje i Manastirit. Duke kënduar në akord më zërat e priftërinjëve dhe drejtuesit e korit, Kryepeshkopi u kthye nga altari, ku ishte varri. Vizitorët diplomatë nga Tirana u ftuan të hynin në altar. Audienca ishte aq e mbushur, sa u deshën xhandarët që të mbanin radhën dhe t'u hapnin rrugën miqve. Gati sa nuk na u zu fryma. Te priftërinjtë, Kryepeshkopi i hoqi vulat e dyllit prej varrit dhe më pas ai e hapi atë. Me kujdesin dhe pasionin e njeriut të

fesë, ai e nxori arkivolin. Ishte një kuti e vogël sa qefini i një fëmije katër vjeç. Ndërsa arka po nxirrej nga dera e altarit, besimtarët përpiqeshin ta preknin me shamitë e tyre të dorës, me kapele, apo çfarë t'u gjendej më mirë. Secili përpiqej ta prekte me diçka, duke besuar se ai do t'u sillte shëndet, e fat të mirë. Ata që ishin më larg ua kalonin shamitë atyre, që ishin më afër, që ta preknin atë. Ata i zgjatnin duart dhe, pasi e kishin prekur arkën, preknin fytyrat e tyre plot me gëzim.

Arka e nxjerrë nga kisha u transportua me vështirësi nëpërmjet një turme shumë të madhe. Brenda ishte shumë nxehtë, por jashtë ajri i freskët sikur na i hapi sytë. Arka u mbart prej katër priftërinjve dhe Kryepeshkopit, për të vijuar procesionin. Nga priftërinjtë e tjerë, dikush mbante qirinj të ndezur, dikush thoshte fjalë të vargëzuara me melodi kishtare, dikush mbante një Bibël në dorë. Diplomatët qëndronin pak a shumë pranë Kryepeshkopit. Dalëngadalë arka e Shenjtit bëri tre rrotullime rreth kishës në krahët e njerëzve. Ata që patën mundësi ta preknin arkën ishin më të lumturit, por shumë prej tyre nuk arritën. Të krishterë dhe muhamedanë njëlloj ishin aq të lumtur që kishin arritur ta bënin këtë. Ata ndienin se kishin siguruar shëndetin dhe fatin e mirë të paktën për një vit, derisa të vinte procesioni tjetër. Ata ishin aq të sigurt tani, sa në mendjet e tyre do të mbretëronte shëndeti dhe fati, si dhe begatia në bujqësi, bereqet e bagëti, pasi kishin prekur arkën. Tani veshjet duhej të çoheshin në shtëpi dhe të vareshin në mure, ose të vendoseshin në shtëpitë e të krishterëve, në dollapë që mbajnë ikona.

Në përfundim të procesionit arka u shtri mbi një tavolinë nën një tendë. Aty u grumbulluan klerikët. U hap fjala se priftërinjtë do t'ia ndërronin rrobat shenjtit. Ky ishte një rast për të parë fshehurazi, nëse ishte në arkë apo jo, siç thuhej për trupin e paprekur të shenjtit. Filloi përsëri këndimi kishtar dhe Kryepeshkopi i ndihmuar nga priftërinjtë e tij u përkul përmbi arkë, që ta nxirrte. Turma u vërsul për të parë çfarëdo që të mund të shihnin. Ishte aq nxehtë, sa Kryepshkopi ishte gati t'i zihej fryma për vete për shkak të turmës. Njerëzit dolën nga tenda dhe tregonin me gëzim fitoreje copa të pambukta të bardha, që iu dhanë atyre prej priftërinjëve. Ky pambuk doli nga brenda arkës dhe ishte ai që ishte vënë aty një vit më parë. Tani po zëvendësohej pambuku me pambuk të ri. Kjo punë bëhej çdo vit. Pambuku i marrë prej besimtarëve i shërbente të njëjtit qëllim, si dhe rrobat që preknin arkën madje edhe më mirë, sepse ato kishin ndenjur me shenjtin një vit të tërë. Ndërrimi i rrobave përfundoi dhe arka u la e hapur për besimtarët. Ata u lejuan të vinin dhe të puthnin ballin e shenjtit.

Z. Djonovitch dhe pjesëtarët e të tjerë të legatës së tij kaluan siç duhet nëpërmjet turmës dhe e puthën kafkën, që ishte e mbuluar me maskë argjendi dhe floriri me një vrimë në ballë. Besimtarët u lëshuan për të puthur shenjtin. Kureshtar për të parë arkën, z. Bernstein iu afrua atij, por ai në fakt gati sa nuk

e puthi atë. Dragomani i tij nuk mund ta refuzonte ftesën e priftit që ta puthte shenjtin, sepse ai është një ortodoks, por ai ia doli të mos e puthte, megjithëse u përkul mbi kokën e tij. Një sasi e madhe parash me stemën e Bankës Kombëtare Shqiptare u mblodhën atë ditë. Kjo i dha fund ditës së shërbimit.

Kishte kaluar pak nga ora njëmbëdhjetë. Kryepeshkopi i ftoi miqtë e nderuar të dilnin jashtë Manastirit, që t'u tregonte pasurinë e tij. Pikërisht në anën e ulët, te muri lindor, ai iu tregoi vizitorëve një lis të gjerë, që dukej se ishte shumë i vjetër. Visarioni thirri: "*Shihni ky lis është më i vjetër se njëmijë vjet dhe është i shenjtëruar. Shën Vladimiri vinte të gjuante këtu. Lisi u shenjtërua bashkë me Shën Vladimirin. Ashklat e tij shërojnë. Do t'ju jap të gjithëve nga një të tillë. Kështu iu dha të gjithëve. Kjo është industria jonë. Krahasojeni me industrinë tuaj",- iu tha ai diplomatëve".*

Pastaj u kthyem në ndërtesën kryesore të Manastirit. Aty na shërbyen drekën. Pas drekës u nisëm për në Tiranë. Sapo dolëm në rrugë mësuam, se kishte ndodhur një mrekulli. Një automobil nga Elbasani, i cili kishte një dyzinë me njerëz u mundua të kthehej drejt Manastirit dhe u rrëzua dymbëdhjetë këmbë poshtë në rrëpirë. Atë e ndaloi një pemë. Nuk ndodhi asgjë me ta. Z. Bernstein i tha Visarionit: "*Kjo ishte një mrekulli e Shën Gjon Vladimirit.*"

Një përshkrim i tillë duket pak sa makabër dhe i rëndë, por përshkruan shumë gjëra interesante, si nga rituali fetar, bashkëjetesa midis feve dhe toleranca etnike që ekziston te ne shqiptarët.

15 Bernstein me klerikët shqiptarë më 5 qershor 1931 në Kishën e Shën Gjon Vladimirit në Shijon të Elbasanit.

16, 17 Pamje e fasadës ballore dhe altarit të Kishës së Shën Gjon Vladimirit në Shijon, Elbasan, foto të vitit 2016.

Është privilegji im që të festoj këtë rast historik në Shqipëri, populli i së cilës ka vuajtur dhe ka luftuar kaq shumë, përpara se të fitonte pavarësinë dhe ku Heroi juaj kombëtar Skënderbeu ishte një prej personaliteteve më të mëdha të botës, edhe si udhëheqës, edhe si kampion i pavarësisë së popullit të vet. Shumë shqiptarë që kanë shkuar në SHBA dhe janë bërë pjesë e atij vendi, kanë ruajtur nderimin e thellë për vendin e tyre. Po ashtu, ata kanë kontribuar moralisht dhe materialisht për pavarësinë e Shqipërisë. Ka një lidhje të fortë midis dy kombeve tona.

200 - vjetori i lindjes së G. Washingtonit festohet edhe në Tiranë

Një prej datave të cilat Bernsteini festoi më bukur, është ajo e 200-vjetorit të lindjes së George Washingtonit.[69] Në fjalimin e tij ai thotë se amerikanët nuk e nderojnë Washingtonin si shenjt dhe as e hymnizojnë si hero të pamposhtur. Më poshtë po citojmë pjesë nga fjalimi i tij i mbajtur me këtë rast:

> Ai nuk i fitoi të tëra betejat. Por me një ushtri të vogël dhe jo të organizuar, pa armë dhe uniforma të mjaftueshme, arriti të fitonte bazuar në strategji që i habiti kundërshtarët. Ai asnjëherë nuk u thye nga vështirësitë dhe pengesat që i zinin rrugën, por besoi fort se e drejta është me të fortin. Ishte mjeshtër i udhëheqjes pa iu diktuar të tjerëve me zor. Të gjitha ato cilësi e bënë atë të pavdekshëm, simbolin e kombit amerikan si Presidenti i Parë i SHBA-ve....
>
> Është privilegji im që të festoj këtë rast historik në Shqipëri, populli i së cilës ka vuajtur dhe ka luftuar kaq shumë përpara se të fitonte pavarësinë dhe ku heroi juaj kombëtar, Skënderbeu, ishte një prej pesonaliteteve më të mëdha të botës, dhe si udhëheqës, edhe si kampion i pavarësisë së popullit të tij. Shumë shqiptarë që kanë shkuar në SHBA dhe janë bërë pjesë e atij vendi, kanë ruajtur nderimin e thellë për vendin e tyre. Po ashtu, ata kanë kontribuar moralisht dhe materialisht për pavarësinë e Shqipërisë. Ka një lidhje të fortë midis dy kombeve tona.
>
> Për të festuar 200-vjetorin e ditëlindjes së George Washingtonit kam nderin dhe kënaqësinë të mbjell fidanin e pemës së sjellë nga Mali i Vermontit, ku gjendet shtëpia e Washingtonit dhe ta vendos atë në truallin e tokës shqiptare, në Legatën Amerikane.[70]

Kam pasur kënaqësinë të udhëtoj shumë në vendin tuaj të bukur dhe kam parë me sytë e mi edhe gëzimin edhe keqardhjen. Kam parë njerëz të padjallëzuar, të thjeshtë, shumë punëtorë, paqësorë, dashamirës dhe të këndshëm, të pajisur me tipare dhe karakter të vërtetë fisnik. Por kam parë edhe varfërinë e skajshme, mjerimine tejskajshëm. Nuk ka dyshim se mundësitë për arritjen e lumturisë në Shqipëri shtrihen kryesisht në kultivimin e përmirësuar të tokës dhe në ruajtjen e paqes. Çdo përpjekje konstruktive në këtë drejtim është një kontribut ndaj prosperitetit dhe lumturisë së popullit shqiptar.

Kujdesi i Ambasadorit Bernstein për arsimin në Mbretërinë Shqiptare

Shkolla Bujqësore në Kavajë, sot Shkolla “Charles Telford Erickson”

Ministri Bernstein mori pjesë në inaugurimin e mjediseve të reja të Shkollës Bujqësore të Kavajës,[71] më 2 prill 1932. Kjo shkollë është plotësisht krijesë amerikane. Babai i kësaj shkolle, emrin e të cilit ajo e mban sot, është amerikani Charles Telford Erickson.

Në fillimin e viteve ’20 të shekullit të kaluar, pas shumë takimeve me Ahmet Zogun (në kohën që ishte Kryeministër, më vonë President dhe Mbret i shqiptarëve) dhe me Fan Nolin, atë kohë ministër i Punëve të Jashtme, Ch.T.Erickson mori miratimin e tyre për hapjen e Shkollës Bujqësore të Kavajës.



19 Foto Faksimile e një letre në dorëshkrim që dëshmon korrespondencën e Ambasadorit Bernstein me Charles Telford Erickson.



20 Faksimile e një letre të Ch.T.Erickson, dërguar Ambasadorit Bernstein në lidhje me shkollën dhe Fondacionin e Lindjes së Afërme.

C. TELFORD ERICKSON

"Erickson of Albania belongs with such hardy pioneers as Livingstone of Africa, Mackay of Uganda, Cornfell of Labrador, who have gone forth not knowing where they were to go, urged on, not by lure of discovery, of fame, or of wealth, but impelled by the passion for service, crusaders not of the Sword but of the Cross."—*Christian Leader.*

FAMINE IN ALBANIA

The Desperate Need of a Brave People

Word has just come from our Albanian American School of Agriculture that 100,000 Albanian mountaineers are starving. I knew last summer, after a tour through that region, that this was inevitable. Field after field of corn shriveled and dried up without a single nubbin of grain, due to the six months' drought. Their crooked stick, gouging the worn-out surface soil, is a poor weapon with which to fight that ghastly trio of Drought, Famine and Starvation, be the people never so brave.

While America is making ready her limitless resources of science, wealth and labor to grapple with her problem of Flood Control, back there in the dim darkness is a little, neglected, caricatured race fighting the primitive forces of nature—food and drought—with their bare hands. Meanwhile, malaria takes its terrible toll of them. Tuberculosis gathers, undisturbed, its white harvest of death. Famine goes before them and prepares the way.

Albania has been called the "Problem of the Adriatic and the Balkans," the



20 21 Këto dokumenta dëshmojnë se një ndër Patronët e Nderit të Shkollës Bujqësore të Kavajës (sot Shkolla Bujqësore "Charles Telford Erickson") ishte edhe Presidenti i 31 – të amerikan, Herbert Hoover.

Ata pajtoheshin se arsimimi në Shqipëri mbetej me të vërtetë prapa asaj, që kishin bërë vendet e tjera ballkanike. Ericksoni mbështeste përpjekjet për reformën agrare, por e kuptonte gjithashtu se vetëm një arsim bujqësor modern, ku të përgatiteshin specialistët e nevojshëm për të ardhmen e vendit, do të sillte zhvillimin e tij. Me këtë ai donte të zhdukte traditën e vjetër primitive të kultivimit të tokës dhe të fuste metodat bashkëkohore. Kështu, ai filloi të mendonte seriozisht për themelimin e një shkolle bujqësore djemsh. Përderisa Shqipëria ishte në përgjithësi një vend me shoqëri bujqësore, një institucion i tillë do të ndihmonte zbatimin e planeve për metoda të përparuara në bujqësi. Ndërkohë ai besonte se sapo studentët e rinj do t'i përvetësonin këto metoda moderne, traditat e dala mode, të cilat ishin praktikuar për brezni të tëra, dalëngadalë do të zhdukeshin. Ai, po ashtu, kuptoi se procesi do të ishte i gjatë dhe i tillë, që do të përjetonte edhe kthime mbrapa, edhe zhgënjime. Megjithëse idetë e Ericksonit do të kërkonin vite përpjekjesh pa pushim, ai ishte i bindur se qasja e tij ndaj këtij problemi më në fund do të kishte ndikim mbi tërë shoqërinë shqiptare.

Më 15 nëntor 1921, Fan Noli i kërkoi Ericksonit të paraqiste me shkrim një propozim, ku të përqendrohej në ato zona, ku arsimi shqiptar duhej të luante rol kryesor në shoqëri. Më 16 tetor 1922 qeveria shqiptare i komunikoi Ericksonit se në përgjithësi ata e miratonin idenë e tij për një Kolegj Bujqësor, megjithëse, siç theksohej, qeveria ende nuk ishte në situatë të përshtatshme për të financuar një shkollë të tillë. Por, meqë financimet për këtë projekt do të vinin nga SHBA-të, Ericksoni sugjeroi që të emërohej si komisionier special për bujqësinë, me qëllim që të mblidhte fondet e domosdoshme në Amerikë, propozim që qeveria shqiptare e pranoi. Më 21 shkurt 1922 Ericksoni Ericksoni i kishte kërkuar qeverisë shqiptare t'i jepte ndonjë zonë, që ishte në pronësi të shtetit, ku të ngrihej Kolegji Kombëtar i Bujqësisë, me një fermë model dhe stacion

eksperimental pranë tij.

Kol Tromara, ish-president i *Vatrës* dhe mik i Ericksonit, e paraqiti kërkesën për tokë te Kryeministri Zog dhe disa zyrtarë të tjerë. Më 8 mars 1922 Kryeministri e informoi Ericksonin se, jo vetëm që kërkesa e tij për hapjen e shkollës ishte e miratuar, por edhe se ai do të lejohej të zgjidhte nga një listë prej tetë ose dhjetë fermash më të mira në pronë të qeverisë, që gjendeshin në zona të ndryshme të vendit.

Në Shtetet e Bashkuara Ericksoni bëri takime me figura të shquara, institucione bujqësore dhe filantropike. Duke dashur që ta bënte sa më të njohur kërkesën e tij, Ericksoni zakonisht e fillonte me një përshkrim të marrëveshjes së shkëlqyer mbi tokën të arritur me qeverinë shqiptare. Pastaj ai fliste për programin arsimor, i cili do të zhvillohej brenda traditës më të mirë shqiptare. Ericksoni pati kontakte me Herbert Hoover,[72] në atë kohë Sekretari i Shtetit për Tregtinë dhe më vonë Presidenti i 31-të i SHBA-ve. Hooveri duket se shprehu interes të padiskutueshëm për projektin e Ericksonit, pasi më 5 shkurt 1924 ai kontaktoi Allan Dullesin[73] në Departamentin e Shtetit, për t'i kërkuar informacion për projektin e Ericksonit. Më 9 shkurt të vitit 1924, Ericksoni, në një letër që i dërgonte Hooverit, theksonte se nevoja më e madhe e menjëhershme e Shqipërisë ishte modernizimi i bujqësisë së saj. Ericksoni i shkruan me aq dhimbje dhe simpati për shqiptarët, sa askush tjetër nuk kishte bërë: *"Shqiptarët janë njerëz të tillë që më mirë vdesin, sesa të kërkojnë, më mirë mbarojnë në dëshpërimin e vet, sesa të qahen... Ata janë popull tragjik, por një racë heroike".*

> Projekti i z. Erickson për themelimin e një shkolle për mësimdhënien në fushën e bujqësisë dhe tregtisë në Shqipëri ka miratimin tim, që buron nga zemra. Metodat e përdorura këtu sot janë tërësisht arkaike. Realizimi i shpresave të mëdha legjitime për mirëqënien e Shqipërisë në të ardhmen, mbështeten kryesisht në përvetësimin praktik nga rinia të shkencave dhe virtyteve të larta,[74] - i përgjigjej atij Herbert Hooveri.

Duke qenë plotësisht i kënaqur me raportin e lëshuar nga Departamenti i Shtetit, Hooveri vendosi t'i jepte mbështetjen e tij këtij projekti, duke bërë një donacion prej 10.000 dollarësh nga llogaria e tij personale, në kushte anonime, me kusht që brenda një viti, Ericksoni të mblidhte edhe një shtesë prej 10.000 dollarësh të tjerë.

Ericksoni ia doli jo vetëm të grumbullonte një fond të tillë shtesë, por edhe të mbetej i heshtur për kontributin bujar të Herbert Hooverit, megjithëse publikimi i këtij donacioni nga ana e tij, do ta kishte ndihmuar shumë në mbledhjen e fondeve të tjera edhe më të mëdha[75].

Me përjashtim të Vernon Kellegut, Sekretarit Ekzekutiv të Këshillit Kombëtar të Kërkimeve, që e dinte këtë fakt, askush tjetër nuk e mësoi për pesëdhjetë vjet, deri kur letrat e Ericksonit u zbuluan dhe u studiuan nga Alan Fusine. Kjo ndodhi pas vdekjes së tij. Zbulimi i këtij fakti flet shumë për kontributin e amerikanëve në të gjitha nivelet

për përparimin e Shqipërisë.

Shkolla e filloi veprimtarinë e saj në vitin 1926. Ndërtesat e saj u vendosën në Malin e Robit dhe ajo vazhdon të operojë edhe sot pas më se nëntëdhjetë vjetësh. Në prill të vitit 1932 Bernsteini merr pjesë në inaugurimin e ndërtesave të reja dhe mban fjalimin e mëposhtëm:

Fjala e Bernsteinit në Kavajë, 2 prillit 1933

Vetëm pak më shumë se nëntë muaj më parë ne vumë gurin e themelit të këtyre ndërtesave të Shkollës Bujqësore dhe sot kam privilegjin të festojmë përfundimin e tyre. Ato u ngritën për t'i bërë shqiptarët fermerë më të mirë. Lëvrimi i tokës ka qenë përherë puna më e rëndësishme e njeriut, shtylla e jetës. Maksima e hershme e mijëra vjetëve të shkuara është po aq e shndritshme edhe sot: Në bujqësi asgjë nuk duhet bërë me vonesë, çdo gjë duhet bërë në sezonin e duhur dhe rasti i humbur nuk kapet më.

Kam pasur kënaqësinë të udhëtoj shumë në vendin tuaj të bukur dhe kam parë me sytë e mi edhe gëzimin edhe keqardhjen. Kam parë njerëz të padjallëzuar, të thjeshtë, shumë punëtorë, paqesorë, dashamirës dhe të këndshëm, të pajisur me tipare dhe karakter të vërtetë fisnik. Por kam parë edhe varfërinë e skajshme, mjerimin zemërthyes.

Nuk ka dyshim se mundësitë për arritjen e lumturisë në Shqipëri shtrihen kryesisht në kultivimin e përmirësuar të tokës dhe në ruajtjen e paqes. Shqipëria mundet që lehtësisht të mbajë një popullsi më të madhe se ajo që ka brenda kufijve të tashëm me metoda më të përkryera bujqësore. Çdo përpjekje konstruktive në këtë drejtim është një ndihmesë ndaj prosperitetit dhe lumturisë së popullit shqiptar.

Është kënaqësi e madhe që Fondacioni i Lindjes së Afërt[76] me një shpirt ndihmese humanitare ka ndërtuar në Shqipëri këtë shkollë bujqësore, një shkollë me klasa dhe me një vend praktike mësimore për kultivim më të mirë, institucion që i dallon njerëzit e ndershëm dhe produktivë nga të tjerët. I takon këtij fondacioni të sjellë paqe dhe siguri, sepse kush e di më mirë se bujku se ai që mbjell me zgjuarsi, zakonisht do këtë të korra të bollshme, ndërkohë që kush mbjell erën, korr furtunën.

Në këtë kohë të furtunës dhe tensionit, të rrëmujës së përgjithshme dhe ankthit, kur e tërë bota është e ngarkuar me kaq shumë mizori dhe vuajtje, si rrjedhojë e Luftës Botërore, unë jam veçanërisht i lumtur të shoh këtë kontribut të ndihmës bujare të dhënë nga kjo organizatë amerikane, e cila ka ardhur që prej anës së anës te ky vend i vogël buzë Adriatikut, te ky vend i bukur, me njerëz të lashtë e përsëri të rinj. Ai fondacion iu ka zgjatur dorën vëllazërore të bashkëpunimit me dëshirën e mirë dhe mirëkuptimin e ndërsjellë, larg nga çfarëdo motivi egoist ose agjende të fshehtë.

Më lejoni t'ju kujtoj se në këto kohë të vështira veprat bamirëse dhe ndihmat janë tepër të nevojshme në vendin tuaj. Padyshim bamirësia duhet të fillojë nga shtëpia, por nuk duhet të mbarojë aty. Mësimet praktike të idealizmit shqiptar nevojiten gjthandej më shumë se kurrë më parë dhe çdo manifestim i ndihmës amerikane jashtë është një kontribut i pagabueshëm drejt paqes dhe drejtësisë në botën, ku jetojmë.

Unë jam i sigurt se dhjetra mijëra amerikanë të shkëlqyer, të cilët vazhdojnë të mbështesin veprimtarinë humanitare të Fondacionit të Lindjes së Afërt nuk janë kursyer të bëjnë punën e tyre të plotë, më së pari për njerëzit në nevojë në shtëpinë e tyre gjatë kësaj periudhe krize të rëndë.[77]

Shqipëria vlerëson këtë kontribut të Fondacionit të Lindjes së Afërt, i cili vlerësohet edhe nga vetë Madhëria e Tij Mbreti Zog dhe qeveria e Tij.

Me këtë rast më lejoni të shpreh keqardhjen që një prej zyrtarëve të lartë shqiptarë, i cili ndihmoi të vihej guri i themelit të këtyre ndërtesave në qershorin e vitit të kaluar dhe që ishte jashtë mase i interesuar për mbarëvajtjen e kësaj shkolle, nuk është sot me ne. I ndjeri Ministër i Arsimit Hilë Mosi,[78] njeri me vizion largpamës, i cili i dinte nevojat e këtij vendi dhe që i shërbeu vendit të vet me një devocion shembullor, nuk jeton më.".

Pas këtij fjalimi kaq të bukur të Ministrit Bernstein, fjalën e mori përfaqësuesi i Mbretit, i cili me një sqimë diplomatike dhe fjalor të zgjedhur iu drejtua Bernsteinit:

Në këto kodra historike, ku në rrjedhë të shekujve të kaluar ushtritë, ndesheshin për lavdi perandorake, sot falë ndihmës amerikane ne po festojmë themelimin e sallave të kësaj shkolle si një institut arsimor, ku të rinjtë shqiptarë do të mësojnë si të arrijnë lavdinë në një mënyrë tjetër: Duke u bërë mbajtës të stafetës së kulturës dhe duke mësuar se si të shërbejnë.

Kuptimi simbolik i kësaj arritjeje nuk mund t'i shpëtojë vëmendjes tonë. Të trajnosh dhe instruktosh gjeneratën e re të qytetarëve shqiptarë, e cila e çmon dhe nderon punën e atyre që do të bëhen kultivuesit e tokës së pasur shqiptare, të ngresh mirëqenien kombëtare dhe prosperitetin, kjo është ajo që pret Shqipëria nga Instituti e prej kësaj feste që po gëzojmë sot. Arsimimi dhe bujqësia janë dy fusha që përbëjnë synimin tonë më të rëndësishëm të programit përparimtar të qeverisë së Madhërisë së Tij, Mbretit. Ne shohim me gëzim se këtu do të përdoren metodat më moderne në bujqësi. Ndërtimi para disa kohësh i ndërtesave për shkollën e vajzave, e cila është si kurorë e bukur në kodrën matanë nesh dhe këto tre ndërtesa që po inaugurojmë sot, flasin vetë për punën e madhe dhe të vështirë që është dashur për të arritur deri këtu dhe sa zell, vëmendje dhe energji është dashur për këtë. Me këtë rast do desha që me mirënjohje të thellë të tregoj atë që ndjejnë shqiptarët për këtë arritje fisnike të kombit amerikan në fushën e

arsimit dhe trajnimit bujqësor. Në këtë ditë historike të Institutit, dua të bëj një homazh ndaj dr. Ericksonit, themeluesit të kësaj shkolle. Më lejoni gjithashtu të shpreh në emër të qeverisë së Madhërisë së Tij, vlerësimin e pamatshëm ndaj zonjave e zotërinjve Acheson, Archer dhe Allen. Po ashtu një falënderim shkon te drejtorët e aftë të Fondacionit të Lindjes së Afërt si dhe bashkëpunëtorët e tyre për shërbimin vullnetar, që kanë ofruar nën drejtimin e talentuar të z. Bach.

Dhe më në fund, ju lutem më lejoni t'ju drejtohem juve Shkëlqesia Juaj, z. Bernstein, përfaqësuesi shumë i nderuar i kombit të madh amerikan, të shpreh ndjenjat e thella të mirënjohjes për interesin Tuaj të madh në çdo fushë që ka të bëjë me Shqipërinë dhe jo vetëm, në ndërtimin dhe funksionimin e këtij instituti. Ky institut është një tjetër provë e marrëdhënieve tona të shkëlqyera, për shpirtin e bashkëpunimit dhe miqësinë midis dy kombeve në vijën e kulturës dhe paqes.

KANUNI I LEKË DUKAGJINIT ËSHTË NJË LIGJ I PASHKRUAR ME TË CILIN MALET E VERIUT TË SHQIPËRISË E QEVERISNIN VETVETEN. KANUNI ËSHTË EDHE LIGJI EDHE PROCEDURA, ËSHTË EDHE KODI CIVIL EDHE AI PENAL. TEKSTI I TANISHËM ËSHTË PËRGATITUR PREJ AT SHTJEFËN KONSTANDIN GJEÇOVIT, PRIFT FRANÇESKAN I VRARË NË MALIN E ZYMIT NË KOSOVË NË VITIN 1929. MENDOHET SE KY LIGJ ËSHTË KODIFIKUAR NË TË GJALLË TË SKËNDERBEUT DHE ËSHTË PËRGATITUR PREJ LEKË DUKAGJINIT.

Bernsteini, mik i madh i kulturës shqiptare

Duke qenë vetë njeri i kulturës, Bernsteini gëzoi respektin dhe simpatinë e intelektualëve shqiptarë të kohës. Atë e gjejmë në korrespondenca të ndryshme me ta. Në një mori komunikimesh të tij me intelektualë të ndryshëm, do të ndalemi te disa prej tyre si At Gjegj Fishta, Aleksandër Moisiu dhe Lef Nosi. Në dokumentet që ka lënë trashëgim Bernsteini gjendet edhe një letër që i ka dërguar At Fishta, e cila shoqëron botimin e asaj kohe të Kanunit të Lekë Dukagjinit, mbledhur nga At Shtjefën Gjeçovi (prift katolik shqiptar nga fshati Janjevë, Kosovë, lindur në 1874 dhe i vrarë nga serbët në Zym, po në Kosovë në vitin 1929). Ky kanun i kushtoi jetën priftit patriot.

At Gjergj Fishta

Për këtë dokument kaq të rëndësishëm për organizimin kolektiv të jetës së shqiptarëve, Bernsteini interesohet shumë. Ai njihet me At Gjergj Fishtën. Më 27 maj 1933 At Gjergj Fishta i dërgon një letër Benshtainit, në të cilin i shkruan:

> Vetëm për me të diftue se spiritualisht gjindem përherë i shoqnuem me Shkëlqesën t'Uej, po ta dërgoj ket kopje të Kanunit të Lekë Dukagjinit, që ndër kto dit është krye së botuemi në Shtypshkronjën t'onë e qi asht' ma e para vepër shqype mbi ket Kanue".
>
> Me nderime të posaçme
> A.Gjergj Fishta
> Nënshkruar



22 Kopje e letrës origjinale të shkruar me dorën e At Gjergj Fishtës.

Në përgjigje të letrës së At Fishtës, Bernsteini i shkruan atij si më poshtë dhe e dërgon në Konventën Françeskane në Shkodër, më 6 korrik 1933.[79]

> I dashur Pater Fishta!
> Ju lutem më ndjeni për vonesën në hapjen e letrës tuaj aq kuptimplotë dhe librit të cilin ma keni dërguar me aq mirësjellje. Libri erdhi disa kohë pasi e kisha marrë letrën. Dua t'ju falënderoj me zemër edhe për letrën edhe për librin. Më vjen keq që nuk mundem ta lexoj këtë libër në origjinal, por një përmbledhje e pjesëve të caktuara të Kanunit të jashtëzakonshëm të Lekë Dukagjinit më ka ndriçuar pamjen e ligjeve, me të cilat malësorët e veriut të Shqipërisë janë qeverisur në të kaluarën. Prifti françeskan At Shtjefën Konstandin Gjeçovi, i cili e ka hedhur në të pastër tekstin e këtij Kanuni të kodifikuar gjatë jetës së

> Skënderbeut dhe përgatitur prej Lekë Dukagjinit III, ka bërë një punë të pallogaritshme. Paraqitja e tij prej jush, së bashku me parathënien që i keni vënë, e kthen atë në një vlerë të paçmueshme historike.
>
> Me të falat më të ngrohta dhe vlerësimin tim të lartë,
> Sinqerisht,
> Herman Bernstein

Më pas Bernstein ulet dhe shkruan përshtypjet për vetë Kanunin e Lekës dhe e përcjell në Departamentin e Shtetit në Washington kështu:

> Kanuni i Lekë Dukagjinit është një ligj i pashkruar, me të cilin malet e veriut të Shqipërisë e qeverisnin vetveten. Kanuni është edhe ligji edhe procedura, është edhe kodi civil edhe ai penal. Ai përmban zgjidhjen e mosmarrveshjeve të çfarëdo natyre qofshin midis malësorëve, edhe nëse ato mosmarrëveshje vijnë si rezultat i dëmeve të vogla ndaj pasurisë, por edhe nga vrasjet e paramenduara ndaj njëri-tjetrit. Teksti i tanishëm është përgatitur prej At Shtjefën Konstandin Gjeçovit (prift françeskan i vrarë në Jugosllavi në vitin 1929). Mendohet se ky ligj është kodifikuar në të gjallë të Skënderbeut dhe është përgatitur prej Lekë Dukagjinit. Parimi i këtij kodi është barazia e plotë dhe hakmarrja kokë për kokë (ose sy për sy) dhe se ajo nuk zgjidhet me pagesa.

Bernsteini gjithashtu shkëmbente dokumente historike me Lef Nosin. Këtij të fundit i kishte kërkuar ta ndihmonte për të gjetur rrënjë dhe shenja hebraizmi në qytetin e tij në Elbasan. Një shkëmbim i tillë korrespondence gjendet sot në arkivën e Institutit të Studimeve hebraike YIVO, në New York.

Lef Nosi

Lef Nosi luajti një rol të jashtëzakonshëm në historinë e Shqipërisë, duke qenë pjesëmarrës në të gjitha ngjarjet më të rëndësishme të historisë shqiptare, që nga dita e shpalljes së pavarësisë. Ai mendohet se ishte bartës i tekstit origjinal të Deklaratës së Shpalljes së Pavarësisë. Ai ka qenë anëtar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris, ku e mbrojti me aq pathos çështjen shqiptare bashkë me Turhan Pashën, Mehmet Konicën, dr. Mikael Turtullin, Imzot Luigj Bumçin dhe amerikanin Ch. T. Erickson.

Ai kishte miqësi të ngushtë edhe me Herman Bernsteinin. Fati i Lef Nosit dihet tashmë. Ndër të tjera gjëra të mëdha që kishte bërë gjatë jetës së tij, ishte edhe mbrojtja që u bëri hebrejve në Elbasan, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ishte pikërisht hebreu Mark Menahemi, të cilin e mbrojti Lef Nosi nga nazistët. Më vonë, pas largimit të gjermanëve,

Lef Nosi u strehua në shtëpinë e Menahemëve në Tiranë, por ata nuk mundën ta mbrojnë, kur komunistët e ndoqën nëpër Tiranë. Hebreu që i mbijetoi terrorit nazist, falë mbrojtjes që i ofroi Lef Nosi, nuk ia mbrojti dot jetën shpëtimtarit të vet, Lef Nosit, të cilin e pushkatuan komunistët më 20 shkurt 1945.[80] Mikesha e tij skoceze, Margaret Hasluck[81] ndërhyri te diktatori për të mos e ekzekutuar atë, por më kot.

Se me çfarë respekti i shkruante ai Bernsteinit, duket nga letra e mëposhtme, e cila daton 23 mars 1933:[82]

> Shkëlqesia Juaj,
> Kam kënaqësinë e veçantë t'ju dërgoj dokumentet, të cilat m'i kërkuat dhe u kërkoj ndjesë për vonesën. Vonesa ka ndodhur thjesht për vështirësitë në kopjimin dhe përkthimin e tyre. Përkthimi nuk pretendoj të jetë krejt pa gabime, por prapëseprapë janë aq afër me origjinalin, sa të japin kuptimin e duhur.
> Ndoshta ju do t'i gjeni shpjegimet e mëposhme, të përdorshme:
> Viti muhamedan 1014 korrespondon me vitin 1605 Anno Domini. [83]
> Shtatë dokumentet e para janë nga dorëshkrimet e vendimeve gjyqësore në qytetin e Elbasanit, të cilat tanimë i zotëroj unë. Numrat e shkruar në krye të këtyre shtatë dokumenteve korrespondojnë me origjinalet në regjistër. Gjashtë dokumentet e para, së bashku me ekstraktin e dytë nga Udhëtimet e Evlija Çelebisë duket se provojnë se nuk ka pasur koloni hebraike në Elbasan, por vetëm tregtarë hebrej të lëvizshëm.
> Dokumenti nr. 1487 dhe ekstrati i parë nga Evlija Çelebia duket tregojnë se ndërtesa në formë kulle përmbi portë ishte një xhami. Nëse kërkoni informacion të mëtejshëm mbi këto tema, unë do të isha shumë i lumtur t'ju ndihmoja. Sa i takon sugjerimit tuaj për blerjen e një regjistri të vjetër, më vjen keq t'ju them se kjo nuk është e mundur. Serbët i dogjën të gjitha librat dhe letrat që gjetën në prefekturë, kur ajo u pushtua prej ushtarëve të tyre gjatë Luftës Ballkanike. Regjistri im i shpëtuar nga zjarri aksidentalisht, është i destinuar për muzeumin e ardhshëm të Elbasanit.
>
> Nënshkruar nga Lef Nosi

Kujtimet e Lef Nosit kanë vlerë të jashtëzakonshme, por edhe vetë ndjesa e tij ndaj Bernsteinit që i vetmi regjistër i shpëtuar në prefekturë, tanimë në duart e tij, do t'i dhurohej muzeut të qytetit Elbasan. Kjo flet për të dy këto figura. I pari që Bernsteini kërkon me ngulm çdo gjurmë të mbetur të racës së vet në Elbasan, ndërsa tjetri i ruan po me aq fanatizëm ato pak dëshmi, që i kanë shpëtuar shkatërrimit serb të ndodhur paralel me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë. Për të pasur një ide edhe më të qartë të këtyre dëshmive, po sjellim disa përkthime të bëra nga arabishtja në anglisht dhe për lexuesin e këtij libri në shqip:

> Tre elbasanllinj, Hasani, i biri i Abdullahut për vete, Sulejmani ustai i mbulesave dhe Osmani i biri Haxhi Memit, si përfaqësues i Biramit (Abrahamit) hebre, u paraqitën në gjykatë dhe thanë:
> Kur ishim herën e fundit në udhëtim për në Venecia me punë, Hasani i biri i Husen Komushit, i ashtuquajtur Haso Aga, ishte marrë në burgim në Anabol (ndoshta Napoli). Ne dëshmojmë nën betim si dëshmitarë se ai vdiq në Anabol. Pasi e dhanë këtë dëshmi, thanë se vdekja është regjistruar siç kërkohet në fillim të muajit të tretë të vitit 1014, kalendari Muhamedan.
>
> Dëshmitarët: Ahmet Çelebi, Sinan Balli, Ymer Voivoda etj.[84]

Një seri dokumentesh gjenden sot në arkivën hebraike, aty ku gjendet koleksioni i Herman Bershtainit, të cilat vërtetojnë praninë e përkohshme hebraike në qytetin e Elbasanit, e dëshmuar kjo nëpërmjet përkthimeve që Lef Nosi, siç u tha më sipër, ia dërgoi ambasadorit amerikan.

Bernsteini viziton Butrintin

Në arkivën e YIVO-s gjenden edhe dokumente që vertetojnë vizitën e Bernsteinit në Butrint. Ai flet me simpati për trashëgiminë arkeologjike të shqiptarëve. Duket po ashtu se ai kishte një njohje të mirë me Luigi Ugolinin, arkelogun e njohur italian, i cili kontribuoi shumë për zbulimet arkelogjike në vendin tonë. Emri i Ugolinit është shumë i përfolur, pasi edhe ai, si shumë të tillë nga vendet perëndimore, jo vetëm nga Italia, kishin marrë me vete vlera të mëdha antike që sot mbushin muzeumet e vendeve më të zhvilluara në botë. Gjithsesi, letra e mëposhtme tregon interesin e vetë Bernsteinit për trashëgiminë historike të shqiptarëve.

Më 25 tetor 1933, Luigi Ugolini, i shkruan një letër në italisht Bernsteinit ku ndër të tjera i thotë:

> Shkëlqesi!
>
> Po ju dërgoj bashkëlidhur disa fotografi. Një prej tyre është e juaja bashkë me shkrimin në të.
> Veç tjerash, po të dërgoj edhe mbishkrimet e dy lokaliteteve të cilat (?) duhet të jenë vendvarrime të hebrejve.
> Me përkushtim, i juaji
> Luigi M. Ugolini
> 4 Via Monteroni, Romë.

Minstri Herman Bernstein viziton Butrintin dhe mahnitet nga bukuritë e tij. Ai vlerëson pa masë vlerat e qytetit tonë antik dhe në përfundim thotë se, nëse do të kishte mundësi udhëtimi për të huajt që të vizitonin këtë vend kaq të bukur dhe interesant, atëherë ky vend do të ishte i mbushur plot e përplot me turistë. Më tej, ai diskutoi për pasuritë e qytetit antik me Ugolinin, arkeologun e njohur italian që e ka zbuluar qytetin, i cili shtroi drekë për nder të ministrit amerikan.[85]

"I Burgosuri", dramë e Aleksandër Moisiut përkthyer nga Herman Bernstein dhe vajza e tij Dorothy [86]

Si diplomat i përmasave të mëdha, Bernsteini nuk ishte thjesht një raportues takimesh, mbledhës informacionesh, analist ngjarjesh, këshillues i qendrës së vet në lidhje me ato që ndodhnin në Shqipëri. Këto janë detyra të përditshme dhe shumë të zakonshme të çdo diplomati. Dhe një njeri aq i madh, i organizuar dhe intelektual, këtë punë e kishte aq të lehtë dhe të zakonshme. Nga ana tjetër, një përgatitje kaq e lartë intelektuale, me interesa kaq të mëdha dhe të gjera, vetëm sa e bënin detyrën që kryente edhe më të rëndësishme, më të vyer dhe shumë më interesante, se atë të një raportuesi të zakonshëm, një njeriu që dërgonte telegrame të shifruara, ose raporte të cilat pasqyronin gjendjen e përditshme të Mbretërisë Shqiptare.

Duke e parë punën e tij si detyrë që duhej të kishte të bënte dhe me historinë e hebrejve në Shqipëri, edhe me historinë e vetë Shqipërisë, edhe me arkeologjinë, edhe me etnografinë, ai iu kushtua edhe një drejtimi tjetër, kulturës shqiptare.

Bernsteini del se kishte marrëdhënie të një natyre të veçantë, sidomos me njërin prej tyre, me Aleksandër Moisiun (2 prill 1879 – 22 mars 1935).

Në kërkimet për ndonjë lidhje të drejpërdrejtë midis këtyre dy bashkëkohësve, del se Moisu ka jetuar vetëm tre vjet më pak dhe që në fakt të dy kanë vdekur relativisht të rinj. Për fat të keq për lidhjet e tyre nuk është arritur të gjendet ndonjë material tjetër me shkrim, përveç atij që po citojmë më poshtë.

Gjurmët e kësaj marrëdhënie gjënden te prirja e Bernsteinit, gjatë asaj periudhe, për të hulumtuar çdo gjë që kishte të bënte me Shqipërinë. Gjithsesi ajo që ka mbetur e dokumentuar është përkthimi nga gjermanishtja në gjuhën angleze bashkë me vajzën e tij, Dorothy Nash, i dramës së shkruar nga Aleksandër Moisiu "*I Burgosuri*". Kjo është një dramë në pesë akte, e cila ruan të drejtën e autorësisë në gjuhën angleze nga Herman Bernsteini.[87]

Drama e Moisiut mund të ketë qenë një sprovë e madhe në punën e tij teatrale, jo vetëm si aktor i famshëm i kohës së vet, por edhe si dramaturg. Ai e vendos ngjarjen në ishullin Shën Helenë, ku Napoleon Bonaparti u internua pas humbjes së betejës së tij finale, atë të Vaterlosë, kundër gjeneralit anglez Wellington. Beteja e Vaterlosë u zhvillua më 15 qershor 1815.

Përkthimi i saj prej Bernsteinit na jep një vepër, e cila tregon për ngjarje të ndodhura

që fillojnë më 18 tetor 1815 dhe mbyllen më 5 maj 1821 (Në gjuhën shqipe veprën e ka sjellë të përkthyer nga gjermanishtja Gjergj Vlashi.).

Përkthimi i kësaj vepre të Moisiut në anglisht ka rëndësi të jashtëzakonshme për autorin. Por parë në vështrimin e qëndrimeve të Bernsteinit ndaj Shqipërisë, ajo merr një rëndësi edhe më të madhe. Vepra i kushtohet një figure të madhe historike të njerëzimit në një moment të rëndë të jetës së tij, kur shpalosen karakteret njerëzore në tërë realitetin e vet. Puna e ambasadorit Bernstein, përkthyes i një vepre të një autori me origjinë shqiptare, shumë pak të njohur si i tillë në të gjallë të vet, jep një kontribut tjetër të çmuar dhe një vlerë të shtuar në karrierën e tij intelektuale, në atë kohë, nën petkun e frakut të diplomatit, në nderim të popullit shqiptar.

Qëkurse erdhi në fuqi, Musolini i ka vënë syrin Shqipërisë së vogël. Lufta europiane që pritej gjatë vitit të Musolinit, 1935, është shmangur falë përpjekjeve të Mbretit Zog të Shqipërisë, i cili e ka shpërfillur Musolinin. Ai ka mbrojtur me kurajë dhe zgjuarsi pavarësinë e vendit të tij kundër synimeve italiane për ta dominuar, militarizuar dhe kolonizuar atë që është quajtur *"Toka e Harruar e Europës"*. Pas Luftës Ballkanike, në vitin 1912, u arrit pavarësia, por gjatë Luftës së parë Botërore ajo e humbi përsëri pavarësinë, për ta ruajtur vetëm në Konferëncën e Paqes, kryesisht falë përpjekjeve të Presidentit amerikan Woodrow Wilson.

Bernstein, mjeshtër i analizave diplomatike

Bernsteini është pa diskutim një analist i zoti diplomatik. Nga shumë raporte që ai i dërgonte Departamentit të Shtetit do të veçojmë vetëm disa, të cilat lexuesi do t'i gjejë në vazhdim. Analizat e tij për vendin ku ishte akredituar dhe prognoza politike që ai paraqet, përbëjnë një model të shkëlqyer për çdo diplomat serioz, i cili nuk është vetëm raportues i thjeshtë i asaj që sheh në zhvillimet e ditës, por edhe pasojat e veprimeve, rrjedhojat e akteve të caktuara, implikimet që rrjedhin prej tyre dhe rezultatin final të tyre. Materialet e mëposhtme e vërtetojnë këtë më së miri, duke e bërë Bernsteinin një model të punës së diplomatit.

Shqipëria – Belgjika e Ballkanit

Pse Shqipërisë i referohemi si një prej zonave më të rrezikshme të Europës, ku ngjet shumë të fillojë luftë?

Kjo është një prej pyetjeve të shumta, të cilat m'i bëjnë shpesh amerikanët. Disa prej tyre janë: Ku është Shqipëria? Sa e vjetër është Shqipëria? A është shtet i pavaruar, apo koloni italiane?

Shqipëria nuk është vetëm vendi më pak i njohur, por edhe vendi i prezantuar më keq në Europën e sotme. Ajo është viktimë e propagandës së fabrikuar dhe shpërndarë në disa prej vendeve fqinjë për qëllime politike dhe egoiste të tyre.

Gazetarë të përgjegjshëm dhe vëzhgues seriozë vijnë rrallë në Shqipëri dhe në të shumtën e rasteve ata nuk rrinë aq shumë kohë, sa të mbrrijnë deri tek e vërteta. Në Ballkan thashethemet, hamendjet dhe intrigat janë aq mjeshtërisht të manipuluara, saqë edhe një vëzhgues shumë i zoti dhe me nivel të lartë e ka të vështirë të dallojë të vërtetën nga mashtrimi.

Shqipëria ka qenë e njohur me emrin "Toka e harruar e Europës", "Cinderella midis Kombeve", "Toka e Çudirave", "Çelësi i Adriatikut" dhe "Belgjika e Balllkanit".

Historia e Shqipërisë shkon thellë në kohërat para kristiane. Qyteti i Durrësit, i njohur si Durrahium, është dymijë e shtatëqind vjet i vjetër. Shqiptarët besohet se rrjedhin nga Ilirët e lashtë. Aleksandri i Madh i Maqedonisë ishte bir i një princeshe shqiptare. Qyteti i Butrintit në Jug të Shqipërisë, aty ku kërkimet e kohëve të fundit kanë sjellë në memorje përsëri skenat e pavdekshme aq të hershme të Virgjilit, ka një amfiteatër të jashtëzakonshëm më shumë se dymijë vjeçar. Kodra fenike, afër Sarandës, në Jug të Shqipërisë, rrethohet prej muresh

masive, të cilat e bëjnë atë një prej vendeve më të fortifikuara dhe akropolin më të gjerë të botës klasike. Grekët, romakët, sllavët dhe më në fund turqit e pushtuan Shqipërinë dhe e mbajtën atë, duke u munduar t'i imponojnë popullit të saj kombësitë e tyre, gjuhën, zakonet, në mes të atyre maleve të ashpra, por pa sukses. Madje as pesëqind vitet e sundimit turk, gjatë të cilave ata qenë të shtrënguar të përqafojnë fenë muhamedane, nuk ua zbutën shpirtin e tyre të pathyeshëm për pavarësi midis malsorëve të veriut dhe megjithë shtypjen më të egër të ushtruar mbi ta, ndalimin e librave dhe gazetave, prapëseprapë gjuha shqipe mbijetoi.

Sot Mbretëria e Shqipërisë zë një sipërfaqe, sa ajo e Belgjikës me një popullsi pak mbi një milion banorë. Mendohet se ka edhe një grup shqiptarësh jashtë vendit, i cili e tejkalon shumën një milion e gjysëm të shpërndarë andej-këndej sa në Greqi, Jugosllavi, Bullgari, Rumani, deri në SHBA.

Shqipëria është vendi i Europës që nuk ka hekurudha, ku njerëzit udhëtojnë me gomarë ose mushka, me kuaj dhe mjete motorike, por në të njejtën kohë ajo ka një shërbim të shkëlqyeshëm ajror, me një program të rregullt komunikimi brenda vendit si dhe me Romën, Selanikun dhe Triesten.

Gjatë revolucionit kundër Sulltan Hamitit, në vitin 1909, shqiptarët luajtën një rol të rëndësishëm edhe si rrebelë edhe si roje në mbrojtje të sulltanit. Ata e dallojnë veten si njerëz me vlera që nuk e njohin frikën. Rënia e Sulltan Abdyl Hamitit u pa prej shqiptarëve si mundësi për emancipim dhe çlirim nga despotizmi turk, por shumë shpejt ata u zhgënjyen, sepse turqit e rinj, në vend që t'i jepnin pavarësinë Shqipërisë, zbatuan një politikë shtrënguese të shovinizmit turk, duke e intensifikuar shtypjen e gjuhës shqipe, literaturës dhe shkollave.

Më 28 nëntor të vitit 1912, në portin shqiptar të Vlorës u shpall pavarësia e vendit prej një asambleje kombëtare. Aty u ngrit flamuri kombëtar shqiptar i ruajtur që në kohën e Skënderbeut. Ishte Ismail Qemali, i cili pas më shumë se katër shekujsh robërie, deklaroi shpalljen e pavarësisë së vendit.

Shqiptarët deshën që natyrshëm të zgjidhnin një udhëheqës të vetin, por ishin disa vende europiane veçanërisht Italia dhe Austria, të cilët kishin kandidatët e vet për fronin shqiptar. Princi gjerman Vilhelm Vid u zgjodh në krye të fronit shqiptar dhe u shpall Mbret i Shqipërisë, megjithatë, mbretërimi i tij ishte i shkurtër. I kërcënuar nga intrigat brenda vendit, froni i tij u trondit shumë shpejt. Fill pas shpërthimit të Luftës Botërore, princi ua mbathi këmbeve nga Durrësi me këshillën e miqve të tij dhe Këshillit të Ambasadorëve të huaj.[88]

Përse shqiptarët e kanë humbur besimin tek italianët?

Bernstein vëzhgon me vemendje të shtuar mardhënjet e Shqipërisë me Italinë dhe sheh se si shqiptarët çdo ditë e humbin besimin tek ai vend, për shkak të veprimeve të italianëve të cilat shiheshin nga populli shqiptar çdo ditë.

Monopoli i Naftës

Është vlerësuar që në fillim se benzina, kerozina, nafta e AGIP-it (Azienda Generale Italiana Petroli), firma që mban monopolin e shitjes së vajgurit në Shqipëri, ishte e përzier me ujë.

Motorët e SITA-s (Electric Light Plant), të cilët funizojnë me dritë dhe energji Tiranën, kishin ndaluar vitin e kaluar, për shkak të përmbajtjes së ujit të shtuar në lëngun e blerë prej AGIP-it dhe kryeqyteti kishte mbetur tri netë rresht pa drita, pa përmendur ndërprerje të tjera.

Dritat e legatës sonë u fikën në fillim, sepse gazolina që blemë nga AGIP-i përmbante ujë. Legata më pas u detyrua të kërkonte dërgesë karburanti nga SOC (Standard Oil Company e New Yorkut në Athinë).

Automobilët ndaluan në mes të rrugës, sepse motorët nuk funksiononin me atë gazolinë. Shumë prej këtyre automobilave u dërguan nëpër garazhe për një pastrim të plotë dhe rregullim të motorëve dhe në shumë raste u ndërruan pjesët e dëmtuara. Të gjitha këto për shkak të benzinës së përzier me ujë nga italianët.

Pronarët e uzinave të elektrikut, automobilëve dhe motorëve protestuan te qeveria për kushtet e benzinës së AGIP-it. Ministria e Financave vulosi dy fuçi gazoline për të gjetur nëse ato përmbanin përqindje të caktuar uji. Ministria kërcënoi se do të ndërpriste marrëveshjen, nëse gabimi nuk korrigjohej dhe nuk do të kompensoheshin humbjet e shkaktuara. AGIP-i ra dakort ta bënte këtë, por realiteti tregoi se bëri të kundërtën. Vetë fakti se tërë agjentët e AGIP-it dhe transportuesit në Shqipëri ishin italianë, i acaronte edhe më shumë shqiptarët."

Firmat italiane të ndërtimit

Në konkurencë me kontraktorët shqiptarë, italianët kanë bërë tendera me çmime më të ulëta dhe me terma më të mira në punët publike. Duket qartë se këto oferta dhe kushtet e tyre nuk kishin qëllim të mbaroheshin, siç e tregonte plotësimi i disa punëve publike. Firma italiane Michele Sacco & Figlio në Tiranë "*fitoi*" një

tender për ndërtimin e Spitalit Ushtarak.

Sipas Ministrisë së Punëve Publike, kjo ndërtesë kaq e madhe është më e shëmtuara ndërtesë moderne që është parë, madje një pjesë e madhe e saj ka mbetur e papërfunduar. E njejta firmë ka marrë kontrata për ndërtimin e urave të përmasave të ndryshme në rrugën Durrës – Elbasan. Shumica e këtyre urave doli se nuk ishin ndërtuar me materialet që ishin parashikuar në kontrata. Inxhinierët italianë, të cilët i inspektuan ato, i miratuan, por inxhinierët shqiptarë të dërguar më pas jo. Si rezultat, firma Michele Sacco & Figlio u shtrëngua t'i shkatërronte disa prej atyre urave dhe t'i rindërtonte sipas kontratave. Sa i takon Spitalit Ushtarak, firma ndërtuese shpalli falimentimin. Qeveria vendosi ta përjashtonte nga kontratat e tjera për punë publike dhe e largoi atë nga Shqipëria.

Sipas hetimeve zyrtare, punëtorët shqiptarë të punësuar nga ndërtuesit italianë në përgjithësi nuk e merrnin mëditjen, siç ishte premtuar fillimisht nga kompania, ndërkohë që në një numër rastesh firma ishte e detyruar të bënte pagesa të plota e në raste të tjerë të humburit ishin punëtorët. Të humburit më të mëdhenj ishin ata të Michaele Sacco & Figlio.

Sjellja e firmave italiane i inatosi firmat shqiptare të ndërtimit dhe shqiptarët në përgjithësi, pasi qytetarët e vendit të tyre aleat ishin të pasinqertë dhe të padrejtë në konkurencën që u bënin atyre në ankandet e punëve publike.

Del e qartë se konstruktorët shqiptarë nuk mund të bënin asnjë hap pa i miratuar punët e tyre nga inxhinierët italianë, të cilët i inspektonin. Pavarësisht nga kjo korrektesë e kontraktorëve shqiptarë, inxhinierët italianë, të cilët inspektonin në emër të Ministrisë së Punëve Publike dhe kryesisht në emër të SVEA-s (kompania huadhënëse) e bënin këtë të vështirë për shqiptarët, pasi zvarrisnin miratimin. Për këtë arësye kishte edhe vonesa në pagesat për punën e kryer nga SVEA. Për më tepër SVEA i detyronte kontraktorët shqiptarë të paguanin një komision prej 10% mbi llogarinë e kontrollit, me qëllim që të mund të bënin pagesat, ndërkohë që kontraktorët italianë nuk e paguanin atë komision.

Sacco & Figlio ndërtoi digën mbajtëse të lumit të Kirit që të mos dilte nga shtrati. Kjo digë, ose mur mbajtës ndaj ujërave, e cila ishte ndërtuar një vit më parë, në pranverë dhe që i kushtoi qeverisë shqiptare 200.000 franga ari, tanimë është fshirë nga faqja e dheut.

Sipas ligjit shqiptar të emigracionit, punëtorëve të huaj të pakualifikuar u ndalohej hyrja në vend. Për t'i shpëtuar këtij rregulli të shtetit shqiptar autoritetet italiane iu lëshonin pasaporta punëtorëve të pakualifikuar. Atyre iu shkruhej në pasaportë se ishin punëtorë të kualifikuar. Autoritetet shqiptare nuk kishin asnjë mundësi që ta hidhnin poshtë, ose t'i shpërfillnin deklarimet zyrtare të autoriteteve italiane në lidhje me profesionin e mbajtësit të pasaportës. Ky është fakt i vërtetë, pasi italianët të cilëve nuk u lejohej të zbrisnin në Durrës, apo në

Vlorë për shkak të statusit të tyre të punës, ktheheshin mbrapsht në Itali dhe shfaqeshin në portet shqiptare me anijen tjetër të radhës me një pasaportë të korrigjuar, e cila u jepte atyre statusin e mjeshtrit, ndërkohë që përsëri në këtë rast autoritetet shqiptare ishin të paafta t'i kundërshtonin këto veprime, ajo që mbetet ishte se italianët ishin të pandershëm. Qeveria dhe njerëzit heshtnin, por nuk harronin.

Është raportuar, jo në shtyp por me të thëna e të dëgjuara, se autoritetet e portit kanë kapur kohëve të fundit Kompaninë Mazzorana, që ndërton në Gjirin e Durrësit, teksa trafikonte punëtorë të pakualifikuar italianë. Puna bëhej duke lënë një prej tenderave të Mazzoranës të ishte e lidhur me një prej anijeve të transportit të udhëtarëve që vinin në Durrës. Anija ankorohej për atë natë vetëm që të zbarkonte punëtorët e pakualifikuar të hynin në qytet. Këta punëtorë më pas merreshin me mjete të tjera transporti dhe dërgoheshin në punët, për të cilat kishin ardhur.

Banka Kombëtare Shqiptare

Banka Kombëtare Shqiptare, një institucion italian, ka ndihmuar në rritjen e urrejtjes së shqiptarëve ndaj italianëve. Kjo bankë, e cila nuk ka konkurencë brenda vendit, pasi nuk ka bankë tjetër, po ua thith gjakun shqiptarëve. Qëndrimi i saj ndaj shqiptarëve është i padurueshëm. Për shembull punonjësit shqiptarë bëjnë punë të thjeshta dhe marrin shpërblime minimale. Pozitat e larta mbahen nga italianët, të cilët marrin rroga dyfish e trefish, krahasuar me ato të shqiptarëve, si dhe pagesën për qiratë e banesave, ngrohjen, elektrikun, ujin etj.

Kjo bankë ka tërhequr shumë monedha floriri nga vendi duke dhënë kartmonedha në vendin e tyre. Floriri është baza e monedhës në bankë, por dyshimi i shqiptarëve shtohet gjithnjë e më shumë se do vijë një ditë, kur kartmonedha, që ata kanë nëpër duar, nuk do të ketë më vlerë. Kur ajo u vendos këtu, i referohej vetëm frangave të arit. Kohëve të fundit ajo ka bërë një ndryshim radikal dhe e quan paranë shqiptare vetëm frang. Por frangu shqiptar nuk do të thotë franga ari.

Banka u jep hua afatshkurtra tregtarëve. Ajo i taton afërsisht dymbëdhjetë për qind, përveç shpenzimeve që duhen. Në fund të katër muajve që është periudha më e gjatë që huamarrësit i duhet të kthejë paranë e marrë borxh, atij i duhet të rinovojë kontratën, por komisionet e transaksioneve janë maksimalisht të larta. Ky institucion diskriminon në mënyrë të pashembullt.

Viti i Musolinit

Bernstein analizon ato çfarë Musolini synonte të arrinte në Tiranë. Në raportin e mëposhtëm ai nxjerr qartë pikërisht atë që Italia fashiste synonte të arrinte:

Viti Musolini ka arritur. Për shumë kohë diplomatët e Ballkanit dhe vëzhguesit kanë qenë të zënë me parashikimet se në vitin 1935 do të shihnin pikën kulmore të relizimit të filozofisë së luftës së Benito Musolinit, dhe se gjatë dy-tre viteve të fundit Ballkani ka ndjerë se një luftë është e pashmangshme, dhe se ajo do të vijë në vitin 1935. Ata nuk mund të thonë se kur do të ndodhë kjo, por janë të sigurt se ajo do të ndodhë.

Ngjarjet e fundit në Afrikë kanë sjellë opinione të tilla. Prej më se dy vjetësh Il Duce ka pushuar së vringëlluari shpatat. Ai predikon paqe dhe mbron çarmatimin. Ai si përherë insiston të jetë i barabartë në armatim me Francën. Përkundër kësaj, përgatitjet për luftë ecin me shpejtësi. Ai flet për paqen në Itali. Përfaqësuesi i tij Baroni Pompeo Aloisi fliste për paqe në Gjenevë, por programi imperialisto-fashist vazhdonte i pandryshuar në rajonet e konsideruara për dominimin Italian.

Qëkurse erdhi në fuqi Musolini ia ka vënë syrin Shqipërisë së vogël. Megjithëse veprimet e tij sensacionale militariste për momentin janë zhvendosur në Etiopi, ai prapëseprapë shpreson në dominimin e tij ndaj vendit malor ballkanik.

Lufta europiane që pritej gjatë vitit të Musolinit, 1935, është shmangur falë përpjekjeve të Mbretit Zog të Shqipërisë, i cili e ka shpërfillur Musolinin. Ai ka mbrojtur me kurajë dhe zgjuarsi pavarësinë e vendit të tij kundër synimeve italiane për ta dominuar, militarizuar dhe kolonizuar atë që është quajtur *"Toka e Harruar e Europës"*.

Për shkak të pozitës së saj gjeografike dhe për arsye se ajo ka qenë molla e sherrit midis fuqive ambicioze, që kërkonin kontrollin mbi këtë det të rëndësishëm Shqipëria mban çelësat e Adriatikut. Vendi njëherë e një kohë ka qenë i pushtuar prej romakëve, pastaj grekëve dhe sllavëve dhe më në fund ra nën zgjedhën turke për pesëqind vjet. Gjatë kësaj kohe, malësorët e paepur shqiptarë, të njohur si Populli i Shqipes, vuajtën shumë deri sa arritën te Pavarësia. Pas Luftës Ballkanike, në vitin 1912, u arrit Pavarësia, por gjatë Luftës Botërore ajo e humbi përsëri për ta rifituar vetëm në Konferencën e Paqes, kryesisht falë përpjekjeve të presidentit amerikan Woodrow Wilson.

Në vitin 1920, Shqipëria u pranua anëtare e Ligës së Kombeve pas një kërkese

këmbëngulëse të bërë në emër të pavarësisë së saj nga Lordi Cecil. Gjatë atij viti italianët pushtuan pjesën jugore të vendit. Të vendosur për të çliruar vendin e tyre nga pushtimi i huaj, udhëheqësit shqiptarë kërkuan tërheqjen e forcave italiane nga Vlora që ishte edhe porti kryesor i jugut të vendit. Kur italianët refuzuan të largoheshin, shqiptarët i përzunë ata me forcë. Forcat e tyre, edhe pse të pakta në numër dhe të organizuara keq e të pajisura mos më keq, treguan guxim të pashoq dhe strategji mjeshtërore në betejën për Vlorën. Këtë betejë nuk e kanë harruar as shqiptarët, as italianët. Megjithatë, italianët e përmendin shumë rrallë, pasi ajo përbën një poshtërim që ua bënë shqiptarët, ishte një grusht ndaj krenarisë së tyre kombëtare, njësoj si shkatërrimi që pësuan në Adowas[89] njëzet e pesë vite më parë.

Më pas Bernstein e përshkruan incidentin detar të vitit 1934 midis flotës luftarake italiane dhe autoriteteve shqiptare, i përshkruar me detaje në këtë libër, në një kapitull tjetër. Kjo kishte ndodhur në qershor të vitit 1934, kur Ministri Francez i Punëve të Jashtme Louis Barthou arriti në Jugosllavi, në vizitën e tij te Mbreti Aleksandër dhe një flotë italiane papritmas u shfaq në Gjirin e Durrësit.

Kështu në vitet e fundit ndikimi italian mbi Shqipërinë kishte filluar të venitej. Me ardhjen e krizës së Etiopisë dhe lajmet që shpërndanin sensacione, të cilat mbivendoseshin ndaj tërë zhvillimeve të tjera ndërkombëtare, Ministria e Jashtme italiane vendosi të përdorte një metodë edhe më të fortë për të frikësuar Mbretin Zog.

Sipas raporteve të autoriteteve, ishte Roma ajo e cila mbështeti një kryengritje të dështuar në Jug të Shqipërisë. Një grup i vogël aventurierësh shqiptarë ishte inkurajuar të rrëzonte regjimin e Zogut, madje edhe ta vrisnin Mbretin. Megjithatë, kur atentatorët hapën zjarr ndaj limuzinës mbretërore afër Fierit, ndodhi që personi, i cili po udhëtonte me të, të mos ishte Mbreti, por gjenerali Leon di Ghilardi[90] një simpatizues pro italian i njohur, i cili mbeti i vrarë.

Një prej verifikimeve më të forta të raportit është fakti që rrethi i drejtuesve të revoltës kërkoi menjëherë strehë përtej Detit Adriatik, në Bari dhe atje u mbrojtën prej qeverisë italiane. Pasuesit me më pak fat, që numëroheshin tetëdhjetë deri në njëqind vetë, u vunë para bankës së gjyqit në Fier dhe si rrjedhojë u dënuan.

Kjo revoltë qe e pasuksesshme, e megjithatë, mund të thuhet se e ka forcuar Mbretin Zog. Fill pasi mbaroi revolta, u njoftua nga Roma me dekret qeveritar se Italia po rifillonte dhënien e kredive të saj vjetore prej dhjetë milionë frangash ari Shqipërisë.

Kështu u rivendos marrëveshja dhjetëvjeçare, e cila mbaroi aq befas prej Musolinit dy vjet përpara. Ky hap, megjithatë, është thjesht lëvizja më e fundit e Mbretit Zog në këtë lojë të rrezikshme për të vënë një grup rival kundër tjetrit. Sa për interesat dhe profesionet sentimentale të Duces në Shqipëri, subvesionet e tij "*altruiste*" për militarizimin e vendit të vogël dhe trysnia e tij, kërcënimet e kërkesat për lëshime të veçanta nuk kanë arritur të frymëzojnë ndonjë miqësi ose respekt për Italinë te shqiptarët.

Diktatori i fuqishëm fashist në fakt u vu në majë të gishtit shpesh herë prej Mbretit

Zog. Urtë e butë, i sjellshmi Ahmet Zogu, mjeshtëria qeverisëse e të cilit ishte e pazakontë, kur sheh se si ai dinte të kombinonte dhelpërinë lindore me finesën perëndimore në politikë, pasi e kuptoi se Pavarësia e Shqipërisë do të merrte fund, nëse vendi i tij bëhej skenë e një tjetër lufte të madhe, ndaj u mundua që me mjeshtëri të barazpeshonte interesat e tij dhe të vendit me interesat konfliktuale të Italisë në njerën anë, dhe ato të Jugosllavisë, Francës dhe Antantës së Vogël, në anën tjetër. Tërthorazi ai, në fakt, po punonte kështu për paqen në Ballkan. Ishte e sigurt se çdo shkelje e hapur e pavarësisë së Shqipërisë prej një vendi tjetër, do të shërbente si një sinjal për një deklarim lufte midis vendeve të tjera.

Ndërkohë Franca kishte ofruar t'i jepte Musolinit dorë të lirë në Afrikë në këmbim të vetëpërmbajtjes së oreksit të saj në Ballkan dhe transferimin e fuqisë së barutit nga Shqipëria në Etiopi. Fatkeqësisht për Etiopinë, Pavarësia e saj nuk është e një rëndësie të tillë për vendet të tjera, sa t'i tërheqë ato në një luftë për mbrojtjen e saj. Musolini e sheh luftën në Etiopi si çështje të tij private. Ai po e shpërfill opinionin botëror, duke injoruar detyrimet e tij ndërkombëtare, duke u përgatitur për të imponuar ndikimin "*civilizues*" të fashizmit të tij mbi popullin e varfër e të prapambetur të Etiopisë me mjete të tilla si forca e armëve, gazi helmues dhe aeroplanët bombardues.

Lufta e planifikuar nga Musolini për të filluar në vitin 1935 në Ballkan do të fillojë më parë në Afrikën Lindore, nëse tërë përpjekjet për ta ndaluar këtë dalin bosh. Por a mund të parashikojmë ne ku dhe si do të përfundojë ajo?

Raport i bisedës së Herman Bernsteinit me diplomatët e huaj

Bernsteini zhvillonte biseda me kolegët doplomatë të akredituar në Tiranë, prej të cilëve ai mësonte shumë rreth politikës së vendeve të tyre ndaj Mbretërisë Shqiptare. Në lidhje me këto takime ai raportonte kështu në Departamentin e Shtetit:

> Kam nderin të raportoj disa prej komenteve të bëra gjatë një bisede me Ministrin italian, Sola, Ministrin jugosllav dhe Ministrin britanik, Sir Robert Hodgson, pas vizitës që patëm në Flotën e Durrësit.

Ministri italian shpjegon motivet pas së cilave fshihen interesat e Italisë

> Shqipëria është ndoshta shteti më interesant në Europë. Ne jemi dëshmitarë të fazës së zhvillimit të saj si komb. Ajo ka lindur vetëm disa vite më parë, por tashmë është një komb, ndërkohë që është ndoshta kombi më i vjetër në Europë. Ky komb nuk pati një shtet deri tani vonë. Shqiptarët janë një popull i veçantë. Ata nuk u ndryshuan dot as nga grekët, romakët, sllavët dhe as nga turqit. Thjesht mbetën shqiptarë. Në fillim ata ishin kryesisht të interesuar për shtëpitë e tyre të vogla plot me kopshtie, pastaj për familjet e tyre dhe më pas për fiset e tyre. Por tani ata janë bërë komb. Patriotizmi i tyre është rritur. Ndihma që po i jep Italia është e lidhur edhe me këtë fakt. Ne kemi rreth njëqind mësues në këtë vend në shkolla ushtarake dhe civile dhe po i mësojmë të këndojnë, marshojnë dhe të duan vendin e tyre. Kemi organizuar rreth pesëmbëdhjetë mijë të rinj të Shqipërisë në këtë lëvizje patriotike. Për të qenë i sinqertë me ju, ne po i bëjmë të gjitha këto për qëllime egoiste. Ne duam që Shqipëria të rritet si shtet, pasi jemi të sigurt që ajo nuk do të vdesë kurrë, sepse kombet nuk vdesin. Ne jemi të interesuar në rritjen e patriotizmit shqiptar, jo për arsye sentimentale, por po aq dhe për interesat tona. Nuk duam që ndonjë shtet tjetër të vijë në Shqipëri dhe të ushtrojë ndonjë ndikim dominues këtu. Është e natyrshme padyshim që, kur një vend ndihmon një tjetër aty do të ketë edhe dyshime dhe një masë të caktuar mosbesimi. Është e vërtetë që disa shqiptarë janë dyshues ndaj motiveve që fshihen pas ndihmës së dhënë nga Italia. Unë jam i kënaqur të shoh një dyshim të tillë, sepse kjo na provon se Shqipëria është me të vërtetë duke u bërë shtet, tepër e kujdesshme në ruajtjen e Pavarësisë së saj. Ne jemi të kënaqur në mënyrë të veçantë ta shohim këtë, pasi e ndjejmë se mosbesimi i shqiptarëve ndaj Italisë, e cila po e ndihmon atë, bën që ajo të mos lejojë ndërhyrje të tjera në Pavarësinë e saj prej ndonjë vendi tjetër. Ne nuk kemi ndonjë motiv tjetër veç atij që të ndihmojmë Shqipërinë të ngrihet si vend i pavarur. Po të gjykojmë nga progresi i pashoq që ka bërë ky vend i vogël gjatë tre viteve të fundit, unë ndihem besimplotë se ajo do të bëhet vend vërtetë i mrekullueshëm brenda një kohe të shkurtër.

Për të ilustruar marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Italisë ai shtoi:

> Vendet nuk e ndihmojnë njëri-tjetrin për arsye sentimentale. Së pari, ata ndihmojnë njëri-tjetrin për motive egoiste, krejt si partnerë në ndërmarrje biznesi. Dy partnerë në biznes, më së pari përpiqen të ndërtojnë marrëdhënien midis tyre për interesat e veta, për përfitimet që merr secila palë. Pastaj, në rrjedhë të kohës, pasi mësohen me njëri-tjetrin, ata mund të bëhen miq, dhe si

rrjedhojë mund të ndodhë që i biri i njërit prej tyre të martohet me vajzën e tjetrit. Të tëra fillojnë me një motiv egoist, por më pas mund të vijohen prej sentimentit, miqësisë dhe dashurisë.

Ministri jugosllav për marrëdhënit italo – shqiptare

Unë sapo kam përmbyllur një udhëtim nëpër Shqipëri. Kam vënë re se nuk ekziston as më i vogli entusiazëm për italianët, sidomos gjatë vizitës së kohëve të fundit të Flotës Italiane në Durrës. Shqiptarët nuk janë fare entuziastë për skemën italiane në Shqipëri. Në fakt ata nuk i pëlqejnë italianët. Ata vërejnë depërtimin ekonomik dhe politik të Italisë në çdo skaj të vendit dhe e kanë zët atë. Italia po bën gjëra në Shqipëri, me qëllim që të krijojë këtë përshtypje ndaj njerëzve, që të bëhen dashamirës me të, por shqiptarët shohin më tutje dhe janë të pakënaqur. Jugosllavët kanë bërë shumë më shumë. Mbreti Zog qëndroi rreth një vit në Beograd. Ne i dhamë atij dhe enturazhit të tij një pagesë substanciale mujore dhe më pas e kthyem mbrapsht në Shqipëri.

Mbreti Zog po mban një qëndrim shumë korrekt në drejtim të Jugosllavisë. Ai më ka kërkuar këto kohë ta ndihmoja me këshilla se cila është mënyra më e mirë për të ruajtur Pavarësinë, pa rënë nën dominimin e Italisë. Unë i thashë atij (Mbretit) se Jugosllavia nuk është e interesuar në asgjë tjetër përveçse Shqipëria të jetë një vend i pavarur dhe po ashtu e sigurova atë se fuqitë drejtuese të botës individualisht dhe kolegjialisht ishin të interesuara në ruajtjen e një Shqipërie absolutisht të pavarur. Mbreti është shumë burrë i zgjuar, më i zgjuari midis shqiptarëve funksionarë dhe diplomatë. Ka pak shqiptarë që janë patriotë të vërtetë dhe që kanë guximin t'i tregojnë Mbretit ndershmërisht pikëpamjet e tyre në lidhje me interesat e Shqipërisë. Një prej këtyre patriotëve është Konica, ish ambasadori në Londër[91]. Ai nuk ka frikë t'ia thotë Mbretit të vërtetën. Tërë të tjerët thjesht marrin urdhëra dhe i tregojnë atij gjëra, të cilat ata mendojnë se ai ka dëshirë t'i dëgjojë.

Shpirti luftarak po bie dukshëm në Ballkan. Popujt nuk kanë harruar tmerret e luftrave të fundit dhe kanë zbuluar se vetëm puna dhe progresi ekonomik i çon vendet e tyre drejt shpëtimit. Shqipëria është shtet ballkanik dhe në të vërtetë nuk ka asgjë të përbashkët me Italinë, prandaj nuk i pëlqen italianët.

Sir Robert Hodgson, Ministri Britanik[92]

Ndërkohë që është e vërtetë se mosmarrëveshjet midis interesave italiane dhe jugosllave në Shqipëri kanë rënë në një farë mase, unë besoj se ende presim telashe të reja. Serbët ende kacavirren në shpirtin e tyre dhe duket se do të ketë një shpërthim. Pas tërë këtyre serbët kanë përfituar shumë nga lufta dhe në zemrat e tyre ata janë

ende duke e qarë një luftë tjetër. Në të vërtetë, jugosllavët janë përgjegjës për kthimin e Mbretit drejt Italisë. Jugosllavët besojnë se për shkak se e ndihmuan Zogun të kthehej këtu nga Beogradi, ata do ta kontrollonin atë plotësisht. Ata mburren për këtë, prandaj e detyruan të binte në krahët e Italisë. Kredia italiane e ka lidhur Mbretin Zog me Italinë dhe duket se nuk ka mundësi të dalë prej këtyre kthetrave, sepse Mbreti nuk ka para, që të paguajë kreditë mbrapsht. Mbretit vetë nuk i pëlqen dominimi italian, por nuk ka çfarë të bëjë. Jugosllavët janë pajtuar tani me Traktatin e Miqësisë midis Shqipërisë dhe Italisë dhe po përpiqen të nxjerrin më të mirën prej tij. Ata e kanë kuptuar se nuk është e dobishme të vazhdojnë politikën e irritimit.

25 Ambasadorët e huaj të akredituar në Tiranë në kohën kur shërbente Herman Bernstein. Në të majtë, Ministri britanik Sir Robert Macleod Hodgson. Në të majtë të qendrës Herman Bernstein me kapele republika në dorë

"Sot, në këtë moment, kur kam marrë besimin e popullit tim, të shprehur nëpërmjet jush dhe ndërgjegjes suaj, i ngarkuar me detyrën e lartë të drejtimit të shtetit me gjithë vështirësitë dhe përgjegjësitë e larta që ajo mbart, ju premtoj se nuk do të harroj asnjëherë detyrimin tim moral ndaj popullit shqiptar, i cili herët ose vonë do të ngrihet me energji të pashtershme në lartësinë e një kombi, midis kombeve."

Nga fjala e Ahmet Zogut, ditën e shpalljes Mbret I Shqiptarëve.

Historia e Mbretit Zog I – rë

Historia e sundimtarit shqiptar siç e ka treguar ai në vetën e tretë.[93]

26 Stema e Mbretërisë Shqiptare

27 Mbreti Zog i rrëfen historinë e tij Ambasadorit Herman Bernstein, e para biografi e tij e shkruar deri në atë kohë.

28 E PLURIBUS UNUM

.

Historia e Ahmet Zogut, njeriut që luajti rol shumë të rëndësishëm në historinë e Shqipërisë, që pas shpalljes së pavarësisë, ka qenë për dhjetëvjeçarë të tërë e mbushur vetëm me baltosje, të pavërteta dhe fyerje nga më të ndryshmet. Regjimi komunist e bëri këtë me mjete dhe forma nga më të egrat. Brenda vendit u përdor propaganda e shfrenuar e mbushur me mashtrime të të gjitha llojeve, duke e quajtur atë thjesht satrap dhe tradhëtar. Në planin e jashtëm veproi agjentura, e cila u përpoq shumë për eleminimin e tij fizik. Tërë mbështetësit e Ahmet Zogut, ose u arratisën, ose u ekzekutuan, ose u flakën nëpër kampe internimi dhe u lanë në mjerim dhe padije. Por ja që vjen një kohë dhe del në dritë një biografi, e para e këtij lloji e Ahmet Zogut, ashtu siç ia ka treguar vetë ai Herman Bernsteinit. Botimi i kësaj biografie përbën një zbardhje të një të vërtete historike. Ky material përveçse tregon natyrën, karakterin, veprimtarinë e Mbretit Zog, shpreh edhe pikëpamjet e tij për demokracinë amerikane dhe idetë e tij patriotike.

Bernsteini pohon se shkrimi i historisë së Ahmet Zogut I, Mbret i shqiptarëve, siç ia

ka treguar ai vetë, në përgjigje të një numri kërkesash të paraqitura prej tij, ka një interes shumë të madh sot, kur Shqipëria është duke u konfiguruar në lajmet botërore si qendër e kryengritjeve të reja. Shumica e historive të reja që kanë të bëjnë me Shqipërinë, të cilat dalin prej vendeve fqinjë janë bazuar në ekzagjerimet propagandistike dhe shtrembërimin e fakteve. Kjo histori jetësore e monarkut shqiptar e treguar prej vetë atij në vetën e tretë, zbulon ngritjen e jashtëzakonshme dhe rekordet unike të një ushtari, të një ish udhëheqësi revolucionar, Ministri të Brendshëm, Kryeministri, Presidenti dhe tani Mbreti të Shqipërisë. Ajo jep një pamje të jo të zakonshme, interesante të këtij vendi, një prej zonave më të ndjeshme të rrezikut në Europë, për shkak të pozicionit të saj gjeografik dhe rivaliteteve të vendeve tjera në Adriatik. Në galerinë e fotografive në fund të këtij libri gjendet edhe një foto e Mbretit Zog me Bernsteinin në breg të detit, në Durrës, e cila ilustron mjaft mirë konfidencialitetin midis tyre.

Zogollët

Ishte fundi i shekullit të pesëmbëdhjetë, kur i pari i derës së Zogollëve u vendos në krahinën veriore të Shqipërisë. Malësor krenar, ai e kishte ndjenjën e lirisë nën lëkurë trashëguar prej heroit kombëtar Skënderbeu, pas vdekjes së të cilit rezistenca ndaj turqve ishte bërë e pamundur. Në kohën kur Zogollët erdhën së pari në Mat, si derë veriore fisi të fortë, u bënë përsëri objekt përndjekjeje prej njerëzve të sulltanit, në pritje të ndonjë rebelimi, që dikush kërkonte ta drejtonte.

Kështu Zogu mori flamurin kundër Valiut turk, Gazi Bej, e luftëtarët e maleve u ngritën furishëm bashkë me të. Valiu u vra në luftimet që vijuan, ndërsa Zogu u bë sunduesi i Matit. Ishtë kjo koha, kur ajo familje, në atë kohë e krishterë, u shndërrua në fenë muhamedane. Në kthim, turqit do ta njihnin atë si sunduesin trashëgimtar të krahinës.

Aty, në ato male dhe pyje të egra, ku mund të ekzistojnë vetëm delet dhe burrat luftëtarë, fisi u zhvillua dhe jetonte i lirë. Pika ku kishin arritur luftëtarët e tyre respektohej anë e mbanë dhe shpesh ata thirreshin për të ndihmuar fiset e tjera të luftonin armikun e përbashkët, Turqinë.

Zogu i Dytë, djali më i ri i çifligarit, u vra në një prej këtyre betejave. Ai kishte marrë një thirrje të dëshpëruar për ndihmë nga drejtuesit e një fisi në jug të Shqipërisë dhe i mblodhi forcat e tij për luftë. Pas luftimesh të ashpra nëpër male, turqit ishin zmbrapsur, por gjatë tërheqjes Zogu u plagos për vdekje dhe u varros në Tiranë. Dita e vdekjes së tij është ditë zie dhe mbetet në kujtesën e përpjekjeve të tij heroike për çlirimin e vendit.

Për pesëqind vjet kjo familje sundoi Matin, përherë duke u përpjekjur të çliroheshin tërësisht nga dominimi turk. Midis tyre ishte për shembull Said bej Zogu, i cili u burgos

dhe u çua në azil për tërë jetën në Tripoli, për shkak të ndjenjave të tij patriotike dhe kundërshtimit të tij ndaj Sulltanit. Edhe atje në Tripoli ai nuk ndejti duarkryq. Ai arriti t'i bindte rojet e veta që ta ndihmonin në një kryengritje, e cila doli të ishte e suksesshme. Duke marrë qeverinë e atij vendi afrikan në duart e veta, ai ia diktoi kushtet qeverisë së mundur turke. Kështu u arrit një marrëveshje, të drejtat e tij u njohën dhe ai u kthye si triumfator në Shqipëri.

Pastaj vjen Xhelal pashë Zogu i cili ishte i pari i Matit nga mesi i shekullit të tetëmbëdhjetë. Pasi e mori qeverisjen, ai udhëtoi drejt Rusisë ku pas shtatë muajsh pritjeje, arriti të takohej me Carin. Rusia në atë kohë kishte ndikim të madh mbi çështjet turke dhe Cari premtoi të përdorte fuqinë e vet në ndihmë të Zogut, prandaj ai u kthye në Kostandinopojë, ku u nënshkrua një dekret, i cili e emëronte atë guvernator të Shqipërisë dhe Epirit. Por bash në ditën e nënshkrimit të dekretit turqit e helmuan atë.

I biri, Xhemal pashë Zogu, u bë më pas udhëheqësi i fisit malsor deri sa vdiq në vitin 1903. Gjatë sundimit të tij, në vitin 1878 u formua Lidhja Shqiptare, me qëllim që të siguronte pavarësinë e vendit dhe të luftonte kundër çfarëdo ndarje të tij. I vëllai i Xhemalit ishte një prej mbështetësve më të rëndësishëm të asaj lëvizjeje dhe punoi për përgatitjen e një kryengritjeje mbarëkombëtare, por Turqia e shtypi atë kryengritje me një ushtri të madhe dhe i vrau tërë udhëheqësit e saj. Edhe një herë liria e shqiptarëve u mor peng prej armikut të saj të vjetër.

Këto ishin rrethanat, kur më 8 tetor 1895 lindi Ahmet Zogu atje lart në Kështjellën e Burgajetit, në malet e larta të Shqipërisë, në vendin e të parëve të tij.

Fëmijëria

Ahmeti i kaloi tetë vitet e para të jetës së tij në fshatin Burgajet. Në heshtjen dhe dinjitetin e kodrave të dendura pyjore dhe luginave të ngushta në formë V-je, djali jetoi në një atmosferë të atij dinjiteti të lartë dhe të qetë, i cili duket të jetë i natyrshëm për të gjithë malet dhe malësorët, që jetojnë aty. Ai dëgjoi këngët e popullit për heroizmat e paraardhësve të tij. Kur u bë tetë vjeç, i ati vdiq, por ende pa u mbyllur zia për vdekjen e babait, nëna vendosi ta dërgonte djalin në një shkollë në Kostandinopojë. Kështu, në vitin 1903 ai u largua për në kryeqytetin e Perandorisë Osmane, i shoqëruar nga një kujdestar.

Sapo arriti në Kostandinopojë, Ahmeti hyri në Lice. Kontaktet me shokët e tij studentë ishin tejet të kufizuara, pasi interesat e tij ishin tërësisht të ndryshme nga ato të të tjerëve. Në fakt, ai gjithmonë gjente arsye për t'u larguar nga shkolla, në mënyrë që t'u bënte thirrje politikanëve të ndryshëm shqiptarë dhe turq, të cilët e lejonin atë, thjesht një fëmijë, të diskutonte me ta çështjet e ditës.

Me t'u diplomuar në Lice, Ahmeti hyri në shkollën ushtarake turke, me qëllim që të ndiqte shembullin e paraardhësve të vet luftëtarë.

Gjatë viteve që Ahmeti ishte në shkollë, Turqia po kalonte në një fazë të vështirë tranzicioni. Në vitin 1908, kur Ahmeti ishte trembëdhjetë vjeç, xhonturqit shpallën Kushtetutën e Perandorisë Osmane, duke siguruar respektimin e të drejtave të kombeve që ishin nën zgjedhën e tyre. Gëzimi dhe entusiazmi qenë të pakufishëm. Shqiptarët të shtypur për shumë kohë e pritën këtë ndryshim politik me brohoritje. Tani ata shpresonin se të drejtat e tyre, të cilat ishin privuar për aq shumë kohë, më në fund do të njiheshin dhe respektoheshin.

Në të vërtetë me shpalljen e kësaj kushtetute të re turke në vitin 1908 u duk se do të fillonte në vend një periudhe e re e mësimit dhe kulturës shqiptare. Gazetat shqiptare filluan të publikoheshin. Librat shkruheshin në gjuhën amtare për herë të parë, klubet kombëtare shpërthyen gjithandej, u hapën shkolla dhe me këtë shije të lirisë Shqipëria filloi të mendonte për çlirimin e saj të plotë.

Ahmet Zogu po e ndiqte këtë zgjim kombëtar në distancë, që nga shkolla e tij në Kostandinopojë. Çdo libër, çdo gazetë, çdo revistë që dilte në gjuhën shqipe gjendej në tavolinën e tij.

Dy vjet më vonë revolucioni më në fund shpërtheu, duke u shpërndarë me shpejtësi në tërë vendin. Kur luftimet midis shqiptarëve dhe turqeve filluan në Grykën e Kaçanikut, djali ndiqte me interes të madh çdo incident, duke pritur çdo ditë të dëgjonte lajmin e mirë të shpëtimit. Por ushtria e fuqishme turke i përfshinte të tërë, duke shkatërruar vendin dhe torturuar popullin dhe duke e ngushtuar zgjedhën e të nënshtruarve. Ahmeti u zhgënjye.

Në vitin 1912 plasi përsëri revolta. Trupat shqiptare kapën Shkupin dhe marshuan drejt Manastirit. Gjithandej, që nga malet e veriut deri tek tokat pjellore të jugut, lëvizja kombëtare ishte përhapur si vetë zjarri.

Tani Ahmet Zogu nuk mund të qëndronte më duarkryq dhe ta vështronte atë që ndodhte në vendin e tij nga larg. Më në fund në qershor, fill pasi një forcë prej 20.000 shqiptarësh kishte hyrë në Shkup triumfalisht, ai e la shkollën dhe shkoi në Mat për të ndihmuar popullin e vet të luftonte për çlirim kombëtar.

Me Princ Vidin

Kryengritja shqiptare qe e suksesshme. Udhëheqësit e saj e shpallën triumfalisht pavarësinë e vilajeteve të Kosovës, Shkodrës, Manastit dhe Janinës. Kjo fitore ishte një prej shkaqeve kryesore të Luftës së Parë Ballkanike. U formua një aleancë me qëllim ndarjen e vendit dhe dhënien pjesëve të tij shteteve ballkanike. Më 8 tetor 1912 Mali i Zi shpalli luftë. Ahmet Zogu tani me gradën kolonel gjendej në Mat. Ai ndërmori menjëherë mobilizimin, për të luftuar këtë armik. Me dymijë burra, luftëtarë të vendosur, të gatshëm për ta mbështetur, i la malet e vendlindjes dhe u nis atje ku e thërriste atdheu. Në Lezhë ai u ndesh me armikun, i cili ishte i pozicionuar mirë dhe e

tejkalonte shumë në numër. Malazezët i kërkuan atij dorëzim pa kushte. Kolonel Zogu e kuptoi se do të ishte e kotë t'i sulmonte. Këtu nuk ishte çështje taktike ushtarake, por zgjuarsie kombëtare. Ai shpalli se ishte gati të dorëzohej, por përpara se ta bëntë këtë duhej t'i takonte udhëheqësit e palës armike. Më pas u kthye dhe luftoi në rrethana krejt të pabarabarta me një ushtri serbo – malazeze, duke lënë qindra të vrarë dhe të plagosur në çdo fushë beteje.

I gjendur pa municion dhe për më tepër me një numër të vogël luftëtarësh, kolonel Zogu u përpoq të çante mes për mes zonës, që kontrollohej nga forcat e armikut dhe arriti të hynte në qytetin strategjik të Shkodrës. Aty mori lajme shumë të këqija për përparimin e forcave të freskëta të serbëve nga lindja drejtpërdrejt mbi të. Kjo ngjarje e paparashikuar e detyroi atë të ndryshonte planin. Ai tërhoqi trupat e tij dhe u kthye në Mat, ku mori masa që të siguronte vendin nga pushtuesit. Duke riorganizuar forcat e tij, ai kapi tërë postat kufitare dhe u përfshi në luftë guerrile kundër serbëve. Kjo formë e mbrojtjes kundër vërshimit të serbëve rezultoi të ishte jo aq e efektshme. Forcat kundërshtare ishin të shumta për t'u luftuar prej një ushtrie të një vendi të vogël si Shqipëria. Ishte e nevojshme të përdoreshin disa armë të tjera për mbrojtje, një e tillë shumë më e efektshme dhe shumë më pak shkatërrimtare ishte diplomacia.

Kështu, ndërkohë që Zogu ishte i zënë me mbrojtjen e kufijve të vendit, një patriot tjetër, Ismail Qemali, i ftoi të gjithë udhëheqësit e rëndësishëm të takoheshin në një Kongres Kombëtar në Vlorë. Këtu do të vendosej një kurs veprimi, të cilin do ta ndiqnin shqiptarët. Edhe Zogu ishte midis të ftuarve. Me njëzet e pesë djelmosha, si një gardë e armatosur mbrojtëse, ai u nis për në Vlorë. Në atë kohë ai ishte vetëm shtatëmbëdhjetë vjeç. Delegatët u takuan në Nëntor 1912 dhe më 28 u shpall Deklarata e Pavarësisë. Zogu planifikoi të kthehej menjëherë në Mat. Që kur kishte ikur ai, serbët i kishin mundur bashkëfshatarët e tij në të gjitha anët, kishin vrarë shumë udhëheqës të ndryshëm të rëndësishëm dhe praktikisht e kishin marrë krejt Shqipërinë nën kontroll.

Ismail Qemali deshi që ai të rrinte në Vlorë dhe ta ndihmonte në rregullimin e punëve të qeverisë. Megjithatë Zogu e ndjeu se kishte detyra ndaj vendit dhe fisit, prandaj vendosi të kthehej në vendlindje.

Ai dalëngadalë u nis për në veri, duke udhëtuar natën e duke pushuar ditën, nëpër pyje dhe shpella. Më në fund, me vështirësi të jashtëzakonshme hyri në Mat, ku edhe njëherë arriti të dilte në krye të vëllëzërve në luftën kundër armikut.

Kur Shqipëria e shpalli Pavarësinë, Fuqitë e Mëdha i futën menjëherë duart aty. Kandidatët për fronin shqiptar ishin të panumërt. Shqiptarët e ndjenin se duhej të sundoheshin prej një shqiptari, por Vjena dhe Roma refuzuan t'u jepnin atyre aq shumë liri dhe u pajtuan të zgjidhnin Princ Vidin, një fisnik gjerman, jo i ndonjë sëre aq të lartë, si Mbret të Shqipërisë. Zogu shfaqi papajtueshmëri me këtë dhe njoftoi Komisionin Ndërkombëtar të Kufijve se e drejta e zgjedhjes i takonte një Asambleje Kushtetuese të popullit shqiptar. Kundërshtimi i tij nuk u mor parasysh. Duke kuptuar kotësinë e kundërshtimit ndaj Fuqive të Mëdha në atë moment, Zogu i paraqiti përgëzimet e tij

Princit dhe e siguroi se do ta mbështeste me tërë fuqinë e tij. Në këtë mënyrë, ai besonte se vendit do t'i jepej një mundësi që të ngrihej edhe një herë në këmbët e veta.

Kishte të tjerë që nuk mendonin si ai. Në Maj 1914, shpërtheu një kryengritje e cila u përhap shpejt nëpër tërë pjesën qendrore të vendit. Qeveria, ende e paorganizuar, nuk ishte e aftë të përballonte forcat rebele dhe çdo natë Durrësi (që ishte kreyqyteti i përkohshëm) goditej prej tyre. Mbreti i mbrojtur vetëm prej pak ushtarësh nga veriu i vari të vetmet shpresa te ndihma, që mund t'i vinte nga Mati i Zogut. Me një forcë prej katër mijë burrash Zogu u nis nga fshati i tij edhe një herë dhe arriti në Krujë, ku i mposhti rebelët në atë territor dhe priti të furnizohej me municion përpara se të marshonte për në Tiranë dhe Durrës.

Ndërkohë një ushtri tjetër që vinte nga verilindja iu bashkua forcave të Zogut, por pasi kishin plaçkitur e djegur shumë fshatra u kthyen në Lezhë, pa lëvizur përpara. Kjo tërheqje e papritur e përforcimeve të domosdoshme e detyroi Zogun të priste në Krujë më gjatë, sesa kishte menduar. Pikërisht në kohën, kur ai ishte i gatshëm të marshonte, Princ Vidi e kishte humbur plotësisht kontrollin e situatës. Ai nuk i dërgoi Zogut instruksionet për planin e tij të veprimit, me të cilin të koordinohej. I zhgënjyer deri në indinjatë, ky u kthye përsëri në Mat.

Shpërthimi i Luftës Botërore

Kthimi i Zogut në Mat me pasuesit e tij ndodhi në një prej momenteve më kritike në rrugëtimin e vështirë të Shqipërisë. Tërë rajonet jugore të vendit ishin djegur dhe shkatërruar prej grekëve pushtues. Edhe lindja kishte rënë në duart e grekëve, ndërsa veriu kontrollohej prej rebelëve. Qeveria e Princ Vidit mbante vetëm qytetin e Durrësit. Edhe atë me vështirësi. Meqënëse situata ishte mjaft kritike, një Këshill i Ambasadorëve së bashku me Komisionin e Kontrollit u takuan më 2 Gusht 1914. Ata vendosën që Fuqitë e Mëdha të mos ndërhynin më tutje. Ata e këshilluan Princ Vidin ta linte postin, të ikte nga Shqipëria dhe ta dorëzonte qeverinë në duart e Komisionit. Ndërkohë vritet Princi i Kurorës së Austro- Hungarisë[94], në Sarajevë. Furtuna që pasoi e hodhi Shqipërinë në harresën e të gjithëve, por jo edhe në atë të shqiptarëve. Zogu ishte në Mat gjatë ditëve të para të Luftës së Madhe, duke i kundërshtuar terroristët e qeverisë rebele. Bastioni i tij u bë një strehë e sigurtë e tërë nacionalistëve që iknin prej taktikave përndjekëse të rebelëve.

Në shtatorin e vitit 1914, fill pas largimit të Princ Vidit, revolta shqiptare u shkatërrua dhe filloi reaksioni. Të udhëhequr prej Myftinisë së Tiranës, kjo kryengritje e zhyti vendin në një det anarkie, të cilës nuk i dukej fundi. Nëse dikush do të guxonte ta kundërshtonte këtë lloj kryengritje, atij i digjej shtëpia menjëherë, burgosej ose vritej ndërsa pasuria i konfiskohej. Flamuri shqiptar u zëvendësua me atë të Turqisë dhe populli u vu përsëri në trysni të tmerrshme. Vetëm në Mat, ku Zogu ia doli ta ruante

paqen, njerëzit mund të jetonin të pashqetësuar, pa kaos dhe jo nën terror.

Zogu qëndroi në Mat deri në pranverën e vitit 1915. Më pas, ndërkohë që ushtria serbe e ndjekur prej austriakëve u zpraps nga Shqipëria, por mbajti Elbasanin, ai filloi të mblidhte trupa për të luftuar përsëri. Atij iu komunikua se njëfarë udhëheqësi tjetër shqiptar Esat Pasha kishte bërë marrëveshje të fshehtë me serbët, për të sulmuar dhe pushtuar krahinën e tij. Kështu, sa herë armiqtë e rinj shfaqeshin, Zogu ishte gati të luftonte për mbrojtjen e vendit të vet.

Esat Pasha e kishte lidhur fatin e tij me atë të serbëve, ndaj ishte i detyruar t'i deklaronte luftë Austro-Hungarisë, kur kjo e fundit pushtoi Serbinë. Në një seri betejash që arritën kulmin në përplasjen e tyre në Malet Lovchen dhe pushtimin e Malit të Zi, austriakët kishin përparuar drejt Shkodrës dhe hynë në qytet në janarin e vitit 1916.

Zogu vendosi të bënte aleancë me austriakët. Kur austriakët arritën afër Matit, ai iu bashkua atyre me trupat e tij dhe marshuan drejt Durrësit. Këtu Esat Pasha dhe një ushtri italiane ishte në fushim, por ata menjëherë lundruan përtej Adriatikut, duke i lënë hyrje të lirë Zogut dhe aleatëve të tij. Flamuri shqiptar edhe një herë u ngrit krenar. U formua një qeveri lokale, ndërsa marshimi vazhdoi drejt jugut.

Zogu u bë tani komandant i përgjithshëm i tëra forcave besnike, kur ishte vetëm njëzet e dy vjeç. Ai ende mbante gradën e kolonelit dhe mbante veshur kishte uniformë shqiptare, jo austriake.

Ai lëshoi urdhëra që në të gjitha nënprefekturat të formoheshin qeveri lokale. E rivendosi Qeverinë e Vidit me Aqif Pashën si Ministër i Brendshëm. U emëruan prefektët dhe nën-prefektët, u hartua një buxhet, dhe gjithë funksionet e tjera të qeverisë ishin gati të ndërmerreshin. Ndërkohë, Zogu i dërgoi një ultimatum komandës italiane në Vlorë, ku iu thoshte se ata kishin pushtuar një qytet, i cili ishte pjesë integrale e vendit, prandaj duhej ta lëshonin menjëherë.

Por jo të gjitha gjërat shkuan aq mirë sa deshi ai. Zogu e kishte lidhur vetveten me austriakët, pasi kishte besuar në deklaratën e Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë Austro-Hungareze deri në atë masë, sa besonte se ata *"po vinin si miq të Shqipërisë, me qëllim që të përzinin mbeturinat e ushtrisë serbe."* Ai besonte se nuk kishte pengesë që të ndalonte formimin e një qeverie kombëtare dhe prandaj ndërmori iniciativën për mbledhjen e një Asambleje Kushtetuese në Elbasan në marsin e vitit 1916. Në këto kushte ftoi delegatë nga i tërë vendi, madje edhe prej kolonive shqiptare në Bukuresht, Sofje, Lozanë dhe vende të tjera "*për të diskutuar çështjet e Shqipërisë dhe për të vendosur për fatin e saj*".

Për më tepër ai i paraqiti qeverisë austriake një fakt kuptimplotë: Kishte rivendosur qeverinë e Princ Vidit. Ish ministrat e kabinetit të Vidit nuk ishin larguar nga postet vullnetarisht, por ishin detyruar të iknin me dhunë nga vendi. Tani që kjo dhunë kishte pushuar, duhej të mbretëronte ligjshmëria.

Kongresi i Elbasanit, sipas pikpamjes së Zogut, do të ishte vazhdim i Kongresit të Vlorës. Tani pas barbarizmave greko-serbe në Shqipëri, pas shkatërrimit të

kryengritësve, pas pushtimit greko- serb dhe pas dhunimit të pavarësisë së garantuar me kaq shumë bujë në Londër, Kongresi i Elbasanit do të vendoste mbi fatin e mëmëdheut të shqiptarëve. Dhe kjo në një kohë, kur Shqipëria e Jugut po shtypej prej grekëve, Vlora prej italianëve, lindja prej bullgarëve dhe pjesa tjetër e vendit prej austriakëve. Me tërë këto në mend, Zogu i shkruajti August Kralit, Komisionerit Civil Austriak në Shqipëri, si më poshtë:

> Ne vendosëm që Kongresi Kombëtar duhet mbajtur këtu më 18 mars, me qëllim që të sigurohet uniteti dhe bashkëpunimi midis fiseve shqiptare. Ai do të diskutojë se çfarë duhet bërë që vendi ynë të vihet në rrugën e përparimit, të gëzojë lirinë e përfituar me ndihmë e armëve të Perandorisë Austro-Hungareze, prej së cilës ne presim zgjerimin e kufijve tanë sipas parimeve të kombësisë.

Krejt të pakuptueshëm ishin austriakët që e ndaluan këtë lëvizje. Te një urë që të çonte drejt Elbasanit, të gjithë delegatët u kthyen mbrapsht me pretendimin se kishte shpërthyer kolera në krahinë. Austriakët e justifikuan veprimin e tyre qesharak, duke thënë: *"Ju duhet të mbani parasysh se tërë mbledhjet e natyrës politike janë të ndaluara."* Ata jo vetëm që e ndaluan mbledhjen, por edhe burgosën oficerë të caktuar shqiptarë duke paraqitur pretendime të sajuara.

Përveç kësaj, ushtria austriake e shpërndau tërë administratën kombëtare që ishte vendosur në Elbasan, duke marrë qytetin drejpëdrejt në duart e tyre. Prefektuarat e tjera, të cilat nuk kishin zyra qendrore u detyruan t'u nënshtroheshin rregullave austriake.

Të gjitha këto veprime kaq të hapura në kundërshtim me premtimet solemne të bëra prej Komandantit të Përgjithshëm austriak, e bindën Zogun plotësisht se këto premtime nuk ishin asgjë tjetër përveçse mjete politike për t'i zbutur mendjet e leshkove shqiptarë. Zogu shkoi menjëherë tek August Kral dhe te komandanti austriak. Pas një debati të nxehtë ai u prish keqas me ta.

Gjithsesi, përpara se ta linin të shkiste fare prej duarve të tyre, ata vendosën ta ftonin atë në Spalato (Split), ku iu ofrua një pritje e shkëlqyer mbretërore. Aty i treguan atij fuqinë e madhe njerëzore të ushtrisë austriake, flotën me anijet e fuqishme ushtarake dhe forcat ajrore. Ata u përpoqën ta bindnin mbi kotësinë e kundërshtimit ndaj një shteti të madh, por shumë shpejt e kuptuan se po humbisnin kohën me të dhe vendosën më mirë ta dërgonin në Vjenë ku do ta mbanin një vit të internuar.

Më 30 shtator 1918, Bullgaria papritmas nënshkroi një armëpushim me aleatët dhe austriakët u detyruan të evakuoheshin nga Shqipëria me shpejtësi. Kështu, në tetor të atij viti tërë territori shqiptar, që ishte i pushtuar prej austriakëve ra në duart e italianëve, përveç Shkodrës e cila ishte pushtuar prej francezëve.

Pas këtij dobësimi të mbrojtjes ushtarake austriake, Zogu priti vetëm një armëpushim të përgjithshëm, përpara se të kthehej në Shqipëri. Ai shkoi drejtpërdrejt në Mat, ku i

duhej të vendoste bashkë me forcat e tij se çfarë duhej të bënte për lirinë e Shqipërisë, e pushtuar tërësisht prej ushtrive të huaja.

29 Foto e Mbretit Zog I – rë dhuruar Abasadoirt Benrstein me autograf

30 Foto zyrtare e Mbretit Zog e botuar në National Geographic Magazine, 1931

Pasojat e Luftës së Madhe

Në fund të luftës nuk kishte as edhe më të voglën shenjë të vetëqeverisjes së lënë pas në Shqipëri. Nuk kishte pushtet të centralizuar, asnjë udhëheqës që të përfaqësonte një çështje për vendin dhe as të kërkonte të drejtat e tij.

Në këtë gjendje, ministri i Jashtëm italian Baroni Sonino, thirri një kongres në Durrës, i cili u mblodh ditën e Krishtlindjeve të vitit 1918. Italianët, të cilët kërkonin të kishin kontrollin e tyre mbi Shqipërinë, nuk e pëlqyen idenë e një qeverie mbarëkombëtare prandaj planifikuan në vend të saj një formë tjetër, një Këshill Ekzekutiv Italian, sa për t'i hedhur hi syve popullit shqiptar.

Megjithëse Kongresi u mblodh me këtë në mendje, ai nuk iu bind urdhërave të tij. Në vend të këtij Këshilli ata themeluan një qeveri të përkohshme, por asaj i mungonte autoriteti i duhur, prandaj Komanda Supreme Italiane vazhdoi të administronte vendin nëpërmjet përfaqësuesve të saj ushtarakë.

Nga Konferenca e Paqes në Paris nuk pritej asgjë më shumë sesa coptimi i Shqipërisë. Një principatë e vogël muslimane rreth e rreth Durrësit do të krijohej nën mandatin italian. Italia dhe Greqia do të merrnin atë që ende nuk ishte ndarë në feta ende. Sipas kësaj, në gusht të vitit 1919, dy përfaqësues të Qeverisë së Durrësit nënshkruan një marrëveshje me Italinë, duke i njohur protektoratin dhe duke pranuar Komisionerin e Lartë Italian. Ishin këto arsyet pse Zogu e kundërshtoi përfundimisht këtë qeveri të re

dhe e luftoi atë vazhdimisht deri në rënien e saj. Vendi ishte në gjendje anarkie, gjë që nuk jepte shpresa për të dalë nga pushtimi italian. Franca ia kishte lënë krahinat jugore Greqisë dhe shqiptarët, ngado që ishin, ishin tejet të dëshpëruar. Qenë emigrantët shqiptarë, të cilët përpiqeshin të gjenin një zgjidhje. Dukej se kishte pak shpresë për të ardhmen.

Në këtë moment kritik, delegatët shqiptarë në Konferencën e Paqes fshehtas i njoftuan bashkatdhetarët e tyre se nuk prisnin ndonjë ndihmë nga jashtë. Shpëtimi varej vetëm prej vetë shqiptarëve. Patriotët, edhe pse të demoralizuar, vendosën të takohen edhe një herë. U njoftua edhe Zogu, i cili bashkë me pasuesit e tij la Matin dhe u nis për në Lushnje, duke kaluar mespërmes ushtrisë italiane.

Në Lushnjë gjendej shtabi i trupave italiane dhe forcat po përqendroheshin aty, me qëllim që të ndalonin mbledhjen e propozuar të revolucionarëve, por duke njohur cilësitë e luftëtarëve matjanë të Zogut, italianët menduan se do të ishte më mirë ta lejonin Kongresin të bënte punën e vet. Të bindur se trupat e Zogut të stacionuara strategjikisht mbi kodrat që shihnin tërë qytetin, do t'i mbronin ata, delegatët bënë hapin tjetër dhe filluan mbledhjen, nga e cila doli një qeveri e përkohshme me Zogun ministër të Brendshëm. Ai u zgjodh me ovacione e u autorizua të kthehej në Tiranë dhe të merrte drejtimin e qeverisë në duart e veta, përkundër kundërshtimit italian. Ky i fundit u nis menjëherë për në kryeqytet.

Qeveria e Tiranës

Qeveria e Durrësit, duke parë që ishte e pamundur ta kundërshtonte Kongresin e Lushnjes, u vetëkyç në qytet, e ruajtur prej një ushtrie italiane. Qyteti gjendet në udhën që të çon nga Lushnja në Tiranë, pra ishte e domosdoshme të kalohej mespërmes. Zogu dhe pasuesit e tij u ballafaquan me mitralozët e italianëve. Oficeri në detyrë, e urdhëroi Zogun të ndalej dhe të mos përparonte më tej. Zogu i dërgoi fjalë se ai nuk do të ndalonte dhe se do t'i urdhëronte ushtarët e tij të kundërvepronin në rast provokimi. Oficeri në detyrë i komunikoi urdhrin që kishin për të hapur zjarr sapo t'i shihnin. Zogu përsëri i tha që të ekzekutone urdhrin, por italiani nuk e bëri këtë dhe shqiptarët ia dolën të përparonin drejt Tiranës. Aty arritën më 11 shkurt 1920. Duke parë se qeveria e re ishte shumë më përfaqësuese e popullit se ajo e tyre, anëtarët e regjimit të Durrësit u dorëzuan njëri pas tjetrit dhe u kthyen në shtëpitë e tyre. Më në fund kishte mbetur vetëm një përfaqësues, i cili më shumë zgjuarsi njohu sovranitetin e administratës së re.

Zogu tani e ndjeu peshën e përgjegjësisë në shpatullat e tij, pasi shqiptarët i kishin varur të tëra shpresat tek ai. Veri dhe jug, perëndim e lindje, ngado të ktheje kokën,

vendi ishte nën sundimin e huaj. Dhe sikur të mos mjaftonte vetëm kjo, fara e dyshimit dhe revoltës po shpërndahej anë e mbanë vendit. Në një anë ishte Mustafa Kruja që nxiste rebelim në krahinën e tij, në anën tjetër mburraveci Esat Pasha bashkëvepronte me tërë agjentët e tij me serbët dhe agjentët e tyre, me provokatorët rreth e rreth Shkodrës dhe andartët grekë në jug të vendit. Trazirat po përhapeshin atë pranverë të vitit 1920. Ishte një pozicion tej mase i vështirë i Zogut dhe qeverisë së tij të Tiranës. Duke marrë me mend rrezikun e madh që i kanosej vendit, ai i dërgoi këtë mesazh popullit të tij: *"Armiku nuk do të kalojë kurrë në vendin tonë si në një shtëpi pa zot. Trupat tona do bëhen fortesat, që do t'ju bëjnë ballë pushkëve dhe armëve të armikut."*

Në mars të vitit 1920 Zogu vendosi ta nxirrte Shkodrën nga duart e ushtrisë pushtuese franceze. Sipas kësaj, pikërisht pak para se t'ua dorëzonin jugosllavëve, ai hyri në qytet natën dhe e mori kontrollin mbi të. Populllsia e priti atë me gëzim, pasi ata i druheshin dominimit serb.

Kështu, qeveria e Tiranës kishte hedhur hapin e parë në drejtim të njohjes së fuqisë së saj anë e mbanë vendit. Praktikisht kishte filluar unifikimi i vendit. Tani që ishin marrë territoret veriore, ishte bërë e mundur hapja e Parlamentit të Shqipërisë, gjë që ndodhi më 27 mars1920.

Këshilli Kombëtar, i cili përfaqësonte dëshirat e tërë popullit shqiptar, e njohu qeverinë e Tiranës dhe shfaqi besimin tek ajo kur deklaroi: *"Qeveria, e themeluar me dëshirën e popullit, bazuar në masat energjike patriotike, e ka bërë Shqipërinë vend më të lirë me territor integral".*

Rajoni mbi të cilin qeveria ushtronte kontroll shtrihej në jug deri në Skrapar, përfshinte Shqipërinë Qendrore dhe shkonte deri në krahinën veriore të Shkodrës. Krahina e Gjirokastrës, sipas Marrëveshjes së Romës, ishte ende nën sundimin italo-shqiptar dhe kjo e detyronte Zogun të dërgonte një forcë aty, me qëllim që të merrte tërë zonën nën kontroll. Në prill të vitit 1920, tërë jugu iu bashkua qeverisë së Tiranës. Shpallja u bë nën tingujt e këngëve dhe marsheve ushtarake. Ushtria italiane u frikësua aq shumë nga këto manifestime, sa filluan ta lëshojnë vendin dhe të përqendroheshin në qytetin e Vlorës. Ndërkohë, lëvizja esadiste e pa shtypur krejtësisht kishte filluar të tregonte shenja jete në Prefekturën e Durrësit. Rebelët ndërprenë linjat telefonike dhe telegrafike, grabitën postat dhe në vende të ndryshme shkatërruan edhe rrugët.

Esati vetë ishte në Paris, ndërsa qeveria vendosi t'i dërgonte një komision të posaçëm, për të rënë në një ujdi me të. Asnjë marrëveshje nuk mund të arrihej, përderisa Esati kërkonte ndarjen e Shqipërisë dhe drejtimin prej tij të asaj pjese, që do të mbetej. Gjatë këtyre bisedimeve qeveria brenda vendit e kishte zhdukur lëvizjen esadiste, ndërsa më 13 qershor, ai u vra në Paris. Kështu, lëvizja u shua ndoshta brutalisht, por të paktën pushoi së qenuri.

Vlora ishte ende e pushtuar prej italianëve. Ndërkohë që delegatët e Kongresit të Lushnjes kishin deklaruar se Shqipëria do të çlirohej nga dominimet e huaja, Zogu e pa se ishte koha e duhur të vinte në jetë këtë premtim. Ai e kishte kuptuar se diplomacia

nuk sillte asgjë dhe e vemja mënyrë e mbetur ishte përdorimi i forcës. Kështu që, kur kërkesa e paraqitur për evakuimin e Vlorës nuk u mor parasysh, shqiptarët rrëmbyen armët dhe marshuan në qytet.

Zogu i priu një force prej dymijë e pesëqint burrash nga Shqipëria Qendrore dhe së bashku me trupa të tjerë ndërmori rrethimin e qytetit. Fshatrat përrreth u morën shpejt. Më 22 qershor 1920, gjatë një beteje vendimtare në rrethinën e Vlorës, italianët u mposhtën dhe u detyruan të dorëzohen. Brenda dhjetë ditëve pushtuesit ia mbathën në shtëpitë e tyre. Shqipëria më në fund u kthye edhe një herë aty ku ishte pesëqind vjet të shkuara.

Vendosja e paqes në vend

Brenda një kohe të shkurtër Zogu dha dorëheqjen si ministër i Brendshëm në kabinetin e Iliaz Vrionit, për shkak se nuk pajtohej me politika të caktuara të asaj qeverie. Ndërkohë shpërtheu një kryengritje në Mirditë, e nxitur nga Jugosllavët, të cilët dëshironin aneksimin e Shqipërisë së Veriut. Forcat qeveritare u dërguan kundër rebelëve mirditorë, por nuk ia dolën ta nënshtronin kryengritjen. Ata luftuan, dogjën dhe shkatërruan fshatra, por megjithatë nuk u vendos rendi dhe qetësia. Më në fund, qeveria thirri Zogun që ta merrte komandën e trupave në operacion. Bandat e armatosura, që po i shkaktonin këto trazira ishin të paguara prej Jugosllavisë, por përfaqësuesit jugosllavë në atë kohë e mohuan këtë. Ata insistuan se jo e tërë Shqipëria ishte nën autoritetin e Qeverisë së Tiranës dhe deklaruan se ishte një tjetër qeveri që funksiononte në Mirditë, prandaj ai kërkoi të emërohej një komision, i cili të gjente se sa qeveri kishte vendi.

Rreziku tani ishte i dyfishtë. Brenda vendit kishte një kryengritje dhe trazira pa pasur një fuqi rivale, që të përpiqej të mbronte territorin shqiptar. Megjithëse në atë kohë Zogu vuante nga malarja, e cila i kishte dhënë një temperaturë të lartë, ai menjëherë u nis për Mirditë. Për një kohë të shkurtër, duke shmangur gjakderdhjen, kryengritja mori fund dhe u vendos rregulli dhe qetësia nëpër fshatra. Ai qëndroi në zonën e prekur nga kryengritja, në mënyrë që jugosllavët të mos mundnin të sulmonin. Ndërkohë që Konferenca e Ambasadorëve në Paris e mbajtur më 18 nëntor 1921 i urdhëroi pushtuesit ta lëshonin Shqipërinë plotësisht.

Ndërsa Zogu gjendej në Mirditë, në Tiranë ndodhi një grusht shteti i cili i detyroi anëtarët e parlamentit dhe kabinetin t'ia mbathnin për në Elbasan. Edhe njëherë terrori ishte gati të mbizotëronte vendin. Sapo e mori lajmin, Zogu i mblodhi forcat e tij dhe marshoi drejt Tiranës, ku e vuri rregullin aty shumë shpejt. Deputetët që kishin ikur në Elbasan u njoftuan të ktheheshin në zyrat e tyre. Ata u kthyen, rifilluan sesionet parlamentare, ndërsa Zogu u rizgjodh Ministër Rendi përsëri.

Ata të cilët morën pjesë në këtë grusht shteti famëkeq, gjetën strehë në zonat malore dhe filluan t'i mblidhnin forcat përsëri. Më në fund, në mars të vitit 1922 përparuan

drejt Tiranës, vranë Komandantin e Përgjithshëm të Xhandarmërisë dhe shpërndanë forcat e tij me një goditje të befasishme. Sapo filloi nata u futën në Tiranë dhe filluan të shtinin në ajër, duke krijuar panik te njerëzit. Ditën tjetër kabineti dhe të gjithë deputetët ia mbathën për në Elbasan, duke e lënë Zogun vetëm me trupat e tij të ballafaqohej me rebelët. Ai filloi të përgatitej për mbrojtjen e qytetit, duke gërmuar transhetë në rrugë dhe duke vendosur tërë mitrolozët e municionet në ndërtesën e Parlamentit.

Rebelët sulmuan. Kërcitën armët dhe filloi lufta. Rrugët u mbushën me të vrarë dhe të plagosur. Beteja vazhdoi katërmbëdhjetë orë. Më në fund ndërhyri Ministri Britanik, i cili u kërkoi forcave kryengritëse të shpërndaheshin dhe të ktheheshin në shtëpitë e tyre. Ndërkohë që luftimet vazhdonin ende, një forcë tjetër e rebelëve po marshonte nga jugu drejt Tiranës. Zogu u njoftua për këtë dhe, përpara se të kishte përfunduar beteja në Tiranë, e la atë për t'u marrë me situatën e re që po shfaqej. Në një tjetër luftim në Kashar ai i mposhti përforcimet e rebelëve dhe e solli tërë vendin edhe një herë në gjendje normale. Pas kësaj humbjeje nga të gjitha anët, drejtuesit e kryengritjes ia mbathën për në Jugosllavi. Ishte pikërisht koha kur Zogu u bë Kryeministër. Sapo doli përpara parlamentit për votëbesim, ai premtoi të mbaheshin menjëherë zgjedhje për një Asamble Kushtetuese, e cila do të fiksonte përfundimisht formën e qeverisjes së shtetit shqiptar. Më 27 dhjetor 1923, pas një fushate tepër të vështirë, u mbajtën zgjedhjet. Ajo çfarë sollën ato zgjedhje ishte një triumf i vërtetë për Qeverinë e Zogut. Mbështetësit e tij në Asamble morën njëqind vende kundrejt një numri të vogël, që mori opozita. Më 21 janar 1924, me rastin e përvjetorit të Kongresit të Lushnjes, filloi punën Asambleja Kushtetuese në Tiranë.

Revolucioni i Fan Nolit

Pakica në opozitë kishte rënë në dëshpërim, për shkak të fitores masive që kishte korrur krahu i Zogut. Të gjitha llojet e komploteve po mendohej të bëheshin, pasi dukej se e njëjta gjë do të ndodhte dhe në zgjedhjet e ardhshme, kurdo që ato të mbaheshin. Atëherë mjeti më i mirë në dorë të kundërshtarëve, për t'i dalë përpara kësaj situate, mbetej eleminimi fizik i Ahmet Zogut. Ata i mbushën mendjen një gjysmë budallai të quajtur Beqir Valteri, nga Mati, që të realizonte planin e tyre. Atij iu tha se ai do të shpallej hero kombëtar dhe se emri i tij do të vendosej në altarin e historisë si mbrojtës i vendit të tij, nëse vriste Ahmet Zogun. Më 23 shkurt 1924, ndërkohë që Zogu po futej në Parlament, Beqir Valteri iu sul dhe e qëlloi dy herë. Zogu i plagosur në dorë dhe në brinjë, kaloi mespërmes sallës. Anëtarët e Asamblesë të alarmuar, e panë atë me sy të shqyer, kur ai qetësisht vajti dhe u ul në një karrige te tavolina e sekretarit. Kryetari i Parlamentit, i frikësuar tashmë ishte larguar nga poltroni i tij, ndërsa të gjithë të tjerët ishin vënë në gjendje paniku. Nga trupi i Zogut rridhte gjaku, por ai ashtu siç ishte u

ngrit dhe e mori fjalën: "*Gjëra të tilla nuk është se nuk ndodhin. Ne nuk mund ta dimë kur dhe ku ndodhin, prandaj le ta marrim këtë çështje me qetësi.*"

Në këtë mënyrë, ai e qetësoi parlamentin. Më pas u dërgua në shtëpi. Aty ia hoqën plumbat dhe mori ndihmën e nevojshme mjekësore. Ai u ngrit shpejt në këmbë dhe nuk përjetoi më gjë të keqe në jetën e tij.

Sulmi i nxiti edhe më keq anëtarët e opozitës, të cilët kërkonin karrige ministrash. Me qëllim që të shmangte rrezikun e hapur që i kanosej interesave të vendit gjatë rimëkëmbjes së tij shëndetësore, Zogu vendosi të jepte dorëheqjen si Kryeministër. Kriza ministeriale që pasoi, zgjati gjashtë javë. Më në fund u formua qeveria e re nën drejtimin e Shefqet Vërlacit. Ajo qeveri ishte njëfarë improvizimi dhe nuk e kënaqi opozitën aspak. Organizatat si "*Dora e Zezë*" dhe "*Dora e Kuqe*" po formoheshin dhe anarkia filloi edhe një herë të kërcënonte vendin. Ishte pikërisht në atë periudhë, kur këta burra hakmerreshin ndaj atyre që i konsideronin armiq. Më 20 prill 1924 vritet Avni Rustemi, i konsideruar masivisht si politikan popullor. Ky veprim i dhunshëm u shfrytëzua prej opozitës si mjet për të treguar forcën e tyre fallco ndaj popullit. Trupi i tij u dërgua në Vlorë dhe ceremonia e varrimit u bë shkak për armatosjen e rebelëve.

Lëvizja e armatosur në Shkodër, Përmet dhe Kosovë kishte filluar tashmë dhe po forcohej. Qeveria e Tiranës kishte një forcë të thirrur ligjërisht nën armë, e cila ishte e mjaftueshme për ta sjellë vendin në normalitet përsëri. Ajo ishte e dislokuar në Tiranë. Zogu e kishte njoftuar qeverinë se ishte plotësisht e mundur të rivendosej rendi e qetësia në vend brenda dhjetë ditësh, pa derdhur asnjë pikë gjaku. Ai do të kishte marshuar drejt Shkodrës dhe Kosovës dhe, pasi t'i çarmatoste ato rajone, do kthehej në Tiranë për t'i dhënë fund rebelimit, por qeveria e Verlacit deshi të adoptonte një qëndrim pajtues me rebelët dhe ia dha komandën dikujt tjetër.

Shpejt kabineti i Vërlacit ra. Ai u zëvendësua nga Vrioni. As ai nuk mundi të bëjë asgjë veçse të dërgonte komisione te rebelët, të cilat shkuan pa ndonjë instruksion të qartë. Ata humbën shumë kohë, duke diskutuar dhe duke pritur që qeveria të dërgonte ushtarët kundër rebelëve. Menjëherë zbuluan se forcat opozitare kishin zënë pozitat strategjike gjithandej. Në jug, veçanërisht, ata mbanin çdo qytet dhe fshat dhe më 10 qershor 1924 hynë në Tiranë të drejtuar nga udhëheqësi i tyre Fan Noli. Atë ditë, Zogu u largua nga kryeqyteti.

Kthimi i Zogut

Triumfi i kryengritësve e zhyti vendin në një det anarkie të pashembullt. Autoriteti i qeverisë as që ndihej gjëkundi. Shumë shpejt u krijua ndjesia se Qeveria e Nolit i kishte ditët të numëruara. Kësaj i ndihmoi, veç të tjerash, edhe fakti që Noli nuk e mblodhi asnjëherë Asamblenë Kushtetuese dhe as mbajti zgjedhje të reja.

Situata ishte bërë vërtetë kritike. Shqipëria u bë e njohur jo vetëm si një vend i

anarkisë dhe trazirave, por edhe si qendër e bolshevizmit. Prej anës tjetër të kufirit, Zogu shihte konditat e mjerueshme, në të cilat kishte rënë vendi prandaj u përpoq ta nxirrte edhe një herë nga ai hon i thellë. Pasi mblodhi trupat e tij, marshoi nëpër Kosovë, Dibër dhe Shkodër. Duke thyer pak rezistencë në Peshkopi, në dhjetor të vitit 1924 ai hyri triumfalisht në Tiranë. Fan Noli dhe qeveria e tij ia mbathën drejt Vlorës pa bërë rezistencë dhe më pas kaluan detin. Me ardhjen e Zogut në Tiranë, të gjitha qytetet e Shqipërisë, të lodhura nga trazirat e rebelimit, në mënyrë telegrafike shprehën mbështetjen e plotë dhe njohën qeverinë e tij. Nuk pati trazira, as beteja, as ndeshje. Forcat e bashkuara nga qeveria revolucionare noliste u kthyen të qeta në shtëpitë e tyre. Zogu më pas urdhëroi zyrtarë të ndryshëm "*të merrnin masa të shpejta për siguri të plotë të rendit dhe të vepronin sipas ligjit.*" Dhe kështu u bë.

Zogu e ruajti paqen dhe qetësinë, duke formuar një qeveri të përkohshme, derisa asambleja arriti të mblidhej përsëri në Tiranë. Më 5 janar 1925, pas një ndërprerjeje shtatë mujore, Asambleja u mblodh përsëri në sesion dhe mori përgjegjësitë si përfaqësuese e dëshirës së popullit e si organ që do të vendoste për fatet e vendit. Që në ditën e parë, kur filloi sesioni, kabinetit të Zogut iu dha njëzëri votëbesimi. Një javë më vonë Asambleja pranoi formën republikane të regjimit si model qeverisjeje. Kështu, u formua një komitet që do të hartonte Kushtetutën, e cila u shqyrtua prej Asamblesë më 31 janar 1925. Në kapitullin e Presidentit të Republikës, sipas neneve të votuara nga Asambleja, në liri të plotë, me dy vota kundër, Zogu u zgjodh President për një periudhë prej shtatë vjetësh. Ai i falenderoi deputetët për nderin e madh që i bënë dhe tha: "*Ju siguroj se s'ka ambicje që do më ndalonte t'u shërbeja interesave të përgjithshme të vendit tonë*".

Vendet e tjera u njoftuan për këto zgjedhje dhe të gjitha ato vende që nuk e kishin njohur regjimin e revolucionarëve të Fan Nolit e njohën menjëherë qeverinë e re, që doli nga parlamenti. Njëra pas tjetrës, përfaqësitë diplomatike u paraqitën për të dorëzuar letrat kredenciale të qeverive të tyre. Shqipëria më në fund po njihej si anëtare e familjes së kombeve të qytetëruara. Gjashtë muaj më vonë, kur të gjitha departamentet e qeverisë po punonin normalisht, Zogu ftoi në Tiranë drejtuesit e fiseve malore. Ai mori prej tyre Besën shqiptare, premtim besnikërie dhe bindjeje ndaj ligjit dhe vendit, premtim për paqe dhe rend.

Edhe pse u dha besa, ai urdhëroi t'u hiqte armët menjëhere atyre njerëzve, të cilët ende kishin zakonin e armëmbajtjes. Pasi u paqëtua edhe jugu, çarmatimi filloi në fiset luftarake të veriut. Kjo u përfundua me sukses, sepse njerëzit ishin të lodhur nga jeta e tyre plot dyshime, druajte e vuajtje dhe e kuptuan se një komb i civilizuar që jeton në paqe nuk e ka të domosdoshme edhe më tej mbajtjen e armëve prandaj edhe i dorëzuan armët me kënaqësi. Që këtu filloi një proces i modernizimt të vendit. Ndërtimi i një rrjeti rrugësh ishte hapi i parë duke lidhur ato krahina të pakalueshme me qytetet më të mëdha të vendit. Edhe ligjet u modernizuan. U përgatitën Kodi Civil, Kodi Penal dhe ai Tregtar. Po ashtu, u organizua xhandarmëria dhe një ushtri e vogël por e

manovrueshme. Vetëm tani mund të thuhet se ishte shtruar një themel i gurtë i një Shqipërie të fortë, të mbarë dhe të pavarur.

Ndarja me Jugosllavinë

Në kodrat e larta afër Pogradecit gjendet një manastir ortodoks, i cili sheh nga Liqeni i Ohrit, i quajtur Shën Naum. Gjykata Ndërkombëtare e Hagës i ka njohur të drejtën Shqipërisë në territorin mbi të cilin është ngritur ai, miratuar nga Konferenca e Ambasadorëve në Paris, por qeveria jugosllave e kishte zënë atë vend dhe kundërshtonte të lëvizte nga ky qëndrim. Konferenca e Ambasadorëve gjykoi se kjo çështje ishte diçka që duhej të zgjidhej midis dy qeverive, prandaj ajo shpalli se, nëse ata nuk do të mirëkuptoheshin, atëherë do të vinte Komisioni i Kufijve për të përcaktuar kufirin shqiptaro-jugosllav. Parlamenti vendosi ta ndërronte këtë territor me disa pjesë të tjera tokash.

Për të hequr dorë nga Manastiri e Shën Naumi, qeverisë shqiptare iu dha fshati Peshkëpi, Lugina e Çërravës, Kisha e Ujit të Shenjtë dhe kodra strategjike e Shën Naumit së bashku me pikat kufitare të patrullimit kufitar jugosllav. Kështu territori i fituar ishte një zonë prej rreth njëzet e dy kilometra katrore. Përveç kësaj, lugina e kullotave Libovicë ishte siguruar, dy shtëpi të fshatit të Grençes, rruga Lumbraja bashkë me kullën vrojtuese turke, kodra dhe liqeni, pjesa e pasme e Velipojës, tërë malet sipër saj dhe kufijtë ishin zgjeruar me rreth njëzet e pesë kilometra. Ky shkëmbim territoresh nuk u bë për të plotësuar një dëshirë të qeverisë jugosllave, e cila ende besonte se regjimi i Zogut, si ai i Esat Pashës, ishte i pafuqishëm dhe puthadorë ndaj jugosllavëve. Ky mendim i gabuar arriti kulmin, kur qeveria jugosllave kërkoi t'i dorëzoheshin emigrantët politikë bullgarë dhe jugosllavë, gjë që nuk kërkohej domosodoshmërisht nga ligjet ndërkombëtare. Në këto rrethana, shqiptarët kundërshtuan kategorikisht, ndërsa jugosllavët mbetën tmerrësisht të pakënaqur. Me qëllim që të tregonin se sa lehtë mund të rrëzohej regjimi i Zogut në Shqipëri, u mobilizuan forca civile në kufi dhe u futën në territorin shqiptar, duke provokuar atë që njihet si *Kryengritja e Dukagjinit*. E drejtuar prej oficerësh të caktuar, refugjatë dhe pasues të tjerë, ky rebelim shpërtheu në pjesën më veriore të vendit në nëntor të vitit 1926 dhe u shtri thuajse deri në Shkodër. Edhe ky rebelim u shtyp më me lehtësi duke përbërë shkakun kryesor të shkëputjes përfundimtare të Zogut me Jugosllavinë.

Kryengritja e Dukagjinit u mësoi shqiptarëve se nuk ishin ende aq të fortë sa t'i bënin ballë të vetëm qerthullit të lakmive dhe makutërive të vendeve nga të cilat rrethoheshin, prandaj, megjithëse revolta u shua në atë kohë, ishte e domosdoshme të siguroheshin që nuk do të kishte kryengritje të tjera të nxitura nga fuqitë e huaja. Për këtë arsye Zogu nxitoi të përshpejtonte përfundimin e një traktati miqësie me një shtet tjetër, duke i dhënë fund kështu një politike të rrezikshme izolacioniste. Ai hyri në bisedime me

qeverinë italiane dhe më 27 nëntor 1926 u përfundua Traktati i Miqësisë në Tiranë, i cili do të zgjaste pesë vjet.

Përveç kësaj, ai e konsideroi të domosdoshme të përfundonte një aleancë mbrojtëse me Italinë, duke ruajtur në të njëjtën kohë edhe të drejtën e sovranitetit kombëtar dhe garantimin edhe një herë të pavarësisë dhe integritetit territorial të Shqipërisë. Bazuar në këto parime themelore dhe të drejtat dhe detyrimet e dyanëshme, më 22 nëntor 1927 u nëshkrua në Tiranë Traktati i Aleancës Mbrojtëse midis Shqipërisë dhe Italisë. Traktati u bë shumë shpejt faktor bazë në stabilizimin e vendit. Ai i dha kohë popullit shqiptar t'i tregonte botës se sa ishte në gjendje të organizonte një shtet modern. Dita e nënshkrimit të traktatit shënoi një fazë të re në jetën e shqiptarëve. Ishte një hap që do të karakterizohej nga arritje të rëndësishme ekonomike, financiare, administrative dhe kulturore. Ndërkohë shqetësimi kryesor mbetej nevoja për fonde për financimin e këtij programi modernizues. Shqipëria ishte shumë prapa vendeve të tjera në çështjet e zhvillimit ekonomik, pasi kishte nevojë të menjëherëshme për ndërtimin e të gjitha llojeve të punëve publike.

Për këtë arsye ministri i Financave Myfid Libohova hyri në bisedime me një grup financiar italian të përfaqësuar nga Mario Alberti. Kështu u arrit një marrëveshje për hapjen e Bankës Kombëtare dhe për një kredi prej 5.000.000 franga ari (afërsisht 10.000.000 dollarë floriri). Sipas kësaj marrëveshjeje të modifikuar dhe miratuar në parlament, në qershor të vitit 1925 përfaqësuesit e grupit italian duhej të fillonin punën me themelimin e Bankës Kombëtare Shqiptare brenda tridhjetë ditësh. Kapitali nominal prej 12.500.000 franga floriri do të ndahej në 495 aksione të zakonshme me vlerë 25 franga ari secila dhe 100.000 aksione të themeluesve të ndara në 1.25 franga ari secila. Zyra kryesore e Bankës do të ishte në Tiranë, por do të hapeshin degë të saj në tërë vendin. Marrëveshja parashikonte zgjatjen kohore prej pesëdhjetë vitesh me të drejtën për ta shtyrë sipas një marrëveshje të re që do të nënshkruhej në kohën e duhur.

Banka, gjithashtu, u angazhua të formonte Shoqërinë për Zhvillimin Ekonomik të Shqipërisë, SVEA. Sipas kësaj marrëveshjeje, kredia e SVEA-s nuk do të ripaguhej (kthehej), për shkak se shuma e fondeve ishte përdorur në punët e përbashkëta, siç janë ndërtimi i Portit të Durrësit dhe shumë rrugë e ura të një karakeri thjesht strategjik, për të cilat qeveria italiane kishte më shumë nevojë se vetë shqiptarët. Që prej vitit 1923 edhe Kompania Amerikane "Standart Oil" dhe ajo "Anglo Persian Oil" kishin kërkuar koncensione nga qeveria shqiptare. Kundërshtimi i ashpër dhe konkurrenca midis dy kompanive e bënë të domosdoshme që qeveria të bënte kujdes dhe t'u përmbahej vendimeve të saj të parashikuara në kushtet e marrëveshjes.

Më në fund, pas largimit të qeverisë së Fan Nolit, në vitin 1925, Parlamenti miratoi kontratën me Shoqërinë "Anglo-Persian Oil" për shfrytëzimin e zonës së petroliferës në Patos. Më vonë koncensione të njejta iu dhanë edhe Kompanisë "Standard Oil", "Ferrovia dello Stato" dhe shumë kompanive të tjera. Në atë kohë Kompania "Anglo-Persian Oil" kishte shpuar në shumë puse në zonën e Patosit dhe kishte gjetur sasira të mjaftueshme

vajguri, ashtu sikundër edhe “Ferrovia dello Stato” në zonën e Vlorës.

Shpallja e Mbretërisë

Për shqiptarët, shpallja e Republikës së Shqipërisë në vitin 1925 nuk dukej arritja më e madhe, pasi traditat e tyre dhe mentaliteti nuk mbështeteshin tek idealet republikane. Për ta patriotizmi dhe dashuria ndaj vendit nuk kishin asnjë kuptim, nëse dikush nuk i mishëronte ato ideale në vetvete. Një shqiptar i vërtetë me zemër është monarkist. Për popullin një fron shqiptar do të thoshte autonomi e vërtetë dhe pavarësi, sepse ata kujtojnë historinë e vendit të tyre, kur Skënderbeu ishte Mbret në Krujë. Kjo ishte arsyeja pse në vitin 1924 Asambleja Kushtetuese ishte ndarë në dy kampe të mëdha: monarkistët dhe republikanët.

Më në fund monarkistët dolën fitimtarë dhe Asambleja Kushtetuese, që përfaqësonte dëshirën e popullit u pajtua menjëherë. Të shtunën e 1 shtatorit të vitit 1928 Shqipëria u shpall Mbretëri, midis një aklamacioni të pashoq dhe gëzimi të madh. Zogu mori fronin si Mbret i Shqiptarëve duke u kurorëzuar si Zogu i Parë dhe mbajti një fjalim përpara Asamblesë në të cilën tha:

> Sot, në këtë moment kur kam marrë besimin e popullit tim të shprehur nëpërmjet jush dhe ndërgjegjes suaj, i ngarkuar me detyrën e lartë të drejtimit të shtetit me gjithë vështirësitë dhe përgjegjësitë e larta që ajo mbart, ju premtoj se nuk do të harroj asnjëherë detyrimin tim moral ndaj popullit shqiptar, i cili herët ose vonë do të ngrihet me energji të pashtershme në lartësinë e një kombi, midis kombeve.

Tentativa për vrasjen e Mbretit në Vjenë

Nga rrënojat e një populli të lashtë filloi të ngrihej një Shqipëri e Re. Puna për organizimin dhe konsolidimin e shtetit ishte e jashtëzakonshme. Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 1930 Mbreti punonte tetëmbëdhjetë orë në ditë. Më në fund kjo punë e pandërprerë filloi ta sforcojë dhe ta dobësojë atë. Për këtë arsye ai u këshillua nga miqtë, shokët dhe familja të shkonte jashtë për një farë trajtimi. Ai i la punët e qeverisë në duart e Këshillit të Shtetit dhe në shkurt të vitit 1931 shkoi në Vjenë, duke e kaluar Detin Adriatik me anijen ushtarake italiane “*Quarto*[95]”. Në Vjenë jetonin disa prej atyre burrave, të cilët kishin organizuar revolucionin e vitit 1924. Pas revolucionit të dështuar, ata ia kishin mbathur dhe bënin një jetë aventureske dhe luksi në kryeqytetin austriak, të financuar nga fuqi të ndryshme të huaja.

Këta ish-kundërshtarë politikë, të nxitur prej atij vendi që i ushqente, vendosën t’i jepnin fund jetës së Zogut. Për ta arritur këtë më 20 shkurt 1931, ish-oficeri i

xhandarmërisë Nok Gjeloshi dhe Azis Çami, u ngarkuan të qëllonin mbi të. Kur Zogu po dilte nga Opera e Vjenës me ndihmësit e tij, ata shtinë mbi të disa herë. Ai shpëtoi për mrekulli, por adjutanti i tij Mark Topallaj, besnik i vërtetë deri në fund, u vra, ndërsa ministri i Oborrit, Ekrem Libohova, u plagos në një përpjekje heroike për ta mbrojtur mbretin.

Në nëntor të vitit 1931, Traktati i Miqësisë me Italinë, i nënshkruar në vitin 1926 skadoi. Qeveria italiane kërkoi rinovimin, por mbreti e ndjeu se kjo nuk ishte e nevojshme për shkak se:

a) përderisa Traktati i Aleancës ishte në fuqi më të drejta dhe detyrime të dyanshme, një traktat tjetër i veçantë miqësie do ishte një përsëritje e panevojshme.
b) Traktati i Miqësisë edhe brenda edhe jashtë vendit, ishte kritikuar aq shumë sa ishte konsideruar i dëmshëm për reputacionin e Shqipërisë, prandaj nga ky këndvështrim dhe për të shmangur përshtypjen e keqe, do të ishte më mirë të mos rinovohej.
c) Traktati i Miqësisë në nenin e parë të tij në lidhje me status quo-në politike dhe juridike ishte kuptuar prej shqiptarëve si traktat që synonte të mbante regjimin në këmbë dhe jo shtetin sovran. Duke mos e ripërtërirë atë, jepej të kuptohej se traktatet kishin si qëllim mbajtjen e shtetit dhe jo të një personi të vetëm dhe as regjimit të ditës.
d) Sido që të jetë ripërtëritja e traktatit do të ishte e pakuptimtë, për shkak të politikës së sinqertë dhe të drejtpërdrejt që ndiqnin dy qeveritë.

Për këto arsye, Mbreti refuzoi të rinovonte Traktatin e Miqësisë me Italinë.

31 Foto zyrtare e Mbretit Zog I – rë.

Dhjetë kreditë italiane

Deri në vitin 1931 zhvillimi ekonomik nuk kishte treguar progres aq të mjaftueshëm sa t'i mundësonte Shqipërisë të vazhdonte rritjen e nevojshme ekonomike për nevojat e saj jetësore. Në kushtet e shpenzimeve shumë të mëdha që duheshin për administratën ushtarake, Mbreti i kërkoi qeverisë italiane, nëpërmjet ministrit të saj në Tiranë Antonio Meli Lupi di Soragna, një kredi të asaj natyre, që të ndihmonte programin progresiv dhe konstruktiv të qeverisë së tij.

Qeveria italiane, tanimë si një qeveri mike, aleate, fqinje në Detin Adriatik, u pajtua të jepte atë kredi. Ajo do të ishte maksimalisht një shumë prej 10.000.000 franga ari, duke filluar nga viti fiskal 1931-1932, e parashikuar për t'u përsëritur për nëntë vjet radhazi. Këto kredi do të jepeshin pa interesa dhe shlyerja e tyre do të mbetej në iniciativën e qeverisë shqiptare, e cila do t'i kthente ato kurdo që ta gjykonte se do të ishte e mundur, pa e dëmtuar situatën ekonomike dhe financiare të vendit. Por në çdo rast nuk do të paguhej asgjë, përpara se të ardhurat buxhetore të shtetit shqiptar të kishin arritur shumën vjetore prej 5.000.000 franga ari.

Kjo kredi vjetore do të reduktohej proporcionalisht me rritjen e të ardhurave, ose reduktimin e shpenzimeve të Thesarit Shqiptar. Më në fund kreditë do të përdoreshin kryesisht për zhvillimin e punëve publike, ekonomisë kombëtare dhe arsimit kombëtar.

Mbi këtë bazë, më 30 qershor 1931 kaloi një ligj i veçantë, i cili miratonte ratifikimin e kredisë së kontraktuar midis qeverive italiane dhe shqiptare. Rregullime të veçanta të dekretuara prej Mbretit Zog iu bënë detyrave dhe të drejtave që mori një komision i përdorimit dhe shpërndarjes së kredive. Komisioni do të përbëhej prej dy shqiptarësh dhe dy italianësh, të emëruar me dekret mbretëror.

Në lidhje me këto kredi vjetore qeveria shqiptare përgatiti një listë të punëve të ndryshme që do të ekzekutoheshin dhe të pjesëve të ndara të punëve publike, ekonomisë dhe arsimit kombëtar. Komisioni i Kreditit e vazhdoi punën e tij për disa kohë, por më vonë mosmarrëveshjet ende të pazgjidhura midis qeverive italiane dhe shqiptare i pezulluan veprimet e mëtejshme të tyre. Kjo e detyroi Mbretin Zog të zvogëlonte shpenzimet e shtetit nga 30.000.000 franga ari në vetëm 18.500.000, me qëllim që të përshtatej me situatën e krijuar dhe t'i siguronte mbretërisë një buxhet realist që nuk binte ndesh me fuqinë e vet financiare.

Vepra e Zogut për paqen në Ballkan

Që prej vitit 1924, Zogu kishte kundërshtuar ndërhyrjet jugosllave dhe intrigat e saj, duke i dhënë të kuptonte se Shqipëria dëshironte të jetonte e lirë dhe e pavarur në Gadishullin e Ballkanit. Ai i bëri të ditur të njëjtin qëndrim Italisë, kur ajo synoi

drejpërdrejt, apo tërthorazi të zgjeronte ndikimin e saj në dëm të sovranitetit të Shqipërisë.

Zogu ka mbrojtur me tërë forcën lirinë dhe pavarësinë e vendit të tij. Po mos të ishte për atë, paqja dhe rendi nuk do të zotëronin në Shqipëri dhe anarkia do të kishte provokuar konflikte përtej asaj, që imagjinohet në tërë Ballkanin.

Italia lakmonte hapur bregdetin e Adriatikut në anën shqiptare dhe veçanërisht Gjirin e Vlorës e rajonit që shtrihet deri në luginën e Lumit Mat. Ndërkohë që Greqia lakmonte Shqipërinë e Jugut, Korçën, Gjirokastrën dhe rrethinat e saj.

Nëse nuk do të ishte Zogu, dëshirat e shprehura haptazi prej vendeve fqinje do të kishin krijuar konflikt me njëra-tjetrën. Paqja në Ballkan gjithmonë do të kishte qenë në rrezik dhe, si rrjedhojë do të rrrezikonte edhe vetë paqen në Europë.

Me Mbretërinë e tij të lirë dhe të pavarur dhe me kujdes të madh në politikën e jashtme, të pandikuar prej fqinjëve, Zogu ia doli të riformonte kombin shqiptar, por edhe të siguronte paqen në Ballkan. Shqipëria mbante ekuilibrin midis vendeve që aspironin hegjemoni dhe dominim përmbi të tjerët. Ai nuk u ndikua as prej atyre rrymave të ndryshme të shteteve fqinjë, të cilat kërkonin ta bënin Shqipërinë fushë të lirë për realizimin e ambicjeve dhe aspiratave të tyre imperialiste.

Prishja e Zogut me Jugosllavinë në vitin 1927 dhe konflikti i tij i fundit me italianët, janë dy dëshmi të qarta të faktit se vepra e tij është e prirur vetëm për lumturinë e popullit shqiptar dhe paqes në Ballkan[96].

Raport i Bernsteinit rreth një bisede me Mbretin Zog

Se sa të afërta dhe konfidenciale po bëheshin marrëdhëniet e Bernsteinit me Mbretin Zog, e dëshmon edhe raporti i mëposhtëm, dërguar në Departamentin e Shtetit [97].

> I nderuar Sekretar i Shtetit!
> Kam nderin t'ju raportoj përmbajtjen e një bisede informale me Mbretin Zog të Shqipërisë më 19 korrik 1930, në Pavionin e Banjos Mbretërore në Durrës. Sapo u ulëm, më tregoi se e kishte lënë duhanin për pak kohë, pasi po vuante nga bronshiti. Pasi pimë kafe turke, më ofroi një cigare dhe e filluam bisedën. Mbreti më tha:
>
> Shqipëria është një vend i vogël dhe mua më duhet të punoj shumë për ta ndërtuar atë. Nuk kam kohë për të humbur. Një prej problemeve më të mëdha që kam është të gjej njerëz, të cilëve tua delegoj disa prej punëve të mia të rëndësishme. Ne vuajmë për njerëz të aftë dhe të përgjegjshëm. Megjithatë e di se edhe vende të tjera edhe më të mëdha se ne e vuajnë këtë mungesë. Kam lexuar ankesa të tilla në shtypin amerikan dhe europian. Unë kam në kabinetin e tashëm dy vetë, të cilët ishin kundërshtarët e mi, armiqtë e mi. I kam marrë në kabinetin tim, sepse besoj se ata mund të jenë të aftë t'i bëjnë shërbim të mirë

shtetit. Po përpiqem me gjithçka që kam të bëj të pamundurën, që të shfrytëzoj të gjitha forcat më të mira të aftësisë njerëzore në të mirë të shtetit, por në këtë aspekt jemi vërtetë shumë të varfër. Sido që të jetë, ne po bëjmë të pamundurën për të forcuar dhe ruajtur pavarësinë e shtetit tonë. Italia më siguron se nuk do asgjë nga Shqipëria, përveçse ta ruajë dhe forcojë pavarësinë. Musolini dhe Grandi më kanë dhënë siguri të tillë dhe unë besoj se për aq kohë sa jeton Musolini, për aq kohë sa ai mbetet në pushtet, ai do ta mbajë fjalën e dhënë. Ajo çfarë kam parë tek ai është se e mban fjalën. Ai i mban premtimet. Kështu, Italia ka qënë mjaft korrekte në qëndrimet e saj ndaj Shqipërisë.

Jugosllavia më ka siguruar nëpërmjet ministrit të tyre këtu se i vetmi interes i saj në Shqipëri është ta ndihmojë atë të mbetet e pavarur. Nëse ne do të mbështeteshim në sinqeritetin e këtyre dy vendeve, atëherë mund të them se jam i kënaqur. E megjithatë e vetmja gjë që kërkon Shqipëria prej tyre është ta bëjmë Pavarësinë tonë të sigurt. I kam thënë qartë edhe ministrit italian dhe atij jugosllav se, nëqoftëse Italia dhe Jugosllavia kanë probleme për të zgjidhur, si në luftë, ashtu edhe në paqe, ata mund t'i zgjidhin ato, por jo në territorin shqiptar. Italia dhe Jugosllavia kanë kufijtë e tyre dhe, nëse dëshirojnë të zgjidhin pakënaqësitë e tyre, mund t'i zgjidhin vetëm atje. Shqipëria dëshiron paqe dhe mundësi për të ndërtuar ekonominë e vet. Nëse cilado nga këto vende është gati të na ndihmojë, ose edhe, nëse të dyja janë gati ta bëjnë këtë, kjo është krejt e pranueshme. Ne do ta vlerësonim shumë këtë. Por nga ana tjetër, ne nuk ua kërkojmë këtë, pasi nuk duam të biem nën trysninë e detyrimeve të fqinjëve që rrjedhin prej kërkesave tona.

I kam treguar edhe ministrit grek se ekzistojnë të gjitha arsyet që Shqipëria dhe Greqia të kenë marrëdhënie mjaft të mira dhe se dallimet midis nesh mund të rregullohen në mënyrë miqësore. Unë i theksova atij se, ashtu si Greqia, edhe Shqipëria nuk është as sllave, as latine, as muhamedane, se interesat e përbashkëta bazohen në marrëdhënie miqësore dhe bashkëpunimi. Tek e fundit, edhe Greqia është një vend i vogël po ta krahasosh me vendet e tjera europiane dhe ajo duhet ta kuptojë këtë. Një gjë është krejt e sigurtë: Shqipëria dëshiron paqe me të gjithë fqinjët, por sigurisht duke ruajtur pavarësinë e saj.

Për aq sa i takon Shqipërisë, asaj i nevojitet zhvillimi kulturor mbi çdo gjë tjetër. Fqinjët tanë janë edhe më keq se ne nga ana kulturore. Shkollat tona, aq të varfra sa janë, janë proporcionalisht më të mira se ato në Jugosllavi. Unë jam i lumtur që Fondacioni i Lindjes së Afërme do të kujdeset për dy shkolla, atë Bujqësore të Kavajës për djemtë dhe atë të trajnimit për vajzat mësuese në Kavajë dhe në Durrës. Veçanërisht, jam i lumtur kur shoh ndikimin amerikan, i cili po rritet në këtë mënyrë në zhvillimin tonë kulturor.[98]

Kur biseda u kthye te propozimi Briand[99] dhe përgjigjja e Shqipërisë ndaj tij,

referuar tonës nr. 44, datë 17 korrik, 1930, Mbreti tha:

Pa dyshim, ajo që po ju them ju është në mirëbesim. Propozimi i Briandit për një formacion të një bashkimi shtetesh europiane, vështirë se mund të merret si çështje serioze. Për një kohë të gjatë kjo do të mbetet veçse një ëndërr, një ideal i largët, një gjest fisnik i Francës, për të impresionuar botën, sikur ajo po punon për paqen. Unë nuk besoj në seriozitetin e atij propozimi të bërë nga një vend, i cili është duke ndërtuar anije luftarake dhe duke i rritur forcat e armatosura, ndërkohë që i fton vendet europiane të bëjnë një Bashkim Federalist për të ruajtur paqen. Në Europë ka kufij edhe natyrorë edhe kufij shtetëror. Ka aq shumë kufinj artificialë, disa prej të cilëve janë sanksionuar që prej Luftës së Madhe, si për shembull ato të Polonisë, Jugosllavisë, Greqisë, Shqipërisë. Është e pamundur të zbusësh dhimbjen e kombeve thjesht, se u ofron atyre të gjenden së bashku nëpër konferenca, veçanërisht, kur shohim se brengat më të mëdha as që konsiderohen fare. Unë kam vënë re se në këto konferenca problemet më të vështira janë ato që mbeten për t'u zgjidhur në mbledhjen e ardhshme e kështu me radhë dhe pastaj fillon akumulimi i problemeve dhe brengave më të vështira, të cilat nuk mund të zgjidhen dhe as rregullohen, pasi vërtetë që aty nuk ka dëshira për t'i zgjidhur ato dhe për shkak se secili prej burrështetasve që shkojnë në ato konferenca është i përkushtuar t'i zgjidhë këto probleme sipas interesave të tij dhe jo nga pozicioni i mbarëvajtes së përgjithshme. Kjo është arsyeja përse unë mendoj se Shtetet e Bashkuara të Europës, siç i propozon Briandi, do të mbeten vetëm një ëndërr boshe, një gjest madhështor, i ndërmarrë me qëllim që Franca, kur të vijë ajo ditë, të realizojë përpjekjet e saj për të bashkuar Europën, me qëllim që të sjellë paqen.

Mbreti përmendi çështjen e John Da Kay:

E kam takuar atë vetëm një herë. E pashë si njeri të këndshëm por jo normal. Ai më impresionoi si njeri me zgjuarsi të jashtëzakonshme dhe ndoshta absurditeti i tij ishte pikërisht aty. Kontrata që u bë me të prej Mehdi Frashërit, ministrit të Ekonomisë Kombëtare nuk ishte marrëveshje që u përqafua. Ajo ishte vetëm për disa koncensione dhe sipërmarrje. Një kontratë e veçantë duhej të bëhej për çdo sipërmarrje veçmas, duke qenë të sigurtë se ai mund të tregonte se korporata e tij kishte një kapital prej dyqint milionë dollarësh për të kryer punën. Ai u prezantua me mua nëpërmjet konsullit tonë në Vjenë në rrugë zyrtare nga shërbimi ynë i jashtëm.

Kur i tregova se e kisha vizituar pallatin, që po ndërtohej në Durrës, Mbreti më tha:

Pallati është thuajse gati. Na ka kushtuar tepër shumë. Shqipëria ka paguar për të 75.000 napolona. Musolini i dhuroi vetëm tavanin e larë në flori në dhomën

e fronit. Çdo gjë tjetër është paguar nga Shqipëria.

Pastaj mbreti më kërkoi, nëse mund t'i sugjeroja atij ndonjë nga gazetat kryesore amerikane, me të cilat të bashkëpunonte për të ngritur një Zyrë Shtypi në Tiranë, nën kujdesin e një shqiptari. Ai tha se nuk kishte shqiptar të zotin, që të ngrinte një departament të tillë shtypi, por që një shqiptar mund ta mbikqyrë materialin me qëllim që në publik të dalë vetëm informacion autentik. Ai tha se shtypi i huaj ka publikuar herë pas here materiale disinformuese rreth Shqipërisë. Ai ishte i etur t'i tregonte gjërat siç ishin, në veçanti në shtypin amerikan. Më pas ai përmendi se qeverisë së Shqipërisë i ishin afruar që të shkruanin në Paris Temps për një milion franga. Ai tha se Shqipëria nuk mund të bëjë marrëveshje të tilla, pasi ishte shumë e varfër.

I thashë Mbretit se marrëveshje të tilla nuk mund të bëhen në Amerikë, pasi atje asnjë ent botues serioz nuk pranon të mbushë kolonat e shtypit më shkrime për qeveritë e huaja. Pastaj Mbreti tha se e dinte që gazetat amerikane nuk bënin atë që bënte "Paris Temps".

I shpjegova përse gazetat amerikane nuk i praktikojnë këto lloj metodash dhe se gazetat amerikane botojnë artikuj për vendet e tjera vetëm, kur e dinë se ato janë interesante për lexuesit e tyre. Mbreti pastaj shtoi se ai ishte në ankth, deri sa të shihte Amerikën dhe kryeqytetin amerikan tek interesoheshin për Shqipërinë nëpërmjet prezantimit të çështjeve, që e shqetësonin vendin e tij. Dhe kjo ishte arsyeja e padurimit të tij për të pasur një Byro Shtypi në vendin e tij.

Më pas ai më foli për Institutin Rockefeller në Shqipëri:

Dr. Hacket nga Instituti Rockefeller dhe ndihmësit e tij kanë bërë shumë për të zhdukur malarjen në Shqipëri. Kjo është një punë e mrekullueshme që ata po bëjnë. Unë u jam shumë mirënjohës për të. Në fakt jam gati të jap krejt fondin që kam për shëndetin, rreth 600.000 franga ari për vit, te një prej përfaqësuesve të Fondacionit Rockefeller. Do të ishim shumë të lumtur, nëse do ia ngarkonim plotësisht punët e shëndetit në Shqipëri. Dhe nuk do të kishte asnjë dallim, pasi mendoj se nuk kemi njerëz që ta bëjnë punën si duhet. Është një shumë e vogël, por besoj se ndihmon sadopak. Nëse Instituti Rockefeller do ta merrte këtë përsipër, Shqipëria do t'i ishte shumë mirënjohëse.

Bernsteini e mbyll këtë raport të gjatë të bisedës me Mbretin Zog me fjalët:

Kam nderin të jem shërbëtori juaj i bindur, Zotëri.

Herman Bernstein[100]

Kabllogram i Herman Bernsteinit dërguar Departamentit të Shtetit [101]

Mbreti Zog në një intervistë me gazetarin amerikan Aleksandër Powell, në prani të Ministrit amerikan, dha këtë intervistë për marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet fqinjë.

1. Traktati i Miqësisë dhe Bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Italisë ka shkaktuar një irritim të madh në Beograd. Mbreti pretendon se më parë ai ishte kritikuar shumë, ngaqë ishte treguar shumë miqësor me Jugosllavët. Më pas, me rebelimin e dhjetorit të vitit 1926, në veri të Shqipërisë, i nxitur dhe shkaktuar prej Jugosllavëve (sipas Mbretit) dhe pas shtypjes së revoltës, atij i dukej si veprim i mençur të nënshkruante një traktat të tillë me Italinë.
2. Problemi me minoritetin shqiptar në Jugosllavi përbën një arsye tjetër të përçarjes. Mbreti i përmbahet idesë se popullsia shqiptare e Kosovës po shpërngulet drejt Kroacisë dhe kudo gjetkë, ndërsa malazezët dhe sllavët po vendosen në fshatra krejt të pastra shqiptare, përkrah vijës ndarëse të Kosovës, si dhe në zona të tjera me qëllim që të shpërbëhet karakteri shqiptar i këtyre vendbanimeve. Mbreti thotë se nuk ka qoftë edhe një shkollë të vetme, ku të mësohet gjuha shqipe.

Korrespendenca të ndryshme të Herman Bernsteinit me Departamentin e Shtetit

Drejtuar Sekretarit të Shtetit në Washington[102]

> Zotëri!
> Duke iu referuar telegramit tim nr. 46 dërguar më 14 dhjetor 1930, kam nderin t'ju raportoj se, sipas informacioneve të mbledhura nga burime të ndryshme, dy specialistët e Vjenës, Bauer dhe Dank, mendojnë se sëmundja e Mretit Zog nuk është aq serioze, sa i frikësoheshin miqtë e tij. Thuhet ta kenë diagnostikuar si një shqetësim intestinal, prandaj i rekomanduan, që të shtojë lëvizjen dhe të ulë orët e punës. Ata qëndruan në Tiranë katër ditë dhe më pas u kthyen në Vjenë. Sëmundja e Mbretit është mbajtur plotësisht sekret nga publiku, madje edhe ardhja dhe largimi i mjekëvë është bërë në fshehtësi të plotë. Gjatë vitit të fundit herë pas here kanë dalë fjalë se Mbreti është i sëmurë. Sipas këtyre fjalëve, shumica e të cilave rrjedhin prej burimeve jugosllave, Mbreti Zog po vdiste nga tuberkulozi, nga sifilizi, kanceri i fytit, kanceri i stomakut, e kështu me radhë.

Janë dhënë gjithashtu informacione në shtypin e huaj se Mbreti është i sëmurë dhe se anëtarët e Parlamentit dhe qeveritarët po shohin si ta zëvendësojnë atë. Nuk ka asgjë të vërtetë në tërë këto raportime publike. Në fakt, ditën kur mendohej se Mbreti ishte në prag të vdekjes, unë e kalova pasditen me të dhe ai gëzonte shëndet të plotë. Në një rast tjetër, kur jugosllavët raportuan se Mbreti po vdiste, ai kishte kaluar tri orë duke kalëruar.

Tani që Mbreti Zog është vërtetë i sëmurë, asnjë raport për gjendjen e tij shëndetësore nuk është botuar as në Shqipëri, as jashtë saj. Por, pasi disa shokë të afërm dhe anëtarë të kabinetit e kishin vizituar atë dhe kishin mësuar për sëmundjen e tij, ata u mërzitën pafundësisht dhe e kishin humbur toruan fare. Askush nuk di se kë do të zgjidhte Mbreti për të trashëguar fronin mbretëor.
Papritmas Tirana politike filloi të mbushet me të gjitha llojet e thashethemeve dhe spekulimeve. Fati i Shqipërisë është diskutuar edhe në qarqe sekrete.

Kontakti i parë që pata për sëmundjen e Mbretit ishte, kur Quaroni, këshilltari i Ambasadës Italiane më tregoi gjatë një vizite në Legatë më 17 dhjetor.
Mbreti është pak i sëmurë nga një grip. Nëse do të ndodhë diçka me të, do të ketë trazira serioze në Shqipëri. Personalisht unë nuk besoj se shqiptarët do të pranonin të kishin një mbret tjetër, që ta pasonte Zogun. Kjo është arsyeja përse unë mendoj se në një emergjencë të tillë shqiptarët do t'i kthejnë sytë drejt djalit të Princ Vidit dhe do ta pranojnë atë si mbretin e tyre. Unë nuk besoj se pas vdekjes së Zogut, Shqipëria do të funksionojë si republikë për disa kohë, për shkak që vështirë se shqiptarët do të pajtohen të kenë ndonjë president. Ndryshe ka qenë koha me Zogun, i cili i ka dominuar shqiptarët me personalitetin e tij të jashtëzkonshëm dhe guximin e tij të madh. Në rastin e vdekjes së Mbretit Zog, Parlamenti do të bëjë një përpjekje për të përcaktuar cili prej tre nipave të tij do ta trashëgojë fronin. Por këta janë tepër të rinj dhe të pamundur për ta qeverisur vendin. Unë mendoj se ata do ta kthejnë Princ Vidin përsëri. Një ditë më vonë dr. Terenc Toci, ish-sekretari personal i Mbretit Zog, më njoftoi, në besimin më të madh se Mbreti Zog ishte duke vdekur. Toci më tha:

Mbreti është në prag të vdekjes. Abdurrahim Krosi, babai i tij i adoptuar, nuk ka dalë nga pallati për tri ditë e tri netë. Mjekët vendas e vizitojnë mbretin. Specialistët austriakë të cilët e vizituan vitin e kaluar, thanë se komplikacioni i parë mund t'i marrë jetën. Tani ai është në shtrat me bronshit. Austriakët konstatuan se mbreti vuan nga kanceri i fytit dhe tuberkolozi. Mendimi im është se ushtarakët më të lartë e urrejnë Zogun, por në rast vdekjeje ata do të ruajnë rendin. Personalisht nuk do desha vdekjen e Mbretit. Italianët janë shumë të shqetësur për gjendjen shëndetësore të Mbretit Zog. Ata e mendojne si shumë të vështirë të arrijnë ndonjë gjë në Shqipëri në atë gjendje që është ai.



United States Commission
for the Celebration of the Two Hundredth Anniversary of the Birth of
George Washington
1732 1932

32 Faksimile e letrës së urimit për Ambasadorin Bernstein dërguar nga Komisioni i festës së 200 vjetorit të lindjes së George Washingtonit.

Historia e Profesor Scarlett Epstein, është një histori tejet e dhimbshme, si shumë të tilla për hebrejtë, por me një fund të lumtur. Ajo ngjet me historinë e thuajse të tremijë hebrejve që shpëtuan në Shqipëri. Ajo deklaronte Çdo ditë: "Unë jam gjallë falë bujarisë shqiptare"!

Puna e Bernsteinit për njohjen e historisë së hebrejve në Shqipëri

Ambasasori Bernstein i kushtoi një vemendje të posaçme njohjes së historisë së hebrejve në Shqipëri. Materialet e mëposhtme e dëshmojnë këtë më së miri. Një ndër dokumentat që e vertetojnë këtë janë shënimet e Kol Kugës, asistentit dhe përkthyesit të Legatës Amerikane në Tiranë, mik i ngushtë e Herman Bernsteinit.

> Kur shkuam me Ministrin Bernstein në Vlorë më 3 mars 1933, dola dhe takova disa hebrej, me të cilët fola për historinë e tyre në Vlorë. Një mik shqiptar më mori dhe më dërgoi te dyqani i Joseph Matattias. Ai më tha se Matatia ishte një hebre me emër shumë të mirë në Vlorë, siç kisha dëgjuar për të edhe më parë. Ai ishte anëtar i Këshillit Bashkiak të Vlorës dhe kishte një dyqan të vogël. Na priti me mirësjellje dhe iu përgjigj kështu pyetjes sime: Ne nuk dimë asgjë për historinë e hebrejve në Vlorë. Pleqtë tanë kanë vdekur, ndërsa pasardhësit nuk janë lodhur të shkruajnë kujtimet dhe tregimet e tyre. Ato që dimë me të dëgjuar është ajo që kolonia hebreje këtu emigroi nga Venecia, gjatë pushtimit të parë venecian, aty rreth pesë shekujve më parë. Turqit e pushtuan këtë vend dhe i përzunë venecianët. Hebrejtë ikën bashkë me këta të fundit. Hebrejtë u kthyen bashkë me venecianët. Por, kur ndodhi pushtimi i dytë turk, hebrejtë ikën në shumë drejtime. Thuhet se aty rreth njëqind vitet e fundit, kolonia hebraike ishte e madhe, por përndjekja e tyre prej turqve u bë e padurueshme, saqë një natë shumë prej hebrejve më të shquar morën familjet dhe gjërat më të vlefshme, i hipën në anije dhe u larguan. Në mëngjes banorët e Vlorës panë se thuajse të tëra dyqanet e hebrejve nuk po hapeshin. Ata e dinin që nuk ishte ditë feste. Më pas u mësua se disa prej hebrejve kishin ikur. Autoritetet i shpërthyen dyert e dyqaneve, por mësuan se ata kishin ikur duke marrë me vete gjërat më të vlefshme.
>
> Në kohët e sotme bashkësia hebraike këtu përbëhet prej dhjetë familjesh me rreth gjashtëdhjetë shpirtëra. Ne nuk kemi organizim. Për shërbimet fetare kemi vënë në dispozicion dy dhoma ku mblidhemi dhe falemi. Midis nesh ka prej atyre që dinë të bëjnë ritet fetare sa për të plotësuar nevojat.
>
> Bashkësia hebraike në Janinë zotëronte një libër shumë të vjetër, i cili thuhet se i takonte Sinagogës së Vlorës. Mendohet se ai ishte aty që prej kohës së eksodit të dytë e këtej. Nuk mund të them se është libër fetar, por mund të them se është shumë i bukur. Ne e kemi trajtuar këtë çështje me bashkësinë e Janinës dhe i kemi kërkuar të na e kthejnë këtë antikë të vlefshme, nëse do të hapnim një sinagogë këtu, por ata kanë kundërshtuar. Na thanë se ai është libër i shenjtë shumë i vlefshëm dhe nuk mund ta lenë të dalë prej andej.
>
> Këtu në këtë qytet ka pasur një ndërtesë të madhe, e cila përdorej prej turqve për magazinë baruti. Kjo ndërtesë u shkatërrua prej zjarrit gjatë Luftës Botërore

dhe mezi ka ngelur ndonjë shenjë e saj. Mendohet se ajo ka qenë sinagogë. Për më tepër, një seksion i konsiderueshëm i qytetit, i cili përfundon aty ku ekzistonte ajo strukturë, njihet me emrin “Çifut’hane” ose “Lagja e Hebrejve”. Nuk ka shenja tjera të jetës së hebrejve këtu. Megjithatë sivjet e kemi gjetur varrezën e hebrejve. Nuk ka shkrime, por janë gjetur shenja dhe kocka. Tani edhe ne këtu kemi vend për varret tona.

Duke folur për këtë çështje me profesor Ugolinin, ai i tha Bernsteinit se tetë kilometra në veri të Urës së Kalasë, midis Sarandës dhe Delvinës, gjendet një varr. Ai ka mësuar prej vendasve se ky varr njihet si “Varri i Çifutit”[103], ose varri i hebreit. Ugolini tha se nuk ka pasur rastin ta shihte atë.

Mesia Falso Sabatai Zevi

Ambasadori Bernstein arriti të zbulonte gjurmët e një bashkësie të gjerë hebraike në Shqipëri gjatë shekujve XV dhe XVI[104]. Ai citon një dokument gjerman të botuar më 1611 në të cilin shkruhet "...shumë prej këtyre vendeve janë të populluara prej hebrejsh, të cilët shkuan në Shqipëri nga Ankona (Itali) gjatë periudhës së Papa Pavlit IV, i cili e vështirësoi inkuizicionin.”[105] Po ashtu ai bie në gjurmë të njërës prej figurave më interesante të botës hebraike, Sabbatai Zevi, [106] i cili besohet se ka vdekur në bregun e Lumit Osum në Berat.[107] Ai, pasi kishte udhëhequr një lëvizje për t’i dërguar hebrejtë e Europës drejt Tokës së Premtuar, ishte kthyer në një rrezik serioz ndaj pushtetit të Sulltanit. Ky i fundit, duke parë mashtrimin e Zevit e thirri dhe e vuri përpara xhelatit, duke i kërkuar të zgjidhte midis dy gjërash: Ose të shndërrohej në islam, ose t’ i pritej koka.

Zevi zgjodhi të shndërrohej në islam. Si i tillë, ai u internua në Ulqin,[108] atë kohë pjesë e territoreve shqiptare. Vitet e fundit të jetës i kaloi i izoluar në Berat, ku mendohet se formoi një sekt islamik, që ekziston edhe sot në Shqipëri. Kur vdiq dhe e morën për ta dërguar në varr, gjetën se ai nën jastëk kishte librin e shenjtë, Torah dhe jo Kuranin, gjë që do të thoshte se ai kishte pretenduar se ishte shndërruar në islam, por kishte praktikuar fshehtas judaizmin. Po ashtu, një kategori hebrejsh të njohur me emrin Dönmeh[109] jetuan dhe vazhdojnë të jetojnë si kripto – hebrej, të cilët edhe pse shndërrohen në fenë islame, e ushtrojnë fshehtas judaizmin. Është interesante të dihet se ka prej atyre që edhe sot besojnë se Zevi nuk ka vdekur dhe se ai një ditë do t’i udhëheqë drejt Jeruzalemit. Zevi është figura më e njohur kontraverse në historinë e hebrejve.[110]

33 Foto e truallit të një sinagoge të shekullit të V – të në Sarandë.

34 Sabbatai Zevi, 1626 – 1676

Efekti i marrëdhënieve Zog – Bernstein në lidhje me hebrejtë

Diskutimet e Bernsteinit me Mbretin Zog në lidhje me mundësinë e vendosjes së një numri hebrejsh nga Europa në Shqipëri, kanë pasur efektin e tyre në ruajtjen e hebrejve para dhe gjatë pushtimit italian dhe gjerman.[111] Mbreti Zog dha një porosi ndaj misioneve konsullore shqiptare në Europë, që të pajisnin me viza ata hebrej nga Europa, të cilët e shikonin Shqipërinë si mundësi shpëtimi. Është kjo arsyeja pse një numër i madh hebrejsh, e gjeti shpëtimin në Shqipëri. Ndër ta ishte edhe zonja Scarlett Epstein, dëshminë e së cilës kam pasur rastin ta mësoj drejtpërdrejt prej saj.

E njoha atë në Londër në vitet e shërbimit diplomatik si Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar. Mësova aq shumë nga kjo profesoreshë e nderuar, e cila vdiq më 27 prill 2014. Pjesëmarrja në funeralin e saj mbetet një prej ngjarjeve, që më ka lënë më shumë përshtypje. Pikërisht për këtë arsye, në atë kohë, shkrova shkrimin e mëposhtëm në kujtim të historisë së jetës së saj. Profesor Epsteini është gjithashtu dëshmia më e qartë e asaj vepre humane, që arriti Ambasadori Herman Bernstein me Mbretin Zog në shpëtimin e hebrejve, bazuar në ndjenja njerëzore të tolerancës ndërfetare, si një model unik e shprehës i vlerave universale njerëzore.

In Memoriam të prof. T. Scarlett Epstein, OBE

Prolog

Profesor T. Scarlett Epstein ndërroi jetë më 27 prill 2014, në moshën 92- vjeçare, duke lënë pas kujtime shumë të vyera, ndër të cilat nga më interesantet janë ato për Shqipërinë.[112]

E njoha atë në ditët e para të punës sime në Londër, kur kolegia ime diplomate, znj. Teuta Starova më njoftoi se prof. Epstein dëshironte të më takonte dhe të njihej me mua. Kështu ndodhi. Ajo ishte zonjë hebreje austriake, e lindur dhe e rritur në Vjenë deri në moshën 16 vjeçe dhe e shpëtuar në Shqipëri në vitet 1938 – 1939. I prirur për të ditur sa më shumë rreth historisë së hebrejve, e prita me shumë kënaqësi. Më pas, me prof. Epsteinin na lidhi një miqësi e fortë.

Epsteini ishte një zonjë që e donte shumë Shqipërinë dhe shqiptarët. Me modestinë e njeriut të madh ajo më "*mori për dore*" në një udhëtim rrëfimtar të një jete, që vërtetë impresionon çdokënd, që ka sado pak ndjesi njerëzore dhe dëshirë për të njohur e mësuar. Ajo kishte një karrierë të gjatë akademike dhe hulumtuese si ekonomiste dhe antropologe, autore e 14 librave, shumë artikujve dhe filmave dokumentarë dhe ishte nderuar me shumë çmime e tituj, mes të cilëve titulli OBE (Urdhëri më i lartë i Perandorisë Britanike) akorduar në vitin 2004. Takimi i fundit me të në shkurt 2014 në

Shtëpinë e Pleqve në Brighton mbetet i paharruar.

Të notosh kundër rrjedhës[113]

Një ditë profesoresha më dhuroi një libër që kishte botuar rreth jetës së saj me titull: *"Të notosh kundër rrjedhës"*. Ky libër gjendet në bibliotekën time dhe mban një dedikim të shkruar me dorë nga autorja: *"Shenjë e vogël e një admirimi të madh", Scarlett.*

Rrëfimi i saj në atë libër të le pa frymë pothuajse në çdo faqe të tij. Dhe unë mendova se bazuar në atë rrëfim të sinqertë e dramatik të profesor Epsteinit të bëja të njohur historinë e saj që është e lidhur me ne shqiptarët, pikërisht në këtë ditë kur ajo u nda nga jeta. Ky libër, i botuar në gjuhën angleze në vitin 2005 në Londër përmban historinë e një jete të vështirë dhe përcjell një mesazh të fortë: *"Unë jam gjallë falë bujarisë shqiptare."*

Prof. Epstein jetoi 92 vjet. Krejt e thinjur, e ndrojtur, trupvogël ajo banonte në qytetin bregdetar Brighton të Britanisë së Madhe. Epsteini gjendej përherë e pranishme mes nesh, sa herë që zhvilloheshin veprimtari të Ambasadës Shqiptare në Londër. Atë e gjeje aty ku flitej për Shqipërinë, aty ku tregohej historia e hebrejve dhe Holokaustit dhe mbrojtja, që atyre iu kanë bërë shqiptarët në ditët më të vështira të historisë së tyre. E gjeje në shkolla, në universitete, në biblioteka, festivale filmi, takime të rëndësishme ndërkombëtare a sinagoga. E gjeje në Washington DC, apo New York në mes shqiptarëve, në Universitetin e Vjenës, apo në Parlamentin Europian në Bruksel, në Cambridge dhe Oxford, por edhe në Tiranë. Kudo, ajo përcillte këtë mesazh: *"Unë jam gjallë falë bujarisë shqiptare."*

Historia e saj është një histori tejet e dhimbshme, si shumë të tilla për hebrejtë, por me një fund të lumtur. Ajo ngjet me historinë e thuajse tremijë hebrejve që shpëtuan në Shqipëri.

Anschluss – Vjenë – Zagreb

Prof. Skarlet Epstein lindi në korrik të vitit 1922. Prindërit e pagëzuan me emrin Trude Grünwald. Ajo bashkë me prindërit dhe vëllezërit e saj u vu në shënjestër të nazistëve në atë periudhë të njohur si Anschluss ose aneksim i Austrisë prej Gjermanisë naziste, i cili ndodhi më 12 mars 1938. Përndjekjet ndaj tyre ishin të përafërta me ato që zbatoheshin ndaj hebrejve në Gjermani. Kështu, si shumë familjeve të tjera edhe familjes Epstein, tani me emra të ndërruar, iu desh të linte Vjenën drejt një vendi më të sigurtë. Vajza e re 16-vjeçare, e cila vazhdonte gjimnazin me plot endrra për të ardhmen, u ballafaqua me alternativën jetë a vdekje. Kështu, ajo e mori në dorë jo vetëm fatin e vet, por edhe të prindërve të saj, arriti të siguronte viza hyrje në Jugosllavi dhe me ndihmën e xhaxhait që ishte industrialist i madh, u vendosën në Zagreb. Pas tre muajsh vizat e tyre skadonin dhe duhej të largoheshin nga Jugosllavia, ose të dëboheshin me dhunë drejt vendit të origjinës. E vetmja rrugëdalje ishte të sigurohej vizë për ndonjë nga vendet jashtë ndikimit të gjermanëve. Ky vend doli të ishte Shqipëria.

Mbreti Zog dhe hebrejtë

Vajza e re troket në dyert e shumë konsullatave, të cilat gjendeshin në atë kohë në Zagreb, por të gjitha i mbyllen me forcë përpara syve, sapo ajo tregonte pasaportën e saj me germën "*J*" të damkosur në të nga nazistët. Në këto rrethana, xhaxhai i saj i thotë se kishte një shpëtim:

"Është Shqipëria"

Një hebre tjetër, i cili bënte tregti me Shqipërinë i kishte thënë atij se Shqipëria kishte një agjensi tregtare në Zagreb, e cila kryente edhe veprime konsullore dhe i priste hebrejtë bujarisht. Sipas xhaxhait, Shqipëria festonte një përvjetor të saj dhe Mbreti Zog kishte dhënë urdhër që të jepeshin viza hyrëse turistike, madje edhe për hebrejtë. Gjithçka që dinte ajo vajzë nga mësimet e gjeografisë dhe historisë për Shqipërinë ishte se ky vend shtrihej në vijën bregdetare të Adriatikut dhe kufizohej me Jugosllavinë dhe Greqinë. Tani familja hebraike kishte tri zgjidhje: të fshihej nëpër Jugosllavi dhe të priste fatin e zi të dëbimit në Austri; të kthehej në Austri vetë dhe të përfundonte në ndonjë kamp përqendrimi nazist, apo të shkonte në një vend të panjohur, në Shqipëri.

Ajo arriti t'i bindte prindërit dhe vetëm tri ditë përpara skadimit të vizës trokiti në dyert e zyrës tregtare – konsullore shqiptare. Konsulli shqiptar e priti me respekt dhe përkundër faktit që ajo i tregon se ishin hebre në kërkim, me pasaporta me germën "J", ai i pajisi me viza. Ata menjëherë morën rrugën për në Split, prej ku zunë një anije që do t'i zbarkonte në Durrës. Në nisje u përcollën prej shumë hebrejve, të cilët ishin zënë në kurthin e tmerrit nazist. Me ata njerëz ajo nuk do të shihej më kurrë, pasi nuk i mbijetuan terrorit nazist.

Durrës – 20 nëntor 1938

Në këtë datë ata arrijnë në Durrës. Pasi zbarkojnë, priten nga dy hebrej gjermanë të cilët e kishin gjetur që më parë Shqipërinë si strehën e tyre mbrojtëse dhe jetonin aty. Ata i shoqërojnë dhe i vendosin në hotelin "Metropol" afër portit detar. Përshkrimi i saj rreth gjendjes së këtij hoteli nuk lë vend për ndonjë kënaqësi, por pritja e shqiptarëve ndaj kësaj familjeje në dëshpërim të plotë, të bën të ndihesh krenar. Ajo e përshkruan Durrësin e asaj kohe si qytet me popullsi të përzier myslimane dhe orthodokse, që jetonin në paqe. Pas disa javësh qëndrim në hotelin "Metropol", familjes i ofrohet mundësia të qëndronte në një kompleks, i cili ishte dhënë nga bashkia. Aty gjendeshin hebrej me shtetësi të ndryshme, të cilët tmerri nazist i kishte bashkuar në fatin e tyre. Ky kompleks banimi financohej nga Komiteti Ndërkombëtar Amerikan Hebraik i Ndihmave, natyrisht me pëlqimin e qeverisë së Mbretërisë Shqiptare.

Jeta në Durrës, nëntor 1938 – 20 prill 1939

Nevoja për të mbijetuar e mëson njeriun më shumë se gjithçka tjetër në jetë, sepse vlera e jetës dyfishohet pikërisht atëherë, kur ajo bëhet e pasigurtë. Kështu Scarlett Epstein fillon të kërkojë punë dhe arrin të gjejë nxënës, që dëshironin të mësonin gjermanisht. Ndër to ishin dy vajza, bijat e familjes Dovana, një nga familjet më të njohura në Durrës. Me këtë familje ajo krijon një lidhje të fortë miqësore që ka vazhduar deri sa ajo u nda nga jeta. Sipas ligjit shqiptar, refugjatët nuk lejoheshin të punonin, megjithatë ajo, falë miqësisë së mënjëherëshme që ndërton me shqiptarët, ia del të bëhet mësuese, edhe pse ishte ende aq e re. Familja e saj trajtohet me një dashuri të veçantë jo vetëm nga banorët e thjeshtë të qytetit, por edhe nga prefekti i Durrësit. Episodet e jetës së saj në Durrës janë të gjitha sa piktoreske dhe aq interesante, por ajo çfarë mbetet në kujtesën e njeriut është se sa herë ajo i rrëfente qoftë në audienca, qoftë në biseda private, apo edhe në librin e saj, është dashuria që ajo përjetoi në atë qytet, për të cilin ishte mirënjohëse.

"*Shqipëria më shpëtoi jetën*" ishte kryefjala e çdo rrëfimi të saj, megjithatë, ky nuk mund të ishte një vend me një të ardhme për hebrejtë e mësuar me tregëti dhe profesione të tjera. Me dy vëllezër në Britani, Oton dhe Kurtin, ajo vendos të përpiqet të bashkojë familjen pikërisht atje. Kështu arrin të sigurojë viza për vete dhe nënën e saj, por jo dhe për babain. Vizat do të skadonin më 30 prill 1939. Ndërkohë ndodh ajo të cilën Epsteini e përjeton dhe e përshkruan si dëshmitare okulare me detajet e mëposhtme:

Dëshmitare e pushtimit fashist Italian, 7 prill 1939

Epsteini tregon në librin e saj se mëngjesi i së Premtes së Mirë, 7 prill 1939 u gdhi në Durrës bashkë me anijet italiane, që kishin filluar të dukeshin mizëri në brigjet e qytetit. Banorët e qendrës ku ishin strehuar refugjatët hebrej ishin udhëzuar të largoheshin dhe të hynin thellë në territorin e vendit pasi qendra e tyre ishte pranë policisë, e cila kishte dy mitralozë. Ky do të ishte edhe objektivi kryesor i italianëve që do të thoshte se mund të dëmtonte seriozisht banorët e qendrës. Në qytet gjendeshin vetëm disa ushtarë të ushtrisë shqiptare. Hebrejtë vendosën të futeshin në qilarin e një shtëpie pranë komunës. Luftimet vazhdonin dhe ndiheshin të shtënat. Hebrejtë prisnin çfarë do të ndodhte me ta dhe si do silleshin italianët?! Skarleti nuk e dinte, nëse edhe italianët ishin anti-semitistë, po aq sa ishin gjermanët. Hebrejtë vendosën të largoheshin, duke marrë me vete vetëm gjërat me të lehta të mundshme. U larguan nëpër një fushë, ku plumbat iu shkonin sipër kokës, për t'u strehuar më pas në një shtëpi, ku mundën të arrinin. Shkëmbimi i zjarrit midis forcave italiane dhe atyre shqiptare zgjati disa orë. Ajo dëshmon se kishte parë njerëz të vrarë dhe të mbetur në rrugë.

Përballë pushtuesit italian miku i armikut bëhet mik i hebrejve

Pas pak grupi i hebrejve u përball me italianët. Me bajonetat e armëve të hapura, ata iu dhanë udhër të ndalonin. Në krye të turmës ishte vajza Skarlet, jo vetëm si guximtare, por edhe se ishte e vetmja që fliste italisht. Ajo iu tha italianëve se ata ishin gjermanë. Italianët menjëherë iu kthyen atyre me dashamirësi, duke iu thënë: "*Gjermanët dhe italianët janë miq*" pa e vënë re faktin që si hebrej që ishin, ata ishin armiqtë më të

mëdhenj të Hitlerit, i cili po i ndiqte këmba-këmbës. Ajo i shpjegoi komandantit italian se ata kishin dalë nga shtëpia, nga frika e sulmit italian, por tani dëshironin të ktheheshin përsëri atje.

Italiani i siguroi se meqë ishin gjermanë konsideroheshin miq, ndaj do t'ju garantonin mbrojtje, duke nderuar kështu marrëdhëniet që ekzistonin midis dy vendeve. Kështu, sado që të duket si një shaka, ata u vunë nën kujdesin italian dhe u kthyen në shtëpi, pa menduar se kë po mbronin realisht në këtë situatë. Me këtë premtim ata nuk po kuptonin, nëse italianët ishin aty për t'i mbrojtur, apo për t'i ndëshkuar. Ajo e tregonte jo pa humor faktin që aleatët e Hitlerit, armikut më të madh të hebrejve, u bënë mbrojtës të tyre.

Pushtimi u krye të nesërmen e së Premtes së mirë dhe italianët vijuan drejt Tiranës. Hebrejtë mbetën në Durrës, ndërsa Skarleti merr një letër nga prefekti i Durrësit, ish-konsulli italian që tashmë ishte bërë prefekt i pushtuesit. Ai i kërkonte asaj të vazhdonte t'i jepte mësim në gjuhën gjermane, siç kishte bërë edhe më parë dhe i premtonte se, përsa kohë të ishte ai në atë detyrë, asgjë nuk do të ndodhte me ta nga ushtria italiane. Vite më vonë ajo interesohet të mësoje për fatin e Luigi Aloisit, pikërisht këtij konsulli, që me veprën e tij kishte sfiduar, jo pa rrezik racizmin fashist Italian.

Largimi nga Shqipëria

Kur rrjedha e ngjarjeve mori drejtim tjetër, Epsteinit nuk i mbetej gjë tjetër veçse të përdorte vizën angleze, të cilën ia kishin siguruar vëllezërit. Kështu, më 20 prill 1939 ajo bashkë me nënën e saj niset për një udhëtim tejet të rrezikshëm deri në Itali, me anije e më pas me avion nëpër Berlin, Këln, Amsterdam, Londër. Vitet e mëtejshme të jetës së kësaj zonje janë të mbushura plot e përplot me ngjarje, por historitë plot vuajtje dhe rrezik u skalitën në kujtesën e saj, duke memorizuar të shkuarën dhe duke ecur përpara udhëve me plot të papritura të jetës. Megjithëse jetën si emigrante në Angli e fillon me sakrifica, duke qepur uniforma për ushtarët anglezë të Luftës së dytë Botërore, falë forcës e vullnetit të saj, ajo arrin të vazhdojë studimet universitare, të përfundojë doktoraturën e të bëhet profesoreshë dhe një ndër antropologet më të njohura në Britaninë e Madhe.

Miqësia me profesor Scarlett Epstein

Me prof. Epsteinin na lidhi një miqësi e fortë, e sinqertë dhe e bazuar në ndjenjat e bukura të mirënjohjes, mikpritjes dhe besës shqiptare. Ajo ka lënë dy vajza, Debby dhe Michelle, por në fakt edhe një tjetër, një zonjë shqiptare, ish Ministre Këshilltare e Ambasadës shqiptare në Londër, pedagoge e nderuar dhe diplomate e shkëlqyer, dr. Teuta Starova, që i ishte bërë si vajza e saj e tretë.

Ditë e netë të tëra, ajo i kalonte ose duke biseduar, lëvizur, shkuar nëpër universitete, sinagoga, shkolla për të folur për shqiptarët, ose në telefonata të gjata, duke bërë plane

se si ta propagandonin vlerën shqiptare të besës dhe mikpritjes në mjediset angleze.

Në vitin 2012 në Wiener Library, Londër, u organizua një takim kushtuar prof. Scarlett Epsteinit në prani të bashkësisë hebraike dhe shqiptare të Londrës. Atë veprimtari e nderoi edhe ambasadori i Izraelit në Britaninë e Madhe, Sh.T. Z. Daniel Taub. Aty, ajo u nderua me simbolin e qytetit të Tiranës. Po ashtu, kishte ardhur edhe znj. Ingrid Strati, një intelektuale e njohur shqiptare nga Durrësi, me qëndrim në Itali, pasardhëse e familjes së shquar patriote të Dovanave.

Me atë familje Scarletti kishte rivendosur kontaktet vetëm pak kohë më parë, me ndihmën e një tjetër diplomateje të Ambasadës Shqiptare, dr. Xhoana Papakostandini, që fati kishte dashur që jo vetëm të ishte nga Durrësi, por edhe që familja e saj të kishte miqësi me familjen Dovana.

Dukej se edhe pas 74 vjetësh buka e Dovanajve nuk ishte harruar nga Epsteini, as mirënjohja për ta dhe as për Durrësin nuk ishte shuar. Kështu, në pranverën e vitit 2012 ajo udhëtoi në Durrës, për të rishkelur përsëri mbi ato rrugë të memories, ku pulsonin kujtime të vjetra dhe për të xhiruar një dokumentar mbi historinë e saj në atë qytet.

Po në vitin 2012, Scarlett Epstein udhëtoi për në Washington DC për të marrë pjesë në përkujtimin e përpjekjeve të shqiptarëve, për të mbrojtur hebrejtë gjatë Holokaustit. Më pas, e ftuar nga Vatra, festuam bashkë me të 100-vjetorin e pavarësisë, të ftuar nga shqiptarët e New Yorkut. Në vitin 2014, pas një sërë aktivitetesh mbi Shqipërinë ajo mbajti një fjalim të gjatë në Parlamentin Europian për besën shqiptare, e cila u prit me një admirim të jashtëzakonshëm.

35 Foto me prof. Scarlett Epstein, Londër 2013



36, 37 Pavarësisht nga bindjet politike, shqiptarët i morën në mbrojtje hebrejtë me të gjitha mjetet dhe mënyrat që kishin. Këto janë Faksimile dokumentash të lëshuara nga Ministri Kol Bib Mirakaj për të lehtësuar shpëtimin e hebrejve nga nazizmi gjerman në Shqipëri.

Nderim

Respekti për këtë zonjë është i pafund dhe rrjedh në të njëjtin shtrat kujtimesh, përpjekjesh, vështirësish që ravijëzuan tek ajo gruan e fortë, mirënjohëse përjetësisht ndaj shqiptarëve. Vërtet që shqiptarët kanë bërë për këtë zonjë atë që bëjnë për çdo njeri që iu troket në derë, por edhe ajo ua shpërbleu me aq shumë punë, për ta bërë të njohur këtë histori kudo, atje ku shqiptarët kanë nevojë për njohje, përkrahje dhe ngrohtësi. Pak kohë para se të ndërronte jetë, i bëmë një vizitë. Takimet e bisedat me të ishin jo vetëm të një kënaqësie të veçantë, por edhe një detyrim moral ndaj një lidhjeje historike midis shqiptarëve dhe hebrejve, dy popuj që e kanë siguruar lirinë me aq mundime, vuajtje e përpjekje.

Prof. T. Scarlett Epstein prehet në varrezat hebraike në Hove, East Sussex, Brighton Ajo la pas një histori, e cila nuk duhet harruar e që e ka zanafillën tek ajo marrëdhënie e veçantë e vendosur nga Herman Bernsteini me Mbretin Zog.

Një krahasim i Shqipërisë së asaj kohe me Meksikën antisemitiste

Bluzat e Arta Meksikane, ose analogët e Bluzave të Kafejta Naziste, i kanë bërë peticion qeverisë meksikane, që të ndalojë hebrejtë të përzihen në politikë, të mos u jepet shtetësia meksikane dhe t'u konfiskohen fabrikat e tyre për t'i kthyer ato te punëtorët meksikanë. Thuajse njëherësh, Mbreti i Shqipërisë lëshoi një ftesë zyrtare për bizneset hebraike, që të vendoseshin në Shqipëri dhe të ndihmoheshin në çdo mënyrë

sipërmarrjet tregtare të ndërmarra prej të ardhurve të rinj.

Organizata fashiste meksikane natyrisht që nuk është përfaqësuese e shpirtit të sotëm meksikan. Meksika, më shumë se ndonjë vend tjetër, në kontinentin amerikan, është tani e angazhuar në një luftë për të përfunduar betejën midis elementeve reaksionarë dhe liberalë. Në sajë të ndërhyrjeve ushtarake dhe policore, janë parandaluar kryengritjet dhe trazirat. Kështu që peticioni i Bluzave të Arta nuk mund të merret si fuqizim i antisemitizmit në Meksikë, por mund të merret si lëvizje politike e një partie, që kërkon të shqetësojë qeverinë. Kjo nuk do të merret serizisht nga shteti.

Oferta shqiptare në anën tjetër, është një gjest drejtpërdrejt i dëshirës së mirë, në drejtim të botës hebraike. Mbreti Zog ka në këtë projekt mbështetjen e këshilltarëve italianë. Ai që meriton më shumë mirënjohje se askush tjetër për këtë ftesë, është Herman Bernstein, ish-ministri i Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Zoti Bernstein është mik i ngushtë i Mbretit Zog dhe ne e dimë se ai iu përkushtua kësaj çështjeje disa kohë më parë. Në të vërtetë, ky është një mësim tolerance si dhe mençurie ekonomike që Shqipëria primitive iu jep fashistëve meksikanë.[114]

Seven Arts Feature Syndicated, Worldwide News Service, New York City

Besa e Tiranës, 8 mars 1933

"Ditën e martë, datë 7 mars, Shkëlqesia e tij Herman Bernsteini, Ministër i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, u sajdis me një drekë me rastin e nënshkrimit të Traktatit të Dëbimit midis Shqipërisë dhe Amerikës.[115] Traktati ishte nënshkruar më 1 mars në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Tiranë. Morën pjesë në drekë: Xhaferr Vila, Ministër i Jashtëm, Ekrem Libohova, Ministër i Oborrit Mbretëror, dr. Dhimitër Berati, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe majori Muharrem Bajraktari, adjutant i Madhërisë së Tij, Mbretit, dr. Mihal Sherko, Drejtor i Byrosë së Shtypit, dr. Fuad Asllani, Shef i Seksionit Politik të Marrëdhënieve me larg, Klois K. Hjuston (Cloyce K. Huston), Sekretari i Legatës, Erich W.A. Hoffmann, Zëvendës Konsull Amerikan në Legatë, Stefan J. Shuttak, Zyrtar i Legatës Amerikane dhe Kol Kuqali, dragomani[116] i Ambasadës Amerikane.

Në këtë rast, Ministri amerikan, duke folur rreth udhëtimit të tij të ditëve të fundit në Butrint, përmendi mënyrën në të cilën ai i pa traktatet e shkruara në kohët e lashta. Ai nënvizoi se gjatë tre viteve të qëndrimit të tij në Shqipëri kishte parë dashuri të madhe dhe të vazhdueshme nga ana e shqiptarëve ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe institucioneve të saj. Ministri doli në përfundimin se Traktati i Dëbimeve formon një tjetër lidhje të miqësisë midis Shqipërisë dhe SHBA-ve.

Ministri për Marrëdhëniet me Jashtë z. Xhaferr Vila, u përgjigj duke falënderuar Ministrin amerikan në emër të Qeverisë Shqiptare për ndjenjat e mrekullueshme që ai ka shprehur dhe ushqyer ndaj Shqipërisë. Ky dokument,- shtoi ai- merr edhe më shumë vlerë, pasi mbart nënshkrimin e një miku të Shqipërisë, siç është z. Bernstein."

Bernsteini asnjëherë nuk ka lënë t'i shpëtojë rasti që të manifestojë ndjenjën e tij miqësore për Shqipërinë. Ai ka folur, ka shkruar, ka vizituar rajonet e bukura, pikërisht si mik i sinqertë, si mbështetës, i cili tregon hapur simpatinë që ndjen për vendin tonë.

Fundi i misionit të Bernsteinit në Shqipëri

Pas një periudhe shërbimi prej shkurtit të vitit 1930 deri në shtator të vitit 1933, Bernsteini largohet nga Shqipëria, duke lënë një trashëgimi të jashtëzakonshme, reminishencat e së cilës vijuan shumë vite pas largimit. Emri i tij u fsheh gjatë 46 vjetëve të sundimit të egër komunist në Shqipëri. Në prag të rënies së komunizmit, Shqipërinë e vizituan dy personalitete të njohura të politikës amerikane: ish kongresmeni me origjinë arbëreshe Joseph DioGuardi dhe kongresmeni me prejardhje hebraike Tom Lantosh.

Në atë kohë ata u njohën me historinë e harruar tëhebrejve dhe trashëgiminë e Herman Bernsteinit. Ajo histori u botua në një libër të quajtur *"Shpëtimi në Shqipëri*[117]*",* shkruar nga filantropisti Harvey Sarner. Ai e shkroi këtë bazuar në dokumente, që këta udhëtarë arritën t'i merrnin. Ky libër ka pasur një efekt të jashtëzakonshëm në njohjen e botës me historinë fisnike të shqiptarëve, që mbrojtën hebrejtë. Por le të kthehemi te largimi i Bernsteinit nga Shqipëria. Ashtu sikurse Vatra ishte lajmëtare e ardhjes së Bernsteinit në Shqipëri, ishte po Vatra që njoftoi largimin e tij me nderin dhe respektin që meritonte.

Si e priti Vatra largimin e Bernsteinit nga Shqipëria[118]

> Njoftimi për mbarimin e mandatit të Herman Bernsteinit ishte një lajm, i cili rrallë ndodh të jetë i tillë, kur një ambasador mbaron detyrën e tij në një vend. Por ashtu, sikundër emërimi i Bernsteinit në Tiranë ishte lajm i rëndësishëm, edhe largimi po ashtu bëri lajm. Ja si e priti atë Vatra:
>
> Ministri i Shteteve të Bashkuara, z. Bernstein është në ikje nga Shqipëria përgjithmonë dhe me të ikën edhe një mik i Shqipërisë. Shkëlqesia e tij Herman Bernsteini nuk ishte thjesht përfaqësuesi i Shteteve të Bashkuara, ndaj të cilave Shqipëria është aq e obliguar dhe që ushqen një mirënjohje të thellë dhe të përjetshme. Ai ka qenë një prej të paktëve që i kanë dëshiruar vendit tonë të mirën dhe që ne kemi pasur rastin ta njohim. Ai kurrë nuk e ka lëshuar rastin të manifestojë ndjenjën e tij miqësore për Shqipërinë. Ai ka folur, shkruar, ka vizituar rajonet e bukura, pikërisht si mik i sinqertë, si mbështetës i cili tregon hapur simpatinë që ndjen për vendin tonë. Kjo shpjegon përshtypjen që ka lënë në tërë Shqipërinë largimi i z. Bernstein. Keqardhja që e shoqëroi këtë njoftim është shumë e madhe në kryeqytet, i cili e rrethoi atë me simpati, nder dhe

mirënjohje gjatë qëndrimit të tij këtu, sepse kontaktet e shpeshta me të zbuluan edhe më mirë dhe më plotësisht ndjenjat e tij në drejtim të vendit tonë dhe cilësitë si një intelektual me emër botërore, gazetar dhe shkrimtar.

Ai do të jetë në Tiranë edhe disa ditë. Ne ndihemi më shumë se të bindur që po japim të njejtin opinon të vendit tonë dhe mund të sigurojmë mikun eminent të Shqipërisë se shqiptarët gjithmonë do të mbeten mirënjohës për ndjenjat e tij miqësore dhe simpatinë e veçantë, që ai ka shfaqur për ne dhe vendin tonë. Ne i dëshirojmë lumturi dhe suksese me gjithë zemër, duke përfshirë në lutjet tona shpresën se ai do na kujtojë në shkrimet e tij si gazetar, profesion të cilit ai do t'i kthehet përsëri.[119]

Z. Herman Bernstein është modeli i burrit të kohës tonë. ai është një njeri universal. Ne po flasim për një tip të veçantë të kohës Sonë, Një Lord anglez, një zotëri europian, një amerikan sportiv. Ai i ka kaluar të tëra fazat e jetës. Pjesëtar i një race të njohur për zgjuarsinë dhe idealet e larta, por e persekutuar dhe torturuar prej fanatizmit të verbër dhe shovinizmit të egër të vendeve të çmendura. I ballafaquar me përvoja të hidhura të kësaj jete të vështirë dhe pastaj i rritur në qarqet më të larta intelektuale të kohës së tij, i ushqyer me parimet e dashurisë për lirinë e kombit të Abraham Linkolnit, ai e njeh botën nga të dyja anët, atë të errëten dhe të shndritshmen. Ai është një prej pionerëve të botës së re.

Ministri Bernstein po largohet nga Shqipëria[120]

Largimi i Bernsteinit u shoqërua nga shumë shkrime rreth tij. Në një prej tyre shkruhet se një largim i tillë është i pangjashëm me largimin e ndonjë personaliteti të huaj:

> Për ne shqiptarët, z. Bernstein nuk ishte thjesht përfaqësues i një vendi të madh. Puna e tij këtu ishte më shumë se zyrtare. Që nga dita, kur erdhi në mision diplomatik në vendin tonë, ai mori përsipër të na njihte më mirë. Aq shumë ka hyrë ai në zemrat e njerëzve, që kanë pasur fatin të njihen dhe të shoqërohen me të, sa ai është bërë miku i afeksionuar i tyre dhe i vendit të tyre. Kjo është arsyeja përse në të vërtetë do të na mungojë shumë.
>
> Zoti Benstein është në vetveten e tij një përsonalitet që rrëmben zemrat e njerëzve. Qëndrimi i tij miqësor, vështrimi i tij i drejtpërdrejt i atyre syve të mprehtë që shkëlqejnë me intelegjencë të thellë, biseda e tij e pasur në fakte dhe njohuritë e gjera të botës mendore, tërheqin gjithkënd, e bën për vete shpirtin dhe e bën ta shohë z. Bernstein me admirim. Ju nuk mund ta takoni dhe të mos e nderoni atë thellësisht, madje nuk mund të largoheni prej tij dhe pastaj të mos ndjeni në zemrën tuaj përshtypjen e thellë që të lë personaliteti i lartë i tij.
>
> Ka njerëz të cilët janë përfaqësues tipikë të racës dhe kombit të vet. Ne po flasim për një tip të veçantë të kohës sonë. Një Lord anglez, një zotëri europian dhe një amerikan sportiv. Z. Herman Bernstein është modeli i burrit të kohës sonë, ai është një njeri universal. Ai nuk mund të ishte ndryshe. Ai i ka kaluar të tëra fazat e jetës. Pjesëtar i një race të njohur për zgjuarsinë dhe idealet e larta, por e persekutuar dhe torturuar prej fanatizmit të verbër dhe shovinizmit të egër të vendeve të çmendura. I ballafaquar me përvoja të hidhura të kësaj jete të vështirë dhe pastaj i rritur në qarqet më të larta intelektuale të kohës së tij, i ushqyer me parimet e dashurisë për lirinë e kombit të Abraham Linkolnit, ai e njeh botën nga të dyja anët, atë të errëtën dhe të shndritshmen. Ai është një prej pionierëve të botës së re.

Më pas autori i kthehet edhe një herë jetëshkrimit të tij që nga lindja në Neustadt, Soherwind, më 21 shtator 1876.

Bernsteini qëndroi tre vjet e gjysmë Ministër i SHBA-ve në Shqipëri. Në jetën diplomatike një periudhë e tillë është mjaft e gjatë. Sidoqoftë, z. Bernstein e ka përdorur këtë kohë jo vetëm në shërbim të dy vendeve në marrëdhëniet e tyre diplomatike, por gjithashtu për dy popujt në përgjithësi.

Nord Deutscher Lloyd Bremen [121]

Në jetën profesionale të Herman Bernsteinit bie në sy diçka shumë e veçantë. Ai bënte lajm thuajse me çdo lëvizje të tij nga njëri kontinent në tjetrin. Madje edhe prania e tij në një anije trans-oqeanike, si njeri i veçantë, i rëndësishëm bënte lajm. Ky fakt vërteton më së miri madhështinë e këtij njeriu. Një fakt i tillë paraqitet edhe në këtë shkrim të botuar nga Nord Deutscher Lloyd Bremen.

Ministri Amerikan në Shqipëri Herman Bernstein, që kthehet në shtëpi nga Europa pas një mungese dyvjeçare, tha:

> Kjo është hera e parë në njëzet e pesë vjet që po kthehem nga jashtë vendit, duke mos qenë në cilësinë e gazetarit. Në rastet e mëparshme kam shkuar në vende të tjera për të studiuar kushtet dhe të përshkruaja ato për gazetat që unë përfaqësoja. Këtë herë unë kam pasur një emërim tjetër dhe raportet e vëzhgimeve të mia nuk janë dërguar në shtyp, por te qeveria. Kolegët e mi të mëparshëm, gazetarët, do të solidarizohen, kur të mësojnë se në pozicionin e sotëm disa prej historive më të bukura nuk janë për publikim.
>
> Shqipëria është vend i vogël. Ajo është i vetmi vend në Europë që nuk ka hekurudha. Transporti bëhet me mjete motorike, gomarë ose aeroplanë. Nga gomari tek aeroplanet, Shqipëria e ka anashkaluar hekurudhën. Shqipëria nuk ka teatër për momentin, por para erës sonë, ajo ka pasur amfiteatrin më të madh në botë, i cili është zbuluar kohëve të fundit në Butrint. Shqipëria ka mjaft çfarë të mësojë nga vendet progresive dhe ajo po mëson me shpejtësi të madhe, por ka edhe gjëra të cilat mund t'i mësojnë vendet e zhvilluara nga Shqipëria. Dhe kjo është ndjenja e lartë e nderit, e cila gjendet midis njerëzve të saj, mungesa e plotë e diskriminimit fetar dhe paragjykimit, në një popull të përbërë nga fe të ndryshme. Vendi i vogël i njerëzve të shqipes, siç quhen shqiptarët, po e edukon rininë e vet dhe po bën progres si vend i pavarur.
>
> Sa i takon situatës së përgjithshme në botën e sotme, mua më duket aq e frikshme si depresioni ekonomik bie në sy kudo nëpër botë. Ai e ka zhytur botën në frikë, mosbesim, shovinizëm të tepërt dhe fanatizëm Rimarrja e shpejtë nga katastrofa ekonomike do të fillojë dhe pastaj një vitalitet i ri do të lëshohet dhe një epokë e prosperitetit dhe zhvillimit paqësor të kombit do të fillojë gjithandej. Por fillimisht , duhet luftuar morali i depresionit, sepse ai është baza e depresionit ekonomik. Në opinionin tim, Amerika po kontribuon shumë për të luftuar depresionin moral.
>
> I frikshën, siç është depresioni ekonomik, i cili shfaqet pothuajse gjithandej, depresioni moral, i cili mbizotëron në tërë botën është edhe më i frikshëm. Në disa vende ai gjen shprehje në mosbesimin reciprok, në nacionalizmin e tepruar dhe maskaradën e shitur si patriotizëm deri në fanatizmin e shfrenuar. Shpirti i frikës dhe shkatërrimit ka mbetur, po të kemi parasysh faktin që shumica dërmuese e masës kudo përfundimisht e neverit luftën.
>
> Kur antidoda efektive ndaj këtij morali depresionues do të administrohet mirë, dalja nga katastrofa ekonomike do të jetë e shpejtë. [...]
>
> Amerika është shumë popullore në Shqipëri. Puna që ka bërë Kryqi i Kuq

> Amerikan gjatë dhe pas luftës, shkollat e ngritura nga Fondacioni i Lindjes së Afërme, vlerësohen shumë prej popullit. Puna e Fondacionit Rockefeller kundër malarjes, po ashtu vlerësohet shumë. Nihma e dhënë nga Amerika për Pavarësinë e Shqipërisë në Konferencën e Paqes mbahet mend gjithandej. Këtë vit pritet të vendoset një bust i Skënderbeut, ndërsa disa rrugë do të marrin emrat Washington, Linkoln dhe Wilson.

Fjala e Bernsteinit në pritjen e dhënë me rastin e largimit nga Shqipëria[122]

Me rastin e largimit nga Shqipëria të Ambasadorit Bernstein u organizuan shumë aktivitete lamtumire. Në ato veprimtari Bernsteini shfaqi pamjen e vërtetë të një burri dinjitoz. Në raste të veçanta ai pas fjalëve të kortezisë dhe të rastit, shfaqte edhe një anë tjetër të natyrës së tij, atë të humorit të këndshëm, të cilin e përdori në një moment shumë solemn. Ai e kthen momentin e ndarjes nga një gjendje nostalgjie në një çast humori dhe gazmendi. Ja si e trajton ai largimin e tij nga shërbimi në Tiranë: - *Dje mora një letër nga Amerika, e cila njoftonte dorëheqjen time nga detyra e Ministrit në Shqipëri. Megjithëse lajmi ishte i vërtetë, kryelajmi ishte se unë kisha vdekur. Z Perry, Drejtor i Komitetit Kombëtar të Edukimit në Radio, në Washington më shkruante pak a shumë si më poshtë:*

> Më erdhi shumë keq, kur pashë dje në gazetë se keni vdekur. Më erdhi keq që dhatë dorëheqjen nga një post, që e keni mbajtur me aq dinjitet, por të dorëhiqeni dhe të vdisni, kjo është tej mase keq. Unë shpresoj se e keni gjetur jetën e përtejme të këndshme dhe që ne do të kemi kënaqësinë të takohemi përsëri, pasi të ktheheni në New York dhe të na tregoni për atë.

Përgjigjja e Bernsteinit ndaj letrës së z. Perry ishte:

> Në fakt u ndjeva i lumtur, kur mora atë letër që ma dërgonit prej asaj bote. Nëse kjo qenka bota e përtejme, mua nuk më tmerron fare. Përkundrazi, unë po i gëzohem shumë. Qenka lezetshëm këtu. Trëndafilat kanë shpërthyer përsëri dhe malet kanë marrë ngjyrë të purpurt nën rrezet e diellit, që po perëndon. Ky njoftim për dorëheqjen dhe vdekjen time më englendisi shumë. Edhe Mark Twain e ka pasur këtë kënaqësi, të raportohej i vdekur, thjesht pse kishte rënë nga kali në Malet Catakill.

Largimi

Bernsteini u dekorua prej Madhërisë së Tij, Mbretit Zog me "*Kordonin e Madh të Urdhërit të Skënderbeut"* për kontributin e tij në marrëdhëniet shqiptaro - amerikane. Me rastin

e këtij dekorimi Mehmet Konica mbajti fjalën e rastit, në të cilën tha:

> Shkëlqesia Juaj!
>
> Besojmë se ju nuk jeni zhgënjyer. Ju gjetët në Shqipëri një popull bujar, miqësor, një popull, i cili donte t'ju tregonte se ata janë pasardhësit e vërtetë të të parëve të tyre. Ju patë djemtë shqiptarë të shkollës teknike, me trup dhe me mendje, me mëngë të përveshura deri në bërryl, tek përfaqësonin atë që mund të quhet forca e madhe rinore shqiptare në punë. Ju i patë vajzat e shkollës, të vogla e të mëdha, nënat e ardhshme të shqiptarëve. Këto vajza, të veshura me kostume të mrekullueshme kombëtare, dëshironin t'ju tregonin juve me këngët dhe vallet e tyre se njerëzit në Shqipëri janë të lumtur, të shohin në vendin e tyre bijtë e një kombi të tillë të madh, i cili i mbrojti ata në kohëra të rrezikshme. O ju bijtë e atij shteti të madh, i cili ka si moto: "E pluribus unum"[123], që është simbol i vërtetë i Shteteve të Bashkuara. Ju keni pasur mundësinë të shikoni se në Shqipëri ata janë vetëm United Albanians (Shqiptarë të Bashkuar), sepse ky vend prej natyrës se vet dëshiron t'ju japë ju një provë modeste të simpatisë, që ata kanë për vendin tuaj, ku mijëra shqiptarë jetojnë të lirë dhe ndihmojnë bashkëatdhetarët e tyre në Shqipëri. Ne pamë qytetarët e lirisë me të cilët jeni mësuar të dëgjoni në himnin tuaj kombëtar:
>
> Ylli n'flamur t'vezullojë
> Triumfant le të valojë,
> Përmbi tokën e lirisë,
> Përmbi vend' të trimërisë[124]
>
> Ne jemi gjithashtu në një vend të lirë, një vend dëshira e të cilit është të përparojë, një popull i mbledhur rreth mbretit të cilit i këndon me gjithë zemër.
>
> Rroftë Zog i Parë, rroftë,
> Shpëtimtari i atdheut,
> Brez pas brezit mbretëroftë!
> Përmbi fron të Skënderbeut![125]
>
> Dhe tani, pasi keni parë këto gjëra, po ktheheni përsëri në vendin tuaj. Udhëtim të mbarë në vatrën tuaj, që është dëshira e të gjithëve ne dhe, kur ju të flisni me shokët tuaj atje, u thoni se në vendin e Gjergj Kastriotit, Skanderbegut, në vendin e heronjve, jeton një komb, i cili ka si parim mirënjohjen ndaj miqve dhe punon me ngulm për progres. Ju, bij e bija të Shteteve të Bashkuara, jeni të mirëpritur në këtë vend përgjithmonë.
>
> Faleminderit!.

Pas këtij fjalimi Bernsteini e ia ktheu përshëndetjen duke i thënë:

> Shkëlqesi!

Do të doja t'ju falënderoja për fjalët tuaja bujare dhe t'ju kërkoja që t'i përcillni mirënjohjen time më të thellë, Madhërisë së Tij, Mbretit të shqiptarëve Zogut I, për nderin më të madh që më ka bërë duke më dekoruar me "Kordonin e Madh të Urdhërit të Skënderbeut", heroit tuaj kombëtar. Unë jam thellësisht i prekur prej kësaj shprehjeje të nderimit dhe miqësisë.

Gjatë misionit tim në Shqipëri kam mësuar të admiroj Madhërinë e Tij dhe popullin shqiptar. Unë u magjepsa prej bukurisë së tokës suaj në brigjet e Adriatikut. Vizitova praktikisht çdo pjesë të Shqipërisë dhe mësova që ta dua popullin tuaj për thjeshtësinë tij, vërtetësinë, mikpritjen dhe mirësinë, të cilat kanë lënë një përshtypje të pashlyeshme tek unë. Marrëdhëniet e mia personale dhe zyrtare me njerëzit dhe qeverinë tuaj kanë qenë përherë më të kënaqshmet. Unë kam ndjekur me interesin më të madh dhe simpati të pafund me progresin e shkëlqyer që ju dhe shteti juaj i ri bashkë me popullin janë duke bërë. Amerika dhe amerikanët janë shumë populloré në vendin tuaj. Ata kujtojnë se si Presidenti Wilson e ndihmoi Shqipërinë në Konferencën e Paqes në Paris, që të ruante pavarësinë e saj dhe, po ashtu, kujtojmë se shqiptarët në Shtetet e Bashkuara kanë bërë aq shumë për ta ruajtur dhe për ta bërë më të sigurt paqen në vendin tuaj. Shqipëria është një prej pak vendeve në Europë, të cilat i detyrohen Shteteve të Bashkuara vetëm nga ana morale. Kjo ka shtuar popullaritetin e Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Gjatë misionit tim në Shqipëri unë pata nderin dhe privilegjin e madh të negocioja dhe nënshkruaja dy traktate në emër të qeverisë sime. Njëri është Traktati i Natyralizimit dhe tjetri i Dëbimeve. Po ashtu, kam qenë i lumtur që munda të ndihmoja Fondacionin e Lindjes së Afërme, për të themeluar Institutin Amerikano-Shqiptar, i cili po bashkëpunon me qeverinë shqiptare në drejtimin e Shkollës Bujqësore dhe fshatit model për djemtë, si dhe të një shkolle për vajzat mësuese. Këto institucione i ofrojnë shërbime të vlefshme sistemit të edukimit dhe ndërtimit të Shqipërisë së re.

Tirana gjatë këtyre tre vjet e gjysmë ishte për mua posti vëzhgues më magjepsës. Aty mësova se përkundër asaj që Shqipërisë i referohen, si njërës prej zonave më të rrezikshme të Europës, shqiptarët vetë janë njerëz paqedashës, ndërsa politika e qeverisë së tyre është pa diskutim një politikë paqësore në Ballkan. Kam vizituar praktikisht çdo pjesë të Shqipërisë, prej nga mësova ta njihja dhe ta doja popullin shqiptar, thjeshtësia, vërtetësia në veprime, mikpritja dhe shpirtmirësia e të cilit kanë lënë gjurmë të pashlyeshme tek unë.[126]

Bernsteini ruan miqësinë me shqiptarët edhe pas largimit

Korrespondenca që Herman Bernsteini mbajti me miq të tij në Shqipëri edhe pas largimit nga posti, që mbante në Tiranë, tregon jo vetëm emrin e madh që ai kishte lënë pas, por është edhe një tablo interesante politike e kohës. Nga letrat që ai merrte, kuptojmë se cilat ishin disa nga ngjarjet më interesante të kohës.

Kështu në letrën e dërguar nga miku i tij, përkthyesi i ambasadës Kol Kuga, mësojmë disa gjëra shumë të rëndësishme, të cilat i japin shpjegim edhe shumë hamendjeve dhe spekulimeve të bëra nga studiues, historianë dhe politikanë të ndryshëm shqiptarë. Një ndër to është edhe ndihma financiare, që Mbreti Zog i dha kundërshtarit më të madh politik të tij, Fan Nolit në ditët e vështira të këtij të fundit, kur nuk kishte mjete financiare për t'u kuruar në Amerikë. Për këtë fakt ka pasur shumë spekulime nga historia jonë. Noli është fajësuar për faktin se ka pranuar një gjë të tillë nga Zogu. Po ashtu, mësojmë se Mehmet Konica kishte nënshkruar një marrëveshje me Beogradin, si dhe për reagimin italian ndaj çdo hapi, që Shqipëria ndërmerrte në marrëdhënie me fqinjët.

Në këtë kontekst, mendojmë se letra në vijim i shton rëndësinë e veprës së Bernsteinit, i cili për fat të keq ishte jetëshkurtër, por për aq sa jetoi pas largimit, nuk e harroi Shqipërinë dhe miqtë e shtrenjtë që kishte lënë pas sikundër miqtë e tij shqiptarë nuk e harruan kurrë.

Kol Kuqa, Tiranë, 10 mars 1934

I dashur z. Bernstein!

Nuk di si të shfajsohem që nuk ju kam shkruar kaq kohë, por gjërat ashtu kanë rrjedhur. Së pari, pasardhësi juaj erdhi shumë më shpejt, se pritej. Fill pasi ikët ju, z. Hjuston i shkrepi në mendje të shkruante një histori të Shqipërisë, që nga koha para erës së re deri sot dhe në fakt pritej ta mbaronte para ardhjes së ministrit të ri. Ai dëshironte t'ia dhuronte atë libër ministrit si referencë doracake për ta njohur sa më shpejt këtë vend. Kjo histori e përmbledhur ishte 120 faqe. Z. Wheeler erdhi dhe më ka mbajtur shumë të zënë me punë këtu, ndonëse ende nuk kam arritur ta njoh aq mirë atë.

Po ju dërgoj gjithashtu një grup fotografish, të cilat i këni lënë tek unë me nënshkrime. Tre prej tyre i kam vënë unë vetë. Po ju dërgoj edhe një përshkrim të vizitës që i bëtë Kishës së Gjon Vladimirit në Elbasan, i cili besoj se do të jetë i kënaqshëm për ju.

Po ju dërgoj bashkëlidhur edhe një letër të pranuar nga njerëzit e Kodakut në

Lausanne. Po ashtu një ekstrakt banke nga Banka Kombëtare Shqiptare, e cila ka arritur për ju.

Profesor Ugolini ju ka dërguar një letër së bashku me dy fotografi të gurëve të Butrintit, me shpjegimet e shkrimeve në to dhe dy përshkrime të historisë së hebrejve në Shqipëri. Po jua dërgoj të përkthyera bashkëngjitur. Ugolini asnjëherë nuk ka ardhur këtu, siç e përshkruan në letrën e tij dërguar juve.

Po ju dërgoj bashkëlidhur edhe një kopje të BESA-ës, e cila përmban raportin rreth dekoratës që ju është dhënë ju dhe amerikanëve të tjerë. Unë e di që ju tashmë e keni dekoratën në trup, por mendova se ju pëlqen ta keni edhe gazetën. Urimet më të mira për këtë dekoratë, të cilën e meritoni plotësisht. Nuk ka shqiptar që ta dijë më mirë, se unë shërbimin e madh që ju i keni bërë këtij kombi të vogël. Unë si shumë shqiptarë të tjerë e vlerësojmë faktin që Mbreti e ka vlerësuar punën tuaj. Lajmi për këtë pati jehonë shumë të mirë, si te vendasit ashtu edhe te të huajt dhe të gjithë shprehin shpresën se kjo do t'jua shtojë edhe më shumë përkushtimin ndaj Shqipërisë.

Ndoshta e keni marrë vesh se një marrëveshje shtesë ndaj Traktatit Shqiptaro-Jugosllav të Tregtisë dhe Navigacionit të vitit 1926 është përfunduar në Beograd. Delegacioni shqiptar përbëhej nga Mehmet Konica, Dhimitër Berati dhe Qemal Kasaruho. Në Beograd u ra dakord që të hapeshin zyra përfaqësuese në vendet respektive dhe Banka Jugosllave të hapte degë të saj në Tiranë, Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Korçë. Disa prej këtyre degëve janë hapur, ndërkohë që dega e Tiranës do ta fillojë punën së afërmi. Situata me Italinë te klubi "Milano" mbetet e pandryshuar, megjithatë ata janë njoftuar se pas 31 marsit kontratat nuk do rinovohen më.

Artikulli juaj për Shqipërinë në "Sunday Times" ishte jashtëzakonisht interesant. Në shtypin shqiptar ende nuk është publikuar, por e di nga burime shumë të besueshme që është përkthyer në shqip, sapo gazeta arriti në Shqipëri dhe u dërgua drejt e te Mbreti. Ndërkohë që ai ishte, siç e kuptoj unë, shumë me interes për ata shqiptarë që e lexuan atë, riprodhimi i tij në shtypin vendas më duket se nuk është i këshillueshëm për momentin që kalojmë.

Mbreti Zog i dërgoi Fan Nolit tre mijë franga ari në fund të dhjetorit. Noli kishte rënë papritmas shumë i sëmurë me një pneumoni dhe gjendej në Boston pa asnjë koronë në xhep. Ai i kërkoi kishës këtu, por ajo nuk u përgjigj. Visarioni thotë se këtë kërkesë telegrafike nuk e ka marrë kurrë nga Noli. Pastaj ai iu drejtuar qeverisë dhe nuk mori përgjigje. Mbreti, megjithatë, i dërgoi vetë tre mijë franga ari.

E kuptoj se pranimi nga ana e Nolit e këtyre parave i ka zemëruar shqiptarët e Amerikës deri në atë pikë, sa refuzojnë t'i paguajnë atij rrogën që i jep kisha. Ky zemërim, siç e marr unë me mend, ka marrë përmasa serioze, pasi Noli i ka dërguar kabllogram at Vasil Markut në Korçë, ku i tregonte për nevojën e jashtëzakonëshme në të cilën ndodhej, duke i kërkuar atij ndihmë të menjëherëshme dhe ku i kërkohej të paraqiste një peticion para parlamentit që t'i lidhej një pension. Unë kam një kopje të këtij kabllogrami. At Marku më tha se Mbreti është gati t'i shkojë deri në fund kësaj çështjeje për të ndihmuar Nolin. Mbreti dëshiron që Noli të kthehet në Shqipëri, por kjo duhet bërë në atë mënyrë që të jetë vetë peshkopi që e kërkon këtë dhe jo si ofertë e dhënë prej Mbretit. Gjëja më e mirë që Noli do të bënte për të ruajtur nderin e tij dhe për t'i shërbyer

Shqipërisë, do të ishte të kthehej në Shqipëri, ku do të pritej me entuziazëm. Është e vërtetë se ekziston një fraksion që nuk e pëlqen atë, por mospëlqimi i tyre do të zbehet, sapo Noli dhe Mbreti të pajtohen. Mua më është kërkuar t'i shkruaj një letër personale, të cilën po e nis bashkëlidhur. Nëse ju nuk e kundërshtoni, unë dhe të tjerët këtu do tua dinim shumë për nder, nëse e postoni atë nën një numër të regjistruar postar.

Disa javë më parë Mehmet Konica më kërkoi të shkruaja një kapitull për Italinë, i cili ka mbetur pa përgjigje, që kur ju e parashtruat listën tuaj të kapitujve me pyetjet e bëra Mbretit. Konica më tha se ai kapitull ishte i papërgjigjshëm atëherë, por tani është koha për t'u përgjigjur. Padyshim, unë nuk e kisha atë kapitull, por e përgatita një përmendësh, e një kopje po e nis bashkëlidhur. Kur t'i jepet përgjigje, unë do ta përkthej dhe, nëse vjen tek unë do ta dërgoj tek ju menjëherë. Mbase e dini që Ekrem Libohova tani është Ministër në Francë dhe nuk kemi Ministër Oborri. Pritet që Ekremi të kthehet në detyrën e mëparshme brenda pak javëve. Peshkopi Visarion ju dërgon bekimet e veta. Dje më telefonoi dhe më tha se i kishte humbur fotografitë, që i dërguat ju nga ceremonia në Kishën e Shën Gjon Vladimirit. I dhashë të mijat, por duket se ato nuk mjaftojnë.

Ndoshta e keni marrë vesh se Krasniqi nuk është më agjenti i përgjithshëm i Linjave të SHBA-ve. Ai dha dorëheqjen dhe mori ato të Italisë për më shumë përfitime. Vendin e tij e zuri z. Gaqi M. Opari, një tregtar i Korçës dhe Tiranës.
Më në fund më lejoni t'ju pyes ju. Si jeni, si është zonja Bernstein? A është ende e mendjes që të jetojë në Sarandë? Po zonjat Nash dhe Willheim me burrat si janë? Po zonjusha Willheim? Besoj se Davidi është mësuar mirë me gazetën ndërsa Joyce ndoshta ende mendon për shokët shqiptarë dhe për Shqipërinë?

Nuk e di a kanë ardhur siç duhet fotot që dolët me Mbretin në prag të largimit. Kryegjyshi bektashi erdhi t'u përcillte por ishte me vonesë dhe i mbeti shumë merak. Edhe ai ju dërgon të fala të përzemërta.

Ju lutem na kujtoni, ju, e gjithë familja e nderuar Bernstein, gruan time dhe mua.

Mezi e pres një vizitë prej teje,

Sinqerisht i juaji,
Kol Kuqali[127]

Telegram i Ambasadorit Faik Konica dërguar Herman Bernstein

"Në përgjigje të telegramit tuaj, kam kënaqësinë që t'ju njoftoj se do të jem në New York të enjten në mbrëmje vonë, nëse mundet do t'ju takoj të premten. A do të kalonit drekën ju dhe zj. Bernstein me mua në Ritz Carlton të premten në oren 1?

Me vlerësimet më të larta,
Faik Konica!

38 Foto e Dy Ambasadorëve, Faik Konica në Washington dhe Herman Bernstein në Tiranë.



ALBANIAN LEGATION
WASHINGTON

January 10, 1934

Dear Mr. Minister:

I spent a few days in New York but thought all the time that you were still in Sheffield, Massachusetts. I found your letter on my return here, and deeply regret that I missed the opportunity of seeing you.

The Boston "Dielli", in its issue of January 5, 1934 published from Albania the news that the Grand Cross of the Order of Skanderbeg has been bestowed upon you. However, up to now, I have received no official notice of the event. You know how slow the Albanian bureaucracy can be; I expect to receive the papers in a couple of weeks or so. I will let you know immediately, and we shall arrange for a meeting to be held here at your earliest convenience.

Wishing you and Mrs. Bernstein a happy New Year, I remain yours very sincerely,

Faik Konitza

Minister
The Honorable Herman Bernstein

39 Bernsteinit, Mbajtës i Kordonit të Madh të Urdhërit të Skënderbeut.

40 Dekorata e dhënë nga Mbreti Zog, ë

Letër e Mehmet Konicës dërguar Bernsteinit [128]

Një vit pas largimit të Bernsteinit nga Shqipëria edhe Mehmet Konica i shkruan atij, duke i treguar me skrupulozitet për atë çka ndodh në Shqipëri dhe ndikimin që ngjarjet e kohës kanë te vendi ynë.

> Po të shkruaj, - thotë Mehmet Konica – rreth ngjarjeve më të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë kësaj kohe në Shqipëri. Pasi ia ndërpreu kreditë qeveria italiane, ajo shqiptare u detyrua të shpallë një kurs të rreptë kursimesh për të balancuar buxhetin.
>
> Me rastin e hapjes së sesionit të ri Parlamentar, Mbreti foli për domosdoshmërinë e të kursyerit të parave për balancimin e buxhetit. Një nga veprimet ekonomike kishte si qëllim të hiqte qafe forcat civile dhe ushtarake italiane. Kjo i tërboi italianët dhe bëri që buxheti të reduktohej nga 22 milionë në 18, pasi ata insistonin që të vihej në buxhet një shumë për S.V.E.A-n. Parlamenti e mori në konsideratë kërkesën italiane dhe kaloi një shumë prej dyqind e

pesëdhjetë mijë franga në favor të S.V.E.A-s.

Një delegacion shqiptar, i kryesuar prej meje bëri një vizitë në Beograd dhe nënshkruam një marrëveshje, ose më mirë të them e rikonfirmuam një marrëveshje tregtare që ekziston. Sipas kësaj marrëveshjeje, Shqipëria eksporton në Jugosllavi vaj ulliri, lesh, peshk dhe lëkura. Shqipëria do të importojë dru për ndërtim, çimento dhe 40 përqind të nevojave të saj për sheqer. Në mënyrë që të ndihmojë këto biznese, është hapur në Tiranë "Export Bank" e Beogradit. Banka do të hapë degë në disa qytete të Shqipërisë. Marrëveshja parashikon që mallra si kafe, sheqer, që vijnë nga territori i dy anëve në një distancë prej 20 km nga kufiri, janë pa taksa doganore.

Sapo kjo marrëveshje u nënshkrua, italianët u ndien shumë keq dhe filluan të intensifikojnë intrigat dhe kërcënimet e tyre. Në shkurt u nënshkrua në Athinë marrëveshja e Antantës Ballkanike[129] në të cilën Shqipëria nuk ishte ftuar të merrte pjesë. Si rezultat i kësaj unë i adresova letrën bashkëngjitur Presidentit të Konferencës Ballkanike.

Më 14 qershor 1934 qeveria shqiptare mbylli tërë organizatat italiane civile dhe ushtarake, të cilat që atëherë kanë ikur nga Shqipëria. U mbajtën 14 organizata ushtarake italiane ndër të cilat dy ishin mjekësore. Edhe inxhinierët ushtarakë italianë të cilët merreshin me ndërtime do të largohen, sapo të kalojë buxheti tjetër. Inxhinierët e fortifikimeve janë zëvendësuar nga inxhinierë shqiptarë.

Më 23 qershor një flotë prej 23 njësish detare arriti në Durrës pa asnjë paralajmërim, pa ngjyra, që do të thotë pa flamuj të ngritur, pa nderuar vendin pritës dhe në një formë krejt pirateske. Një oficer zbriti në tokë për të bërë një vizitë, por atij nuk iu kthye vizita nga pala jonë. Ministri ynë i Jashtëm e thirri inistrin italian, por ai u përgjigj se nuk kishte asnjë dijeni për arritjen e flotës. Xhafer Vila i dërgoi një notë zyrtare Legatës italiane në lidhje me këtë vizitë. Ministri italian Koch e telefonoi z. Vila dhe i tha se çështja ishte thjesht, sepse telegrami nga Roma ishte vonuar dhe flota kishte ardhur, duke pasur parasysh natyrën shumë miqësore të marrëdhënieve midis dy vendeve. Pas këtyre shpjegimeve verbale u shkëmbyen vizitat midis admiralit të flotës dhe prefektit të Durrësit. Megjithatë, që nga dita e arritjes së flotës, trupat shqiptare u dislokuan në gjendje gatishmërie në kodrat e Rrashbullit të Durrësit dhe morën urdhër të hapnin zjarr, nëse diçka do të ndodhte. Njëra nga skuadriljet e la Durrësin më 29 qershor dhe pjesa tjetër më 2 korrik.

Ndërkohë që flota gjendej aty, ministri italian kërkoi me forcë likujdimin e tërë çështjeve që ekzistonin midis Shqipërisë dhe Italisë. Qeveria shqiptare u përgjigj se nuk do të hynte në diskutime të tilla, për sa kohë flota gjendej në ujërat shqiptare. Që prej kësaj kohe nuk janë zhvilluar më bisedime midis palëve. Arritja e flotës koinçidoi me arritjen e M. Louis Barthou në kufirin me Jugosllavinë. Ndërkohë, italianët kishin përgatitur një kryengritje në veri, e cila kishte filluar pikërisht në ditën e arritjes së flotës. […]

Në lidhje me projektin e përfaqësuesve shqiptarë për instalimin e refugjatëve gjermanë në vendin tonë, unë nuk di gjë. Do të interesohem dhe do të njoftoj edhe ty për këtë çështje. Sa i takon letrës që ke dërguar për një mendim timin për luftën[130], unë e konsideroj veten të parëndësishëm për të prekur një temë të tillë. Mund të them vetëm se sa kohë që ka koka të nxehta, për të mos folur për njerëz të çmendur, që i drejtojnë popujt, ne përherë do të kemi rrezik për luftë.

Ju lutem përcillini respektin tim zonjës Bernstein dhe të falat e mia për tërë familjen tuaj.

Edhe një lajm tjetër: Unë jam martuar me vejushën Edibe Delvina, të cilën ju e njihni. Kjo do t'ju kujtojë edhe historinë, që ju pata treguar për vajtjen në parajsë, kur martohesh me një të ve.

Përzemërsisht i juaji
Mehmet Konica.



41 Kopje e një letre në dorëshkrim dërguar nga Ministri i Jashtëm Mehmet Konica dërguar Herman Bernsteinit.

Herman Bernsteini lavdërohet nga Hoover dhe Ford [131]

Tekstet e nderimeve në darkën e organizuar për nder të botuesit dhe ishdiplomatit Herman Bernstein janë lexuar në darkën e shtruar për nder të tij. Mbrëmja organizohej për nder të përvjetorit të kthimit të Bernsteinit nga Rusia. Atij iu dha një album me fotot e tij më të bukura dorëzuar nga Isidore D. Morrison. Midis atyre që e uronin zotin Bernsteinin ishin profesor Albert Ajnshtajni, Charles Evans Huges, dr. Cyrus Adler e shumë të tjerë.[132]

"Shqipëria e vogël është bërë kështu një peng në lojën e dy blloqeve në konflikt në diplomacinë europiane, njëra e kryesuar nga Italia dhe tjetra nga Franca. Ajo ka përfituar deri në një farë mase prej konfliktit të interesave dhe ia ka dalë në forcimin e unitetit të saj kombëtar."

Pas largimit nga Shqipëria përsëri Bernsteini i shërben Shqipërisë

Pas largimit nga Shqipëria Bernstein vazhdon të shkruajë dhe të botojë artikuj rreth vendit tonë. I tillë është shkrimi i mëposhtëm, botuar me datën 28 Janar 1934 në gazetën më të madhe të botës, The New York Times. Në këtë shkrim ai parashikon atë që do të ndodhte në Shqipëri për shkak të politikës ekspanisoniste të fuqive tçë mëdha e veçanërisht asaj italiane.

Shqipëria peng i fuqive të mëdha[133]

Shqipëria njihet si një prej zonave më të rrezikshme në Europë. Aty mund të fillojë një luftë e re, nëse interesat politike dhe ushtarake të vendeve tjera ndaj Shqipërisë vazhdojnë të konfliktohen me njëra-tjetrën. Për shkak të pozitës së saj gjeografike, ky vend i vogël mban çelësat e Adriatikut dhe ka qenë vazhdimisht mollë sherri në konfliktet midis vendeve të rajonit.

Nga pikëpamja strategjike vija e saj bregdetare do të ishte e një vlere të pallogaritshme për Italinë, në rast të një lufte. Italia ka derdhur shuma të mëdha në Shqipëri për ta ndihmuar atë që të organizojë ushtrinë, të ndërtojë rrugët, urat dhe fortifikatat. Në Ballkan besohet se përpjekjet e Italisë për ta militarizuar Shqipërinë janë pjesë e një programi ambicioz imperialist të iniciuar nga Musolini, për të depërtuar Ballkanin dhe për të ripushtuar të famshmen Via Egnatia, e cila kalon nëpër Shqipëri dhe Jugosllavi dhe të çon drejt Selanikut dhe Stambollit.

Çdo lëvizje e Italisë në Shqipëri shihet me dyshim dhe frikë prej Francës, prej Antantës së Vogël dhe veçanërisht prej Jugosllavisë. Gjatë viteve të fundit ndihmat financiare dhe drejtimi ushtarak të ofruara nga Italia ndaj Shqipërisë

kanë shërbyer për të intensifikuar ndjesinë e nervozizmit në Ballkan dhe kanë bërë që Jugosllavia të ndërmarrë përgatitje të ethshme ushtarake, për të luftuar depërtimin e frikshëm italian në Ballkan.

Peng i fuqive

Shqipëria e vogël është bërë kështu peng në lojën e dy blloqeve në konflikt në diplomacinë europiane, njëra e kryesuar nga Italia dhe tjetra nga Franca. Ajo ka përfituar deri në një farë mase prej konfliktit të interesave dhe ia ka dalë në forcimin e unitetit të saj kombëtar, së pari me ndihmën e Jugosllavisë dhe më pas me ndihmën e Italisë. Cilat do të jenë motivet e padukshme të këtyre dy vendeve? Shqipëria ka mundur që me guxim dhe kurajë të ruajë pavarësinë e saj, edhe pse është detyruar të bëjë sakrifica të panumërta, koncensione dhe kompromise në kthim të ndihmës materiale që ajo merrte që prej përfundimit të luftës. Të ndërtuara ose jo për skemat ushtarake të Italisë, rrugët dhe urat e ndërtuara me paratë e Italisë tani i shërbejnë interesave ekonomike të Shqipërisë, pasi kanë vendosur komunikim normal midis pjesëve malore të këtij vendi të vogël.

E pushtuar gjatë luftës botërore

Gjatë luftës Shqipëria u bë skenë e shumë pushtimeve. Ushtritë greke, serbe, franceze, austriake dhe italiane luftuan njëra-tjetrën në Shqipëri dhe toka e këtij vendi të vogël u nda në disa zona influencash të huaja. Ndërkohë populli i saj u bë subjekt i mungesave dhe mizerjes së patregueshme. Ahmet Zogu, Mbreti i tanishëm, u internua në Vjenë gjatë periudhës së luftës. Pavarësia e Shqipërisë e shpallur në vitin 1912, u rrënua. Në Konferencën e Paqes në Paris kërkesat e saj në fillim u injoruan plotësisht. Delegacioni shqiptar i kryesuar nga Mehmet Bej Konica, vëllai i Ministrit të sotëm shqiptar në Shtetet e Bashkuara i vari shpresat te Presidenti Wilson dhe apeloi te delegacioni amerikan që SHBA, si fuqi pa pretendime territoriale, ta merrte Shqipërinë nën një mandat të vet.[134]

Jugosllavia, Greqia dhe Italia ishin të etur për t'u sigurar "sferat e tyre të influencës. Në vitin 1919 u arrit një marrëveshje midis Clémenceau, Lloyd George dhe Nitit, në mungesë të përfaqësuesve amerikanë. Kjo marrëveshje i jepte Italisë mandat mbi Shqipërinë në Lidhjen e Kombeve dhe i lëshonte pjesë të veriut të vendit Jugosllavisë. Shqiptarët protestuan kundër këtij vendimi të imponuar, i cili jo vetëm i privonte ata nga pavarësia, por edhe e ndante vendin copa-copa.

Protesta e presidentit Wilson

Presidenti Wilson kundërshtoi me forcë marrëveshjen bazuar në faktin se ajo ishte arritur në mungesë të përfaqësuesve amerikanë dhe që kishte për qëllim "ta ndante Shqipërinë, midis tri fuqive të huaja, përkundër protestave të forta të popullit shqiptar. Pavarësia e Shqipërisë u ruajt vetëm atëherë, kur Qeveria Amerikane deklaroi se: Çështja shqiptare nuk duhet përfshirë si çështje në grindjet midis Italisë dhe Jugosllavisë. Presidenti riafirmon se ai nuk mund të aprovojë asnjë plan, i cili i jep Jugosllavisë toka shqiptare në rajonet veriore të Shqipërisë, si kompensim territorial për ato që ajo ishte privuar diku tjetër dhe që Italia e Jugosllavia nuk mund dhe nuk duhej të bashkonin interesat në dëm të atyre të Shqipërisë.

Shqipëria u pranua anëtare me të drejta të plota në Lidhjen e Kombeve në dhjetor 1920, pas një apeli dramatik në emër të Pavarësisë së Shqipërisë lëshuar prej Lordit Robert Cecil. Ai u ballafaqua me kundërshtime të forta të disa shteteve ballkanike.

Një vit më vonë ambasadorët e Britanisë së Madhe, Francës, Italisë dhe Japonisë *"duke parë se shkelja e këtyre kufijve, ose e Pavarësisë së Shqipërisë mund të përbënte një rrezik për sigurinë strategjike të Italisë"*, arritën një marrëveshje me qëllim që:

> Nëse Shqipëria do të gjente ndonjëherë veten të pamundur për të mbrojtur tërësinë e saj territoriale, asaj do t'i lejohej t'i drejtonte një kërkesë Këshillit të Lidhjes së Kombeve për ndihmë nga jashtë [...] qeveritë e Perandorisë Britanike, Italisë dhe Japonisë të vendosnin që në një rast të tillë si ky ato të instruktonin përfaqësuesit e vet në Këshillin e Lidhjes së Kombeve që të rekomandonin restaurimin e kufijve territorial të Shqipërisë, të cilët do t'i besoheshin Italisë.[135]

Edhe pse tashmë anëtare e Lidhjes së Kombeve, Shqipëria as që ishte konsultuar për këtë marrëveshje. Ajo protestoi kundër saj, duke deklaruar se nuk do ta njihte vlefshmërinë e marrëveshjes. Edhe sot e kësaj dite, Italia e njeh marrëveshjen e Ambasadorëve si instrument ndërkombëtar detyrues, i cili njeh interesat e saj të veçanta ndaj Shqipërisë, por pakti është i lidhur me dyshimin dhe frikën prej fqinjëve të afërt të Shqipërisë në Ballkan, kështu që në atë kohë marrëveshja ka shërbyer si shkak përplasjesh dhe e ka bërë Shqipërinë atë zonë të ndjeshme që shohim ne sot.

Në vitin 1920, italianët ishin ende në zotërim të Vlorës, të cilën e kishin pushtuar. Udhëheqësit shqiptarë, të vendosur për të çliruar vendin e tyre nga dominimi i huaj, i detyruan italianët, që të tërhiqeshin. Pastaj ata filluan të organizonin shtetin dhe vendosnin rendin në vend. Ahmet Zogu ishte një prej udhëheqësve të rinj më të shquar, dhe qeveria në të cilën ai ishte Ministër i Brendshëm dhe më pas Kryeministër i saj, u identifikua me emrin e tij.

Në vitin 1924 Zogut u rrëzua nga pushteti nëpërmjet një revolucioni të drejtuar nga peshkopi Fan Noli. Ahmet Zogu, me shumë prej kolegëve të tij, nxitoi drejt Beogradit për strehë dhe ndihmë. Qeveria revolucionare e Nolit zgjati vetëm nga qershori deri në dhjetor të vitit 1924, kur Zogu i cili ishte dënuar me vdekje, u kthye fitimtar në Tiranë në krye të një ushtrie të vogël, të cilën ai e kishte organizuar në Jugosllavi.

Brenda një muaji pas kthimit në Shqipëri, Zogu u zgjodh President i Republikës së Shqipërisë për shtatë vjet. Qeveria e tij filloi të riorganizohet dhe të modernizojë vendin, por kryengritjet e herëpasherëshme, për shkak të mosmarrëveshjeve nuk pushonin. Jugosllavët, meqë e kishin ndihmuar Ahmet Zogun të rifitonte pshtetin, prisnin prej tij

që të zbatonte një politike pro-jugosllave të fuqishme, ose më mirë të themi me orientim anti-italian. Duke parë rrezikun e madh që i kanosej vendit të tij nga një politikë e tillë, Presidenti Zog u orvat të manovronte në një kurs të rrugës së mesme, që do të thotë të ishte pro-shqiptar.

Pakti i Tiranës

Në vitin 1926 ndodhi një kryengritje në veri të Shqipërisë. Ahmet Zogu ishte i bindur se ajo ishte nxitur prej Jugosllavëve. Edhe Italia edhe Jugosllavia i kishin propozuar atij një pakt miqësie dhe sigurie. Kjo kryengritje e detyroi atë të merrte një vendim të shpejtë në favor të Italisë dhe më 27 nëntor 1926 u nënshkrua një pakt pesëvjeçar i miqësisë dhe sigurisë midis Shqipërisë dhe Italisë.

Nënshkrimi i Paktit të Tiranës krijoi te fqinjët e Shqipërisë një gjendje shtangie dhe alarmi. Një vit më vonë, fill pas nënshkrimit të Traktatit Franko – Jugosllav, një traktat i aleancës midis Italisë dhe Shqipërisë u përmbyll për një periudhë prej njëzet vjetësh.

Shqipërisë iu garantua një hua prej 50,000,000 franga ari prej Italisë nëpërmjet një grupi financiar italian të njohur me emrin SVEA. Banka Kombëtare e Shqipërisë u vendos nën mbikëqyrjen e këtij grupi. Një program i gjerë publik pune u iniciua dhe u financua prej kësaj huaje. Organizatorë ekonomikë italianë, inxhinierë dhe kontraktorë erdhën menjëherë në Shqipëri, bashkë edhe me ushtarakë dhe instruktorë. U ndërtuan rrugë, ura dhe ndërtesa publike. Çdo lëvizje në Ballkan vëzhgohet tepër hollë si me mikroskop. Jugosllavët vëzhgojnë me dyshim përpjekjet e italianëve në Shqipëri. Ata i quajnë traktatet shqiptaro-italiane, huatë dhe vërshimin e organizatorëve dhe instruktorëve italianë si pjesë e një skeme politike dhe ushtarake për të siguruar një pozitë të fortë në Adriatik, me qëllimin për të depërtuar në Ballkan. Një program të tillë Beogradi e sheh si sfidë direkte ndaj Jugosllavisë. Situata është e rrezikshme.

Më 1 shtator 1928, Presidenti Zog u shpall Mbret i shqiptarëve prej Asamblesë Kushtetuese. Republika u kthye në Mbretëri. Gjenerali italian Alberto Pariani, ndihmoi të organizonte dhe stërviste ushtrinë shqiptare. Xhandarmëria u organizua drejpërsëdrejti nga gjenerali britanik Sir Jocelyn Percy. U ngritën gjykatat e drejtësisë. U hapën shkolla të reja. Ky vend i vogël, ku *"gjërat mund të bëheshin vetëm, nëse kishe durim dhe duhan të mjaftueshëm"*, filloi të lëvizte me një shpejtësi shumë më të madhe. Kur skaduan pesë vitet e Paktit të Miqësisë dhe Sigurisë, Mbreti Zog nuk pranoi ta rinovonte atë, pavarësisht presionit të hapur që ushtronte Musolini. Mbreti Zog iu përmbajt arsyetimit se ai traktat nuk ishte më i nevojshëm, pasi nuk i duhej më fuqi tjetër, që ta mbronte atë. Ai gjithashtu nënvizoi se Traktati i Aleancës me Italinë, i cili do të mbetej në fuqi prej disa vitesh, mbulonte të gjitha pikat, që kishin të bënin me marrëdhëniet e përzemërta midis dy vendeve.

Situata e vështirë financiare

Ndërkohë kushtet ekonomike dhe financiare në Shqipëri kanë arritur një pikë kritike.

Italia i ofroi Shqipërisë përsëri një hua vjetore prej 10.000.000 franga. Fqinjët e Shqipërisë u alarmuan, duke besuar se oferta italiane nuk ishte asgjë tjetër përveçse një subvencion i ri për qëllime ushtarake. Huatë vjetore do të jepeshin nën mbikëqyrjen e komisioneve të përbashkëta italo-shqiptare. Shqipëria pranoi dhe u lëvruan huatë e dy viteve të para, megjithëse jo plotësisht. Huaja e vitit të tretë këtë vit u mbajt me arsyetimin se Shqipëria nuk po i përmbushte pikat e marrëveshjes në ato që kishin të bënin me "marrëdhëniet e përzemërta".

Kur rreth një vit më parë, Italia la të kuptohej se një bashkim doganor midis Italisë dhe Shqipërisë do të ishte i pranueshëm për Italinë dhe do të provonte se ishte një përparësi e madhe për Shqipërinë, Mbreti e hodhi poshtë këtë sygjerim, pasi kishte kuptuar se një marrrëveshje e tillë nuk do të irritonte vetëm fqinjët e tij ballkanikë, por mund të krijonte gjithashtu një trazirë në tërë Europën.

Më pas Italia u irritua prej një amendamenti të papritur që u vendos në Kushtetutën Shqiptare, i cili çonte në mbylljen e disa shkollave famullore dhe të huaja. Qeveria Shqiptare shpjegoi se kjo masë nevojitej të merrej në atë moment me qëllim që të konsolidonte unitetin kombëtar nëpërmjet sistemit të shkollave publike dhe të parandalonte propagandën e huaj anti-kombëtare. Italianët refuzuan të pranonin një drejtor administrativ shqiptar në shkollat e tyre. Ata i mbyllën shkollat e tyre dhe i kthyen instruktorët në Itali. Vlefshmëria e ligjit të ri shqiptar në lidhje me sistemin e shkollave ishte e diskutueshme, po të kihet parasysh pamjaftueshmëria e mësuesve të mirëpërgatitur shqiptarë.

Ndihmat nga italia ndërpriten

Qeveria Italiane, duke ditur mirë kushtet e mjerueshme financiare të Shqipërisë përshtati politikën "prit dhe shih çdo të ndodhë" duke ndërprerë tërë ndihmat financiare. Importet e Italisë nga Shqipëria filluan të bien. Italianët mohuan se dëshironin ndonjë koncension të ri në Shqipëri, se ata kërkonin kontroll të ushtrisë, të xhandarmërisë ose të degëve të tjera të qeverisjes. Ata thanë se ajo që dëshironin ishte bashkëpunimi i përzemërt dhe ndikimi kulturor.

Mbreti Zog nuk pranoi të rihapte shkollat, por bëri një gjest të vullnetit të mirë, duke urdhëruar që gjuha italiane të bëhej e detyrueshme në shkollat e mesme shqiptare. Kjo nuk i kënaqi sa duhet italianët, prandaj ata vazhduan të vononin ndihmën vjetore të huasë. Atëherë Mbreti Zog urdhëroi një zbritje drastike në buxhet, duke reduktuar shpenzimet ushtarake thuajse gjysmë për gjysmë. Ai gjithashtu i paraqiti administratës zvogëlim me një të katërtën e rrogës së tyre dhe shpenzimet e tij mbretërore. E tëra kjo e ndihmoi Mbretin Zog të rriste popullaritetin midis shqiptarëve, por kjo nuk e zbuti zemërimin e Romës.

Problemi i sotëm

Shqipëria, duke e ditur mirë se e vetmja shpresë e saj për rihabilitim qëndron në zhvillimet paqësore, po përpiqet të dalë nga kokolepsjet të cilat rrezikojnë marrëdhëniet e saj miqësore me fqinjët ballkanikë. Italia, Jugosllavia dhe Greqia kanë deklaruar në

mënyrë të përsëritur se e kundërshtojnë shkeljen e pavarësisë së Shqipërisë.

Ndërkohë, beteja diplomatike midis Musolinit dhe Mbretit Zog vazhdon. Kështu Mbreti Zog duket të ketë qenë fitimtar për arsye se forca e Shqipërisë qëndron në dobësinë e saj. Ajo, tani së voni, ka përfunduar një traktat tregtar të favorshëm me Greqinë dhe po negocion një traktat të ri më Jugosllavinë. Këto janë simptoma të pagabueshme të një marrëdhënieje më të ngushtë midis Shqipërisë dhe fqinjëve të saj ballkanikë.

Në qoftë se Shqipëria ia del të vendosë marrëdhënie të përzemërta më fqinjët e saj të Ballkanit, pa u armiqësuar me Musolinin, vendi i vogël buzë Adriatikut i quajtur "Toka e Harruar e Europës" do të jetë në pozitë që të zhvillojë paqësisht dhe me sukses potencialin e saj bujqësor dhe mundësitë e saj ekonomike.[136]

Bernsteini i survejuar nga Italia fashiste[137]

Bernsteini është shqiptarizuar, shprehen qarqet diplomatike italiane

Gjatë studimit të jetës së Herman Bernsteinit, nuk mund të mos studjosh edhe një seri kabllogramesh që Legata Italiane në Tiranë kishte dërguar, jo vetëm në Ministrinë e Jashtme të Italisë Fashiste, por edhe në Legatën Italiane në Washington. Për të sjellë nga origjinali tekstet më të rëndësishme dhe komentuar ato ndihmoi dr. Xhoana Papakostandini, e cila shkruan*:*

- Gjatë viteve të misionit të Herman Bernsteinit në Shqipëri, duket se Përfaqësia Diplomatike e Italisë fashiste ngarkohet me një detyrë të dyfishtë. Përveç ndjekjes së realitetit e politikës së vendit pritës, ky mision identifikon një rrezik konkret që po cënonte interesat e Italisë në Shqipëri, në këtë fazë delikate të marrëdhënieve dypalëshe, kur Italia priste nga mbreti Zog rikonfirmimin e Paktit Pesëvjeçar të Miqësisë dhe Sigurisë. Ky rrezik është pikërisht Ministri Amerikan Herman Bernstein dhe vëzhgimi i aktivitetit të tij në Shqipëri ka prioritet të veçantë për Legatën Italiane.

  Në arkivat e Ministrisë së Jashtme Italiane ekzistojnë një seri kabllogramesh të dërguara nga Legata e saj në Tiranë, që kanë për objekt raportimin e veprimtarive të ndryshme të Herman Bernsteinit, takimet e tij me kolegë të tjerë diplomatë, vizitat e

tij turistike nëpër Shqipëri, botime artikujsh në shtypin vendas, ose ngjarjesh të tjera, prapa të cilave Legata Italiane mendon se është gjithmonë shefi i misionit diplomatik amerikan. Eshtë me tepër interes raporti i mëposhtëm dërguar Ministrisë së Jashtme (Ministër ishte vetë Musolini), i cili i transmetohet nga Roma më 28 korrik 1933, Ambasadës Italiane në SHBA për vëmendje të menjëhershme:
Pas referenceve ndaj telegrameve të mëparshme me të njëjtën lëndë, thuhet se:

> Aktiviteti i këtij Ministri [Herman Bernstein] vazhdon me intensitet. Mund të thuhet tashmë se ky është i vetmi aktivitet i dyshimtë që zhvillohet në Tiranë. Kontaktet e tij me kolegët francezë dhe sidomos Ministrin Jugosllav vazhdojnë, me ritme më të ngadalta; por janë intensifikuar ato me personalitete shqiptare, sidomos me anëtarë të qeverisë dhe deputetë, dhe njëkohësisht me shefa shërbimesh nëpër ministri, e në veçanti ato me eksponentin e njohur të grupit jugosllav Mehmet Konica.[138] Pardje, pasi dola nga një takim me Ministrin e Punëve të Jashtme dhe të Financës Xhaferr Vila, ky i fundit shkoi për një bisedë të gjatë te zoti Bernstein.
>
> Kam arsye të besoj se ky aktivitet nuk do të ketë ndonjë rezultat konkret që duhet të na shqetësojë. Shqiptarët synojnë mbi të gjitha që të krijojnë te ne pikërisht këtë lloj shqetësimi. E përdorin këtë aktivitet [të Bernsteinit] si 'manovër', sipas sistemeve të tyre të zakonshme. Për sa i përket zotit Bernstein, ai ndoshta kërkon të sigurojë një platformë këtu, meqenëse së shpejti mund të shkarkohet nga detyra nga qeveria e re demokrate.
>
> Megjithatë, këto kontakte, duke krijuar iluzione te funksionarët shqiptarë, na pengojnë në punën tonë të qartësimit të marrëdhënieve dypalëshe, në të cilën po hasim shumë vështirësi. Ju lutem Sh. J. të na vini në dijeni për hapat që, sipas udhëzimeve tuaja, po merr Ambasadori ynë në Washington për këtë çështje.

Udhëzime të MPJ italiane për ambasadorin italian në Washington

> Eshtë e qartë se Departamenti i Shtetit nuk i ka tërhequr akoma vëmendjen Ministrit të Shteteve të Bashkuara në Tiranë për interesat që Italia ndjek në Shqipëri e për politikën e saj paqësore e konstruktive edhe në atë vend.
> Prandaj, Shkëlqesia Juaj, duhet të tërheqë përsëri vëmendjen e Qeverisë [Amerikane] mbi aktivitetet e paqarta të zotit Bernstein, duke nënvizuar sidomos, kur Ministrave tanë në Kubë ose në vendet e Amerikës qendrore nuk do t'i vinte ndër mend të angazhoheshin në një politikë të ngjashme me atë të diplomatit tuaj në fjalë.
>
> Në rast se Departamenti i Shtetit tregohet i gatshëm për një transferim të z. Bernstein, ju mund t'i sygjeroni mundësinë e zëvendësimit me një të ngarkuar me punë, pasi kjo do të thoshte një ndërprerje e menjëhershme e një rrjeti keqkuptimesh që kanë rrethuar Legatën Amerikane në Tiranë, e që në fund të fundit nuk sjellin asnjë avantazh praktik as për Amerikën, as për vetë Shqipërinë, që kultivon vetëm iluzione[139] kimerash.[140]

Pra, Roma është e shqetësuar për ndikimin e Bernsteinit te qeveria shqiptare, ndërkohë që ndikimi i Italisë në Shqipëri është në rënie. Musolini i druhet ndërhyrjes së Amerikës në "oborrin" e vet dhe mundohet të mbrojë interesat e tij në Shqipëri, jo më vetëm në Tiranë, por direkt në Washington. Duhet thënë se sikurse vihet re nga korrespondenca, diplomatët italianë në dy anët e oqeanit janë tepër të aftë në dedektimin e situatës dhe manipulimin e saj me mjete diplomatike.

Në përgjigje të këtij telegrami, reagimi i Ambasadorit italian në Washington Augusto Rosso, i cili është njoftuar si më lart nga qendra për aktivitetin e Ministrit Amerikan Bernstein në Shqipëri, me sa duket nuk vonon. Ai i raporton Romës si më poshtë*:*

> Kohët e fundit kam pasur takime të shpeshta jashtë Departamentit me z. Wallace S. Murray, Shef i Divizionit për Lindjen e Afërt [në Departamentin Amerikan të Shtetit] dhe kam përfituar nga relatat e përzemërta personale për të biseduar me të për çështjen shqiptare. Pretekstin për ta hapur këtë bisedë ma dha vetë Murray, duke përmendur me shaka një telegram që Ambasadori i ri amerikan në Romë, z. Breeknridge Long, kishte dërguar në Washington pas vizitës së tij të parë në Palazzo Chigi.[141] Gjatë kësaj vizite, Sh.T. Aloisi[142] duhet të jetë shprehur rreth z. Bernstein në terma të tilla, që e kanë lënë Ambasadorin kaq të habitur, sa i ka shkruar një telegram të gjatë alarmi Washingtonit. Departamenti,- tha Murray- nuk e kishte marrë çështjen si tragjike, por kishte nxituar të qetësonte Ambasadorin Long, duke e siguruar se kolegu i tij në Tiranë, nuk ndiqte një politikë anti-italiane në Shqipëri, as me iniciativën e tij, as i udhëzuar nga qendra. I thashë menjëherë z. Murray se edhe unë nuk besoja se qeveria ime kishte dyshime, apo shqetësime të tilla, por se kisha frikë se z. Bernstein, pa dashur mund të krijonte përshtypjen te Qeveria Shqiptare që aktiviteti i tij frymëzohej nga Qeveria Amerikane e se mund ta interpretonte rrjedhimisht këtë aktivitet si inkurajim, për t'u mbështetur tek Washingtoni për t'i rezistuar ndikimit italian.
>
> Në mjedisin e ngushtë të Tiranës, veprimet dhe fjalët e Ministrit të Amerikës kishin pasoja, të cilat ndoshta Washingtoni nuk mund t'i kuptonte me saktësi, por që në disa rrethana dëmtonin përpjekjet e qeverisë fashiste për qartësimin e raporteve italo-shqiptare.
>
> Zoti Murray më tha se e kuptonte situatën e më siguroi për qëllimet e mira dhe ndjenjat miqësore të z. Bernstein për Italinë dhe përfaqësuesit e saj në Shqipëri. "Bernsteini, – shtoi ai – nuk është diplomat karriere, ai është gazetar si profesion dhe shkrimtar i shkëlqyer. Ai është sinqerisht dashamirës i popullit shqiptar dhe i Mbretit Zog. Duke qenë inteligjent e me ambicie, ai i dërgon Departamentit përshkrime të gjata për njerëzit dhe ngjarjet shqiptare. Unë i lexoj, sepse janë interesante e të shkruara bukur, por sigurisht për ne janë thjesht punë akademike.[143]
>
> I thashë në këtë pikë zotit Murray se sikur zoti Bernstein të mjaftohej me informimin e qeverisë së tij për ngjarjet në Shqipëri, kjo sigurisht nuk do t'i kishte prishur punë askujt. Por më dukej se veprimtaria e Ministrit Amerikan i tejkalonte kufijtë e detyrës së vëzhguesit, për të hyrë në atë të këshilltarit politik e promovuesit, edhe në fusha, ku Shtetet e Bashkuara nuk kishin ndonjë interes për të mbrojtur. Çfarë do të mendonte Washingtoni sikur një Ministri Italian, në vende si Kuba ose Nikaragua të fillonte të bënte "politikë aktive?.
>
> […] Nuk m'u duk e përshtatshme t'i kërkoja z. Murray që të ndërhynte direkt për të frenuar aktivitetin e Bernsteinit, por jam i bindur se biseda në Romë e Aloisit

> me Ambasadorin Long dhe e imja me zotin Murray do të japin rezultate. Zoti Murray pastaj më tha se, meqënese Bernsteini është emëruar në postin e Tiranës nga administrata republikane, nuk përjashtohet mundësia që ai të zëvendësohet sa më shpejt. Kjo gjë nuk ka ndodhur deri më sot, pasi deri tani nuk ka dalë ndonjë kandidat demokrat për të shërbyer në Tiranë."[144]

Është e rëndësishme të përmendet se ky telegram mban datën 7 gusht 1933 e se më pak se një muaj më vonë Bernsteini lirohet nga detyra e Ministrit.

Më 11 shtator 1933 Ministria e Punëve të Jashtme Italiane i përcjell Ambasadës së vet në Washington një telegram të Legatës Italiane në Shqipëri, ku njoftohet se Ministri Amerikan në Shqipëri, Bernstein është liruar nga detyra. Roma, në bazë të informacioneve të marra nga Tirana, shpreh qartë se Italia ka lobuar prej kohësh në Washington kundër Bernsteinit dhe analizon si më poshtë arsyet e përfundimit të misionit të Bernsteinit:

> Zyrtarisht, largimi [i Bernsteinit] është justifikuar me faktin se ai është militant i partisë kundërshtare të Presidentit aktual Roosvelt, se ai ka marrë pjesë aktivisht në zgjedhjet presidenciale verën e kaluar, e se në fund, meqënëse Departamenti i Shtetit në Washington duhet të procedojë me zëvendësimin e krerëve të misioneve jashtë, që janë kundërshtarë të fituesit të zgjedhjeve presidenciale, atëherë edhe Bernsteini është përfshirë në këto lëvizje të përgjithshme.
>
> Në fakt ne jemi njoftuar dhe lajmi na duket i besueshëm, se shkaku kryesor për largimin e papritur të Bernsteinit ka të bëjë me aktivitetin e tij, i cili jepte shenja të dukshme "*shqiptarizimi*" në mënyrën e tij të të vepruarit.
>
> Ikja e Bernsteinit do të jetë një humbje për mbretin Zog, i cili e përdorte atë jo vetëm për këshillat e tij (Bernsteini është padyshim një burrë shumë i zgjuar, i kulturuar, gazetar i shkëlqyer, tërheqës, cilësi këto që i duhen politikës shqiptare), por edhe sepse [Zogut] i leverdiste që të linte të kuptonte se prapa emrit të Bernsteinit fshihet e gjithë Amerika, me dollarët e saj.
>
> Pata rastin ta takoj z. Bernstein, i cili më tha se ka në plan të largohet nga Shqipëria në mesin e muajit shtator, për të udhëtuar në Washington e më pas në qytetin e tij, Sheffield, Massachussets, ku do t'i kthehet profesionit të tij si gazetar.
>
> Dyshoj për sinqeritetin e fjalëve të tij: Bernsteinit i kanë krijuar një ndjenjë vetëkënaqeje politikanët e zotë shqiptarë, të cilët i kanë lënë të nënkuptojë se ka mundësi që ai të bëhet "këshilltar" i mbretit, "shpëtimtar" i Shqipërisë; pra, nuk e besoj se tani ai papritur do ta harrojë krejtësisht politikën shqiptare.
>
> Nuk duhet gjithashtu të harrojmë karakterin intrigant të Bernsteinit, origjinën e tij hebraike, dëshirën e zjarrtë për t'u bërë i famshëm, difekt ky i shumë amerikanëve. Të gjitha rrethanat do të bëjnë ta kemi z. Bernstein edhe për shumë kohë akoma në ingranazhet e politikës shqiptare, me botime librash, artikujsh, novelash, që ai do të shkruajë për Shqipërinë dhe politikën shqiptare, por edhe nëpërmjet tentativave për të sjellë kapitale të huaja në këtë vend.
>
> Do të ishte e dobishme për ne që të ndiqet aktiviteti i Bernsteinit në Amerikë, e po ashtu të merret ndonjë informatë për zotin Wheeler.[145]

MPJ italiane mbi vendosjen e hebrejve në Shqipëri

Që Italia vazhdonte të mbante nën vëzhgim veprimtarinë e Herman Bernsteinit dhe lidhjet e tij me Shqipërinë, del qartë edhe nga ky telegram i datës 13 gusht 1935, dy vjet pas ikjes së Bernsteinit nga Shqipëria, dërguar nga Konsullata e Përgjithshme e Selanikut, Legatës Italiane në Athinë, Ministrisë së Jashtme në Romë dhe Legatës Italiane në Shqipëri. Në telegramin me lëndë "*Vendosja e hebrejve në Shqipëri*", shkruhet:

> Gazeta në gjuhën frënge e Selanikut, me titull "Le Progres" ka botuar nga mesi i qershorit një lajm nga New York (me sa duket e ka marrë nga gazeta a New York-ut), sipas së cilit, z. Herman Bernstein, ish-Ministri i Shteteve të Bashkuara në Tiranë, ka deklaruar se ftesa e qeverisë shqiptare, hebrejve të huaj për t'u vendosur në Shqipëri ju hap horizonte të reja mbi çështjen e rëndësishme të kolonizimit izraelit.
>
> Z. Bernstein ka shtuar më pas se, kur ishte Ministër në Tiranë ka përgatitur një projekt mbi emigracionin e izraelitëve në Shqipëri dhe se vitin e kaluar ia ka paraqitur këtë raport Komitetit të Përbashkët për Shpërndarjen (organizata e madhe që ndihmon hebrejtë amerikanë), si dhe Komisarit të Lartë të Lidhjes së Kombeve për Refugjatët Gjermanë.
>
> Po kjo gazetë (Le Progres) muajin e kaluar ka botuar një artikull, ku thuhej se Ministri Shqiptar në Londër, z. Fuad Asllani, i ka konfirmuar një gazetari hebre udhëzimet e Qeverisë Shqiptare në favor të hebrejve e se qeveria është gati të lehtësojë vendosjen e tyre në Shqipëri, sidomos të zanatçinjve dhe bujqve, e t'i garantojë në atë rast edhe shtetësinë shqiptare imigrantëve të rinj.
>
> Duket gjithashtu, se tani në muajin e gushtit do të zhvillohet në Londër një konferencë e hebrejve nga vende të ndryshme, ku thuhet se do të diskutohen edhe propozimet e mësipërme shqiptare.
>
> Në Selanik, siç dihet, ekziston një bashkësi e madhe hebrejsh, më i rëndësishmi i Mesdheut, dhe kjo bashkësi vazhdon të largohet për shkak të luftës së heshtur që i bën popullata vendase dhe emigrantët e Azisë së Vogël. Tregtarët e mëdhenj, profesionistët e të pasurit po ikin sa në Milano, sa në Paris. Shtresa e mesme e sidomos ajo më e varfër, kur ka mundur, ka marrë rrugën e Palestinës. Asnjë largim drejt Shqipërisë nuk është verifikuar akoma, as pas kufizimeve të autoriteteve britanike për të shmangur emigrimin në masë drejt Palestinës..
>
> Firmosur nga Konsulli, Pietro Santucci.[146]

"Herman Bernsteini ishte një ekzemplar i rrallë hebraiko – amerikan, i cili zgjodhi Amerikën si shtëpinë e vet. Ai ishte një hebre amerikan besnik ndaj Amerikës, por po aq besnik edhe ndaj çështjes së hebraizmit".

Vdekja e Herman Bernsteinit

Herman Bernsteini jetoi shumë pak kohë, pasi e mbaroi shërbimin në Shqipëri. Më 31 gusht të vitit 1935 ai i mbylli sytë përgjithmonë. Në njoftimin për vdekjen e tij New York Times shkroi për eulogjinë kushtuar Herman Bernsteinit, duke mos harruar të përmendë postin që kishte mbajtuar në Tiranë.[147]

> Udhëheqësit hebraikë i japin lamtumirën e fundit Ministrit Amerikan në Shqipëri dhe editorit të gazetës së tyre hebraike. Më 31 gusht 1935 Herman Bernsteini, ish-Ministër i SHBA-ve në Shqipëri ndërroi jetë në Sheffield, në moshën 59 vjeçare. Ai ka lënë pas djalin, David Bernstein, botues i gazetës New Talent, zonjën e tij Sofie Friedman dhe tri vajzat.

Në funeralin e tij Rabini Levi tha:

> Herman Bernsteini ishte një ekzemplar i rrallë hebraiko-amerikan, i cili zgjodhi Amerikën si shtëpinë e vet. Ai ishte një hebre amerikan besnik ndaj Amerikës, por po aq besnik edhe ndaj çështjes së hebraizmit. Ai kishte guximin të luftonte anti-amerikanizmin, kudo që shfaqej me tërë forcën dhe argumentin e tij të pashoq. Hebraizmi botëror dhe ai në Shtetet e Bashkuara e ka vështirë ta përballojë humbjen e këtij njeriu të madh, pikërisht në rrethanat më kritike të historisë sonë.

Natyrisht që vdekjen e tij do ta ndjente thellë, miku dhe ish homologu shqiptar, Ministri Shqiptar në SHBA, Faik Konica. Ai që nga Legata Shqiptare në Washington i shkruan

zonjës së Bernsteinit, Sofie Bernstein:

> E dashur zonja Bernstein,
> Pas një pushimi të zgjatur, u ktheva në Washington pak më parë. Ndjehem tejet i trishtuar për humbjen e papritur të z. Bernstein dhe më vjen keq që ritet orthodokse që kërkojnë varrim të shpejtë nuk më dhanë kohë dhe rast të merrja pjesë në funeralin e tij dhe të nderoja atë njeri, të cilin e kam admiruar aq shumë. Nuk e di, nëse keni marrë ndonjë letër ngushëllimi nga qeveria shqiptare, pasi i kam njoftuar po atë ditë, kur lajmi u publikua në shtyp. Nëse keni marrë një gjë të tillë, do të desha të kisha një kopje të atij kabllogrami që t'ia tregoj z. Rhoade.
>
> Me shpresë që ju dhe familja juaj ta përballoni këtë dhimbje,
> Mbetem i juaji,
>
> Faik Konica

BERNSTEINI ISHTE NJË AVOKAT I MADH I VENDIT TONË TË VOGËL. AI MËSOI PËR HISTORINË DHE KULTURËN, SHKROI ARTIKUJ PËR VENDIN TONË NË GAZETAT MË TË RËNDËSISHME TË BOTËS, NDIHMOI NË HAPJEN E SHKOLLAVE DHE PARALAJMËROI BOTËN RRETH TË ARDHMES TRAGJIKE QË E PRISTE SHQIPËRINË PËR SHKAK TË POLITIKËS IMPERIALISTE ITALIANE.

Nderim për këtë njeri të madh

Bernsteini zë një vend shumë të rëndësishëm në historinë e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane. Ai ishte një avokat i madh i vendit tonë të vogël, mësoi për historinë dhe kulturën, shkroi artikuj për vendin tonë në gazetat më të rëndësishme të botës, ndihmoi në hapjen e shkollave dhe paralajmëroi botën rreth të ardhmes tragjike, që e priste Shqipërinë, për shkak të politikës imperialiste italiane. Por Bernstein është po ashtu figurë shumë e rëndësishme për vetë historinë e hebraizmit dhe të Amerikës.

Ai është një prej intelektualëve më të shquar amerikanë, që arriti të bëhej ambasador. Edhe hebrejve të tjerë u është dhënë titulli i ambasadorëve dhe kjo, bazuar vetëm në kontributet e tyre financiare, ndërsa Bernsteini e mori këtë post, bazuar thjesht në vlerat e tij intelektuale, prandaj mund të themi se vendosi një standard të lartë intelektual për diplomacinë amerikane. Ai krijoi, po ashtu, një precedent jetësor në marrëdhëniet shqiptaro-hebraike dhe hebraiko-shqiptare. Bernsteini zbuloi dhe shkroi rreth vlerave më të mira të kombit shqiptar siç janë besa dhe mikpritja, mungesa e plotë e antisemitizmit midis shqiptarëve, toleranca etnike dhe harmonia fetare e përcjellë në shekuj dhe që ekziston edhe sot e gjallë, si shembull për botën e tashmë të trazuar. Bernstein vdiq duke lënë pas një trashëgimi të madhe për Shqipërinë dhe një simpati po aq të madhe të popullit shqiptar për hebrejtë. E njëjta mund të thuhet për dashurinë që shqiptarët ushqejnë për SHBA-të, e cila do të vazhdonte edhe pas largimit të tij. Ajo dashuri nuk u shua asnjëherë, edhe pse pushtimi italian dhe më pas ai komunist, shkaktuan një ndërprerje të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe SHBA-ve për gati pesëdhjetë e dy vjet. Falë miqësisë me Bernsteinin, Mbreti Zog i instruktoi të gjitha misionet konsullore në Europë t'u jepnin viza të gjithë atyre hebrejve, që kërcënoheshin

nga përndjekja e gjermanëve. Disa qindra hebrej arritën t'i shpëtojnë ferrit nazist dhe të gjenin një qiell të mbrojtur në Shqipëri. Gjurmët e Herman Bernsteinit ndaj këtij veprimi fisnik të shqiptarve janë të qarta, të dukshme dhe të shquara në këtë histori njerëzore.

Pjesa e dytë

HERMAN BERNSTEINI PARA ARDHJES NË SHQIPËRI

Bernsteini, poet dhe shkrimtar

Bernsteini e filloi jetën e tij intelektuale si poet e vazhdoi si përkthyes, si gazetar, si analist, si polemist dhe e përmbyll si diplomat. Ndër krijimet e tij të para janë disa vjersha të botuara në titullin "*Fluturimi i kohës*". Libri përfshin 24 vjersha dhe poema të gjinive dhe temave të ndryshme. Në këtë libër duket se Bernsteini i ri është i frymëzuar nga natyra, i shqetësuar për paqen në botë e i lidhur ngushtë me identitetin e tij hebraik. Aty gjen vjersha për natyrën si: "*Shiu dhe shkëlqimi diellor*", "*Bilbilat*"; për paqen si: "*Paqja*"; tema universale si: "*Muzika*", "*Dashuria*", "*Fama*"; hebraizmi si: "*Rabini i varfër*"; histori si: "*Franca*" etj. Për të pasur një ide rreth kësaj vepre të veçantë të rinisë së Bernsteinit, po paraqesim të përkthyera disa nga vjershat e tij.

Fluturimi i kohës[148]

Ç'pamje shndërrimtare më kalon përpara mua,
Pranë dritares së trenit tek sodis i mahnitur,
Atje ngrihet një mal i tërë, këtu një livadh i ujitur,
Më tutje gjarpëron plot shkulme një përrua.

Me shpejtësi shpërdridhen pemët tej nëpër zabelë,
Mahnitshëm në përkëdheljen që iu bën lehtas era,
Sa shpejt ikën një kasolle, më pas dhe një kështjellë
Dhe një vajzë faqekuqe si mollët që pjek vera.

Treni i gjatë vazhdon ngjitjen, ecën rend, gulçon,
Është i lodhur, do të fiket edhe qan si me dënesë,
Rrotat që nga poshtë ngjitin këtë div që i mundon,
Sillen, dridhen pa u ndalur, pa më të vogëlën ankesë.

Çfarë pamjesh mahnitëse shohin tash sytë e mi,
Sa herë tutje tej qelqnajës tres shikimin kureshtar,
Herë e shoh atë me dhimbje, herë me t'ëmbëlën kënaqësi
Herë me flakët e zjarrit ndezur, herë në grurë apo në bar.

Kështu na qasen lavdet, gaz-rëniet dhe lakmia,
Vetëtima të shpejta që shuhen përgjithmonë.
Hare e të pasurit, dhimbje varfërore kur qan fëmija,

Mirësi që na merret për dobësi në botën tonë.

Ikën koha me të shpejtë dhe me vrullin fluturues,
Që nuk pyet as për mjerime, mëkatarë a kokëgdhë,
S'vë re rrotat e viganit, pa mëshirë uturues,
Përveç aksit rrotullues, s'do t'ia dijë më për asnjë gjë.

Shiu dhe shkëlqimi diellor [149]

Toka ra në gjum' të thellë sapo Dielli perëndoi,
Qetësia, errësira, si një plaf botën' mbuloi.
Njeriu veç dëgjon fëshfërima petalesh,
Dhe currilat flladitëse atje në kroje shpatesh.

N' lule t'freskëta tashmë reja ka lënë lotin,
Re e zezë që na errësoi dhe na e prishi motin,
Pezull rri krenare përmbi tokën e trazuar,
E larguar në harrim dhe në ikje e zem'ruar.

Nata shkon pa kuptuar, dita përsëri agon,
Dielli shpërndan dritë mbi ne, dje e sot, e përgjithmonë.
Endrrat tona i rizgjon me hare edhe me vrull,
Dhe natyrën shkëlqim' artë si me shi e bëri qullë.

Kështu natyra e shpreh vet' shpirtin tonë,
Të veshur me lloj lloj gjërash, herët apo vonë.
Tani na jep lehtësira, më pas një gëzim,
Dhe fill na tërheq në gracka ankthesh plot shqetësim.

Dashuria e famës[150]

Ndjenjë, shqetësim mahnitës,
Është pagjumësia e Gjeniut.
Që vjen për lartësimin e botës,
Dhe frymëzimin e njeriut.

Dëshira e tij torturuese,
Qysh kur lindi nga e Ama,
Zien brenda të pavdekshmit,
Përvëluese - Fama.

Legjendë[151]

Mbushur ndjenja, plot kumbim,
Bashkë me harpën magjiplotë,
Mbreti David' këndon psalme,
Sa njerëzia derdhin lotë.

Zogjtë ndalin cicërimat,
Ujrat rrjedhën, oshëtimat,
Zë Davidi magjiplotë,
Bashkë i bën Diell e Tokë.

Vjen një çast, psalmi mbaron,
Edhe Zoti e nderon,
Dhe çdo zog me këngën çmallet,
Gjithësia zë ringjallet.

Vërshojnë ujrat an' e mbanë,
Në blerime, bjeshkë e vrri,
Në çdo cep të tokës amë,
Mbushin jetën me freski.

Muzika[152]

Veprimet e zemrës e të mendjes njerëzore,
Fisnike, shenjtërore, tokësore dhe hyjnore,
Drejtohen nga fije të padukshme madhore,
Nga valë melodie mpleksur zërash qiellore.

Aty shpërthim i gazit të njëmëndët gjen strehën,
Ëndrrat e mëdha të njeriut aty gjejnë shpresën.
Aty dhimbja, brenga, loti, zhgënjimi gjejnë shërimin,
Veprat e mëdha, dinjiteti aty marrin bekimin.

Aty gjen vajin kur dhimbja shpirtin na godet,
Zbehet zemërimi i tmerrshëm në gjoksin e vet,
Prej shpërthimit pasionant të absurdeve të kota,
Që derdhen në shpirtin tonë si uji nëpër gota.

Përshpërimë e Kupidit, shtyllë prej shprese,
Zjarr-endës i puthjes së parë, premtim bese,
Natyrë e përfshirë melodish pafund harmonike,
Që ngre brenda nesh një botë hiresh fisnike.

Në tërë ato zëra të bëra tufë në melodi,
Në qiellin hyjnor të ëndrrave ngjitet shpirti im,
Nuk njeh më brenga, zi, as dhimbje, as trishtim,
Dhe s'do tjetër gjë, veç... të lirën Dashuri.

Libri me tregime “NË PORTËN E IZRAELIT” [153] - histori hebrejsh

Ky libër i botuar në vitin 1902, përmban një seri tregimesh shumë të bukura, me shumë të papritura. Në to gjenden përshkrime zakonesh, traditash, bestytnish të hebrejve të vendosura në rrethana interesante dhe me të papriturat e jetës dhe në gojë të përsonazheve të thjeshtë të jetës. Në fakt, po të ndaleshim te secili, tregim do të gjenim aq shumë ngjashmëri midis karaktereve të këtyre tregimeve me tipa të letërsisë sonë. Një ndër to mund të ishte tregimi “*Artisti*”:

Artisti[154]

Dy prindër i kërkojnë djalit të tyre piktor të shkojë dhe të kërkojë dorën e një vajze, Florencës, që ata e njihnin. Pas njëfarë hezitimi, djali Williami, shkon dhe e takon vajzën në shtëpinë e saj. Ajo është bashkë me të ëmën dhe një zonjë tjetër të quajtur Rosenthal. Pasi iu merr leje që të zhvillojë një bisedë me vajzën, Florencën, ato e lejojnë. Ai kalon në dhomën tjetër bashkë me vajzën. Piktori nuk guxon t’i propozojë. Në vend të propozimit ai i kërkon një fotografi të saj që t’i bënte një portret të bukur. Ai i bën një portret dhe, pas dy muajsh, shkon t’ia tregojë e t’ia dhurojë Florencës. Për habinë e tij gjen se ndërkohë që koha kishte kaluar, vajza ishte martuar. I ndodhur në një situatë të vështirë ai thjesht dëshiron të vendosë portretin në një vend të bukur të dhomës, ku kishte mjaft dritë. I shoqi i Florencës, i biri i zonjës Rosenthal, që William kishte gjetur në shtëpi në vizitën e mëparshme, nuk e do pikturën. William, si i tërbuar nga dështimi, e çan me thikë pikturën dhe e bën të pavlefshme.

Shkuesi [155]

Në tregimin e tij "*Shkuesi*" Bernsteini shfaq vetitë më të dukshme të një hebreu, Purkinit, i cili është i zoti të bëjë para në çdo gjë. Ai e kthen shkuesinë në një biznes, me të cilën mban familjen. E papritura e tregimit është se, ndërsa ka bërë me qindra bashkime çiftesh me mjeshtërinë e tij, për t'i gjetur pikat e takimit midis çifteve, ndër të cilat paraja ishte e para, ai nuk mund të martojë vajzën e vet. Pas tridhjetë vitesh përvojë shkuesie, ai dështon në të fundit, por e shoqja arrin të martojë të bijën me z. Goldstein, i cili ishte shumë i pasur. Këtu shkuesi Purkin e le profesionin e shkuesit dhe kthehet në bashkëpronar të fabrikës "*Goldstein & Purkin*.

Në fakt, tregimet e Bernsteinit kanë përshkrime shumë të bukura dhe ai mund të quhet pa frikë një O'Henri hebre, amerikan.

Romancë në geto

Shimsheni emigrant hebre rus, i vendosur në një geto në New York kujton me dhimbje ditët e rinisë së tij dhe shpreh keqardhjen që nuk i kishte propozuar për martesë shoqes së tij të fëmijërisë, Esterit. Vitet kalojnë dhe në mjerimin, ku jetonte, kjo ndjenjë vjen dhe e mundon gjithnjë e më shumë. Një ditë ai ballafaqohet me një ngjarje shumë të rëndë. Në ndërtesën ku banonte ai dhe shumë hebrej të tjerë, bie zjarr. Flaka dhe tymi mbulojnë gjithçka. Një djalë i ri ka ngelur në një dhomë dhe është në rrezik vdekje. Shimshen ndihet i turpëruar, nëse nuk do të bëntë edhe sakrificën sublime, duke rrezikuar edhe jetën e vet për të shpëtuar atë të atij djali. Ai futet dhe e nxjerr djalin në gjendje të fikëti. Të dy dalin në gjendje të shpërfytyruar nëpër flakët dhe tymin, që kishte kapluar tërë ndërtesën.

Disa ditë më vonë ai shkon për vizitë tek Esteri, shoqja e tij, e cila kishte një vit që kishte ardhur nga Rusia në Amerikë. Ata përqafohen me mall. Flasin për shumë kujtime të fëmijërisë. Flasin për qytetin ku ishin lindur dhe ishin rritur. Në shtëpi gjëndej një plakë zevzeke, e cila nuk i linte rehat. Nuk vonon dhe në dhomë futet Samueli, një djalë i ri. Ester ia prezanton Shimshenin si shokun e saj të fëmijërisë. Samueli menjëherë i thotë Esterit:

"*Ester, po ky është ai që më shpëtoi jetën nga flakët.*"

Esteri i hidhet në qafë Shimshenit, e puth dhe e përqafon me shumë, shumë dashuri, pasi ai kishte shpëtuar burrin e saj të ardhshëm, Samuelin.

Kurë xhelozie

Në tregimin "*Kurë xhelozie*" Bernsteini sjell një ngjarje sociale shumë prekëse. Z. Lampert, i cili është kthyer në një pijanec, bixhozxhi dhe njeri i nënshtruar ndaj vesit, është në prag të shkatërrimit të familjes së tij. E shoqja, Lisa, bashkë me vajzën e vogël Xhanetën, e vuajnë pa masë sjelljen e tij. Lisa vjen deri në atë gjendje, kur mund të bënte vetëvrasje. Në vend të kësaj, ajo zgjedh të nxisë xhelozinë e të shoqit, duke u miqësuar me një artist, piktor. Piktori bie në dashuri të marrosur me Lisën. Ndërkohë i

shoqi i Lisës e ka kuptuar lidhjen e tyre dhe fillon të reflektojë deri në atë masë, sa t'i kthehet përsëri jetës familjare. Në fund artisti i kërkon me këmbëngulje një takim me Lisën. Ajo i premton ta takojë pranë Muzeut Metropolitan në New York, pikërisht aty ku ngrihet statuja e Napoleon Bonapartit. Zoti Lurie, artisti, shkon një orë përpara kohës, i emocionuar nga takimi i pritshëm me Lisën. Në orën e caktuar, në vend të Lisës vjen i shoqi Wiliam Lampert. Piktori Luria tenton të largohet dhe mohon të ketë lënë takim me Lisën. Por z. Lampert, që e dinte mirë se kë priste ai, arrin t'i lëshojë një letër në dorë, të cilën ia kishte dhënë vetë Lisa. Ai e merr dhe e lexon dhe mëson se Lisa, e kishte afruar atë, që të ngjallte xhelozinë e të shoqit. Kështu, ajo ia kishte arritur qëllimit të ribashkonte familjen e saj, ta sillte të shoqin në gjendjen e duhur. Në fund të letrës ajo i kërkon piktorit ndjesë prekëse për dhimbjen që i kishte shkakuar, por i deklaron atij se do ta ruante respektin për të tërë jetën dhe e falënderonte, që i ktheu njeriun e saj të jetës, në gjendje normale.

Vetëm

Në këtë tregim Bernsteini tregon jetën e mundimshme të emigrantëve hebrej nga Rusia në Amerikë. Aty jepen skenat e përpjekjeve të jashtëzakonshme për të mbijetuar në format e tyre. Shpirti tregtar i hebrejve të cilët e nxjerrin "*paranë nga toka*" bie në sy në çdo rresht të tregimit. Po ashtu dalin në pah traditat dhe zakonet hebraike, martesat me shkuesi, roli që luajnë rabinët (priftërinjtë hebrej) në jetën e grigjës së tyre.

Si edhe në tregimin e mësipërm, hebrejtë e quajnë biznes edhe shkuesinë dhe bëjnë gjithçka, që të bashkojnë njerëzit brenda rrethojave etnike të racës së vet. Në qendër të tregimit është Dorothy, emigrante ruse, e cila për shkaqe të ndryshme i është vonuar lidhja e fatit. Ajo bën jetë të vetmuar, pasi ka humbur vëllain dhe familjen. Nuk ka pasur fat në jetë dhe nuk është lidhur kurrë me një burrë. Rabini e ndihmon atë që të lidhet me dr. Adlerin, i cili kishte mbetur i ve. Çdo gjë rregullohet dhe vjen momenti që ata të takohen.

Si edhe në tregimet e tjera të Bernsteinit, në finale vjen diçka krejt e pazakonshme. Ajo që Dorothy kishte pritur tërë jetën kthehet në një dramë. Sapo ajo futet në dhomë për të takuar dr. Adlerin, i bie të fikët. Kështu shkuesia dështon dhe dr. Adleri, pezmatohet pasi e konsideron se shkuesi i kishte ofruar martesë me një femër të sëmurë. Ai largohet. Doroti kthehet në shtëpi dhe i shtrohet një jete normale, duke ardhur në përfundimin se nuk është vetëm martesa, ajo që mund ta bëjë njeriun të lumtur.

"Gjëja më e jashtëzakonshme rreth incidentit të Gorkit në Amerikë është se, ndërkohë që në tregimet dhe artikujt e tij për Amerikën ai nuk shkruan asgjë përveç atyre më të këqijave që mund të thuhen per një vend, në biseda të ngushta kurrë nuk më ka thënë diçka, që të mos jetë më e bukura po për atë vend, Amerikën. Ndoshta ai vetë një ditë do t'i tregojë përshtypjet e tij ashtu sikurse m'i ka treguar mua."

LEONID ANDREJEV

Letërsia ruse dhe kontributi i Herman Bernsteinit në njohjen e saj në botën anglisht folëse

Herman Bernsteini duket se e shfrytëzoi shumë mirë njohjen e gjuhës ruse nga fëmijëria e tij dhe njohjen e gjuhës angleze nga vitet e tij të rinisë dhe studimeve në SHBA. Vetë fakti që ai filloi të njihej si përkthyes me famë, që në moshën 25-vjeçare na bën ta besojmë këtë. Përkthimi i veprave të mëposhtme e vërteton këtë fakt. Si i ri, ndoshta edhe i shtyrë nga ide revolucionare, ai iu filloi me veprën e Gorkit, duke përkthyer në gjuhën angleze "Foma Gordejevin" (1901). Libri u botua me titullin, "*Njeriu i frikësuar*".[156]

Në shënimin hyrës të librit Bernsteini shkruan:

> Prej thellësive më të errëta të jetës, ku sundojnë vesi, krimi dhe mizerabiliteti, del "Bajroni" i shekullit të njëzetë, poeti i vagabondit dhe i proletariatit, Maksim Gorki. Ai vjen jo si lypës që përgjërohet me përulje për një kothere buke në emër të zotit, as si argjendar që shpalos gurët e xhevahireve vezulluese për të ngazëllyer dhe kapur vështrimin e syve tanë; ai nuk vjen përpara botës jo me zërin e Tyrteusit[157], por si njeriu i thjeshtë i Nizhni Novgorodit dhe godet me romuz mbi trupat e heronjve të tij të dashuruar pas lirisë, për të na pushtuar ne, të mësuar me një letërsi të sotme të vetëkënaqurish, të patrazuar, duke sjellë një jetë të re mbi skeletet e zverudhra pa gjak e pa jetë.
>
> Njësoj si në britmat pasionante të Bajronit, "lindur mbi motivet e një melodie të egër pa asnjë vlerë artistike" ai është zëri i furishëm, i paepur, i fuqishëm, sikur këndon "marrëzinë e guximit" të ëndërrimtarëve këmbëzbathur, të cilët janë krenarë për varfërinë e tyre e që nuk zotërojnë asgjë dhe nuk i frikësohen asgjëje, të cilët janë të kënaqur në mizerjen e tyre, bash nëpërmjet mizerabilitetit që iu jep gëzim.

Zëri i Gorkit është i qetë, i lëmuar. Është zëri i mirëbalancuar i Çehovit, De Mopassanit rus, duke mos qenë aspak apostolik, i mirëmenduar, por krahasimisht zë i mekur i Tolstoit-predikues. Ai zë është ulërima e luanit, shkreptima e rrufesë. Në fuqinë e tij fillestare është zemra, qarja e së cilës del prej një shpirti të sinqertë, por të vuajtur, që pa brutalitetin e jetës në tërë tmerret e veta dhe tani e përplas përvojën e tij në faqe të botës me simpatinë e pashoqe dhe guximin e një gjiganti.

Sepse Gorki, mbi të gjitha ka kurajën dhe guxon të thotë se e gjen vagabondin, njeriun jashtë shoqërisë, më frymëzues dhe më të rëndësishëm se vetë shoqëria. Bysyaku i tij, personifikimi simbolik i mbinjeriut, është aq i pafajshëm dhe i guximshëm si fëmijë ose edhe si gjeni. Në pasionet e fuqishme të heroit fisnik, mëshirues në rrënojat, në aristokracinë e shpirtit të tij dhe në etjen e tij të përhershme për liri, Gorki sheh shpirtin rrebelues dhe të papajtueshëm të njeriut, sheh diçka të bukur, të fuqishme dhe monumentale. Prandaj rrëmbehet prej psikologjisë së tyre të çuditëshme. Sepse jeta ëndërrimtare e këmbëzbathurit është jeta e Gorkit, idealet e tij janë idealet e Gorkit, kënaqësitë dhe dhimbjet e tij janë kënaqësitë dhe dhimbjet e Gorkit. Kështu, Gorki i molisur nga shëndeti, tani i goditur nga stuhia e fatit, i plagosur dhe në dhimbjet e fushëbetejës së jetës, përsëri njësoj si Bajroni dhe Lermontovi "...e kërkon stuhinë sikur ajo të mbartëte ngushëllimin" dhe me një ulurimë prej luani, ai qan sfidueshëm:
Le të shpërthejë stuhia më me forcë edhe me furi!"

Herman Bernstein, 20 Shtator 1901.

Kështu, Herman Bernsteini ka një kontribut të madh në njohjen e letërsisë ruse në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ose më mirë të themi në botën anglisht folëse. Ai bëhet një ndër eksploruesit më të shquar të kohës së tij, të asaj letërsie dhe përkthyes i kryeveprave të saj, e cila zë një fond të artë në letërsinë e përbotshme. Autorët e tij rusë të parapëlqyer, siç do të shohim në këtë libër, janë Tolstoi, Gorki, Çehov, Andrejev, Lermontov, Turgenjev etj. Ai kishte edhe miqësi personale me disa prej tyre. Tolstoin e kishte vizituar në Krasnaja Poliana, në fshatin e shkrimtarit, dhe intervistën me të e përfshin në librin "*Me mendjendriturit*". Andrejevin e ftoi për vizitë në SHBA, por ai nuk ia arriti asaj dite.

Ky libër nuk do të ishte i plotë, nëse nuk do të kishte fragmente të letërsisë ruse të përkthyera në gjuhën angleze dhe të sjella këtu prej andej për lexuesin shqipfolës. Le të shohim me radhë disa prej tyre.

Leonid Andrejev, "Brengat e Belgjikës"

Dramë në gjashtë akte shkruar nga Leonid Andrejev, përkthyer nga rusishtja në anglisht nga Bernsteini. Ai ishte shumë i dhënë pas historisë së Belgjikës dhe tragjedisë së popullit belg, prandaj e përmend shumë herë atë në kontekste të ndryshme, por gjithmonë me simpati. Në hyrjen e librit "*Brengat e Belgjikës*[158]" ai shkruan:

> Leonid Andrejev, autori i madh rus vjen tani edhe me një vepër të re të quajtur "Brengat e Belgjikës", ku ndjen thellë deri në palcë dhimbjen për kombet e dobëta dhe të shtypura. Andrejevi i paraqet viktimat e kësaj lufte me simpati të thellë. Në këtë vepër janë belgët ata që vuajnë, ndërsa në një kryevepër tjetër analizon vuajtjet e hebrejve në Rusi. Të tëra këto vuajtje janë produkt i luftërave. Ai i përshkruan me realizëm ndjenjat e turpit që duhet ta zenë popullin rus për shkak të politikës anti hebraike që ata zbatojnë.
>
> Në të dya këto vepra Leonid Andrejevi bën përgjegjës militarizmin dhe ndikimin gjerman për angazhimet e mbrapshta kundër kombeve të vogla. Në studimin e tij rreth tragjedisë së hebrejve në Rusi për "barbarët rusë" dhe ata "gjermanë", ai shkruan si më poshtë:
>
> Nëse për vetë hebrejtë Pale Setlement[159], norma në përqindje dhe kufizime tjera, ishin një dëshmi fatale që ua shkatërroi krejt jetën atyre, për mua ka qenë, si një ndjesi e thellë intuitive, si një gjë ruse e ngulur në shpinën time, një si gerbë[160] monstruoze, të cilën e mora, nuk e di se kur dhe në çfarë rrethanash, por kudo që të shkoj dhe çfarëdo që të bëj, ajo gerbë është gjithmonë me mua. Ajo më ka prishur gjumin e natës dhe në orët e mia, kur jam zgjuar, në prani të njerëzve, më ka mbushur me ndjenjën e konfuzionit dhe të turpit.
>
> Është e domosdoshme për të gjithë të kuptojmë se fundi i vuajtjeve të hebrejve është fillimi i vetë respektit tonë, pa të cilin Rusia nuk jeton dot. Ditët e errëta të luftës kaluan dhe barabarët gjermanë të sotëm do të bëhen edhe një herë gjermanë të kulturuar, zëri i të cilëve do të dëgjohet përsëri në tërë botën. Dhe është qenësore, që as zëri i tyre as zëri i askujt tjetër të mos ulurijë me klithmën: "barbarët rusë".
>
> Edhe sikur me mjeshtërinë dhe me vlerat e saj dramatike të treguara, vepra "Brenga e Belgjikës" të synonte të ngjallte pak më shumë simpati për vuajtjet e viktimave të luftës, ose, në qoftë se ajo do të ndihmonte për t'u bërë thirrje mendjeve të popullit të kuptonin tmerret e luftës, atëherë edhe kaq do të mjaftonte t'i njihnim meritën se ai i ka bërë një shërbim shumë të madh njerëzimit.

Kështu shprehet Herman Bernsteini në parthënien e librit të Andrejevit, nënshkruar më 25 maj 1915.

Bernsteini kritik letrar

Miqësia e Bernsteinit me Leonid Andrejevin duket se ishte e një përmase shumë të

madhe intelektuale. Njohja me të dhe shkrimet me këtë antibolshevik e ka shtyrë atë të shkruajë perla të kritikës letrare si këto që gjenden më poshtë. Një ndër to ilustrohet më së miri në parathënien e librit të Andrejevit:

Parathënie e librit e shkruar nga Herman Bernstein

Leonid Andrejev, i lindur në Oryol në vitin 1871, është figura më popullore dhe fill pas Tolstoit, shkrimtari me dhuntitë më të mëdha në Rusinë e sotme. Ai ka shkruar shumë drama dhe histori me vlera të mëdha. Ndër to veçojmë si më të njohurat: "E qeshura e kuqe", "Jeta e njeriut", "Drejt yjeve", "Jeta e Vasil Fiveskit", "Eliazar," "Maskat e zeza" dhe "Historia e të shtatëve që u varën".

Me "Të qeshurën e kuqe" ai nxori në pah tmerret e luftës, ashtu sikundër pak kush e kish bërë më parë. Ai e ngjeu penën e tij në gjakun e Rusisë dhe shkroi tragjedinë e luftës së Mançurisë. Në veprën e tij "Jeta e njeriut" Andrejevi na ka dhënë një dramë të madhe të "moralit" imagjinar, e cila është renditur prej kritikëve europianë midis kryeveprave dramatike më të mëdha. "Historia e të shtatëve që u varën" bëhet kështu arritja e tij më e madhe e shkëputur shumë nga veprat të tjera.

Depërtimi i mprehtë psikologjik dhe thjeshtësia mjeshtërore me të cilin ai përçon dhe ve në pah tragjedinë e secilit prej të shtatëve të cilët u varën, e vendosin atë në të njejtën kategori me mjeshtrat më të mëdhenj rus të trillimit, përkrah Dostojevskit, Turgenjevit dhe Tolstoit.

E konsideroj vetveten me fat që pata mundësinë t'i paraqes lexuesit të gjuhës angleze këtë vepër të jashtëzakonshme, e cila tashmë ka lënë një përshtypje të thellë në Europë ashtu siç besoj unë është e destinuar që për një kohë të gjatë në të ardhmen të luajë një rol në hapjen e syve të botës për të parë tmerret, që janë kryer në Rusi, si edhe dhunën dhe padrejtësinë e ushtruar për shkatërrimin e jetëve njerëzore. Nuk ka rëndësi cila është arsyeja. Janë gabime apo krime.

Herman Bernstein, New York

Anatema [161]

Tragjedi në shtatë akte e përkthyer me autorizim të Herman Bernsteinit (1910). Në vitin 1925 u botua drama "*Anathema*" e Leonid Andrejevit, e cila ishte një variant modern i legjendës së Faustit, në të cilën karakteri i Faustit i është veshur një dyqanxhiu antipatik hebre rus. Është interesant të shihet se si premiera e dramës në Amerikë është dhënë në hebraisht, në Teatrin Lipzin në Bowery. Vepra ishte përshtatur nga përkthimi anglisht, që i kish bërë asaj nga rusishtja, Herman Bernstein. Libri mban nënshkrimin e Bernsteinit në faqen e brendshme të kapakut të tij në një botim të vitit 1925.

Të shtatët që u varën [162]

Dedikim

Ky libër i kushtohet kontit Leo N. Tolstoit, nga Leonid Andrejevit, ndërsa përkthimi i kësaj historie është gdhendur, po ashtu me respekt, për kontin Leo N. Tolstoi prej Herman Bernsteinit. Përkthim i letrës paraprijëse të Bernsteinit në rusisht:

> Jam shumë i lumtur që historia e "Të shtatëve që u varën" tani do të lexohet edhe në gjuhën angleze. Fatkeqësia që kemi ne të gjithë qëndron tek ajo që dimë kaq pak, madje asgjë për njëri-tjetrin. Nuk dimë as rreth shpirtit, jetës, vuajtjeve, zakoneve, ndjenjave, prirjeve, shpresave dhe as aspiratave të njëri-tjetrit. Letërsia, të cilën unë kam nderin të ofroj, është e dashur për mua, sepse ajo ka detyrën më fisnike të shfaqet, duke mos marrë parasysh kufijtë, pengesat dhe as largësitë prej nga shkruhet dhe ku lexohet. Njësoj si në një guackë të fortë, çdo njeri është i kyçur në një mbulesë të trupit dhe të jetës së tij. Po kush është njeriu? Ne vetëm mund ta marrim me mend. Çfarë përbën gëzimi apo brenga e tij? Këtë ne mund ta hamendësojmë vetëm bazuar në veprimet e tij, të cilat shpesh herë janë të pashpjegueshme. Mund ta shohim në qeshjen dhe lotët e tij, të cilat janë shpesh tërësisht të pakuptueshme për të tjerët. Dhe nëse ne rusët, që jetojmë kaq afër së bashku në një mizori të përhershme e kuptojmë kaq pak njëri-tjetrin dhe aq pamëshirshëm i çojmë drejt vdekjes ata që duhet të na vijë keq për ta, ata që duhen vlerësuar, ndërkohë vlerësojmë dhe shpërblejmë ata që duhen dënuar si të neveritshëm, që shkaktojnë urrejtje dhe zemërim, a mund të merret me mend se sa hërë më e vështirë është për ju amerikanët ta kuptoni Rusinë e largët? Nga ana tjetër, është po aq e vështirë për ne rusët që të kuptojmë Amerikën e largët, për të cilën ne ëndërrojmë, kur jemi të rinj dhe pastaj rrimë e mendojmë aq shumë, kur arrijmë moshën e pjekurisë.
>
> Masakrat dhe uria masive e imponuar ndaj hebrejve, parlamenti dhe ekzekutimet, grabitjet dhe heriozimi më i madh, "Qindëshja e zezë"[163] dhe Leon Tolstoi, çfarë përzierje figurash dhe konceptesh, çfarë burimi i frytshëm për të gjitha llojet e keqkuptimeve! Ndërsa e vërteta e jetës qëndron e strukur në heshtje varri. Falsiteti i saj i paturp gërthet me zë të lartë, duke u shprehur dhe kërkuar përgjigjen e pyetjeve të dhimbshme: Kë duhet të simpatizoj unë? Kë duhet të besoj? Kë duhet të dashuroj?
>
> Në historinë e "Të shtatëve që u varën" jam përpjekur të jap një përgjigje të sinqertë dhe të paparagjykuar ndaj disa prej këtyre pyetjeve. Që unë e kam trajtuar Rusinë sunduese e shtypëse me kujdes dhe mëshirë, mund të kuptohet prej faktit që censori rus e ka lejuar librin tim të dalë nga botimi dhe të qarkullojë. Kjo është provë e mjaftueshme, po të marrim parasysh faktin se sa shumë libra, broshura dhe gazeta kanë gjetur prehje të përjetshme nën hijen paqes ose të stacioneve policore, kur janë ngritur deri në qiell në formë flake, tymi dhe hiri të djegur.
>
> Por unë nuk kisha si qëllim të dënoja qeverinë, fama e zgjuarsisë të së cilës dhe virtyti tashmë janë shpërndarë përtej kufijve të atdheut tonë fatkeq. Modeste dhe e turpëruar përtej çdo mase të virtytit, Rusia sinqerisht do të dëshironte të hiqte dorë nga ky nder, por fatkeqësisht shtypi i lirë i Amerikës dhe Europës nuk e kanë ruajtur modestinë e vet dhe kanë dhënë një pamje të qartë të mjaftueshme

të aktiviteteve të saj të lavdishme. Ndoshta unë e kam gabim këtë: Ka mundësi që shumë njerëz të ndershëm në Amerikë besojnë në pastërtinë e qëllimeve të qeverisë ruse, por kjo çështje është e një rëndësie të tillë, që kërkon një trajtim të veçantë, për të cilën është e domosdoshme të kemi edhe kohën e duhur edhe qetësinë e shpirtit. Ajo që vlen të thuhet është:

Nuk ka shpirt të qetë në Rusi.

Detyra ime ishte të vija në pah tmerrin dhe padrejtësinë e dënimit kapital në çfarëdo rrethane. Tmerri i dënimit me vdekje është i madh, kur ai bie mbi ata njerëz të guximshëm dhe të ndershëm, faji i vetëm i të cilëve është dashuria e tyre e tepërt dhe ndjenja e fisnikërisë në një rast të tillë revolte të ndërgjegjshme. Por konopi është edhe më i tmerrshëm, kur hidhet rreth qafës së një njeriu të dobët dhe të paditur. Dhe sado e çuditshme që mund të duket, unë e shoh me më pak keqardhje dhe vuajtje ekzekutimin e revolucionarëve siç janë Werner dhe Musya, sesa mbytjen e vrasësve injorantë, mizerabël në mendjen dhe zemrën e tyre, si Yanson dhe Tsiganok. Madje edhe tmerri i marrëzisë së fundit me ekzekutimin e pashmangshëm të Wernerit, mund të shihet në gjurmën që ai la me mendjen e tij të ndriçuar dhe dëshirën e tij të hekurt dhe atë që la Musya me pastërtinë dhe pafajësinë e tij.

Por këta janë të dobëtit dhe mëkatarët që ballafaqohen me Rusinë e sotme. Fëmijët që luajnë, kalojnë pranë trupave gjysmë të varrosur dhe shohin turma të grumbulluara çizmesh të fshatarëve, që kundërmojnë prej dheut, persekutorët që kanë dhënë vendimin dhe i kanë parë vetë këto ekzekutime po çmenden dhe dërgohen nëpër spitale. Ndërkohë njerëzit vazhdojnë të varen, e të varen pandëprerë.

Unë iu jam thellësisht mirënjohës për detyrën që keni ndërmarrë në përkthimin e kësaj historie. Duke njohur ndjeshmërinë e popullit amerikan, i cili njëherë e një kohë dërgoi për këtej oqeanit avulloret plot me bukë për Rusinë e goditur nga vdekjet për shkak të urisë, jam i bindur se në këtë rast populli ynë në mizerjen, idhnimin dhe zinë që e ka pllakosur diku, do të gjejë edhe mirëkuptim dhe simpati. Dhe nëqoftëse historia ime e vërtetë, rreth shtatë prej mijërave që u varën do të ndihmojë të shkatërrojmë qoftë edhe një prej barrierave, të cilat i ndajnë kombet tona nga njëri-tjetri, një qënie njerëzore prej një tjetre, një shpirt prej një tjetri, unë do të ndihesha shumë i lumtur që arrita misionin tim.

Me respekt të thellë, i juaji,
Leonid Andrejev

Herman Bernsteini dhe Leonid Andrejevi (1871 – 1919)

Nga studimi i veprës së Bernsteinit, pjesa që ka të bëjë me Andrejevin, na lë të kuptojmë se ka pasur një lidhje shumë të fortë intelektuale midis tyre. Ndërsa Bernsteini në anën tjetër të detit gëzonte lirinë e tij në SHBA, Leonidi ishte syrgjynosur në Finlandë.

Andrejevi ishte një prej shkrimtarëve më të njohur rusë, brez i asaj që njihet si Epoka e Argjendë, një shkrimtar që ndërthur në veprën e tij elemente realiste, natyraliste dhe simboliste. Ai njihet si babai i ekspresionizmit rus, por ai ishte edhe antibolshevik dhe e konsideronte regjimin e sovjetëve edhe më të keq se regjimin carist. Në 1917 shpërngulet në Finlandë dhe shpallja e Pavarësisë së Finlandës po atë vit, i jep mundësi të botojë artikuj kundër regjimit bolshevik, mes të cilëve edhe një thirrje Aleatëve, me titull S.O.S., e vitit 1919.

Andrejevi ka lënë një varg veprash, të cilat Bernsteini i ka përkthyer në gjuhën angleze. Midis tyre është edhe "*Ditari i Satanit*".

Disa nga mendimet e Bernsteinit rreth Andrejevit janë dhënë në parathëniën e kësaj vepre të përkthyer në anglisht prej tij. Ai ndër të tjera thotë:

> Vepra e fundit e Leonid Andrejevit "Ditari i Satanit"[164] është përfunduar prej këtij shkrimtari të madh rus vetëm pak ditë para se ai të vdiste në Finlandë, në shtator të vitit 1919. Edhe pse disa vite më parë Andrejevi konsideroihej si një prej shkrimtarëve më popullorë dhe më të suksesshëm të Rusisë, ai vdiq puthuajse pa asnjë qindarkë në xhep. Vdiq si figurë tragjike, i deziluzionuar dhe zemërthyer për tragjedinë, që kishte pllakosur Rusinë.
>
> Një vit më parë Andrejevi më shkroi se dëshironte të vinte në Amerikë për të studiuar këtë vend dhe të njihej me fatin e bashkëatdhetarëve të tij fatkeqë. Unë ia rregullova vizitën dhe e njoftova me telegram, por si në legjenda, pikërisht në ditën që i dërgova njoftimin, më erdhi nga Finlanda lajmi i keq se Andrejevi kishte vdekur nga një sulm në zemër.
>
> Në "Ditarin e Satanit" Andrejevi shprehu përmbledhtazi zhgënjimin e tij të pakufishëm në një satirë shterruese të jetës njerëzore. Pa frikë dhe pa mëshirë, ai shpalosi hipokrizinë dhe falcitetin përpara publikut. Ai e portretizoi me tërë ngjyrat e duhura Satanin, që vinte në tokë për të luajtur dhe zbavitur. Duke marrë formën e një multimilioneri amerikan, Satani ndërmerr një tur nëpër Europë, për t'u kënaqur me aventura. Përpara tij kalojnë forma të ndryshme të virtyteve fallso, hipokrizisë, brutalitetit të pamëshirshëm dhe shpesh edhe pafajësia e pandershme e grave. Brenda një kohe të shkurtër Satani e gjen vetveten në një botë që i takonte krejt atij në djallëzi dhe mashtrime.
>
> Ai që ndihej rehat në milionat e tij e gjen vetveten të përqeshur, të poshtëruar, të rrahur prej njerëzve, që ishin bërë edhe më të djallëzuar se ai vetë.

Andrejevi e tregon autobiografinë e tij më mirë se kushdo në vitin 1908.

> Kam lindur,- thotë ai - në Oryol, në vitin 1871 dhe studjova atje në gjimnaz. Isha

> i dobët në mësime. Në klasën e shtatë gjatë tërë vitit isha nxënësi më i keq dhe nota ime kurrë nuk shkonte përmbi 4, madje shpeshherë binte edhe në 3. Koha më e këndshme që kaloja në shkollë, të cilën e kujtoj edhe sot me kënaqësi, ishte ajo e pushimit midis orëve dhe nganjëherë rrallë, kur më nxirnin nga klasa.
>
> Kur studioja në gjimnaz, babai im, që ishte inxhinier, vdiq. Si nxënës i gjimnazit kisha nevojë shumë të madhe. Gjatë kursit të parë në Shën Petërsburg gati sa nuk vdiqa nga uria. Edhe sot turpërohem, kur mendoj se si shkova dy ditë pa ngrënë në shkollë në një kohë kur kisha dy ose tre palë pantallona dhe dy pallto, të cilat mund t'i kisha shitur për të blerë ushqim.
>
> Ishte pikërisht koha, kur shkrova tregimin e parë rreth një studenti që po vdiste nga uria. Qava kur e shkrova atë dhe botuesi, i cili ma ktheu dorëshkrimin, qeshi. Ai tregim mbeti i pa botuar. Në vitin 1894, në janar, bëra një përpjekje të pasuksesshme për të vrarë veten me armë. Si rezultat i dështimit u detyrova prej autoriteteve fetare të reflektoja, po pastaj pata shqetësime në zemër, edhe pse jo të një natyre serioze. Por jo se nuk ma bëri jetën të hidhur. Gjatë kësaj kohe unë bëra një ose dy përpjekje të pasuksesshme në të shkruar. Mendova t'i përkushtohesha me kënaqësinë më të madhe pikturës, të cilën unë e dashuroja që nga fëmijëria. Bëra portrete të cilat porositeshin për 3 dhe 5 rubla.
>
> Në vitin 1897 mora diplomën dhe u bëra ndihmës avokat, por isha krejt jashtë asaj sfere. M'u afrua një punë në "The Courier", për të cilën më duhej të raportoja për procedurat e gjykatës. Nuk pata fat të bëja asnjë lloj praktike si avokat. Mora vetëm një çështje dhe atë e humba me sukses. Në vitin 1898 shkrova historinë time të parë. Që nga ajo kohë i jam kushtuar vetëm letërsisë. Maksim Gorki më ka ndihmuar konsiderueshëm në punën time letrare me këshillat dhe sygjerimet e tij.

Hapat e parë në letërsi, tregimet e para të shkurtra nuk tërhoqën aq shumë që në daljet e para nga shtypi. Vetëm atëherë kur kontesha Tolstoi, e shoqja e Leon Tolstoit, në një letër dërguar Novoye Vremja doli në "mbrojtje të pastërtisë artistike dhe fuqisë morale të letërsisë bashkëkohore", duke deklaruar se shoqëria ruse, në vend që të blejë, lexojë dhe ta bëjë të famshme veprën e Andrejevit, duhej të "ngrihej kundër një fëlliqësire të tillë me indinjatë", thuajse çdonjeri, që dinte të lexonte në Rusi iu kthye veprave të mia.

Në sulmin e saj ndaj Andrejevit, kontesha Tolstoi shkruante si më poshtë:

> Shkrimtarët e rinj varfanjakë si Andrejevi, ia dalin vetëm atëherë, kur e përqendrojnë vëmendjen e tyre në pikat e fëlliqura të degradimit njerëzor dhe shprehin qarramanllëkun e tyre përpara një lexuesi të pazhvilluar, gjysmë intelegjent, duke e ftuar atë të shohë dhe të ekzaminojnë trupin e dekompozuar të degradimit njerëzor dhe të mbyllin sytë përpara mrekullive të Zotit, botës së gjerë me bukuritë e natyrës, madhështisë së artit, me dëshirat rebele të shpirtit njerëzor me luftërat fetare dhe morale dhe idealet e mëdha të qiellit – madje edhe në rënien, fatkeqësinë dhe dobësinë e njerëzve të tillë, siç i vlerëson Dostojevski…Duke i përshkruar tërë këto çdo artist, që është i tillë me të vërtetë, duhet të nxjerrë në pah qartë përpara njerëzimit jo pamjen e fëlliqësisë dhe të vesit, por duhet të luftojë kundër atyre, duke ndriçuar me idetë më të larta të së mirës, të vërtetës dhe triumfit mbi të keqen, dobësinë dhe veset e njerëzimit. Unë do të doja të qaja me zë të lartë përpara tërë botës me qëllim që t'i ndihmoj ata

> njerëz fatkeqë, ku secilit i janë dhënë krahët për të fluturuar lart, drejt mirëkuptimit të dritës shpirtërore, bukurisë, mirësisë dhe Zotit, por që i lidhen prej këtyre Andrejevëve.

Kjo letër e konteshës Tolstoi i hapi rrugën një stuhie protestash në tërë shtypin rus dhe për habinë e të gjithëve, ishin pikërisht gratë mbrojtëset më të flakta të autorit të ri. Duke ju përgjigjur sulmit, shumë gra në letrat e tyre dërguar shtypit, theksuan se autori i Ana Kareninës, është sulmuar pothuajse në të njejtën mënyrë për veprën e tij "*Sonata Kreutzer*" dhe që Tolstoi vetë ishte akuzuar pikërisht për aplikimin e një ndikimi të njëjtë me atë që kontesha ia atribuoi Andrejevit mbi rininë e Rusisë. Që prej publikimit mohues të letrës së konteshës Tolstoi, Andrejevi ka shkruar një seri kryeveprash siç janë "*Jeta e At Vasilit"*[165], një studim të fuqishëm psikologjik i quajtur "*Qeshja e kuqe"*[166]*,* një tregim për luftën "*shkruar me gjakun e Rusisë*," një paraqitje shokuese moralizuese në pesë akte, "*Anatemën*[167]*",* dramën e tij më të madhërishme dhe "*Të shtatët që u varën"*[168], në të cilën tmerret e jetës ruse në kohën e Carit ishin dhënë me një bukuri të thellë, të thjeshtë dhe aq forcë, saqë Turgenjevi ose Tolstoi vetë, do t'i kishin vënë firmën poshtë këtyre kryeveprave me kënaqësinë më të madhe.

Kështu, akuzat kundër Andrejevit u çarmatosën prej vetë veprave të tij letrare me vlerë të jashtëzakonshme dhe dashuri të thellë, thotë Herman Bernsteini.

> Ndërkohë që po shkoja nga Terioki në shtëpinë e Andrejevit, shoferi finlandez me një rusishte të keqe më tha:
> Andrejevi është shkrimtar i mirë. Edhe pse është rus, ai prapëseprapë është njeri i mirë. Kur arrita te shtëpia e Andrejevit, pashë një strukturë fantastike shumë origjinale. E ëma na tregoi se Andrejevi kishte shkuar në Gjirin e Finlandës, por do të kthehej shpejt.

Pasi Andrejevi erdhi në shtëpi, Bernsteini thotë se ai nuk i ngjiste asnjë fotografie të tij, që kishte parë deri atëherë. Pas prezantimit, ata flasin për letërsinë ruse. Andrejevi i flet Bernsteinit për dëshirën që kishte të vizitonte Amerikën, por kishte frikë se do ta pësonte njësoj si Gorki në New York. Pas kësaj Andrejevi shton:

> Gjëja më e jashtëzakonshme rreth incidentit të Gorkit në Amerikë është se, ndërkohë që në tregimet dhe artikujt e tij për Amerikën, ai nuk shkruan asgjë përveç atyre më të këqijave që mund të thuhen për një vend, në biseda të ngushta kurrë nuk më ka thënë diçka, që të mos jetë më e bukura për atë vend, Amerikën. Ndoshta, ai vetë një ditë do t'i tregojë përshtypjet e tij, ashtu siç m'i ka treguar mua.

Në një shëtitje ato ditë në Finlandë, Andrejevi i thotë Bernsteinit: "*Në qoftë se Tolstoi do të ishte i ri, do të ishte me ne tani.*". Bernsteini e takon përsëri Andrejevin disa herë deri në takimin e fundit në Shën Petërsburg, gjatë kryengritjes së qershorit të vitit 1917. Më pas ai shkruan për vdekjen tragjike dhe funeralin edhe më tragjik të Andrejevit, në mërgim, ku nuk ka asnjë njeri nga kombi i tij për ta përcjellë në banesën e fundit: "*Ai pushon në një vend të huaj, në pritje të Rusisë së lirë, që kërkon kthimin e hirit të birit të vet, për t'i kthyer haraçin gjenisë së atij vendi.*"

Midis shënimeve të tij të fundit, kur merrte frymë në dëshpërim të thellë dhe ankth, ai ka lënë edhe këto rreshta:

> Revolucioni është mjet aq i pakëndshëm për të zgjidhur mosmarrëveshjet, sa ç'është edhe vetë lufta. Por, nëse do të ishte e pamundur të gjendeshin forma të tjera për mposhtjen e armiqësive dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përveçse me thyerje kafkash dhe me maja bajonetash, atëherë sigurisht që duhet luftuar….

Leonid Andrejev vdiq zemërthyer, por shpirti i tij gjenial është i pavdekshëm. Këto shkruante Herman Benshtaini[169] në shtator 1919 nga New Yorku.

Anton Çehov

Bernsteini ka përkthyer edhe disa vepra nga shkrimtari i madh rus Anton Çehov.[170] Në këtë libër po sjellim një prej tregimeve të tij me titull:

Shpifësi[171]

Sergey Kapitonlch Akhineyev mësuesi i kaligrafisë e martoi vajzën e tij me mësuesin e historisë dhe gjeografisë, Ivan Petrovich Loshadinikh. Dasma shkoi shumë mirë. Ata kënduan, lozën dhe vallëzuan në sallën e zbukuruar për atë ditë. Kamarierët e marrë në punë enkas nga klubi silleshin sa andej e sa këndej plot me nxitim. Ata ishin veshur me frakë të zinj dhe mbanin në qafë papionë të bardhë. Një zhurmë e fortë e zërave e shponte ajrin. Nga jashtë njerëzit i shihnin ata nëpërmjet dritareve, pasi pozita e tyre shoqërore nuk i lejonte të futeshin brenda.

Pikërisht në mesnatë mikëpritësi, Akhineyev, u nis për te kuzhina për të parë, nëse çdo gjë ishte gati për darkën. Kuzhina ishte mbushur me tym, që nga dyshemeja në tavan. Kundërmonin erërat e patave dhe rosave të pjekura, si edhe shumë gjërave të tjera. Ushqimet dhe pijet ishin shpërndarë thuajse në dy tavolina në një çrregullim artistik. Marfa, kuzhinjerja, një grua faqekuqe, e hollë dhe e fortë ishte njeriu më i zënë me punë në atë mbrëmje.

-Pa më trego peshkun tim, blin të madh e dashur,- i tha Akinejevi, duke fërkuar duart dhe duke lëpirë buzët.

-Çfarë ere e mirë që vjen këtu. Unë mund të përlaj krejt guzhinën. Mirë atëherë, lermë të shoh peshkun.

Marfa hypi sipër një stoli dhe ngriti me kujdes njerën prej gazetave të lyrosura. Poshtë letrës, në një pjatë tejet të madhe shtrihej një peshk i madh, një blin i majmë midis karrotave dhe ullinjve. Akhineyev e pa me zili blinin dhe mori frymë i lehtësuar, i shkëlqeu fytyra dhe i shndritën sytë. Ai u përkul dhe, duke e prekur me buzë, lëshoi një

zë si kërcitja e një rrote. Ai qëndroi pak ashtu pastaj i kërciti gishtat nga kënaqësia dhe i lëpiu buzët edhe njëherë.
-Plluq, plluq! A ishte kjo zhurma e një puthje zemre? Kë po puthje ti aty, Marfusha,- u dëgjua zëri i dikujt nga dhoma ngjitur dhe shpejt koka e qethur e Vankinit, ndihmës–instruktorit të shkollës, u duk te dera e jashtme.
-Kë po puthje ti këtu? A-a-ah! Shumë mirë! Sergey Kapitonich! Një burrë plak i këndshëm në fakt. Me një femër kokë më kokë?!"
-Nuk isha duke puthur fare,- iu kthye Akhineyevi, i ngatërruar.
-Kush jua tha këtë mor budalla? *Unë veç sa e preka pllaq - plluq me buzë, për kënaqësinë time. Unë veç sa i mora erë peshkut.*
-Tregoja këtë dikujt tjetër jo mua!
Vankini, fytyra e të cilit u zgjerua në një ngërdheshje të madhe dhe u zhduk pas derës. Akinejvi u skuq i tëri.
-Një djall e di se çfarë do më dalë prej kësaj, - mendoi ai.
Ai do të sillet sikur ka tërë botën të vetën. Maskarai! Ai do më çnderojë përpara tërë qytetit, shtaza.
Akinejevi hyri në korridor ngadalë dhe hodhi një sy dinak, për të parë se çfarë po bënte Vankini. Vankini qëndronte pranë pianos dhe ishte përkulur, duke pëshpëritur tek kunata e inspektorit, e cila po qeshte.
-Kjo ka të bëjë me mua! - mendoi Akinejevi.
Për mua, djalli e marrtë! *Ajo i beson atij prandaj po qesh. Ej Zot! Jo, jo kjo nuk duhet lënë kështu. Më duhet ta rregulloj këtë punë në atë mënyrë që askush mos ta besojë atë. Do të flas me të gjithë dhe më në fund kjo do të mbetet një thashethem idiotik.*
Akhineyevi e kruajti kokën dhe siç ishte i ngatërruar vajti te Padekoi.
-Isha në kuzhinë pak më parë duke u marrë me punët e darkës - i tha një francezi.
E di që juve ju pëlqen peshku dhe unë kam një blin kaq të madh. Është gati dy jard i gjatë. Ha, ha, ha! Po se gati harrova. Ka një anekdodë për atë blin në kuzhinë. Pak më parë hyra në kuzhinë dhe desha të shihja se si po përgatitej darka. I hodha një sy të shpejtë peshkut dhe nga kënaqësia i vura buzët pllaq-plluq mbi të. Ishte shumë pikant. Pikërisht në atë çast ai budallai Vankini hyri dhe bërtiti: "Oh, shih shih,! Ju po putheshit këtu me Marfën ë?" Vetëm ta mendosh, këtë, me kë? Me kuzhinieren!? Çfarë sajese e një kokëtrashi! Ajo grua është aq e shëmtuar, sa duket si një gomare, ndërsa ai thotë se unë po e puthja. Çfarë njeriu dyshues!
-Kush është ai dyshues?- pyeti Tarantulovi, i cili iu qas atyre.
-E kam fjalën për Vankinin. Shkova dhe e pashë kuzhinën…
Historia e Marfës dhe peshkut u përsërit.
-Ajo më bën të qesh. Çfarë dyshuesi që është. Sipas meje, është më e këndshme të puthësh qenin, sesa Marfën,- shtoi Akhineyevi dhe, kur ktheu kokën, pa Mazdan.
-Po flisnim për Vankinin,- i tha ai atij.
Çfarë njeriu dyshues! Ai hyri në kuzhinë dhe vuri re që po qëndroja ndanë Marfës dhe menjëherë filloi të sajonte përralla të ndryshme.
-Çfarë tha ai, se ju po puthnit njëri-tjetrin? - Ishte i dehur, kështu që mund të ketë qenë edhe në ëndërr. Aha! Unë më mirë puth një patë, sesa të puth Marfën, ndërkohë që unë kam grua, - i thashë unë. Ju jeni budalla, ai më bëri të dukem si njeri i trashë.
-Kush ju bëri ju të dukeni si njeri i trashë?"- deshi të dinte mësuesi i fesë, duke iu

adresuar Akhineyevit.
-*Vankini. Unë po qëndroja në Kuzhinë dhe po e shihja peshkun.*
Kështu filloi kjo histori dhe në një hark të shkurtër kohor prej gjysmë ore tërë krushqit e morën vesh historinë e Vankinit dhe të peshkut blin.
-*Tani le t'i tregojmë atij*, - mendoi Akhineyevi, duke fërkuar duart. *Ta lemë ta bëjë ai këtë. Ai do të fillojë t'u tregojë atyre dhe ata do t'ia presin shkurt, pasi e dinë se çfarë ka ndodhur.*
-*Mos fol marrëzira, budalla! Tërë e dinë tashmë atë histori.*
Akhineyevi u ndie i lehtësuar prej gëzimit dhe piu katër gota konjak të mbushura plot e përplot.
Atë e mori e bija te dhoma e saj dhe ra menjëherë në gjumë si fëmijë i pafajshëm.
Kur u zgjua, as që i kujtohej ajo që kishte ndodhur, historia e peshkut.
Por jo, nuk ishte e thënë. Ne njerëzit flasim, Zoti i Madh qesh me ne. Gojët e liga bëjnë punë e tyre, kështu që as dredhia e Akhineyevit nuk bëri efekt.
Një javë më vonë, një të mërkurë, pas orës së tretë të mësimit, Akhineyevi po qëndronte në sallën e mësuesve dhe po diskutonte prirjet e egërsuara të një nxënësi të quajtur Visjekin. Drejtori iu afrua dhe pasi i bëri me shenjë e mori mënjanë.
-*Shiko këtu, Sergei Kapitoniç*," - i tha drejtori,
Do më falësh, pasi kjo nuk është puna ime, por gjithsesi më duhet ta sqaroj, pasi prapëseprapë edhe kjo është detyra ime. Ju e shihni, thashethemet kanë marrë dhenë për një *marrëdhënie intime tënden me atë gruan, kuzhinieren tënde. Nuk është detyra ime, por ju mbase jeni në marrëdhënie intime me të, ju edhe mund ta puthni atë, mund të bëni çfarëdo që të dëshironi, por të lutem mos e bëjë këtë kaq hapur. Të lutem mos. Mos harro se je edukator.*
Akhineyevi mbeti i shtangur si një cung i zi, sikur i ishte hedhur një kovë me ujë të valë në fytyrë. Uli kokën dhe u nis për shtëpi.
Gjatë rrugës iu duk se tërë qyteti e shihte vetëm atë si njeri i lyer me zift. Nuk mjaftonte kjo, pasi në shtëpi e prisnin telashe edhe më të mëdha.
Pse nuk ha asgjë, - e pyeti e shoqja në darkë.
Çfarë po mendon? A po, mendon *për Kupidin ti ë? Të ka marrë malli për Marfushkën. Tani kam marrë vesh çdo gjë, për ty. Njerëzit e mirë m'i hapën sytë, për ty barbar*!
Ajo ia futi me shpullë në faqe.
U ngrit nga tavolina dhe pa një pa dy, pa kapele në kokë dhe pa pallto veshur u nis drejt Vankinit.
E gjeti në shtëpi.
-*Maskara*, - iu hakërrye.
Përse më ke baltosur para tërë botës? *Pse ke shpifur për mua*?
-*Për çfarë shpifje e ke fjalën, çfarë po thua*?
-*Po kush i tregoi gjithë njerëzisë se unë po e puthja Marfën*? *A nuk ishe ti*? *Nuk ishe ti mor vrasës*?
Vankini i kapsalliti sytë dhe krejt damarët e fytyrës filluan t'i fryhen e t'i rrihnin me shpejtësi.
Ia nguli sytë Akhineyevit dhe shpërtheu në be e në rrufe:
-*Zoti më vraftë, mos i paça sytë e ballit, nëse kam thënë qoftë edhe një fjalë të vetme për këtë punë te kushdo qoftë. Mbetsha pa shpi e katandi, nëse kam folur për këtë çështje*

qoftë edhe një herë!
Sinqeriteti i Vankinit nuk linte vend për të dyshuar. Dukej qartë se nuk ishte ai që e kishte përgojuar.
-*Po kush paska qenë, kush*,- Akhineyevi e pyeti vetveten, duke i sjellë ndërmend tërë shokët e tij dhe duke goditur gjoksin e vet.
Kush paska qenë ai !

Ivan Turgenjev [172]

Në radhën e shkrimtarëve rusë, Bernsteini zgjedh edhe Ivan Turgenjevin me tregimin e tij të dhimbshëm:

Takimi
(The rendezvous, Сближение)

Në vitin 1907 Bernsteini i dhuron lexuesit në gjuhën angleze një ndër kryeveprat e autorit të madh rus, Ivan Turgenjevit, me titull "*Takimi*[173]". Në rusisht tregimi titullohet Сближение, ndërsa në anglisht do të përkthehej fjalë për fjalë "*The meeting*". Por Bernsteini, si përkthyes i madh që ishte, e quan atë "Rendezvous", nga frëngjishtja e përdorur edhe në anglisht pikërisht në kontekstin e përmbajtjes që ka tregimi: Takim midis dy njerëzve të dashur.

Për një lexues të lirshëm të gjuhës angleze tregimi "*Takimi*", ashtu siç e ka sjellë Bernsteini është një vepër brilante, e mrekullueshme. Ajo jep një pamje magjike, një pikturë të mahnitshme të natyrës, sikundër edhe një dramë të brendshme tronditëse të çarjes së dhimbshme të ndjenjave midis një të pasuri dhe një të varfëre. I tillë është edhe kontrasti midis natyrës dhe njeriut në tregim. "*Takimi*", i cili në fakt është ndarja e Aleksejoviçit me Akulinan, përmban një dramë të dhimbshme të shpërdorimit të sinqeritetit të një femre nga një aventurier. Ngjarja është pak a shumë e tillë:

Turgenjevi e përshkruan natyrën me gojën e një gjahtari që e ka parë ngjarjen. Përkthimi i Bernsteinit e paraqet me aq detaje të hollësishme, sa lexuesit i duket sikur jeton në mes të atij pylli të bukur vjeshtor me ngjyrat e natyrës dhe cicërimat e zogjve, që tingëllojnë si zile të vogla metalike në mes të pyllit. Gjahtari e kalon natën në pyll, derisa zgjohet në mëngjes. Ai papritmas sheh sesi një vajzë e bukur, e veshur me rroba të reja të kopsitura deri në fyt, me një tufë lule në duar vjen dhe ulet në një trung në mes të një zabeli në pritje të dikujt.

Autori e ka vënë natyrën në gjendjen e saj më të mrekullueshme, si sfondin e një takimi dramatik, ku nuk ka as luftë, as betejë, as duel, as përplasje fizike. Ka vetëm dramë ndjenjash, përplasje emocionesh, dashuri të sinqertë nga ana e vajzës dhe mospërfillje dhe megallomani nga ana e djalit. Ai vjen t'i tregojë asaj se do ta takojë përsëri pas një viti, ose edhe më vonë, pasi punëdhënësi i tij e kërkon, që të shkojë në Shën Petërsburg e ndoshta edhe jashtë vendit. Vajza e ndrojtur i lutet atij të mos e harrojë. I lutet që t'i thotë vetëm një fjalë, vetëm një fjalë, një fjalë dashurie. Vajza jetime e tronditur nga ndarja dhe mospërfillja nuk kërkon asgjë më shumë, vetëm atë fjalë, të cilën ai ja kursen pamëshirshëm. Akulina nuk e mori atë fjalë magjike që priste nga Viktori. Në vend të asaj fjale, ajo sheh shpinën e tij tek largohej me vrap pa as më të voglën keqardhje. E pa vetveten, një krijesë të pafajshme që u braktis në mes të pyllit. Ajo bie përtokë, qan dhe më pas e rimerr veten. Gjahtari e vëzhgon tërë skenën dhe sheh me keqardhje lulet e Akulinas të destinuara për Viktorin, të mbeteshin të shpërndara në lëndinën e pyllit. Ai i merr ato dhe thotë se i ruan, edhe pse janë tharë ende sot e kësaj dite...

Bernsteini gazetar i famshëm investigativ. Revolucioni bolshevik i tetorit dhe telegramet "Willy - Nicky"

Bernsteini gazetar dhe poet me reputacion të madh ndërkombëtar, fitoi famë edhe për arritjet e tij në gazetarinë investigative. Ai u prir të zbulonte veprimet totalitariste ruse, pa marrë parasysh, nëse ishin cariste a bolshevike, veçanërisht për ato që ndikonin te fati i hebrejve rusë. Raportet e tij zbuluan përfshirjen e policisë sekrete ruse në rastin e Mendel Belilis[174], një hebre gabimisht i akuzuar për vrasjen e një fëmije jo hebre në vitin 1911. Ai gjithashtu dokumentoi kushtet shoqërore dhe politike të Rusisë para dhe pas Revolucionit komunist.

Më pas Bernsteini shkruajti për *New York American* dhe *Brooklyn Eagle,* shpesh duke raportuar nga Europa dhe nga Rusia.

Por kulmin e tij si gazetar investigativ ai e arrin me zbulimin e korrespendencës së fshehtë midis Kaizerit të Prusisë dhe Carit të Rusisë. Kjo ndodhi në vitin 1918. Bernsteini e publikoi atë në një libër me titull "*Korrespendenca Willi – Nicki*", e cila u publikua nga Knopf [175], me një parathënie prej ish presidentit amerikan Theodore

Roosevelt.

Bëhej fjalë për një pako mesazhesh të shkëmbyera midis Wilhelmit II, Perandorit Gjerman dhe Nicholas II, Cari i Rusisë, në vigjilje të Luftës së Parë Botërore, nga gushti 1904 -1907.

Kaizeri Vilhelm II dhe Car Nikolla II ishin kushërinjë të tretë (të dy ishin stërnipa të Paulit të Rusisë) dhe Kajzeri ishte kushëriri i parë i gruas së Nikollas, Alixit të Hesses-it.[176]. Perandorët i shkruanin njëri -tjtrit në anglisht dhe ishin mësuar ta thërrisnin njëri-tjetrin miqësisht Willy dhe Nicky.

Në komunikimin formal ata përdorinin emrat e tyrë të plotë. Burimi i telegrameve është Libri i Bardhë Gjerman (Das Deutsche Weißbuch[177]), një pamflet i dokumenteve zyrtare të publikuara, për të justifikuar pozicionin e qeverisë gjermane para shpërthimit të Luftës së Parë Botërore. Telegramet shkëmbeheshin midis dy Perandorëve madje edhe pa dijeninë e Ministrave të Jashtëm të dy Perandorive. Një ndër ngjarjet më tragjike, rezultat i kësaj korrespondence të fshehtë e komplotuesve, është mbytja e anijes trans-oqeanike *Lusitania*. Ajo u bë viktimë e këtyre intrigave në Luftën e Parë Botërore. Më 7 maj 1915 anija Lusitania u godit me silur në brigjet jugore të Irlandës prej një nëndetseje gjermane, ose siç quheshin atëherë u-boat, U-20. Anija u mbyt brenda 18 minutash dhe mori me vete 1198 të vdekur.

Telegramet Willy – Nicky u diskutuan gjatë luftës prej përfaqësuesve të vendeve ndërluftuese, gjatë Konferencës së Paqes në Paris dhe në vitet e ndërmjetme të luftës dhe më tej. Kontributi i Herman Bernsteinit qëndron edhe te fakti që këto telegrame janë bërë objekt studimi për historianët e kohëve të mëvonëshme.

Bernsteini e përmbledh përmbajtjen e tyre si vijon:

> Gjatë qëndrimit tim të kohëve të fundit në Rusi, mësova se menjëherë pas shfronëzimit të Carit u zbuluan një seri telegramesh sekrete, intime në arkivat e fshehta të Nikolla Romanovit në Tcarskoje Selo[178]. Korrespendenca e plotë, e cila përbëhej prej gjashtëdhjetë e pesë telegramesh të shkëmbyera midis perandorëve gjatë vitit 1904, 1905, 1906 dhe 1907, përbëjnë një pamje të jashtëzakonshme të hipokrizisë dhe dhunës, të sajuara prej njerëzish përgjegjës për luftën më të tmerrshme në historinë e njerëzimit. Dokumentet, të fshehura edhe prej vetë ministrave të jashtëm të të dy perandorive, përbëjnë aktakuzën më të rëndë ndaj sistemit të qeverive, të kryesuara prej këtyre dy perandorëve të njejtë.
>
> Kajzeri është ekspozuar si një mjeshtër intrigant dhe komplotist mefistofelian për dominimin e Gjermanisë mbi botën, ndërsa ai tjetri, Cari, zbulohet si kapriçioz, i dobët, njeri pa karakter, pa ngjyrë e identitet. [...] Ata të dy flisnin për paqe dhe të dy komplotonin kundër saj.

Ndërsa librin ua kushton: *"Të gjithë atyre të cilët punojnë ta bëjnë botën të sigurt, demokratike me paqe të qëndrueshme dhe një vend të drejtë për të gjithë"*.

Bernsteinit i ranë në dorë këto telegrame sekrete, falë punës së disa miqve të tij, përfshirë profesorët Tarle dhe Bourtseff, dy historianë të revolucionit. Ajo që e bën më të vlefshëm botimin e këtyre telegrameve është parathënia që ka shkruar për të Theodore Roosevelt[179], në një letër në të cilën shkruhet si më poshtë:

> I dashur Bernstein!

Dua t'ju falënderoj për shërbimin e jashtëzakonshëm, që i keni bërë njerëzimit me zbulimin dhe publikimin e këtyre letrave. Ato ndriçuan si një dritë që shkëlqen mbi skutat e errëta të diplomacisë së despotëve dhe tregojnë se çfarë diplomacie është ajo e vendeve autokrate në të vërtetë, çfarë kanë bërë ata dhe duan të bëjnë deri në kohën e sotme. Tërë bota duhet të kuptojë tani se despotizmi i Gjermanisë ishte i shoqëruar me komplote dhe intriga, me brutalitet të pamëshirshëm dhe barbarizma. Aty, në mënyrën më cinike mungojnë tërësisht ndjenjat morale të sjelljes në marrëdhëniet ndërkombëtare, ku mungon plotësisht besimi, aty shihet se si ata kërkonin të bashkëpunonin kukullat e dobëta e djallëzore. Në këtë rast ato mishërohen te despotizmi i Rusisë.

Këto letra duhet t'i bëhen të njohura tërë popujve të civilizuar. Ato tregojnë marrëzinë e njeriut, i cili dëshiron që të besojmë se shpëtimi nga monarkia në Rusi mund të vijë me rivendosjen e autokracisë. Kjo e fundit në vetvete ishte vetë shkaku i asaj anarkie. Kushtet qeverisëse ishin kaq të patolerueshme, saqë ato e vendosnin dhunën e jashtligjshme, që prodhon ajo kundër atyre, që e duan lirinë dhe që kërkojnë një rend të drejtë e të ndershëm për të gjithë. Ata për më tëpër tregojnë marrëzinë e pabesë të tërë atyre, të cilët tani gostiten me despotizmin gjerman për një paqe të arritur me bisedime, një paqe pa fitore, një paqe në të cilën keqbërësit dhe ata që e pësojnë keqbërjen vihen në kushte të barabarta. Kjo luftë u bë prej autokracisë ushtarake dhe kapitaliste gjermane dhe ajo ishte pranuar në heshtje dhe madje promovuar prej palës socialiste gjermane, e cila që këtej e provoi veten tradhëtare ndaj punëtorëve dhe bujqve të botës. Me këto dokumente përpara, asnjë amerikan i cili deri tani, drejtpërdrejt ose jo, mbështeste Gjermaninë e prusianizuar të Hohenzollernëve nuk mund të pretendojë të besojë te të drejtat e njeriut, për barazi para ligjit ose për lirinë e kombeve të vogla fisnike. Me lejo të përsëris, i dashur zotëri, që me publikimin e këtyre letrave ju i keni bërë një shërbim të madh, jo vetëm vendit tonë por mbarë njerëzimit.

Shumë sinqerisht i juaji,

Theodore Roosevelt
Presidenti i 26 - të i ShBA – ve (1901-1909)

Henry Ford - beteja ligjore e fituar e Herman Bernsteinit kundër tij

Edhe pas shumë vitesh e dhjetëvjeçarësh, Herman Bernsteini[180] studiohet nga personalitete të shquara në SHBA. Një ndër to është Victoria Woeste, autore e librit "*Lufta e Henry Fordit kundër hebrejve dhe beteja ligjore kundër fjalimit të tij*", libër në të cilin shpjegon përpjekjet dhe fitoren e Herman Bernsteinit kundër Henri Fordit. Ky i fundit kinse në një udhëtim me anije të quajtur "Peace Ship" për Europë, kishte takuar Bernsteinin. Henry Fordi thotë:

Arsyeja e vërtetë se përse e botova këtë artikull është se mora si burim

> informacioni ato që më tha një hebre i quajtur Herman Bernstein, gjatë udhëtimit tonë nëpër oqean me anije. Ai më tha se, nëse do të donim t'i jepnim fund luftës, mënyra për ta bërë atë ishte të shihnim çfarë bëjnë financierët hebrej, të cilët e krijuan atë. Unë luajta të padituri dhe e lashë të vazhdonte. Ai më tha të shumtën e atyre gjërave që kam botuar.

Kjo u kundërshtua ashpër nga Bernsteini, i cili doli hapur kundër Fordit. Kjo betejë u bë objekt i shtypit amerikan për shumë kohë. "*Evening Post"* dhe ajo "*Herlad"* botuan shkrime me përgjigjet e Bernsteinit. Ai i hyri një beteje ligjore, të cilën e fitoi më në fund, duke mposhtur Henry Fordin. Nga kjo betejë e humbur, Fordi i pagoi si gjobë Bernsteinit 200 mijë dollarë amerikanë. Më pas Fordi i kërkoi ndjesë dhe ishte ai që e rekomandoi dhe pranoi emërimin e tij Ambasador në Tiranë[181].".

Në fakt, fitorja e Bernsteinit ndaj Fordit ishte fitore e lirive dhe të drejtave të njeriut, e të drejtave të minoriteteve dhe grupeve të vogla, si dhe një fitore mbi gjuhën e urrejtjes.

Bernsteini intervistues i figurave më të shquara të kohës së tij

ME MENDJENDRITURIT[182]

Një ndër veprimtaritë më të spikatura të Bernsteinit është gazetaria. Në një moshë të re ai arriti të bëhej personalitet i tillë, saqë të merrte intervista nga njerëzit më të mëdhenj të kohës, që jetonin në Europë dhe në Rusi. Mjafton të përmendim këtu Leon Tolstoin, George Bernard Shoun, Auguste Rodin, Henri Bergson, Papa Benediktin XV, Pjetër Kropotkin, Leon Trockin, Chaim Weizman, Sheik-Ul-Islamin, Hevelok Ellisin, Romain Roland, Albert Ajnshtajnin, Theodore Roosevelt, Woodrow Wilson etj.

Në këto intervista Bernsteini nxjerr në pah shqetësimet e këtyre njerëzve të mëdhenj të kohës, konceptet për politikën, artin, shkencën, estetikën, luftën, revolucionin, por si një hebre i përbetuar, ai nuk harron asnjëherë të përmendë çështjen e popullit të tij të shpërndarë nëpër botë. I njohur që në atë kohë si luftëtar i çështjes hebraike dhe një ndër korifejtë, që vunë bazat e shtetit të ardhshëm izraelit, ai kërkon të dijë mendimin e tërë të intervistuarve rreth kësaj çështjeje.

Intervistat e Herman Bernsteinit me këto figura e tejkalojnë interesin thjesht historik. Prej tyre sot mësojmë se si bota po shkonte drejt dy luftrave botërore dhe se si çështja hebraike do të evoluonte deri tek ajo që u quajt *Holokaust*, *Shoah* në hebraisht, apo *Zgjidhja Përfundimtare,* sipas nazizmit. Dukej se ky njeri i madh e ndjente rrezikun, që e priste popullin e vet. Intervistat janë botuar në ente të ndryshme botuese amerikane për të ardhur te një libër i quajtur "*Me mendjendriturit*", Herman Bernsteini dhe njerëzit e famshëm të kohëve tona.[183]

Nga intervistat me këto personalitete të kohës është me interes të shohim disa prej koncepteve më të zgjedhura dhe më brilante të bisedave të tij me ta. Ja si shprehet Bernsteini në hyrjen e librit të tij "*Me mendjendriturit"*:

> Unë i kam përvetësuar teoritë shkencore më moderne, sepse m'i ka shpjeguar Metchnikof, kam diskutuar për fenë dhe për artin me Leon Tolstoin, parimet e filozofisë moderne më janë dhënë nga Henri Bergson, diplomacinë botërore dhe çështjet ruse m'i kanë analizuar Konti Witte dhe Maksim Kovalovski, teorinë e artit ma mësoi August Rodin, shtetformimin Theodore Roosevelt dhe Woodrow Wilson, mbrojtjen e të drejtave të grave Havellock Ellis, imperializmin gjerman Hans Delbrueck, literaturën dhe pacifizmin Georg Brandes, politikën e luftës dhe paqes së Vatikanit Papa Benedikti i IX, Islamin ma shpjegoi Sheik-Ul -Islami, i cili shfronësoi Abdyl Hamitin, sionizmin ma mëkoi Nordaut Weizman dhe Albert Ajnshtajn (Albert Einstein), Revolucionin Rus ma shpjegoi Trocki, libralizmin britanik e mësova nga Lordi Robert Cecil, dramën kontinentale e pashë tek Arthur Schnitzler, historinë e Japonisë ma tregoi Maruqis Okuma dhe gjithçka tjetër ma nguliti në tru George Bernard Shaw....

Që nga ky paragraf hyrës të krijohet ideja e një teksti me vlera të rralla, disa pjesë të të cilit janë përkthyer më poshtë për kënaqësinë e lexuesit.

Leon Tolstoi [184]



42 Skicë e portretit të Leon Tolstoit, botuar në librin "Me Mëndjendriturit" shkruar nga Herman Bernstein

Bernsteini merr pjesë në një konferencë të përfaqësuesve më të shquar të shtypit rus të mbledhur për të festuar sa më bukur datëlindjen e tetëdhjetë të Tolstoit. Të rinj dhe të vjetër, burra e gra, që merrnin pjesë, bënin përpjekje se si ta festonin sa më me madhështi përvjetorin e "*krenarisë së vetme që i kishte mbetur popullit rus*". Ata flisnin me entuziazëm të pakufishëm, me zjarrin, me zellin dhe thjeshtësinë me të cilën një popull i skllavëruar, papritmas çlirohet dhe flet për lirinë. Një nga të rinjtë u ngrit dhe tha se 28 gusht, që është datëlindja e Tolstoit, duhet të jetë dita, kur të ndërpritet dënimi masiv me vdekje në Rusi.

Nga Shën Petërsburgu, Bernsteini niset për në Yasnaya Polyana, për të takuar Leon Tolstoin. Po atë ditë, ai mëson nga shtypi se një shoqatë me emrin e Leon Tolstoit ishte ndaluar të regjistrohej.

"Përpara se të nisesha për Yasnaya Polyana,- thotë Bernstein- profesor Maxime Kovalevsky, një prej botuesve më të shquar dhe autoritar në të drejtën ndërkombëtare më tha: "*Po shkoni të shihni të vetmin njeri në Rusi, i cili guxon të thotë të vërtetën, madje edhe përpara Carit e që nuk dënohet për këtë.*"

Rrugës në tren ai takon një prift, të cilit i tregon se ku do të shkonte. Nëpërmjet kësaj bisede lexuesi mëson thuajse tërë gjendjen e Rusisë së kohës. Prifti i thotë:

> Qenkeni njeri i lumtur që do ta shihni njeriun më të shenjtë të Rusisë. Kur ta takosh, i thuaji se keni takuar një prift fshati, i cili i dërgon atij përshëndetje nga zemra. I thuaj se prifti, që takova u përkul i turpëruar për mënyrën se si e kanë trajtuar Tolstoin. Po ashtu, thuaj atij se gjithë fshatarët rusë ,që kanë mësuar sado pak shkrim e lexim, nuk lexojnë asgjë tjetër përveç Biblës dhe librave të Tolstoit. Ata madje e kuptojnë veprën e tij më mirë se Biblën.

Bernsteini arrin përpara shtëpisë së Tolstoit dhe takohet me Nicholas Gusev, sekretarin e tij, i cili e çon atë drejt dhomës së shkrimtarit të madh. "*Burri më i madh qenka edhe më i thjeshti në këtë botë*" - thotë me vetë Bernsteini. Në fund të dhomës, si një portret vezullues i Rembrandit gjendet i ulur plaku, me një turban të butë të zi mbi kokë, me sy të mëdhenj të shndritshëm plot mirësi. Bernsteini kurrë nuk kishte parë ndonjë portret ose fotografi të Tolstoit.

Ata takohen dhe shkëmbejnë fjalë njohjeje. Gjatë bisedës, Tolstoi i thotë Bernsteinit se ndërprerja e ekzekutimeve në Rusi do të ishte veprimi që do e kënaqte atë më shumë se çdo gjë tjetër.

Ndërsa ai fliste, Bernsteinit iu kujtuan fjalët e Rjepinit:

"*Ky njeri nuk i përket kësaj bote.*"

Më pas ai e pyet Kontin: "Kont, a mund ta di mendimin tuaj për të ardhmen e Rusisë?"

Tolstoi i përgjigjet se një prej paragjykimeve më të tmerrshme, më të dëmshme se të gjitha fetë, ajo që ka shkaktuar lumenj gjaku, është paragjykimi i çuditshëm, i cili u shpërnda me dhunë dhe që i bën njerëzit të besojnë se vetëm një numër i vogël njerëzish tani është i aftë të ndërtojë jetën sociale të gjithë shoqërisë. Më pas ai shton se, ndërsa Revolucioni frëng nxori në skenë Napoleonin, Lufta Civile prodhoi problemin e tmerrshëm të zezakëve në Amerikë.

Tolstoi flet për emancipimin e bujkrobërve rusë, proces që kishte filluar pesëdhjetë vjet më parë dhe që nuk kishte përfunduar ende. Ai flet për qindra të ekzekutuar të dyshuar për tentativë vrasje ndaj Car Nikollës II dhe për zgjidhjen e vetme që kishte Rusia që ishte çështja e pronësisë mbi tokën. Ai i flet për idetë e Henry George[185], të shpallura disa dhjetëvjeçarë më parë, të cilat bazuar në teoritë e tij mund ta shpëtojnë edhe Rusinë, më së shumti bazuar në teoritë e tij për shpërndarjen e pronësisë mbi tokën. *"Drita shndrit më shumë në errësirë, ndërsa errësira nuk e pengon dot dritën. Në një Rusi, ku nëntë në dhjetë vetë janë bujqër dhe, kur vendi është në prag të revolucionit, vetëm ide të tilla mund ta shpëtojnë vendin nga katastrofa,"* - thotë Tolstoi.

Bernsteini e pyet Tolstoin se cila ishte vepra artistike më e rëndësishme e jetës së tij tani që po shkruante librin "*Unë nuk mund të heshtë*", në të cilën ai flet për varjet dhe ekzekutimet e përditshme në Rusinë e kohës së tij. Dhe ai përgjigjet: "*E konsideroj veprën time si të parëndësishme. Veprat e mia më të rëndësishme janë ato, që kanë të bëjnë me subjektet fetare, me shkrimet rreth të cilave jam marrë gjatë dhjetë vitet e fundit.*".

Bernsteini e pyeti Tolstoin në lidhje me veprat e tij artistike të dhjetë viteve të fundit dhe mori këtë përgjigje: *"Ndoshta ju i referoheni "Ringjalljes". Po është e rëndësishme, pasi e trajton fenë në vetëperfeksion. Atë që e quajmë vepër artistike është art i aristrokacisë. Prandaj unë jam kundër tij. Më shumë më pëlqen vepra "Wise Thoughts for Every Day"[186], me të cilën merrem çdo ditë*".

Më pas i kërkohet një mendim rreth letërsisë ruse të kohës së tij dhe ai përgjigjet:

> Unë kam një mendim shumë të varfër për të. Po lexoj një libër të Pushkinit. Zot i Madh çfarë rënie e tmerrshme është shënuar që nga Pushkini deri tek shkrimtarët e sotëm! Kur mendoj për shkrimtarët rusë, unë ndalem te Dostojevski, Turgenevi, dhe Ostrovski. Çehovi ishte shkrimtar i këndshëm, mjeshtër i madh i ironisë, por vepra e tij nuk është mjaftueshmërisht substanciale. Asaj i mungon ndjesia e thellë.
>
> Prerja në pjesë më të vogla përcaktohet nga numeratori. Sa më e madhe të jetë prerja, aq më e vogël është pjesa. Nëse prerja është zero, nuk ka rëndësi se cili është numëratori. Rezutati do të jetë po ashtu zero. Shkolla dekadente e letërsisë në Rusi, sikundër edhe në vende të tjera, përbëhet prej asgjësë, përveçse mendjemadhësisë dhe kjo është prerja, e cila i redukton ata në zero. Ibseni, Oskar Wilde dhe të tjerët (Tolstoi numëron shumë shkrimtarë francezë anglezë dhe amerikanë), janë të gjithë dekadentë, të gjithë të fryrë me mendjemadhësinë e tyre të pafund. Kur lexoj Pushkinin, në të lexoj modestinë dhe bukurinë në çdo rresht. Kur lexoj shkimtarë anglezë dhe amerikanë, unë pa dashje mendoj për Dikensin dhe Thekerin dhe krahasimi është fatal me shkrimtarët e rinj.

Ekziston një thënie, shprehet Tolstoi: "*Duhet të mirëprisni opinionin e njerëzve të marrë, sepse ata përbëjnë përherë shumicën.*".

Në atë takim Bernsteini pyeti për shumë tema të jetës dhe letërsisë në Rusi, por nuk harroi të trajtonte çështjen e hebrejve, aq shumë të shtypur në Rusi.
Tolstoi iu përgjigj:

> Herzen tregon historinë e një zënke të një të krishteri grek, të një katoliku romak dhe të një protestanti. Greku thoshte se të gjitha shtrigat vijnë nga Kievi. Katoliku romak e mohonte se ato vijnë nga Kievi. Ato vijnë nga Tchernigovi,- ngulmonte ai. Protestanti betohej se nuk vijnë as nga njëri vend e as nga tjetri, por nga Vollga. Atëherë atij i kërkuan, që ta zgjidhte këtë çështje vetë Herzeni dhe ai iu përgjigj: Nuk mund ta zgjidh sepse unë nuk besoj aspak te shtrigat. Kështu,- i thotë Tolstoi Bernsteinit, - as unë nuk besoj te çështja hebraike në këto çështje kombëtare dhe politike.
>
> Nuk ka çështje hebraike, po aq sa nuk ka çështje gjermane, ruse apo polake. Unë nuk iu besoj trillimeve për hebrejtë, aq sa nuk ju besoj përrallave për shtrigat, të cilat dikush thotë se vijnë nga Kievi, të tjerët nga Vollga, dikush tjetër nga Tchernigovi.[187]

Pas kësaj Bernsteini thotë se ata u ngritën dhe vajtën të flenë. Tolstoi i thotë atij: "*Po, po, po plakem dhe dobësohem. Fundi im po afron. Por sa më i vjetër bëhem, aq më i lumtur ndjehem. Ju nuk e kuptoni këtë. As unë nuk e kuptoja këtë kur isha i ri. Por, sa më shumë plakem aq më shumë lumturohem.*".

Ishte qershori i vitit 1908 dhe në atë kohë Bernsteini ishte vetëm 32 vjeç, kur zhvillonte një bisedë të tillë me të madhin Leon Tolstoi.

Konti Sergius Witte [188]

43 Skicë e portretit të *Konti Sergius Witte*, botuar në librin "Me Mëndjendriturit" shkruar nga Herman Bernstein.

Në intervistën me Kontin Sergius Witte, konstitucionalisti më i madh rus i të gjitha kohërave, në mes të tjerash, Bernsteini flet edhe për çështjen e hebrejve, duke marrë këtë përgjigje: *"Hebrejtë nuk duhet të lejohen të blejnë tokë edhe për 25 vjet, në mënyrë që mos të bëhen objekt i sulmeve të rusëve. Me një fjalë, e vetmja mënyrë për t'i përmirësuar kushtet e hebrejve në Rusi është t'u jepen atyre të njëjtat të drejta që gëzojnë edhe vetë rusët."*

44 Metchenikof [189]



Në intervistën me Metchenikof, i cili është gjithashtu hebre, Bernsteini ndalet edhe te pikëpamjet e tij për fenë: "*A mund të di pikëpamjen tuaj në lidhje me fenë*?" "*Unë jam ateist, siç e shihni në studimet e mia "Studimet mbi optimizmin". Fakti që shumica e njerëzve besojnë në zot dhe në ekzistencën e botës së përtejme bazohet jo mbi instinktin fetar, por mbi shkallën e arsimimit. Ja pse ne shpesh shohim që njerëzit, të cilët në fëmijërinë e tyre besojnë në atë që ata janë mësuar të besojnë, me kohë e humbin atë për shkak të ndriçimit të mendjes."*

Në lidhje me çështjen e trajtimit të hebrejve ai i përgjigjet kështu këtij partizani të mbrojtjes së kombit të vet: *"Jam krejt i sigurt se do të ketë një ndryshim edhe në këtë. Qeveria ruse do t'i kuptojë gabimet e saj dhe do t'i përmirësojë kushtet e hebrejve për hir të vetvetes, nëse jo për arsye të tjera."*

"*Kur e lashë Institutin Lui Paster, mora me vete një përshtypje të thellë të një personaliteti të fortë të thjeshtë dhe të dashur, një apostulli të optimizmit që e ka bërë fenë shkencë, njësoj sikundër Tolstoi e ka bërë shkencën fe",*[190]"- shkruan Bernsteini.

George Bernard Shaw [191]



45 Skicë e portretit të Geroge Bernard Shaw, botuar në librin "Me Mëndjendriturit" shkruar nga Herman Bernstein

Takimi me Bernard Shaw, zhvillohet në shtëpinë e artistit në Adelfi Terrace, në Londër. Autori i Cashel Byron's Proffesion,[192] i flet atij për dashurinë midis artistëve, nyjet irracionale, socializmin jo social, quintesencën e ibsenizmit, esenë fabiane të socializmit, vajzën në të zeza që kërkonte Zotin, tri dramat për puritanët etj. Bernsteini e përshkruan:

> Njësoj si Anatema, G.B. Shaw duket se është plot me inkoherenca e përsëri i mprehtë dhe i shkëlqyeshëm. Tani i dobët, mënjëherë i fortë, njëherë i sjellshëm e fill pas i vrazhdë, përherë në kërkim dhe i pabindur, ai e sheh pamjen në ikje, përpjekjet dhe arritjet, padrejtësinë dhe sakrificën dhe, ashtu siç i sheh ai, bën një qeshje si ajo e Mefistofelit.[193]

Askush nuk e vë në dyshim se gazetari që i merr intervistë një kolosi të madh të kulturës botërore, siç ishte G. B. Shaw, duhet të ishte në fushën e vet i një kalibri, po aq të lartë sa i intervistuari. Dhe ky ishte Herman Bernsteini.

Henri Bergson[194]

46 Skicë e portretit të Henry Bergson, botuar në librin
"Me Mëndjendriturit" shkruar nga Herman Bernstein

Në Paris, në vitin 1912, Bernsteini interviston një tjetër hebre të shquar: Henri Bergsonin, të cilin ai vetë e konsideron *"njeriun që njihej si mendimtari më origjinal në Francën e asaj kohe"*. Kjo intervistë vjen në fazën kulmore të teorisë filozofike bergsoniane, sikurse ishte formuluar në veprën e tij kryesore "*Evolucioni krijues*" (1907).

Interesat poliedrike të vetë Bernsteinit e shtyjnë të thellohet në disa aspekte themelore të filozofisë së Bergsonit, i cili tejkalon intelektualizmin dhe pozitivizmin shkencor me një lloj rilindje shpirtërore, që shpjegon jetën dhe realitetin si liri krijuese, të paskematizueshme nga shkencat tradicionale:

> Filozofia zbulon tek ne një realitet që përqaset me kënaqësinë e idealeve tona më të larta. Ajo zbulon jetën e shpirtit. Ajo mund të mos na japë ne as Zotin as pavdekësinë në kuptimin e vjetër teologjik të këtyre fjalëve, ndërkohë që nuk na shfaq as jetën njerëzore dhe sjelljen individuale, si fundi i gjithçkaje, qëllimi dhe qendra e interesit. Por realiteti i jetës është esencialisht liria. Filozofia na shkëput nga ndjesia e shtypur e domosdoshmërisë që konceptimi shkencor i universit të mbyllur na ka imponuar në mendimin modern. Jeta është veprimtari e lirë në një

> univers të hapur. Ne mund të jemi të parëndësishëm në tërësinë e pafundme të gjërave. Njerëzimi vetë dhe planeti në të cilin ai e ka ndërtuar suksesin, mund të jetë pjesë ndikuese e jetës së universit. Por ajo është njëshe dhe identike më atë jetë me përpjekjet dhe mundimet tona, të cilat janë vetë shtytja e jetës. Dhe mbi gjithkça tjetër, jeta jonë shpirtërore do të thotë për ne e kaluara nuk është venitur, e ardhmja është në krijim e sipër.[195]

Si përherë Bernsteini, kurrë nuk harron të pyesë bashkëbiseduesin për opinionin e tij për hebrejtë. Profesor Bergsoni i përgjigjet:

> Ne francezëve, pyetja për hebrejtë na duket paradoksale. Ne jemi të asimiluar. Nëse do të kishte një Zion të Ri, nuk besoj se do kishte shumë hebrej që do të shkonin atje. Një burrë shteti hebre i pyetur në vitin 1848 se çfarë mendonte ai për sionizmin u përgjigj se do të ishte në favor të tij, nëse do t'i jepej posti i Ambasadorit Hebre në Paris.

Bergsoni megjithëse gjatë jetës së tij iu afrua shumë kristianizmit, kurrë nuk e braktisi hebraizmin, për të mos u mënjanuar nga vuajtjet e popullit të tij gjatë persekutimit nazist.

August Rodin[196]



47 Skicë e portretit të August Rodin, botuar në librin “Me Mjeshtrat e Mëndjes” shkruar nga Herman Bernstein

Intervista me Rodin është pa diskutim leksion i rrallë estetike dhe arti, i marrë nga një njeri i madh, artistit që ka hyrë në historinë e artit si Michelangelo modern. Duke folur ngadalë, Bernsteini tregon ato që thotë Rodin:

> Skulptura është art i përjetshëm. Në disa periudha ky art do ta shprehë vetveten më fort se sa të tjerat, por do të ekzistojë përgjithmonë. [...] Arti i skulpturës u perfeksionua prej egjiptianëve, asirianëve dhe grekëve, të cilët e sollën atë në pikën më të lartë. Në kohët moderne janë prezantuar stile të ndryshme në këtë art dhe i janë dhënë emra të ndryshëm, por ato janë shmangur nga shkolla e egjiptianëve, grekëve dhe romakëve, prandaj puna jonë është inferiore, sepse arti antik është pothuajse i përkryer.
>
> Misioni i artit është moraliteti, feja. Ai është shprehja më e mrekullueshme e zgjuarsisë njerëzore dhe e fisnikërisë së mendimit të të gjithë njerëzimit. Çdo gjë në natyrë është e bukur për artistin dhe e vërtetë për njeriun e imagjinatës. Nuk ka gjë më të pakuptimtë, sesa përpjekja e një artisti për të prodhuar diçka të bukur, diçka të përkryer, duke kombinuar pjesë të tilla të modeleve të ndryshme në një. Kështu, artisti i cili riprodhon sytë e një modeli, duart e një modeli tjetër, këmbët e një të treti, qafën e një të katërti, prodhon ndoshta një kukull të bukur por ajo është pa jetë dhe pa vlerë.[197]

Havelok Ellis[198]



48 Skicë e portretit të Havelock Ellis, botuar në librin
"Me Mëndjendriturit" shkruar nga Herman Bernstein

Bernsteini zhvillon një intervistë edhe me psikologun britanik Havelock Ellis, i cili me studimet e tij pioniere, frymëzoi edhe fazat e hershme të lëvizjes feministe. Veprat e tij *"Burrë dhe grua", "Psikologjia e seksit*", studimet e tij shkencore në pisikologjinë e grave janë të njohura botërisht dhe janë përkthyer në shumë gjuhë të botës. Përveç kësaj, në këto vepra të rëndësishme ai vlerësoi në një mënyrë mjeshtërore shpirtin e ri në letërsi, sikurse e trajton atë Didëroi, Hajne, Witmani dhe Tolstoi, në një periudhë ndryshimesh të mëdha midis shekullit XIX dhe XX. Ellis ishte gjithashtu i pari, që e drejtoi vëmendjen e lexuesve anglezë drejt Friedrich Wilhelm Nietzsche.

Leonid Andrejevi[199]

49

Skicë e portretit të Leonid Andrejev, botuar në librin
"Me Mëndjendriturit" shkruar nga Herman Bernstein

Bernsteini takohet me Kontin Leonid Andrejev, i cili njihej si shkrimtari më modern i Europës. Me veprën e tij *"Jeta e njeriut",* ai krahasohej me Dostojevskin. Në bisedë ata flasin për incidentin e Gorkit me amerikanët. Andrejevi thotë: *"Gorki, ndërsa shkruan për Amerikën nuk lë fjalë të keqe pa thënë për atë vend, por kur flet për të nuk le fjalë të mirë pa thënë.*[200]

50 Sheikh - Ul - Islam [201]



Skicë e portretit të Sheik Ul Islam, botuar në librin
"Me Mëndjendriturit" shkruar nga Herman Bernstein

Vlerësimi i Bernsteinit për këtë figurë është unik, i rrallë, i habitshëm, tolerant dhe gati ekzotik në shpjegim. Ai na e citon *Sheikun Ul-Islam* që thotë:

> Pak kohë më parë ekzistonte një thënie në Turqi se sulltani është hija e Zotit mbi tokë dhe që hija e sulltanit është Sheikh-Ul-Islam, kreu i fesë myslimane. Kur u shfronësua Abdyl Hamiti, sulltani i ri që erdhi në fuqi, edhe pse shumë popullor me njerëzit, pushoi së qeni hija e Zotit mbi tokë. Rrethanat në të cilat ai ishte shpallur Kalif i Perandorisë Osmane e kanë bërë atë më shumë një figurinë.

Një takim me të në Pallatin Yildiz në Stamboll ishte ngjarje e rëndësishme për Bernsteinin. Ai takohet një të premte pas faljeve, kur gjërat kishin ndryshuar shumë, kur njerëzit shëtisnin me varka, me të cilat pak kohë më parë shëtiste vetë sulltani Abdyl Hamit. Përshkrimi i rrugëve të Stambollit që nga Pera është aq piktoresk dhe ekzotik, aq interesant, sa kushdo që e sheh edhe sot atë zonë të qytetit, gjen diçka nga përshkrimi i Bernsteinit.

Pasi e shoqëron i biri i Sheikut, ai ndjek tërë protokollin e duhur në takimin me Sheikun e ri, i quajtur Sahib Molla Efendi, i cili ishte më liberal se paraardhësi dhe natyrisht as që krahasohej me Sulltan Abdyl Hamitin. Në bisedën e tyre mëson shumë

gjëra: *"Unë jam zgjedhur prej sulltanit jo pse jam njeriu më i zgjuar për këtë post, por më tepër, sepse ka kaq pak njerëz të vërtetë në Turqinë e sotme."*[202]

Bernsteini e pyet atë, nëse është e vërtetë që Kurani nuk lejon kushtetutë për qeverisje. Përgjigjja e Sheikut-Ul-Islam është befasuese:

> Kjo është gabim. Kushtetuta ka dalë prej fesë sonë. Në fakt, feja myslimane kërkon një qeveri konstitucionale. Kurani na mëson se njerëzit e zgjuar të një kombi duhet të bashkohen dhe të vendosin se çfarë është më e mira për të gjithë popullin, prandaj mund të thuhet se Kurani e ka lindur vetë Kushtetutën.

Ai i përgjigjet pyetjes së Bernsteinit se çfarë do bënte kreu i fesë islame, nëse një shkrimtar mysliman do të bënte atë që ka bërë Tolstoi, i cili ishte çkishëruar, për shkak të pikpamjeve të tij. Sheiku i përgjigjet:

> Feja jonë është liberale. Feja jonë është e lirë. Çdokush mund të shkruajë çfarë të dojë. Ne nuk kemi frikë. Ne i shohim ata që nuk besojnë, si dhe skeptikët me një ndjenjë mëshire. Na vjen keq për kritikët, por nuk kemi asnjë farë frike. Dhe e di përse? Sepse askush në botë nuk ka shkruar një libër më të bukur se Kuranin dhe as që do ta shkruajë ndonjëherë. Prandaj.[203]

Këto intervista janë vetëm një pjesë e punës së Bernsteinit, si një emër i madh në gazetarinë e kohës.

"TË FAMSHMIT E KOHËS SONË" [204]
botuar në vitin 1924

Koncepti i Bernsteinit për librat e tij *"Me mendjendriturit"* shtrihet te *"Të famshmit e kohës sonë*". Ai merr një formë edhe më të gjerë. Në fakt gama e jashtëzakonshme e temave, numri shumë i madh i njerëzve të shquar që ai ka takuar dhe intervistuar, e bën atë në fushën e vet të gazetarisë shpesh herë, po aq të madh, sa bashkëbiseduesin. Në parathënien e botimit të vitit 1924 të këtij libri, Bernsteini shkruan:

> Gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit kam takuar njerëz të famshëm, të gjetur në

të gjitha rrethanat e mundshme dhe në shumë vende të ndryshme të botës. Disa ishin vetëm të famshëm fatkeqë, që rastësia i ka sjellë në skenë, të formësuar nga ndonjë situatë e papritur, që vishnin rrobën e madhështisë së rastit, lavdia e të cilëve binte poshtë po aq shpejt sa ngrihej. Ndriçimi i tyre zbehej ende pa ndriçuar mirë.

Ndryshe nga këta, ishin të famshmit e vërtetë. Për t'i takuar ata kam udhëtuar mijera kilometra. Këta ishin ata njerëz, talenti gjenial i të cilëve në art, shkencë, apo në aftësitë qeverisëse, prekën bash atë nervin e jetës. Ata ishin të famshmit e vërtetë, edhe pse ngandonjëherë të panjohur, bij të rrethanave të caktuara.

Kam takuar kështu praktikisht çdo figurë të shquar të kohës sime, i cili ka ndikuar në mendimet dhe trajtën e ngjarjeve më të rëndësishme të botës. Kam provuar kënaqësinë e stimuluar prej diskutimit me këta gjeni në vendin e punës së tyre, në studiot, ku ata formulonin dhe ekzekutonin veprën e tyre, kam bërë pyetjet e duhura rreth shkrimeve të tyre, kërkimeve, ose rreth veprimtarive të tyre politike.

Përherë dhe kudo kam shkuar deri te maja e ujëhedhësit, ajo që më lumturon më shumë është shoqërimi me disa prej këtyre njerëzve, deri në miqësi, duke ndërtuar marrëdhënie të tilla të cilat i çmoj si thesar me krenari të pafund.

Nuk e di se sa dhjetra mijëra milje kam përshkuar në rrjedhën e këtyre udhëtimeve gjatë pesëmbëdhjetë viteve. Edhe pse në ato milje fshihen aq shumë vështirësi, prapë ato përbëjnë kënaqësinë më të madhe të jetës sime. Ditët në udhëtim shpesh janë të mbushura me incidente e herë-herë me ngjyrime të bukura. Kam arritur ta shoh dhe ta njoh detin në të tëra stinët e vitit, Atlantikun dhe Paqësorin, Mesdheun dhe Detin e Zi, madje edhe Arktikun. Kam parë komeditë e rastit të turistëve si dhe tragjeditë e tmerrshme të luftës. I pashë këto të fundit jo vetëm në frontin ushtarak dhe diplomatik, por edhe në shtëpitë e njerëzve të përfshirë në luftë. Po cilat janë emocionet që më kanë shkaktuar takimet me këta njerëz të shquar? - jam pyetur shpesh.

Le të flas vetëm për njërin prej tyre: Leon Tolstoin. Me të jam ndjerë si një rreze e shndritshme në mbrëmjen vezulluese të perëndimit të diellit, kur kap tokën, ndërkohë që dita po i lëshonte vendin natës. Një vizitë aty ishte si të shkoje në një vend të mrekullive, aty ku të mahnit arti magjik. Në intelektin dhe vizionin e tij e pashë veten miliona milje larg tokës, duke vështruar magjishëm laboratorin e shkëputur nga vaniteti i species njerëzore.

Dikush tjetër ma tregonte botën si një cirk në të cilën ai ishte një kloun, dikush tjetër i bënte njerëzit sikur ishin gomerë në një shfaqje, ndërsa Zotat Olimpikë si një audiencë qesharake. Disa të tjerë ishin si rryma elektrike që transmetonin fuqinë e voltazhit të lartë të revolucionit nëpër jetët e miliona njerëzve. Midis tyre gjendeshin Apostujt e Paqes dhe vetë udhëheqësit e trazirave.

E kam parë luftën nga afër, i kam parë diplomatët dhe politikanët militaristë të verbuar nga pasioni i egër, mbushur me hakmarrje, egërsuar nga pamja e gjakut, të etur për pushtime dhe pushtet. Ata e kthyen botën në një çmendinë, në një varrëze gjigante, ndërkohë që po të gjithë lexonin të njëjtën Bibël, i faleshin të njëjtit Zot, për të shkatërruar armikun, pra njëri-tjetrin. Ata nuk kishin keqardhje të vërtetë për askënd që donte paqe, punë dhe lumturi. Kam parë viktima të luftës, fëmijë. Tronditem sa herë kujtoj se si i kam parë. Mendoj se çfarë do të mendojë brezi tjetër, kur të rritet dhe të shohë të vërtetën e pasluftës?

Çfarë idealesh do të ketë ai brez? Çfarë standardi moral? Çfarë respekti për ligjin dhe rregullin? Çfarë sensi të simpative? Pas luftës më të përgjakshme në histori, në të cilën pikërisht arritjet e shpikësve u përdorën për shkatërrim, çfarë respekti do të kenë fëmijët për jetën e njerëzve. Lotët dhe gjaku vaditën fushat e shkatërruara. Çfarë të lashtash do të mblidhen prej tyre?

E kam parë edhe paqen. I kam parë viktimat e paqes në shumë vende të ndryshme. Edhe pse kanë kaluar pesë vjet e gjysmë që nga koha e armëpushimit, paqja është ende larg për t'u vendosur. Shpirti i luftës ende nuk është çmobilizuar në shumë vende. Konflikte të reja, zemërim i ri, urrejtje të reja kanë çelur sytë. Në vend të paqes pa fitore kemi fitore pa paqe.

Intervistat e përfshira në këtë libër janë ndoshta ato më karakteristiket midis qindra bisedave që kam pasur me njerëz të famshëm në toka të ndryshme. Kam bërë përpjekje t'i shkruaj bukur, por më së pari kam synuar t'u qëndroj besnik pikëpamjeve të shprehura prej tyre. Shpresoj se ia kam dalë t'i paraqes ato me përpikëri. Jam munduar të dalloj se kush midis këtyre njerëzve të famshëm e lexon dhe e gjykon të ardhmen qartë dhe kush syresh është dritëshkurtër.
Subjektet e librit janë shumë të ndryshme, prandaj edhe mund të duken të fragmentarizuara. Megjithatë vendi që kanë zënë në historinë e kësaj kohe këto figura të rëndësishme të botës sonë provojnë interesin e veçantë të të gjitha llojeve dhe kushteve të leximit.

Në qoftë se intervistat e mbledhura në koleksionin e këtij libri, do ta përcillnin lexuesin drejt një studimi më të vëmendshëm të veprës së disa prej burrave të famshëm të përmendur këtu, atëherë e ndjej se ky libër ia ka arritur qëllimit të tij.

Herman Bernstein, New York 21 qershor, 1924

Papa Benedikt XV [205]

Në vitin 1915, i ndihmuar nga një miku i tij botues në Londër dhe një burrë shteti francez, Bernsteini arrin të sigurojë një audiencë me Papën Benedikt XV. Ai ishte zgjedhur Papë me 3 shtator 1914, pra vetëm pak javë pas fillimit të Luftës Parë Botërore bazuar në përvojën e tij diplomatike në Vatikan e përpjekjet për parandalimin e Luftës. Menjëherë pas kurorëzimit në nëntor 1914, Benedikti XV boton thirrjen[206] e tij të parë ndaj krerëve të shteteve, për t'i dhënë fund luftës. Në vitet e Luftës së Madhe përpjekjet e tij diplomatike dhe publike për paqe qenë të shumta, edhe pse Vatikani mbetet i izoluar me hyrjen e Italisë në luftë dhe tërheqjen e trupit diplomatik nga Roma. Izolimi diplomatik ishte pasojë edhe e izolimit gjeografik të shtetit të Vatikanit, pasi ai nuk kishte në atë kohë akoma marrëdhënie diplomatike me Italinë, megjithëse ndodhej brenda territorit të saj.

Në këto kushte, interesi i audiencës me një gazetar amerikan, hebre dhe me ndikim, siç ishte Bernsteini, ishte i dyanshëm.

Në audiencë janë të pranishëm edhe Kardinali Gasparri[207], Sekretari i Shtetit të Vatikanit. Papa Benedikti interesohet pikësëpari për gjendjen në Amerikë, rreth

qëndrimit të popullit amerikan ndaj luftës dhe më në fund në lidhje me gjendjen e hebrejve atje. Bernsteini i flet atij për autokracinë ruse, ndërsa Papa e pyet për gjendjen e hebrejve në Rusi.

> E di tragjedinë e hebrejve në Rusi, - i thotë Papa atij. Vuajtjet e tyre kanë prekur thellë zemrën time. Kam marrë informacione prej priftërinjve të mi rreth persekutimit të hebrejve në Rusi. Kam dijeni për dëbimet masive dhe vuajtjet e tyre të papërshkrueshme. E di që ndjenja anti - semitiste është stimuluar nga qeveria Ruse edhe në Poloni. Edhe polakët vetë vuajnë dhe priftërinjtë e mi janë trajtuar mizorisht nga qeveria e Carit. Unë jam armik i vendosur i anti-semitizmit. Unë jam, dhe ne të gjithë jemi, përherë për lirinë. Unë jam forcë e lirisë dhe po ashtu forcë e paqes.

Papa, gjithashtu shpreh admirim shumë të madh për Presidentin Wilson, duke e konsideruar atë udhëheqës dhe burrë shteti me fuqi të madhe për paqen. Bernsteini e pyet Papa Benediktin XV, nëse ky i fundit do të dëshironte të shihte SHBA-të si ndërmjetëse të paqes. Papa i përgjigjet:

> Unë nuk dyshoj se ju do të më bëni një shërbim. Besoj se e keni lexuar letrën time për paqen. Ne e dërguam letrën te sundimtarët e vendeve ndërluftuese. Ende nuk e kemi dërguar te fuqitë asnjanëse. Unë dua t'u jap juve një kopje të asaj letre me një përkushtim personal ndaj Shkëlqesisë së Tij, Presidentit Wilson dhe do të isha i lumtur, nëse do t'ia dorëzonit atë letër në dorë, kur të ktheheni në Amerikë.

"*Sapo u ktheva në Amerikë"*, - thotë Bernsteini – "*e dorëzova letrën me autograf të Papës te Presidenti Wilson, i cili shprehu vlerësimin e tij dhe e falënderoi Papën*."

Në fakt, dy vite më pas, në 1917 ai do t'i bëjë apel përsëri drejtpërdrejt Presidentit Wilson, për të parandaluar hyrjen e Amerikës në Luftë. Ai mesazh, sikurse dihet, nuk pati rezultatin e shpresuar nga Papa dhe shënoi falimentimin e planit për paqe të Vatikanit. Ky plan, i cili përmbante 10 pika, thuhet se shkaktoi xhelozinë e Presidentit Wilson ndaj kreut të kishës së Romës, që kishte formuluar një program paqeje më përpara se vetë Wilson. Më pas Presidenti Wilsoni hartoi planin e njohur me 14 pika. Marrëdhënia delikate mes Benediktit XV dhe Wilsonit do të rezultojë në takimin e tyre historik në Vatikan në vitin 1919, gjatë vizitës në Europë të Presidentit me rastin e Konferencës së Paqes së Parisit.

Bernsteini diskuton gjithashtu me Papa Benediktin XV rreth aspiratave të sionistëve, argument ky me vlerë të madhe historike pasi tezat mbizotëruese e shohin Vatikanin kundër vendosjes së hebrejve në Palestinë. "*Unë simpatizoj aspiratat kombëtare hebraike në Palestinë. Ne duam liri dhe drejtësi krejt ashtu sikundër hebrejtë e kërkojnë atë kudo që janë,*" - i thotë Papa Bernsteinit.

Ky i fundit i kujton Papës persekutimin e tmerrshëm të hebrejve në Rusi e i rrëfen me kujdes faktin sesi pesëdhjetë mijë hebrej, burra, gra dhe fëmijë i kishte vënë përpara ushtria ruse dhe më pas ishin qëlluar me armë prej trupave të Fuqive Qendrore.
Pas kthimit në Amerikë, Bernsteini informon Komitetin Amerikano - Hebraik se Papa ishte gati të lëshonte një deklaratë, ku të dënonte anti-semitizmin, persekutimin e

hebrejve si jo-kristianë, nëse do të merrte një kërkesë zyrtare nga një organizatë hebraike. I nxitur nga ky kusht, Bernsteini shkruan një letër në emër të hebrejve të Amerikës[208], të Komitetit Hebraik të Amerikës dhe e dërgon tek Papa Benedikti XV dhe Sekretari i Shtetit, Gasparri.[209]

Leo Trocki [210]

Një ndër figurat më tragjike të Revolucionit të Tetorit është Leo Trocki, një hebre bolshevik, njeriu më i afërt i Leninit dhe viktima e prerë në besë nga Stalini. Në Mars të vitit 1918 Bernsteini shkon në Shën Petërsburg për ta takuar atë, pasi e konsideronte si më të zgjuarin prej të gjithë udhëheqësve bolshevikë. Kjo intervistë zhvillohet vetëm pak ditë, pasi Trocki, në rolin e tij si "*Komisar i Populllit për Punët e Jashtme*", kishte firmosur për palën ruse traktatin e Brest-Litovskit[211], që shënonte daljen e Rusisë nga Lufta. Biseda mes tyre hedh dritë mbi disa nga detajet dhe prapaskenat e këtyre negociatave të brishta mes superfuqive.

Trocki e pret Bernsteinin në Institutin Smolny, ku gjendej Shtabi i Bolshevikëve. Bernsteini e takon Trockin në zyrën e tij, pas një odiseje me sekretarët dhe rojet dhe vetëm, kur vetë Trocki pa kartvizitën e gazetarit, e pyet Bernsteinin: "*A flisni anglisht*?".

Bernsteini i përgjigjet se mund të flasin rusisht. Trocki e drejton në një dhomë shumë të madhe, duke i kërkuar ndjesë për shkak se administrata bolshevike po transferohej në Moskë.

Situata që përshkruan Bernsteini në zyrën e Trockit është shumë e çrregullt dhe ai vetë ishte i shpërqendruar. I pyetur për marrëveshjen Brest – Litovsk, Trocki përgjigjet se pozita e Rusisë në atë kohë përcaktohej më shumë e ndikuar nga politika e jashtme, se ajo e brendshme.

> Ne, siç e dini edhe ju, na kanë quajtur agjentë të gjermanëve, - thotë Trocki, por të siguroj se Gjermania nuk ka armik më të madh se partinë tonë. Ambasadorët e huaj ndërhyjnë në çështjet tona të brendshme. Nuk dua t'i fajësoj ata, por duhet pranuar se ata ndërhyjnë. Në fakt Ambasadori Amerikan vepron me ndershmëri, por nuk e kupton si duhet situatën në Rusi.
>
> Bernsteini i përgjigjet se e dinte këtë, pasi ishin botuar shumë artikuj nëpër gazeta rreth kësaj çështjeje. Atëherë Bernsteini e pyet Trockin: - Sipas jush, për çdo gjë, të huajt duhen fajsuar?
>
> Trocki i përgjigjet: -Revolucioni ka natyrën e vet të çorganizuar dhe nuk janë vetëm të huajt që duhen fajësuar. Qëllimi ynë ishte ta përhapnim revolucionin në Gjermani dhe në Austri. Grevat e përgjithshme në ato dy vende tregojnë se kemi arritur shumë, por Lenini desh t'i jepte pak frymëmarrje revolucionit, për shkak të mungesës së organizimit dhe kështu pranuam paqen.
>
> Më pas Trocki i thotë Bernsteinit se ekziston një marrëveshje midis Gjermanisë dhe Japonisë, për të ndarë Rusinë. Bernsteini e pyet, nëse Trocki është në dijeni të plotë të kësaj marrëveshjeje dhe ai i përgjigjet: - Nuk e di saktësisht, por e di se ata duan ta ndajnë Rusinë me gjermanët në Perëndim dhe japonezët në Lindje.

> Pastaj Bernstein e pyet se sa mendonte se do të zgjaste paqja me Gjermaninë dhe Trocki përgjigjet: - Ne bolshevikët po luftojmë me gjermanët për Poloninë. Asnjëra palë nuk e konsideron paqen afatgjatë. Imperializmi gjerman dhe bolshevizmi rus nuk kanë asnjë pikë takimi. Ne po marrim ekspertët e vjetër të ushtrisë. Nuk kemi frikë prej tyre se po e depolitizojmë ushtrinë. Pastaj revolucioni do të fitojë dhe do të lëvizim për në Moskë.

Disa ditë më vonë Bernstein arrin të sigurojë një letër të cilën Trocki e dërgonte prej Brest-Litovskit për Leninin dhe Stalinin, në të cilën ai sugjeronte formulën: *"Ne shpallim mbarimin e luftës dhe çmobilizimin, pa nënshkruar traktat paqeje."*.

Ai parashikonte revolucion në Gjermani, prandaj i shkruante Iliçit se do t'i jepte fund luftës pa nënshkrim traktati. Fjalët e Trockit "*as luftë, as paqe*", që simbolizonin qëndrimin e Rusisë, kanë hyrë në histori.

Bernsteini si përherë është në krye të atyre njerëzve, të cilët dinë të gjejnë dhe të zotërojnë informacione të tilla, të cilat kanë ndikim në vetë zhvillimet globale. Të mendojmë vetëm për pak çaste se çfarë rëndësie kishin në atë kohë zhvillimet e Rusisë Bolshevike dhe militarizmit gjerman, të cilët një ditë u ndeshën për t'i shkaktuar botës numrin më të madh të viktimave.

Në bisedën e Bernsteinit me Trockin në zyrën e këtij të fundit në Shën Petërsburg, ndihet pikërisht kjo frymë militariste, që po i kërcënohej botës me një tragjedi të tmerrshme. Kur dihet se Trocki ishte bolshevik i betuar dhe një nga liderët që po përcaktonin fatet e Luftës së Madhe, një intervistë e tillë tregon për aftësitë e jashtëzakonshme të Bernsteinit, për të përcjellë para publikut të kohës njoftime nga burimet më të drejtpërdrejta e më të rëndësishme të kohës.

Lordi Robert Cecil [212]

Lordi Cecil ka luajtur rol të jashtëzakonshëm në historinë e Shqipërisë. Ai ishte miku i ngushtë i Aubrey Herbert, prej të cilit mori frymëzimin për të mbrojtur Shqipërinë në Lidhjen e Kombeve në vitin 1920.

Nuk kishin kaluar vetëm disa muaj qëkurse Presidenti Wilson kishte mbrojtur vendin tonë në Konferencën e Paqes në Paris, kur ky Lord, bashkë me Lordin tjetër Balfour (ish kryeministër i Britanisë) dhe historianin Fisher, dhanë tërë argumentet e duhura, për të mbrojtur vendin tonë nga një coptim i mëtejshëm.

Lordin Cecil e interviston Herman Bernsteini dhe pyetja e parë që i drejton ka të bëjë me Lidhjen e Kombeve. Lordi Cecil i shmanget një përgjigjeje për këtë pyetje, pasi sikurse thotë ai: "*Çfarëdo që të them, kam frikë se do të keqinterpretohet në Amerikë, në veçanti në këto momente.*".

Bernsteini e pyet atë, nëse do të ketë ndonjë ndryshim në politikën ndaj Rusisë sovjetike dhe, nëse ai do të ishte në favor të rifillimit të tregtisë me atë vend. Lordi Cecil i përgjigjet:

> Mua përherë më kanë kundërshtuar politikën e ndërhyrjes ushtarake në Rusi

> pas armëpushimit. Derisa nuk kemi ndërmend të luftojmë qeverinë sovjetike të Rusisë, atëherë përse mos të bëjmë tregti më Rusinë? Madje, edhe nëse nuk pajtohemi me qeverinë, si ta lëmë popullin e saj të vdesë urie? Një politikë e tillë është e pandershme dhe jo e zgjuar. Mua më duket se tregtia me Rusinë do të fillojë pa vonesë. E di që një masë të konsiderueshme të tregtisë Rusia e bën nëpërmjet Estonisë, e cila ka bërë paqe me qeverinë sovjetike.

Më pas Bernsteini kërkon të dijë mendimin e Lordit Cecil në lidhje me Traktatin e Versajës dhe merr këtë përgjigje:

> Rregullimet territoriale që kanë ndikim te Gjermania, sipas detyrimeve të traktatit, nuk janë aq të këqia. Ato që kanë të bëjnë me Austrinë janë padyshim shumë më të këqia, por rregullimet ekonomike me të dyja janë krejtësisht të pambrojtshme. E vetmja gjë që mund të thuhet është se mjeti i adoptuar, dëmshpërblimi, nuk ka qenë shpikje amerikane.

"*Po a mundeshin Shtetet e Bashkuara atëherë, të ushtronin ndikim të mjaftueshëm në konferencën e Paqes, për të ndaluar këtë mjet pa e mishëruar në traktat*?"- e pyet Bernsteini. Dhe Lordi Cecil i përgjigjet: *"Padyshim që u bënë përpjekje të mëdha, por në fund u arrit kompromisi".*
Bershtaini e pyet përsëri: *"A mund të thuash se në tërësi jeni i kënaqur me atë çfarë solli lufta*?".
Lord iu përgjigj: "*Padyshim që është më mirë të fitosh luftën, sesa të mposhtesh nga Gjermania.*".
"*Kjo nuk do shumë mend por ajo që desha të mësoja është nëse ju jeni i kënaqur me paqen ashtu sikurse u arrit në Paris?*"-pyet Bernstein.
"*Unë sigurisht që nuk jam*", - përgjigjet Lordi.

Korrespondenca e Bernsteinit me Lordin Cecil është me vlerë të madhe, sidomos, kur ata diskutojnë çështjen e hebrejve në Rusi, persekutimin, vuajtjet dhe mjerimet e tyre. Ai ka gjithashtu korrespondencë me Sir Eduard Grey dhe kjo tërheq vëmendjen për kalibrin shumë të lartë të Bernsteinit, në raport me njerëzit e shquar të kohës dhe në këtë rast me dy prej atyre, që kishin luajtur një rol kryesor në formimin dhe më tej ekzistencën e shtetit shqiptar.

Chaim Weizmann [213]

Në udhëtimin e tij interesant për të nxjerrë në pah idetë dhe këndvështrimin e njerëzve më të shquar të kohës së tij, Bernsteini ndalet te Chaim Weizmann[214]. Doktor Weizmann identifikohet lehtë me lëvizjen sioniste gjatë Luftës Botërore. Organizata sioniste ishte gjymtuar, për shkak të pozicionit të veçantë të hebrejve, te cilët e gjetën vetveten përballë ushtrive të të gjitha vëndeve ndërluftuese në të dy krahët, edhe në atë të aleatëve edhe të ushtrive qendrore. Përgjegjësia e marrë nga dr. Theodore Herzl, themelues i shkëlqyer i lëvizjes moderne sioniste, ra në duart e dr. Weizmann, i cili njihet nga e gjithë bota si

njeriu që ëndrrën dhe shpresën e hebrejve e ktheu në realitet.

Ishte ai që mbrojti Deklaratën e Lordit Balfour të vitit 1917 në favor të bërjes së Palestinës si atdheu kombëtar i hebrenjve dhe po ashtu ratifikimin e Deklaratës së Balfourit të 24 Prillit 1920 në Sanremo. Në atë ditë historike për popullin hebre, Kryeministri Britanik Lloyd George i tha dr. Weizmann:

"Ne ju hapëm rrugën. Tani është detyra juaj të rindërtoni Palestinën. Nëse dështoni, faji nuk është i yni."

Weizmann iu përgjigj: *"Populli hebre kurrë nuk do të dështojë."*

Bernsteini edhe në këtë rast gjendet pikërisht aty, ku bëhej historia, pranë dr. Weizmann. Fjalët e Weizmann gjenden në bllokun e shënimeve te Bernsteinit:

> Sot Izraeli hyri edhe një herë si faktor aktiv në skenën botërore. Nuk do të ketë më vuatje pasive. Do të ketë një mundësi të madhe për të vënë në jetë energjitë e tij dhe përvojën e akumuluar ndër shekuj për ringritjen e shtëpisë së tij të lashtë, të cilën do ta bëjmë fanar ndriçues. Nuk ka më Judea Capta[215], pas Konferencës së Sanremos.

Bernsteini udhëton së bashku me dr. Weizmann në Zvicër. Gjatë ditëve të qëndrimit me dr Wesmann, Bernsteini i merr atij një intervistë, në të cilën ai thotë se restaurimi i Palestinës në Izrael është thjesht një mrekulli.

> Hebrejtë nuk mund ta lënë këtë mundësi të artë tu ikë nga dora dhe jam i sigurt se ata mund dhe do të bëjnë sakrifica të panumërta për rindërtimin e shtëpisë sonë të lashtë. Sa ju takon arabëve, unë shpresoj se ata nuk do të drejtohen më nga një propagandë e mbrapshtë. Ata na nevojiten ne, sikundër ne u nevojitemi atyre. Me një dëshirë të mirë nga dyja palët të gjitha keqkuptimet do të zhduken.

Bernsteini e pyet dr. Weizmann se kur do të zbatohej Deklarata e Lordit Balfour? Dr. Weizman e përshkruan situatën siç është:

> Sa në Turqi, sa në Rusi e sa në Britani, ju siguroj se ne tani kemi miliona hebrej, të cilët nuk kanë qenë të artikuluar deri tani, por që gjejnë tek ne shprehjen e zërit të tyre. Kam bërë dy mijë intervista me burrështetas britanikë, për t'i bindur ta kuptojnë se çfarë është sionizmi. Ne kemi mbështetje nga sionizmi amerikan, që na ndihmon shumë. Kam marrë kritika, sepse kam kërkuar vetëm një atdhe kombëtar për hebrejtë dhe jo për një shtet të hebrejve. Më thonë së plani i Balfurit nuk do të thotë shtet hebraik, pra sigurisht që nuk do të thotë asnjë shtet hebre.

Pyetjes nëse është e vërtetë që autoritetet ushtarake britanike në Palestinë ishin më simpatizuese ndaj arabëve, sesa hebrejve, dr. Weizmann i përgjigjet:

> Mund të duket e çuditshme, por është e vërtetë se pothuajse të gjithë anglezët, pasi vizitonin Jeruzalemin ishin të prirur nga një antipati ndaj hebrejve, po kjo është e kuptueshme, duke parë mënyrën se si vishen ata.
> Ndërkohë që arabët i jepnin një pamje më piktoreske, arsyeja e dytë është se britanikëve iu duken hebrejtë më të vështirë për t'u marrë vesh me ta, në

> krahasim me arabët, të cilët u bindeshin urdhrave të tyre.
>
> Arsyeja e tretë ishte se britanikët i atribuan hebrejve etjen për të grabitur gjithçka në Palestinë. Ka aq shumë intelektualë të shkëlqyer midis këtyre hebrejve, saqë ne nuk mund të lejojmë t'i humbasim ata, tani që institucionet e përbëra nga hebrejtë e shkolluar në Rusi dhe Poloni, ndjejnë nevojën e tyre.

Bernsteini e takon përsëri dr. Weizmann në prill të vitit 1921. Ai flet për takimin që kishte pasur me Presidentin amerikan Harding, flasin për valët migratore të hebrejve në Europë e për kontributet që duhet të japin intelektualët më të mëdhenj hebraikë për ndërtimin e shtetit të Izraelit, duke iu referuar me emër Albert Ajnshtajnit.

Në takimin e vitit 1923, ata flasin për trazirat e ndryshme, nëpër të cilat kalonte Europa dhe Lindja në atë kohë. Ata përmendin bolshevizmin, kemalizmin dhe lëvizje të tjera, me të cilat ballafaqohej politika botërore.

Në takimin e fundit të dr. Weizmann me Bernshtanin, ai thotë:

> Ndoshta do të vijë një ditë, kur do të ketë një mbledhje tjetër të Lidhjes së Kombeve, mbledhje të vërtetë për paqen, harmoninë dhe drejtësinë, një vend për të gjithë idealet humanitare, të cilat kanë formuar shtratin e gurtë të civilizimit tonë në Jeruzalem. Profetët ende nuk kanë vdekur. Ata sot janë të heshtur, por nesër mund të flasin[216].

Albert Ainshtajn[217]

Herman Bernstein, siç del në disa raste në këtë libër, ishte mik i shkencëtarit më të madh të shekullit të njëzetë, Albert Ajnshtajn. Ajnshtajni ndërmerr një udhëtim në Izrael, jo për të shpërndarë teorinë e tij të relativitetit, por për të parë interesin e hebrejve të Amerikës në ndërtimin e Universitetit Hebraik në Palestinë.

Bernsteini e paraqet atë si hebrenë më gjenial të kohës së tij, njeri modest, zotëri të këndshëm, pa pretendime, gati si fëmijë në thjeshtësinë e tij, me një ndjenjë të thellë humori. Bernsteini na tregon se profesori është shtetas zvicerian, që jep mësim në Universitetin e Berlinit dhe se ka vuajtur nga sulmet e drejtuara kundër tij prej gjermanëve antisemitistë, kur agjitacioni i tyre u intesifikua. Në intervistën e dhënë Bernsteinit gjeniu i fizikës thotë se në Gjermani quhet gjerman i shkencës, ndërsa në Angli paraqitej si një hebre zvicerian.

"*Nëse vjen një kohë, kur të quhem si një bête noire[218] përshkrimi do të shndërrohet dhe unë do të bëhem hebre zvicerian për gjermanët dhe gjerman i shkencës për anglezët.*"

Bernsteini ndalet te dëshira e Ajnshtajnit, për të hapur Universitetin e Palestinës. Ai thotë se ka parë dhe takuar studentë hebrej anë e mbanë Europës e veçanërisht në Poloni, Rusi dhe Hungari dhe ka parë me sytë e tij vuajtjet dhe mjerimin e tyre, si dhe persekutimin që ata provojnë për shkak të fesë dhe racës së tyre.

Më tej ai thotë se janë mijëra studentë të talentuar hebrej, të cilët do të ishin shkencëtarë të mëdhenj, nëse do të lejoheshin të studionin, por atyre nuk iu mundësohet kjo dhe bota çdo vit humb talente të mëdha, prandaj Universiteti Hebraik

i Palestinës ishte bërë domosdoshmëri.

> Ky Universitet do të bëhet si një Vend i Shenjtë për tërë hebrejtë,- thotë Ajnshtajni. Hebrejtë e Amerikës janë hebrejtë më të lumtur sot në botë. Europa është e sëmurë dhe hebrejtë e Europës po përjetojnë persekutim dhe përndjekje të paparë më parë. Prandaj kam ardhur këtu me shpresën e palëkundur se hebrejtë e Amerikës nuk do të kursehen në ndihmën e kërkuar për hapjen e Universitetit të Jeruzalemit. Një grup profesorësh hebrej janë organizuar për të ndihmuar Universitetin.

I madhi Ajnshtajn flet me një modesti gjeniu:

> Unë nuk profetizoj që kjo sipërmarrje do përfundojë me sukses. Unë nuk jam as organizatori i kësaj sipërmarrjeje. Profesorët do të jenë ata. Por unë dua të them se ajo që mund të bëj unë, është të bëj atë që duhet të bëj.
>
> Universiteti do të ketë fakultetet e studimeve hebraike dhe orientale, të filologjisë, letërsisë, historisë, juridike, arkelogjike, fetare dhe filozofisë, kryesisht hebraike, por edhe arabe dhe semitike në përgjithësi. Do këtë fakultet shkence, por mbi të gjitha atë të studimit të gjuhës moderne hebraike. Është e qartë se përveç tragjedisë së shkencës së hebrejve pa një shtëpi, nuk mund të ekzistojë një shtëpi kombëtare hebraike pa shkencë. Nuk ka dyshim se me këtë universitet do të vijë rilindja e gjenive hebraikë, të cilët janë shpërndarë keq nëpër botë.

Stepan Radicz, Zagreb, Kroaci 1922

Bernsteini shkon në Jugosllavi për t'u njohur me situatën që ishte krijuar. Popullata ishte në prag të shpërthimit të protestave masive dhe në çdo moment mund të shkaktoheshin trazira, në qoftë se nuk merreshin masa parandaluese në kohën e duhur. Duhej përjashtuar katastrofa e re në vendin, ku kishte filluar Lufta Botërore.
Çështja kryesore në Jugosllavi kishte të bënte me faktin se një pjesë e popullsisë ishte për një shtet militarist, ndërkohë që pjesa tjetër ishte për republikë.

Serbët po përpiqeshin të themelonin një Serbi të fuqishme militare nën emrin e Jugosllavisë, ndërkohë që kroatët dhe sllovenët ishin për një ekzistencë kombëtare paqësore, si republikë.

Bernsteini i njeh aspiratat e ndryshme të këtyre popujve që, megjithëse flasin të njejtën gjuhë, dallohen nga feja vetë historia e tyre. Serbët kanë jetuar disa shekuj nën sundimin e turqve. Ata vështirë se kanë pasë ndonjë mundësi për zhvillim kulturor. Kjo është arsyeja përse e gjejnë lavdinë te një shtet i fuqishëm ushtarak, ndërsa kroatët, edhe pse nën pushtimin hungarez, gëzuan deri në një farë shkalle autonominë dhe ndikimin e kulturës perëndimore.

Pas mësimit të marrë nga Lufta Botërore, kroatët e shohin shpëtimin dhe mundësinë e tyre për zhvillim në një formë të qeverisjes republikane. Perveç të tjerash, një çerek milion kroatë gjenden në SHBA e nëpërmjet tyre, ndikimi i amerikanizimit ndihet praktikisht në çdo fshat të Kroacisë.

Por ndërkohë që kroatët duan një republikë në Kroaci, me Zagrebin si kryeqytet, ata janë të gatshëm të shoqërizohen me mbretin serb, bazuar në termat e miqësisë dhe barazisë. Serbët po ua imponoin dëshirën e tyre pjesës tjetër të popullsisë me forcën e armëve.

Bernsteini diskuton situatën në Jugosllavi me udhëheqës të ndryshëm kryesisht në zonat fshatare. Udhëheqësi më popullor, piktoresk dhe me ndikim më të madh në Kroaci është Stepan Radicz. Ja si e përshkruan Bernsteini atë:

> Publicist dhe filozof, ai është idhulli i fshatarsisë kroate, e cila përbën pjesën më të madhe të popullsisë. Serbët e konsiderojnë atë si armikun e tyre më të rrezikshëm. Ata e quajnë rebel, prandaj e mbajtën në burg për dy vjet. Fshatarët kroatë e quajnë martir, madje e thërrasin president, e duan si mikun dhe mësuesin e tyre. Ai është futur në burg shtatëmbëdhjetë herë nga autoritetet austro – hungareze, vetëm se ka marrë në dorë luftën për pavarësi të popullit të vet dhe pas luftës është mbajtur në burg për njëzetenjë muaj nga Qeveria e Serbisë.
>
> Stepan Radicz nuk është revolucionar ashtu siç e quajnë serbët. Ai është fetar por jo fanatik. Ai beson në progres dhe nuk është mbrojtës i dhunës. Ai është udhëheqës i përgjegjshëm i popullit, i frymëzuar prej një sensi real drejtësie. Ai është orator brilant dhe shkrimtar i fuqishëm. Portreti i tij gjendet në shtëpitë e fshatarëve.

Radicz e fton Bernsteinin në shtëpinë e tij, por para se të shkojnë atje, ai i tregon monumentet e ngritura shumë vite më parë për poetët, shkencëtarët, filozofët, martirët kroatë. Ai i thotë Bernsteinit: "*Para se të shikoni popullin tonë në fshatra, duhet të shihni se kombi ynë gjithnjë i nderon intelektualët dhe udhëheqësit përpara heronjve ushtarakë.*".

Bernsteini pa me sytë e tij se si fshatarët e përshëndesnin "*Presidentin*", të cilit i ankoheshin për taksat e larta, të vëna nga qeveria serbe për të mbajtur një ushtri të madhe. Ai takon kroatët e kthyer nga Amerika. Nëpër fshatra, në shtëpitë e tyre valvitet flamuri amerikan, por ata janë të pakënaqur, sepse në atdhe nuk kanë gjetur lirinë që mendonin.

Udhëtimin me Stepan Radiczin, Bernsteini e përfundon me një incident të vogël. Makina e tyre prishet rrugës për në Zagreb diku pas mesnatës. Ata kalojnë disa orë, derisa herët, me të zbardhur, gjejnë një çift kuajsh që do t'i çonte në kryeqytetin kroat.

Presidenti amerikan Theodore Roosevelt [219]

Miqësia me Rooseveltin datohet që në vitin 1908, kur Bernsteini i merr një intervistë Kontit Witte në Shën Petërsburg dhe e pyet lidhur me Traktatin e Portsmuthit, në të

cilin presidenti Roosevelt kishte luajtur rol kryesor.

Konti Witt i thotë Bernsteinit se ai ka vetëm një dosje të këtij dokumenti në bibliotekën e tij, ndërsa një kopje gjendej në arkivën e Carit. Bernsteini ulet dhe e kopjon fjalë për fjalë me dorë. Aty gjen telegramet e papublikuara të Konferencës së Portsmuthit, drejtuar Carit nëpërmjet Ambasadorit Amerikan Meyer.

Ai zbulon se aty kishte telegrame, të cilat as vetë Konti Witte nuk i dinte, pasi Roosevelti i dërgonte drejtpërdrejt te Cari. Pas këtij zbulimi, Konti Witte zbret vetë në bibliotekë dhe kërkon të dijë se çfarë kishte gjetur dhe përzgjedhur Bernsteini.

"*Më duhet t'ju komplimentoj për ato që keni zgjedhur,*" - i thotë Konti Bernsteinit. *Por Roosevelti nuk e dinte se telegramet e tij sekrete, dërguar Carit, ky i fundit m'i kalonte mua.*".

Tekstet e këtyre telegrameve Bernsteini i boton në gazetën The New York Times. Fill pas botimit Presidenti Roosevelt e takon Bernsteinin dhe e pyet se si i kishte gjetur këto telegrame. Bernsteini e siguron se telegramet ishin origjinale. Roosevelti konfirmon se ato origjinale ishin, por shpreh keqardhje për faktin se ai kishte ndërmend t'i botonte vetë në kujtimet e tij.

I pari telegram i Presidentit Roosevelt i ishte dërguar Ambasadorit Meyer më 9 gusht 1905. Ai flet për paqen e mundshme midis Rusisë dhe Japonisë. Telegrami i dytë mban datën 13 gusht 1905. Këto telegrame për kohën e tyre kishin përmbajtje me rëndësi strategjike për paqen në dy anët e hemisferave të globit.

Pas botimit të telegrameve, më 13 shkurt 1913, atëherë kur Roosevelti nuk ishte më President i Amerikës, i shkruan Bernsteinit:

> I dashur z. Bernstein,
>
> Në deklaratën që i keni bërë Kontit Witte, mund të kishit shtuar se është fallsitet absurd të mbrosh idenë se ndonjë përfaqësues i Qeverisë japoneze mund të më kishte kërkuar drejtpërdrejt ose jo t'i bazoja bisedimet me ta në faktin se Japonisë po i shterroheshin mjetet për të vazhduar luftën.
>
> Besnikërisht i juaji,
> Theodoree Roosevelt.

Korrespendenca e Herman Bernsteinit me Presidentin Roosevelt vazhdon edhe më tej për të arritur kulmin me parathënien, që ai i bën librit Willy - Nicky Telegrams, korrespondencës sekrete midis Carit të Rusisë dhe Kajzerit të Gjermanisë, i cili trajtohet gjerësisht edhe në këtë libër.

Me Presidentin amerikan Woodrow Wilson [220]

Midis të gjitha figurave të ndritura të fillimit të shekullit XX, me të cilët Herman Bernsteini ka pasur njohje personale, i ka intervistuar, ka mbajtur korrespondencë, ose

ka komunikuar drejtpërdrejt me ta, ai që renditet si më i rëndësishmi, mund të jetë Presidenti Wilson. Kjo jo vetëm për trashëgiminë që Wilsoni ka lënë me aktin e tij të pashembullt në historinë e Shteteve të Bashkuara, duke dërguar për herë të parë jashtë territorit të vendit trupa ushtarake, për deklarimin e 14 pikave të vetvendosjes së kombeve në Konferencën e Paqes në Paris 1919, por dhe mbrojtjen që u bëri territoreve shqiptare nga coptimi i mëtejshëm. Këtu gjejmë edhe një ndërthurje të mrekullueshme të veprimtarisë së këtyre dy burrave në një aspekt, i cili është për ne më i rëndësishmi, atë të mbrojtjes së çështjes shqiptare.
Në artikullin për Presidentin Wilson, Bernsteini midis të tjerash thotë:

> Woodrow Wilson ishte idealist i madh dhe si çdo i tillë edhe ai u zhgënjye. Tragjedia e tij lidhet me faktin se ai ishte shumë përpara kohës së tij. Brezat e ardhshëm të Amerikës do të mësojnë se si të vlerësojnë trashëgiminë e shkëlqyer të idealizmit që ai i ka lënë njerëzimit.

Në këtë shkrim Bernstein jep dhe vlerësimin e Aleksandër Moisiut per Wilsonin. Ai e cilëson Moisiun si *"aktori i madh europian",* i cili ka shfaqur një kuptim të thellë të jetës dramatike të amerikanit të ditëve tona, idealistit suprem, i cili vdiq këtë vit dhe që ka si vendndodhje të renditet me Linkolnin në historinë e Amerikës. Aleksandër Moisiu[221] thotë:

> Pesëdhjetë vite më vonë do të ketë më shumë drama të shkruara rreth Woodrow Wilson, sesa janë shkruar për Napoleonin ose ndonjë personaszh tjetër të shquar të historisë. Në jetën e tij ka një dramë më të madhe sesa ato që ka përshkruar vetë Shekspiri.

Është interesant të nënvizojmë me këtë rast se më vonë miqësia e artistit tonë me Bernsteinin forcohet aq sa ky i fundit, bashkë me të bijën Dorothy, përkthen nga gjuha gjermane në atë angleze dramën "*I burgosuri*", të cilën Alekasandër Moisiu ia kishte kushtuar Napoleon Bonapartit për internimin e tij në Ishullin Elbë dhe që përbën një pjesë të vogël të këtij libri për Bernsteinin.

Më tej Bernsteini thotë se ngritja deri në ato lartësi, të cilat rrallë i mbërrin njeriu, por edhe zhgënjimi i tij, do të kuptohen më mirë në vitet që vijnë, sepse ngjarjet janë shumë afër me të tashmen, për t'u parë në këndvështrimin e duhur.

> Kur Wilsoni i hyri jetës politike atë e shtyu një forcë e re e brendshme bazuar në vlerat e larta morale, pasioni për të drejtën, të drejtën sociale, për një liri të re dhe paqe universale. Ai ishte ai lloj politikani dhe burrë shteti amerikan, i fuqishëm dhe i mprehtë, i përcaktuar për t'i realizuar në jetë teoritë e tij fisnike dhe doktrinat humanitare. Ai nuk ishte vetëm një ëndërrimtar. Idealizmi i tij kishte edhe bazë praktike. Ai shihte shumë më larg në të ardhmen, sesa bashkëatdhetarët e tij dhe tragjedia e tij qëndron në faktin se ai duke qenë shumë përpara në kohë, shpesh keqkuptohej.
>
> Gjatë luftës, Presidenti Wilson u ngrit si figura më e rëndësishme e botës jo vetëm si President i vendit më të madh, më të pasur dhe republikës më të fuqishme, por edhe si zëri i vetë njerëzimit. Ai përfaqësonte një shpresë të re për

> botën. Edhe pse Europa jetonte në çmendinën e kasaphanës, aty papritmas iu shfaqet ndërgjegja e një njeriu të ri të madh, vetë ndërgjegja e lartësuar e Amerikës, Presidenti Wilson me fjalët më të thjeshta, të ndërthurura me elegancë, që mishëronin ideale fisnike. Ai ngjan me një Gospel të ri, që predikon për Sinain.

Bersnteini ndalet tek ajo që përbën trashëgiminë më të mirë të Presidentit Wilson që është *"Formula e tij e vetvendosjes së kombeve."* Ai e mbrojti atë dhe e bëri kauzë të Lidhjes së Kombeve duke e shoqëruar me një thjeshtësi thuajse naive dhe me besim të jashtëzakonshëm. Bernsteini sjell një anekdodë lidhur më Presidentin Wilson dhe atë Francez Clemenceau ku ky i dyti e pyet të parin: "*Përse këmbëngulni kaq shumë në ato katërmbëdhjetë pikat tuaja të vetvendosjes së popujve kur Moisiu na ka lënë vetëm dhjetë komandamente?*"

Kësaj pyetje, thuhet se Wilson iu përgjigj: "*Nëse më garantoni se do t'i zbatojmë dhjetë komandamentet në Konferencën e Paqes, unë do të isha krejt i gatshëm të heq dorë prej katërmbëdhjetë të mijave.*"

Ai erdhi në Europë si ndërmjetësues i madh i paqes, thotë Bernstein. Popujt, veçanërisht ata të vegjël, panë tek ai një prej liderëve më të mëdhenj të botës - mishërimin e shpresës dhe shpëtimit të tyre. Popujt e adhuruan atë në Itali, Belgjikë, Çekosllavaki. Ata ndezën qirinj madje edhe në Siberinë e largët dhe popujt e pushtuar panë tek ai një shpëtimtar.

Ajo që ai bëri në Europë u duartrokit prej milionave, sikundër nuk kishte ndodhur kurrë me ndonjë lider qoftë politik apo edhe fetar. Ai u pa si një lider idealist, që përfaqësonte një shtet gjigant, të cilin nuk ishte e lehtë ta kundërshtoje. Liderët europianë nuk guxuan ta kundërshtonin dhe mbetën me shpatulla të rrudhura, kur ai fliste. E vetmja gjë që iu mbetej atyre ishte të pranonin në heshtje, edhe pse pa dëshirë.

Një prej trashëgimive të Wilsonit ishte shkatërrimi i Dinastisë së Hohensollenëve dhe i kajzerizmit. Wilsoni i drejtoi forcat morale dhe fizike të Amerikës kundër kajzerizmit dhe e shtypi atë. Kjo ishte arritje monumentale.

Bernsteini e ka takuar Presidentin Wilson në Hotel Crillon në, Paris, një ditë, përpara se ai të kthehej për Amerikë.

Ai e ka ndjekur atë tek iu fliste një grupi korrespondentësh amerikanë rreth Traktatit të Paqes. Ai e pranoi se dokumenti nuk ishte më i miri, por ishte më i mirë se ç'pritej. Bernsteini tregon se një prej gazetarëve e pyeti Presidentin se a duhet të merret Amerika me tërë shqetësimet e botës? Ai iu përgjigj: "*Kudo që të nevojitet të bëhet drejtësi, nëse ajo do të bëhet ndonjëherë, pa marrë parasysh për një grup të madh apo të vogël, forca morale e Amerikës duhet të jetë aty, për të mbrojtur ata që janë dëmtuar ose shtypur.*".

Kontaktet e Bernsteinit me Presidentin Wilson ishin të hershme dhe të vazhdueshme dhe fillojnë qëkurse ishte Guvernator i New Jersey, në vitin 1911, kohë kur ai vendosi të hynte në politikë, duke sjellë në skenën amerikane një frymë krejt të re.

Korrespondenca midis të dyve është një material për studim në vete, por ia vlen të përmendet një moment shumë i rëndësishëm, i cili vërteton marrëdhënien e ngushtë midis tyre. Bernsteini thotë se ai pati privilegjin ta prezantonte Wilsonin në fazën e konkurimit të tij si kandidat për President i SHBA-ve në Klubin Kombëtar të Artit, para një delegacioni prej më se njëqind gazetarësh dhe botuesish të gazetave në gjuhë të huaja. Ata ishin grumbulluar të bisedonin për problemin e emigracionit. Me këtë rast

Bernsteini iu drejtohet të pranishmëve:

> Ju që keni ardhur në këtë vend prej pjesëve të ndryshme të Europës, në kërkim të një vendbanimi dhe lirie, ju të gjithë jeni amerikanë, ose njerëz që synoni të bëheni amerikanë. Ju keni sjellë me vete traditat më të mira, idealet tuaja të larta dhe fisnike, energjinë, sinqeritetin dhe thjeshtësinë, dashurinë për letërsinë dhe kulturën e lartë, të kaluarën e lavdishme të kombeve tuaja. Këtu në këtë vend të madh të tolerancës dhe mundësive të barabarta ju po luftoni për të ardhmen tuaj së bashku me popullin amerikan. Të gjithë ne jemi të interesuar për një Amerikë më të mirë dhe sa më e mirë të jetë Amerika, aq më mirë do jetë pjesa tjetër e botës.

Wilsoni u shpreh kështu:

> Unë përherë e kam ndjerë kënaqësinë e idesë se Amerika, në një farë shkalle, ekziston në shpirtin e tërë botës. Ka njerëz që vijnë në këto brigje për të treguar forcën e tyre në çështjet tona. Ata sjellin Amerikën te një koncept më i gjallë, sesa ai që ka në të vërtetë madje përtej asaj që e mendojmë shumë prej nesh, të cilët janë lindur dhe rritur këtu. Dua ta mbyll këtë bisedë, duke mos ju konsideruar juve korrespondentë të huaj, por amerikanë. Gjuhët që keni sjellë me vete janë pasuri për ne.

Bernsteini ka një mori letrash të shkëmbyera me Presidentin Wilson. Gjatë periudhës së hershme të Luftës Botërore, para se SHBA-të të përfshiheshin, Presidenti Wilson i thotë Bernsteinit gjatë një takimi në Shtëpinë e Bardhë: *"Sa kohë që gjermanët më akuzojnë sikur jam pro – aleatëve, ndërsa aleatët besojnë se unë jam pro – gjerman, ndjehem i qetë, se po ndjek kursin e duhur të asnjanësisë, kursin e drejtë që duhet të ndjekë Amerika."*

Në vitin 1914, kur Bernsteini themeloi gazetën e përditshme hebraike "*The Day*", Presidenti Wilson i dërgon atij një telegram, në të cilën e përgëzon për atë gazetë, e cila nxit interesin e lartë rreth hebrejve të Amerikës.[222]

Po ashtu, Bernsteini këmben letra me Presidentin më 18 mars 1915, 16 qershor 1916, 20 shtator 1916.

Një korrespondencë dhe komunikim i tillë i Bernsteinit me Presidentin Wilson vërteton edhe njëherë rëndësinë e kësaj figure, i cili do të shërbente për disa vite si Ministër i SHBA-ve në Mbretërinë Shqiptare.

Me Presidentin amerikan Herbert Hoover[223]

Më 21 dhjetor 1922 Bernsteini merr një letër personale nga Herbert Hoover, atë kohë Sekretar i Departamentit të Tregtisë. Hooveri e falënderon Bernsteinin për artikullin e

botuar më 18 dhjetor 1922 dhe artikullin e parapërgatitur për numrin e ardhshëm të periodikut “Our World”. Hooveri i thotë atij se e ka lexuar artikullin me shumë interes” “Kjo përbën, thotë Presidenti i ardhshëm amerikan, një shtesë ndaj tërë diskutimeve të këtyre marrëdhënieve të ndërlikuara.”

Nënshkruar Herbert Hoover.

HERBERT HOOVER, NJERIU QË E SOLLI AMERIKËN NË BOTË. Libër i Herman Bernstein

Në vitin 1925 Herman Bernsteini boton një libër me titull “*Herbert Hooveri, njeriu që e solli Amerikën në Botë*”. Pas katër vitesh, në 1929 Hooveri do të zgjidhej Presidenti i 31-të i SHBA-ve, pasi vinte nga një karrierë e shkëlqyer politike. Mbi kontekstin historik të këtij botimi Bernsteini nxjerr në pah disa elemente:

Së pari, kontributin e jashtëzakonshëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në nxjerrjen e Europës nga bataku që po vetëzhytej. Kujtojmë se jemi pas Luftës së Madhe, që i kushtoi njerëzimit miliona jetë njerëzish. Pa zbarkimin e SHBA-ve në Europë, ajo luftë do të merrte edhe miliona të tjerë.

Së dyti, pa ndihmat e Shteteve të Bashkuara me ushqime, veshmbathje dhe ilaçe plagët e luftës nuk do të mund të ishin mbyllur, madje mund të kishin shkaktuar edhe konflikte të tjera.

Së treti, Bernsteini, si njohësi më i mirë i Rusisë së asaj kohe në Shtetet e Bashkuara, flet hapur për epideminë bolshevike. Njeriu që njihte psikologjinë, letërsinë, politikën, botën intelektuale ruse, Herman Bernstein ishte i mirëinformuar mbi atë që mund të pritej prej bolshevikëve në vitin e tetë të qeverisjes së tyre brutale.

Në këtë libër Bernsteini fillimisht thotë:

> Kataklizma e Luftës Botërore, e cila çrrënjosi dinastitë dhe zgjidhi pasionet e ushtrive, mosmarrëveshjeve dhe revoltave, solli në skenë disa udhëheqës dhe figura legjendare. Apostuj dhe heronj të rinj dolën që të mbrojnë botën. Disa prej këtyre “apostujve” tashmë e kanë diskreditуar vetveten, sepse doktrinat dhe kulminacionet e tyre janë provuar si të dështuara. Të tjerët kanë mbijetuar tragjedinë e luftës dhe pasojat e paqes dhe do të kujtohen dhe vlerësohen për një kohë të gjatë prej brezave të ardhshëm për idealizmin e tyre të pakufishëm, për vizionin e tyre të madh dhe shërbimin e paçmueshëm që i kanë bërë qytetërimit.
>
> Është një burrë, i cili i ka shërbyer Amerikës gjatë periudhës më të pakëndshme të historisë së botës, por që i ka shërbyer edhe botës nëpërmjet Amerikës. Ai është një njeri i dashur në çdo cep të globit. Ky është Herbert Hoover. Është njeriu që e solli Amerikën në Botë. Ai, pa as më të voglin dyshim,

është heroi më popullor jashtë vendit të tij. Ai ka shpëtuar miliona njerëz, nëpërmjet punës ndihmuese humanitare gjigante gjatë luftës dhe pas pushimit të saj. Ai ka shpëtuar miliona jetë fëmijësh në vendet aleate, por edhe në ato të Fuqive Qendrore.

Amerika mori pjesë në dy ndërhyrje që e shpëtuan Europën nga shkatërrimi në udhëkryqin e saj më kritik. Amerika e shpëtoi Europën nga triumfi i militarizmit prusian dhe pasojat e tij, duke hyrë në luftë në prill të vitit 1917, fill pas rënies së autokracisë ruse. Njerëzit nuk e kuptojnë ende se çfarë do të kishte ndodhur, nëse do të fitonte militarizmi prusian. Gjatë luftës, Amerika i erdhi në ndihmë Europës, duke dërguar ndihma si dhe bijtë e saj në fushë betejë. Amerika i erdhi në ndihmë edhe Belgjikës në një shkallë të plotë. Herbert Hooveri, i cili organizoi dhe drejtoi tërë këtë makineri ndihmash është vetë shpirti i vërtetë amerikan, që e shpëtoi Belgjikën nga vdekja prej urisë.

Pastaj, pas luftës, vjen ndërhyrja e dytë e Amerikës në Europë. Kjo ishte ndoshta edhe më e madhe dhe më e rëndësishme, sesa e para. Europa po ziente nga trazirat, në agoninë e luftës që tronditi botën. Ndërsa Rusia ishte kthyer në një laborator kaviesh bolshevike që popullsinë ruse e trajtoi si lepuj dhe derra eksperimentalë.

Bolshevizmi u mendua fillimisht si ilaçi shërues i botës së re për të gjitha sëmundjet sociale. Masat e njerëzve të mësuar me mospajtimin, zemërimin, dështimin dhe poshtërimin ngado, panë tek eksperimenti rus shpëtimin e botës. Revolta dhe kaosi u ngritën si fantazmë në protestat ndaj tiranisë së Carit dhe bënë që tërë Rusia të ngrihej në këmbë. Por jashtë atij vendi, bota dinte shumë pak dhe epidemia e revolucionit socialist ishte gati të shpërthente në tërë Europën. Popujt ishin të pakënaqur. Lufta la miliona të gjymtuar e të plagosur, vejusha e jetimë, një botë të shkalafitur andej këndej, që vuante pasojat e saj. Ishte pikërisht ajo kohë, kur Herbert Hooveri nëpërmjet Këshillit Ekonomik Suprem të përfaqësonte Amerikën, ta shkelte vetë dhe ta mbronte Europën nga epidemia e bolshevizmit. Ai e kuptoi baticën në ngjitje, e cila do të përfshinte tërë Europën dhe do të shkatërronte institucionet e saj të kulturës, gjë që mund të arrinte edhe në anën tjetër të Atlantikut, në brigjet tona. Përparimi i qytetërimit mund të ishte ndërprerë për një kohë të gjatë. Ishte imagjinata dhe largpamësia e Hooverit, përcaktimi dhe guximi i tij si Yanky, njohuritë e tij të gjëra rreth botës dhe njerëzve dhe mbi të gjitha, gjenia e tij e lindur si organizator, që e shpëtoi botën nga një katastrofë edhe më e madhe, sesa Lufta Botërore.

Historia e jetës së Herbert Hoover është një romancë aventureske e punës së palodhur, energjive të pashtershme dhe guximit të pashoq, përvojës së pafund dhe përgatitjes së tij të lartë, për t'u ballafaquar me sfidat e jetës, në shkollë, në jetë dhe në pjesë të ndryshme të botës.

Në vitin 1917, Hooveri emërohet nga Presidenti Wilson, Administrator i Ushqimit dhe Kryetar i Komisionit të Ndihmave për Belgjikën. Ndërkohë ai ishte propozuar që të merrte drejtimin e Komitetit të Ndihmave për Rusinë, e cila: "po përpëlitej midis brutalitetit të caristëve, që kërkonin të ktheheshin në pushtet dhe dhunës së bolshevikëve që e kishin marrë atë".[224]

Hooveri, me veprimet e tij të guximshme, e shpëtoi Europën nga një katastrofë e re e pas Luftës së Madhe. Në një kërkesë që ai i bën Presidentit Wilson për furnizim me ushqime në zonat europiane të urisë masive ai shkruan[225]:

Pse duhet ta ushqejmë Gjermaninë:

1. Të gjitha të këqijat vijnë nga stomaku.
2. Nga pikëpamja ekonomike, janë 70 milionë njerëz që duhen ushqyer, që të prodhojnë dhe prodhimi varet nga ushqimi.
3. Uria sjell anarki dhe anarkia destabilizon jo vetëm Gjermaninë, por edhe Francën dhe Britaninë e Madhe.
4. Sa kohë gjermanët nuk kanë të hanë, kot pritet që ata të paguajnë dëmshpërblimet e luftës.
5. Nga ana humanitare, janë fëmijët dhe gratë që e vuajnë më shumë urinë.
6. Nga pikëpamja ushtarake, ushtarët tanë duhet të kthehen në shtëpi.
7. Nga pikëpamja monetare, i kursen Amerikës shumë shpenzime dhe i kthen njerëzit në vendet e tyre të punës.
8. Nga pikëpamja e pozitës negociuese të Amerikës, ne do të gjendemi në pozitat më të forta.

Kërkesa e tij përqendrohet te heqja e embargos ndaj ushqimeve, që i ishte imponuar Gjermanisë në atë kohë.

Herman Bernstein, në librin e tij, sjell edhe një episod shumë interesant lidhur me ekzekutimin nga ana e Krybashkiakut të Varshavës të 37 hebrejve më 11 prill 1919, me pretekstin se ata ishin të gjithë bolshevikë. Hebrejtë kishin shkuar të merrnin ushqimet e siguruara nga Komiteti i Ndihmave, por ishin marrë për bolshevikë që mblidheshin "*në një takim komunistësh*". Qëndrimi i Herbert Hooverit lidhur me këtë çështje është i prerë dhe ai menjëherë takohet me Kryeministrin polak të asaj kohe Ignacy Jan Paderewski.

Ndërkohë ai i shkruan edhe Lordit anglez Cecil, më datën 1 qershor 1919, duke konfirmuar angazhimet Amerikane në Europë.[226]

Më tej në librin e tij, Bernstein konstaton se Herbert Hoover nxori në pah më mirë se askush tjetër në Paris rrezikun e madh që përfaqësonte bolshevizmi. Ai asnjëherë nuk ndërhynte në punët politike, por, kur politika ndërhynte te të ushqyerit e fëmijëve të popullsisë civile, atëhere ai gjente mënyrat si të ndërhynte te politika, për t'i bindur ata që të mos preknin në punët e organizatave amerikane të ndihmave dhe mëshira që tregonin ato. Në këtë aspekt, konstaton autori, ndikimi i punës humanitare të Hooverit ishte më i madh se vetë ndikimi ushtarak.

Hooveri arriti të bënte një marrëveshje me qeverinë sovjetike, prej së cilës Administrata Amerikane e Ndihmave u lejua të shpërndante ndihma në Rusi. Kjo solli shpëtimin e miliona fëmijëve rusë, pjesa më e madhe e të cilëve për shkak të diskriminimit politik rus, mund të vdisnin pa asnjë ndihmë.

Ndihmat ushqimore amerikane nën drejtimin e Hooverit arritën të shpërndahen në Belgjikë, veri të Francës, Danimarkë, Hollandë, Itali, Gjermani, Austri, Bullgari, Turqi, Çekosllavaki, Poloni, Hungari, Rumani, Serbi, Kroaci, Lituani, Letoni, Estoni, Finlandë, Rusi, Armeni dhe në qytetin e Danzingut.

Janë miliona e miliona dollarë dhe po ashtu miliona tonë ushqime të shpërndara njerëzve në nevojë të asaj kohe. Një sipërmarrje organizative e jashtëzakonshme dhe e paimagjinueshme në një periudhë kohore disavjeçare. Në këtë veprimtari ishin përfshirë shoqatat më të mëdha të ndihmave të Shteteve të Bashkuara, të gjitha nën drejtimin e Herbert Hooverit.

Në një intervistë që Bernsteini i merr Hooverit, ai na jep një përshkrim për

marrëdhëniet e tij me Presidentin e Amerikës Harding, në vitin 1923. Hooveri i shkruan Presidentit Harding përshtypjet e tij nga shpërndarja e ndihmave në Rusi dhe thotë: *"Në sytë e rusëve të varfër, dërgimi i ndihmave amerikane ishte një mrekulli e rënë nga qielli."*. Bernsteini, pasi shpjegon veprimtarinë e Hooverit, pra Presidentit të ardhshëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (1929-1933), e mbyll me këtë konstatim:

> Herbert Hooveri përfaqëson pikërisht zemrën e Amerikës ndaj Botës. Ai e përktheu idealizmin e Amerikës në shërbim humanitar, jo vetëm duke shpëtuar popullatën europiane prej urisë gjatë katastrofës më të madhe botërore, por edhe duke vënë në pah valën e anarkisë dhe revoltën e papërmbajtur, që rrezikonte civilizimin dhe mirëqënien për brezat e ardhshëm."

Për herë të parë në historinë e kombeve, Amerika bëhet mbështetje e vëllëzërve pa asnjë motiv egoist, pa menduar për të marrë asnjë lloj fitimi prej saj në këmbim. Dhe këtë e organizoi pikërisht, njeriu që e solli Amerikën në Botë, Herbert Hooveri."

A MUND TË SHMANGIM LUFTËN? [227]

Libri i fundit i Herman Bernsteinit

Pasi e la detyrën e Ministrit Amerikan në Tiranë, Herman Bernsteini iu kthye përsëri profesionit të tij të dashur, gazetarisë dhe shkrimeve. Ai duket se kishte një shqetësim shumë të madh për rrezikun e luftës, që po i kanosej botës në atë kohë. Si intelektual i shquar amerikano - hebre, si gazetar, shkrimtar, diplomat e humanist, ai angazhohet në një betejë publike për shmangien e luftës dhe gjen mënyrën e tij për të sensibilizuar njerëzimin rreth këtij kërcënimi. Si zë i fuqishëm dhe autoritar ai ka besueshmërinë që

t'u drejtohet 100 njerëzve më të famshëm të kohës së tij. Me shumë prej tyre ai kishte pasur marrëdhënie edhe më pare dhe merr përgjigje prej dyzet syresh. Pasi merr përgjigje prej tyre, ai i formulon dhe i boton ato në librin me titullin "A mund ta shmangim luftën?".

Në shënimin hyrës Bernstein shkruan:

> Disa muaj më parë iu dërgova njëqind letra burrave dhe grave më eminente në fusha të ndryshme anë e mbanë botës. Atyre iu kërkova sugjerime ose formulën për vendosjen e një paqeje të qëndrueshme.
>
> Kam marrë deklarime prej dyzet syresh nga SHBA, Austria, Çekosllavakia, Anglia, Greqia, Haiti, Hungaria, Meksika, Norvegjia, Paraguaji, Suedia, Venezuela, si dhe nga shumë gjermanë të shquar, tani në mërgim.
>
> Dua të shpreh mirënjohjen e thellë ndaj tërë atyre që kontribuan me idetë e tyre në këtë libërth të vogël për paqen.
>
> Një mirënjohje e veçantë shkon te botuesi dhe korrektuesi i librit si dhe për lejen që më dhanë për të riprodhuar disa prej deklaratave, të cilat ishin përfshirë në artikullin tim të publikuar në një botim të fundit në atë revistë popullore.
>
> Herman Bernstein, 2 prill 1935, New York.

Në letrën tip dërguar këtyre 100 personaliteteve ai midis të tjerash shkruante:

> Të paktën Adolf Hitleri e ka hequr maskën paqësore dhe ka zbuluar para botës fytyrën e shëmtuar të luftës. Vetëm një front i bashkuar i kombeve për paqen, kristalizimi i një opinioni të shëndoshë publik mund të shpëtojë njerëzimin nga katastrofa që po i kërcënohet në të ardhmen e afërt.
>
> Në një emision radiofonik që pata më 30 janar 1934, iu referova rrezikut hitlerian ndaj paqes në botë si më poshtë:
>
> Vite të tëra pas luftës, populli gjerman, nën regjimin republikan, u përpoq ta rihabilitojë vetveten me punë të palodhur. Duke qenë verbuar nga propaganda e luftës, ata ndjenë dhimbjen e stigmës së fajit të luftës, të lënë nga traktatet e paqes. Ata në fakt besojnë se Gjermania ishte krejt e pafajshme dhe nuk kishte asnjë përgjegjësi për zhytjen e Europës në luftë të përgjakshme. Populli gjerman punoi shumë, por ata kundërshtuan të mobilizojnë shpirtin e tyre luftarak.
>
> Të rinjtë e deziluzionuar gjermanë, të cilët besojnë se Gjermania ishtë krejt e pafajshme, mendojnë se e vetmja rrugë për restaurimin e fuqisë gjermane është armatosja, prandaj edhe kanë filluar të ndjekin Hitlerin, demagogun e urrejtjes, i cili iu ka premtuar bukë të uriturve dhe lavdi të vdekurve. Gjermania është sot e helmuar nga urrejtja dhe marrëzia, me venomin fetar dhe racial. Nazistët kërkojnë barazi midis kombeve dhe "të drejtën" për t'u riarmatosur.
>
> Që bota të shpëtojë nga testamenti i purpurt i gjakderdhjes së luftës, popujt nga çdo vend i botës duhet t'i qëndrojnë besnikë testamentit të paqes. Në qoftë se civilizimi dështon të ndalojë marrëzinë e luftës, atëherë me siguri marrëzia e luftës do ta shkatërrojë qytetërimin.

Në parashtrimin e tij mbi shmangien e luftës, Bernsteini citon shumë personazhe historike. Ndër ta edhe Presidentin Wilson dhe rolin që ai luajti në shpëtimin e kombeve të vogla me paraqitjen e 14 pikave të vetvendosjes së kombeve në Konferencën e Paqes

në Paris.

Bernsteini si njohës i shkëlqyer i historisë, vëren se janë bërë përpjekje më të hershme për të arritur paqen midis kombeve. Ai përmend se në vitin 1713 Abbe de Saint Pierre[228] ishte ai që propozoi një plan për shmagien e luftës. Ai ishte një projekt i njëzet e tre vendeve të krishtera, të cilat do të organizonin një aleancë të përhershme për sigurinë e tyre të ndërsjellë edhe nga luftërat midis shteteve edhe nga luftërat civile, duke garantuar edhe zotërimet e tyre edhe traktatet e paqes. Kështu do të formohej një Senat i Paqes. Aleanca duhej të armatosej e tëra dhe të ndërhynte ndaj atij shteti, që krijonte konflikt.

Në fakt, duket se kjo nismë e asaj kohe përbën edhe zanafillën e përpjekjeve të vendeve perëndimore për krijimin e një aleance që do të ruante paqen. Ndoshta ajo që sot ekziston në formën e asaj që njihet si Aleanca e Atlantikut Verior, NATO, mund ta ketë fillesën pikërisht atje.

Po kështu, na kujton Bernstein, përpjekje të tilla u bënë në vitin 1879 nga filozofi dhe juristi anglez, Jeremy Benthan[229] i cili publikoi një plan paqeje midis kombeve si dhe një Gjykatë Ndërkombëtare, e ngjashme me atë që sot njihet si Gjykata e Hagës. Të njejtën gjë propozonte edhe Immanuel Kanti, i cili idenë e tij e bazonte në një federatë të përgjithshme të shteteve, por në një kuptim më të gjerë, një paqe universale.

Bernsteini, po ashtu, vëren se pajtohet me financierin hebre rus, Jean Bloch, tetëmbëdhjetë vjet para se të shpërthente Lufta e Madhe, i cili thoshte: *"Luftërat nuk vijnë nga dëshira për luftë, por nga uria, e cila sjell falimentimin e shteteve dhe anarkinë sociale."*

Më tej ai shton se sipërmarrja më e madhe ndërkombëtare ishte organizimi i Lidhjes së Kombeve. Edhe pse ajo lindi si rezultat i luftës midis kombeve të mëdha, ato vetë e kanë përdorur Lidhjen për të shtypur kombet e vogla dhe kanë përparuar në realizimin e përmbushjes së interesave të tyre. Kjo solli që shumë kombe të vogla të mos i besonin më kombeve të mëdha. Më pas vijnë Traktati i Lucarnos dhe Pakti Kelloge – Briand,[230] i të konsideruara si arritje të jashtëzakonshme.

Bernsteini arrin në përfundimin se:

> Shpresat për paqe varen tek mirëkuptimi i përftuar bazuar në mësimin e marrë nga tmerret e patregueshme të luftës, në çmobilizmin e psikologjisë së luftës, kudo që ajo të manifestohet dhe në mobilizimin e të gjitha forcave konstruktive, morale dhe ekonomike, për gatishmërinë për paqe. Ajo që i nevojitet sot botës nuk është asgjë më pak se demokracia, mirëkuptimi më i lartë, më shumë drejtësi sociale dhe çmobilizim i plotë i forcave të urrejtjes dhe fanatizmit. Disa prej formulave të paraqitura në këtë libër përbëjnë sugjerime praktike për zgjidhjen e problemeve më të rëndësishme, me të cilat ballafaqohet qytetërimi ynë sot.[231]

Përgjgjet që merr Bernsteini nga letra e dërguar për paqen përmbledhur në librin e tij të fundit

Bernsteini mori përgjigje nga dyzet personalitete të shquara të botës. Ndër ata që janë

shumë të njohur për ne shqiptarët mund të përmenden Jane Admas, Lordi Robert Cecil, shkrimtari Theodore Draizer, ish-Presidenti Amerikan Herbert Hoover, shkrimtari Hainrih Haine, Austen Chamberlian, psikanalisti Sigmund Freud etj. Le të shohim shumë shkurt një përshkrim të përgjigjeve drejtuar Herman Bernsteinit.

Carl William Ackerman,[232] Dekan i Shkollës së Gazetarisë në Universitetin Columbia, New York

> Shtypi sot është termocentrali i demokracisë. Gazetat amerikane janë zëri i popullit. Liria në formën latine apo anglo-saksone është e kufizuar gjithkund me përjashtim të SHBA-ve, Anglisë, Australisë, Kanadasë, Afrikës së Jugut, Zvicrës, Hollandës, Danimarkës, Norvegjisë, Suedisë dhe Zelandës së Re. Shtypi i lirë dhe informimi publik, bashkë me organizmat ndërkombëtare dhe shoqëritë të shqetësuara për luftën, mund të përbëjnë pengesën që i pret rrugën asaj. Ekziston ende mundësia për parandalimin e luftës. Edhe, nëse i shohim të pamundura, ne njerëzit e lirë duhet të kontribuojmë me idetë tona, përpara se të shohim aeroplanët që bombardojnë dhe fushat e betejave të mbushura me të vrarë.

Jane Adams,[233] fituese e Çmimit Nobel[234]

Jane Adams iu përgjigj letrës së Bernsteinit pak kohë, para se ajo vetë të largohej nga kjo jetë (21 maj 1935). Ajo mendonte se mënyrat për të shmangur luftën ishin:

1- Marrëdhëniet e mira komunikuese dhe njohja e popujve me njëri-tjetrin.
2- Paqja mund të vijë vetëm nëse njerëzit janë të përkushtuar për ta sjellë atë.
3- Paqja botërore është produkt politik. Një mbretëri e paqes qëndron krejt afër nesh, e gatshme, për të ardhur në ekzistencën e saj. Për ta bërë atë reale, është detyra e njerëzve që mbushin rruzullin sot.

Eusebio Ayala [235], President i Paraguajit [236]

> Megjithëse vendi im është në luftë, prapësprapë shpresat e mia për paqe nuk janë zbehur. Misticizmi i luftës e ka mbizotëruar përherë njerëzimin.

Nicholas Murray Buttler [237] President i Universitetit Columbia, fitues i Çmimit Nobel [238]

> Paqja mund të arrihet, kur themelet e saj ndërtohen mbështetur në besim reciprok dhe ai besim duhet të jetë edhe intelektual, edhe moral, prandaj edhe e gjen shprehjen e saj në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin ndërkombëtar.

Lord Robert Cecil, personalitet i politikës britanike

Njerëzit e duan paqen, po përse nuk e arrijnë atë? Kjo për shkak të doktrinës së mallkuar të nacionalizmit. Nacionalizmi është sinonimi i zhurmshëm i egoizmit, individit më të neveritshëm, që karakterizohet me fjalët: "Vetëm ne", "Vetëm unë", "Vetëm vendi im", për mbarë apo për mbrapsht, "Deutchland über Alles"[239] dhe një dyzinë parullash amorale, kudo që gjenden. Derisa kombet dhe sunduesit e tyre të pushojnë së menduari vetëm për interesat e tyre dhe të fillojnë të kujdesen edhe për interesat e të tjerëve, nuk mund të ketë paqe të qëndrueshme.[240]

Theodore Drajzer, shkrimtar [241]

Si të arrijmë paqen? Bindi njerëzit e mençur në çdo vend të studiojnë ekonominë e re, e cila përfshin të gjitha qëllimet e reja, përdorimin demokratik dhe të njejtë të përfitimeve për të gjithë.

Julius Goemboes, Kryeministër i Hungarisë [242]

E tërë bota thërret sot: "Jo më luftra! Parandaloni luftën me çdo mjet!" Unë e kam theksuar në shumë raste se qëllimi i vetëm i Hungarisë është paqja. Të gjithë burrat e shtetit të Europës duhet të bashkojnë forcat, për të gjetur një zgjidhje të drejtë dhe të ndershme ndaj situatës kritike, që ka mbërthyer Europën. Qëllimi është të ruajnë paqen, duke siguruar superioritetin e moralit të lartë mbi forcat brutale. Kjo vjen me përpjekje të paepura për një fitore përfundimtare të drejtësisë.

Gjeneral Juan Vicente Gomes[243], President i Venezuelës [244]

Në gjendjen që jemi, nuk besoj se mund të ketë një formulë për paqen që të kënaqë dëshirat e të gjithëve.

Herbert Hoover, ish-President i Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Paqja nuk është diçka statike. Ruajtja e paqes është po aq dinamike në kërkesat e saj sa ç'është nisja e luftës. Ne nuk mund të themi: "Le të ketë paqe" dhe të merremi me gjëra të tjera! Nuk janë as metodat prej të cilave paqja duhet të ruhet dhe lufta të parandalohet, të ndërtohen me parulla a fraza abstrakte prej teorive akademike. Përparimi drejt paqes mund të arrihet vetëm si rezultat i të sjellurit të përditshëm praktik midis kombeve. Ajo mund të vijë si rezultat vetëm i njohjes miqësore të forcave, të cilat mund ta cënojnë paqen.

Ne duhet që me mirëkuptim të pranojmë faktin se ne dhe të tëra kombet e botës do të përfshihen për tërë kohën e ardhshme në kontradikta dhe përçarje të vogla e të mëdha, duke parë ngritjen e shumë kauzave. Në tërë këto kundërshti fshihet rreziku i padukshëm, që pasioni i verbër nacionalist mund të ngrihet deri në pikën e përflakjes, prandaj paqja duhet të jetë rezultat i përpjekjeve të pareshtura.

Alfred Kerr, kritik letrar gjerman në mërgim[245]

Unë jam mik i kafshëve, megjithatë them se një qen i çartur duhet vrarë. Unë jam gjithashtu pacifist, megjithatë një politikan - qen i çartur duhet vrarë. Mos e vra atë me masat idiotike dhe të kushtueshme të luftës. Vraje ekonomikisht, por ama, vraje atë! Vraje! Vraje atë qen! Vraje atë qen të çartur, ama vraje!

Heinrich Man, autor gjerman në mërgim[246]

Përgjigjja ndaj pyetjes suaj varet nga përvoja ime. Unë jam një prej atyre që ka humbur vendin e vet, pasi tek ne nuk ka më vend për miqtë e paqes, përveçse në kampet e përqëndrimit. Përgjigjja do të ishte kjo:

Tëra ato fuqi që iu intereson paqja duhet të ndalojnë Gjermaninë dhe ta ndalojnë atë tani në rrugën që po na çon drejt një katastrofe të përgjithshme. Për të qenë më i qartë, Amerika dhe Anglia duhet të marrin një qëndrim në krah të Francës. Ato nuk duhet të përpiqen të ndërmjetësojnë, të ndërtojnë urat nëpërmjet ndërmjetësimit, ose të rrinë duarkryq.

Për mua personalisht nuk mendoj se njerëzimi ekziston thjesht dhe vetëm për hatër të kapitalizmit, pikërisht sikundër Gjermania nuk ekziston vetëm për hatër të Rajhut të Tretë. Qytetërimi botëror, rregullimet njerëzore, përparimi i drejtësisë dhe lumturisë janë pafundësisht më të rëndësishme. Për aq kohë sa ka qenë e mundur të bëja kështu, unë luftova për të gjitha këto gjëra. Qëkur edhe zëri im edhe çdo fjalë e së vërtetës u ndalua të dëgjohej në Gjermani, unë ndaj me të tjerët krejt çfarë di nga përvojat e mia të vështira dhe ju siguroj që jam duke e bërë këtë, bazuar në motivet më të thjeshta.

Gerald P. Nye [247], Senator Amerikan [248]

...Do të ishte e padrejtë të themi se prodhuesit e municioneve janë tërësisht përgjegjës për luftrat, pasi ata nuk janë. Por mund të thuhet plotësisht se rreziku i më shumë luftrave mund të reduktohet në masë shumë të madhe, duke hequr elementin e përfitimit nga gatishmëria dhe pritshmëria e çfarëdo lloj përfitimi që sjell lufta, për këdo qoftë.

Gjeneral P. Tsaldaris, Kryeministër i Greqisë [249]

Mendoj se unë mund të kërkoj që Greqia dhe fqinji i saj Turqia të jenë krenare për vetveten, për atë që kanë dhënë për konsolidimin e paqes së qëndrueshme. Në fakt, ka pak shembuj të tillë kaq të habitshëm në historinë e dy popujve, të ndarë me shekuj prej mosmarrëveshjeve dhe armiqësive, që të kenë dhënë impulse të përbashkëta për t'u pajtuar dhe për të harruar të kaluarën e furishme dhe të përgjakshme, për t'u bërë kampionë të paqes në Lindjen e Afërt. Ecja krah për krah e dy vendeve në këtë mënyrë nuk është thjesht akt i arsyes së imponuar prej politikës së dy vendeve, por edhe i shprehjes së vërtetë të ndjenjave vëllazërore midis dy popujve.

Hartimi i përbashkët në fillim të tetorit 1930 i një traktati miqësie gjeti përkushtimin e shkëlqyer në projektin e marrëveshjes miqësore të nënshkruar në Angora, në shtator 1933. Përpjekjet e dy vendeve u kurorëzuan me sukses. Edukimi kombëtar i rinisë i vulosur me një kulturë të bazuar në shoqërimin dhe respektimin e të tjerëve, do të përshpejtojë mirëkuptimin reciprok midis popujve, të cilët shpesh dinë fare pak për njeri-tjetrin, edhe pse janë fqinjët më të afërt. Ndoshta zhvillimi i ndërkomunikimit intelektual do të jetë preludi i një përpjekjeje të përbashkët, e cila do të sigurojë ndaj kombeve një periudhë qetësie, si e vetmja mënyrë për t'u kthyer te mirëqenia.

Austin Chamberlain [250], politikan britanik, fitues i Çmimit Nobel

Unë nuk kam ndonjë formulë për paqen dhe më duhet të rrëfehem, se nuk besoj në gjykimet e atyre që thonë se e kanë një të tillë[251].

Abraham I. Elkus, ish-Ambasador Amerikan në Turqi [252]

Është e kotë të shpresohet për paqe botërore, derisa të arrijmë të vijmë të gjithë së bashku te një bazë mirëkuptimi, tolerance ndaj fqinjëve tanë dhe zhdukejs së babëzisë, zilisë dhe ambicjeve nacionaliste. E di që kjo është gjë e madhe. Kjo mund të arrihet, në qoftë se të gjithë bashkohemi në një proces të ngadalshëm, por këmbëngulës edukimi. Të tëra ilaçet e tjera, besoj unë do të jenë të pavlefshme.

Sigmund Freud, themeluesi i psikanalizës [253]

Shpresoj se ju e dini qëndrimin tim ndaj luftës dhe, nëse e dini, më besoni se unë e urrej atë jo më pak se ju. Por unë rezervohem të jap një formulë për paqen. Unë jam tërësisht, thellësisht dhe dhimbsurisht i bindur për kotësinë e tërë demonstrimeve që bëjnë gazetat.

Selma Lagherlof [254], shkrimtare suedeze, fituese e Çmimit Nobel [255]

> Nëse do të kisha ndonjë formulë se si të bëhej paqja do të isha shumë, shumë e lumtur t'jua dërgoja, për ta përdorur për librin tuaj. Mjerisht nuk kam asnjë të tillë që ta besoj as vetë. Kështu me mirë është të hesht!

Fakti që Bernstein merr përgjigje nga një numër i konsiderueshëm nobelistësh tregon më së miri për fuqinë e zërit të tij në arenën ndërkombëtare.

HERMAN BERNSTEIN, MIK PERSONAL I ALBERT AJNSHTAINIT

Në këtë libër, lidhjet e Bernsteinit me Albert Ajnshtajnin gjenden shumë shpesh. Ai ka pasur korrespondencë me nobelistin e famshëm, ka përkthyer nga gjermanishtja në anglisht gjatë vizitave të Ajnshtajnit në Amerikë. Por rasti më kuptimplotë i marrëdhënieve midis tyre është ngjarja e mëposhtme, kur Bernsteini ishte caktuar kryetar i komisionit për festimin e ditëlindjes së tij. Më bukur se çdokush e përshkruan këtë shkrimi i mëposhtëm i New York Times:

Në ditëlindjen e vet Ajnshtajni fshihet [256]

51 Foto e Albert Ajnshtajn, me Herman Bernsein në ditën e pesëdhjetëvjetorit të lindjes së shkenctarit të madh

I preokupuar me një mikroskop që i kishin dhuruar, njësoj si djalë i gëzuar me një lodër, ai rri i përhumbur, kur tërë bota e përshëndet atë.

14 mars, Berlin: Në brigjet e lumit Havel në fshatin e Gatowut, një gjysmë ore larg me makinë nga qendra e Berlinit, gjendet një ndërtesë në mes të një zone shumë të kultivuar, që i takon një prodhuesi polak këpucësh i quajtur Franz Lemn. Ishte përhapur lajmi se profesor Albert Ajnshtajni, ndoshta do të gjendej atje i "*fshehur*" nga admirimi popullor në pesëdhjetë vjetorin e lindjes së tij, me qëllim që të shmangte të tëra ceremonitë, festimet dhe zhurmat që sjell ajo ditë për të.

Më në fund, Ajnshtajni ishte zbuluar, jo në pallatin e madh, por në katin e sipërm të një ndërtese të vogël. Fizikanti i shquar ishte ulur pranë një tavoline në një dhomë të vogël, i përkulur mbi një mikroskop, një prej dhuratave që kishte marrë për ditëlindje, krejt si djalë i zakonshëm, kur luan me një lodër, që sapo ja kanë dhuruar.
Ditëlindja e pesëdhjetë e Ajnshtajnit është e mbushur me shumë episode të thjeshta dhe njerëzore. Aty gjen telegrame nga tërë bota, familjarë, një drekë të thjeshtë, pasionin e tij për të mos humbur asnjë minutë nga puna e tij gjigante, si dhe anekdoda pa fund rreth teorisë së tij të relativitetit si kjo:

> Kur je ulur pranë një vajze dhe qëndron dy orë, të duket sikur ke ndenjur vetëm një minutë, por po të ulesh mbi një stufë të nxehtë, për një minutë të duket sikur ke ndenjur dy orë. Ja si shpjegohet teoria e relativitetit.

New York Times njofton për një fakt shumë kuptimplotë: Në pesëdhjetëvjetorin e Aishtainit është Herman Bernstein ai që merret me tërë organizimet e festimit të asaj dite të rëndësishme, jo vetëm për atë, por për mbarë njerëzimin.

Sipas një njoftimi të bërë nga Herman Bernstein, Kryetar i Komisionit të Festimeve për nder të pesëdhjetëvjetorit të lindjes së Ajnshtajnit, Fondi Hebraik Kombëtar me paratë e mbledhura për shtresat e tokës së Palestinës, do të emërtojë një pyll si "*Pylli i*

Ajnshtajnit". Kjo do të vendoset në atë që quhet Libër i Artë. Në atë libër figurat më të njohura të njerëzimit, organizatat dhe individët do të ftohen të gdhendin emrat e tyre kundrejt një pagese prej 100 dollarësh. Libri i Artë do të kthehet te profesor Ajnshtajni, në një ceremoni hebraike me përmasa botërore më 28 qershor në Kongresin Botëror të Sionistëve në Zurich. Urimet nga universitetet nuk kanë fund.

Ajnshtajni pret të nderohet [257]

Profesor Albert Ajnshtajni do t'u drejtohet studentëve dhe miqve të Kolegjit Yashiva dhe do të marrë Gradën e Nderit të Doktorit të Letrave Humane, me rastin e hapjes së ushtrimeve të kolegjit më 8 tetor. Kjo do të jetë e para gradë nderi që i jepet Aishtainit qëkurse ai është vendosur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Folës të tjerë në atë ushtrim do jetë guvernatori Lehman, Herman Bernstein, ish-Ministër i Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, dr. David Eugene Smith, Profesor Emeritus i Universitetit të Kalifornisë dhe anëtar i Këshillit të Kolegjit Yashiva, si dhe dr B. Ravel, President i Kolegjit. Ceremonia do të mbahet në orën 4 pasdite.

NJOHJA E HISTORISË SË HEBREJVE NË SHQIPËRI, DIÇKA MË E GJERË SE SA STUDIMI I JETËS SË HERMAN BERNSTEINIT

Ky libër nuk është i vetmi përkushtim ndaj figurës së Herman Bernsteinit nga ana ime. Studimi, njohja dhe përhapja e historisë se hebrejve në Shqipëri ka qenë dhe mbetet për mua një nga temat më tërheqëse hulumtuese.

Duke pasur fatin e madh të përfaqësoja Shqipërinë në Vilajetin e Stambollit, të bashkëpunoja me Lidhjen Qytetare Shqiptaro-Amerikane dhe me Vatrën në New York,

të punoja për Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë e më vonë Ambasador i Jashtëzakonshëm e Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe, Irlandën e Veriut dhe Irlandën, më duhej modeli i një diplomati, i cili nuk ishte edukuar me atë profesion, që në fillimet e veta të veprimtarisë së tij. Unë nuk mund të gjej një model më të përshtatshëm se sa Herman Bernstein. Për hir të kronologjisë në vijim do të rendis një sëri veprimtarish që i kanë paraprirë dhe më kanë motivuar për këtë libër, në nderim të këtij njeriu të madh.

Le të shpresojmë se ky vëllim dhe dokumentet e përkthyera nga unë e të përmbledhura për herë të parë në shqip, do të nxisin hulumtime të tjera dhe promovimin e mëtejshëm të këtij kapitulli unik të historisë së kombit tonë.

Wiener Library, Londër, 22 nëntor 2012

Më 22 nëntor 2012, Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Londër dhe Wiener Library, në mjediset e kësaj të fundit, organizuan aktivitetin mbi historinë unike të shpëtimit të hebrejve në Shqipëri gjatë Holokaustit. Isha i pranishëm si organizator i këtij aktiviteti dhe si i Ngarkuar me Punë i Republikës së Shqipërisë në Londër, së bashku me z. Ben Barkow, Drejtor i Bibliotekës Wiener, qendër e specializuar e studimeve për genocidin. Të ftuar nderi në këtë mbrëmje ishin Ambasadori i Shtetit të Izraelit në Mbretërinë e Bashkuar, Sht. T. Z. Daniel Taub dhe znj. Liri Berisha, Presidente e Fondacionit "*Nënë Tereza*", Tiranë.

Në qendër të kësaj mbrëmjeje kulturore ishte prof. Scarlett Epstein, OBE, e cila është një dëshmi e gjallë e mikpritjes shqiptare dhe kujdesit, që shqiptarët kanë treguar për hebrejtë gjatë periudhës së Luftës II Botërore.

Në vitin 1938 ajo mundi t'u shpëtonte kampeve naziste të përqendrimit, në sajë të marrjes së vizës për të hyrë në Shqipëri, ndërkohë që konsullatat e vendeve të tjera europiane refuzonin vizat për hebrejtë. Historia e rrallë e jetës së saj si dhe konteksti më i gjerë historik, u ndoq me shumë interes në filmin dokumentar "*Shqipëria më shpëtoi jetën*", si dhe në dëshminë e vetë znj. Epstein.

Znj. Liri Berisha i dorëzoi prof. Epsteinit, në emër të Bashkisë së Tiranës dhe kryetarit të saj, z. Lulzim Basha një "*Çertifikatë mirënjohje*", e shoqëruar nga simboli i Tiranës, Kulla e Sahatit, për punën dhe kontributin e saj të çmuar në promovim të vlerave dhe virtyteve të Shqiptarëve, që mbrojtën dhe shpëtuan hebrejtë të cilët jetuan ose kërkuan azil në Shqipëri gjatë Holokaustit.

Angli – Middlesex University, Veprimtari përkujtimore për Holokaustin, 20 janar 2013

Më 20 Janar 2013, në Middlesex University të Anglisë u organizua një prezantim me temë "*BESA shqiptare dhe historia e judaizmit në Shqipëri",* gjatë një meshe përkujtimore kushtuar Holokaustit. Veprimtaria u drejtua nga kryebashkiaku i qytetit të Barnetit, këshilltari Brian Schama.

Kjo veprimtari përkujtimore iu kushtua respektit midis komuniteteve të ndryshme, duke nderuar viktimat e genocidit. Bashkësi të tëra janë shkatërruar gjatë Holokaustit nën persekutimin nazist dhe më vonë gjatë genocideve të tjera, që pasuan si në

Kamboxhia, Bosnje, Ruanda, Darfur, por mbijetesa e hebrejve në Shqipëri është rasti më unik, kur një palë e shtypur dhe e përndjekur të mbijetojë pa asnjë të humbur ose të dëmtuar. Kjo falë fisnikërisë së popullit shqiptar.

Londër, Sinagoga Pinner, mbrëmje përkujtimore, 7 prill 2013

Të dielën e 7 Prillit 2013, në cilësinë e Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë, pata nderin të ndiqja një aktivitet përkujtimor në përkujtim të Yom Hashoah në Sinagogën Pinner. Me rastin e 70-vjetorit të Kryengritjes së Getos të Varshavës, tema e kësaj mbrëmjeje ishte "*Rezistenca dhe shpëtimi*". I ftuari i parë ishte Ambasadori i Republikës së Polonisë, Sh.T. Z. Witold Sobkow, si dhe fëmijë të të mbijetuarve të Getos polake Janine Webber dhe Lili Stern-Pohlmann. Znj. Gaby Glassman, Kryetare e Komitetit Yom Hashoah, Pinner Synagogue, në fjalën e saj tha: "*Do të dëshiroja të nderoja ata shumë shqiptarë të cilët ndoqën kodin e tyre të sjelljes, Besën, e cila kërkon që i huaji të trajtohet me bujari si anëtar familjeje. Kjo histori po del tani në pah, falë kryesisht profesoreshës Epstein, e cila sonte është midis të pranishmëve.*". Më pas gjatë fjalës përmenda emrat e 69 familjeve shqiptare të gdhendur në Yad Vashem në nderim të këtyre fisnikëve midis kombeve.

Londër, Festivali Hebraik, filmi "Besa - The Promise, 17 nëntor 2013

Më 17 nëntor 2013, në kinemanë Triclycle Theatre Kilburn, Londër, u shfaq filmi "*Besa*", një produksion amerikan, i cili sjell përpara publikut hebraik të Londrës një histori të jashtëzakonshme të marrëdhënieve midis shqiptarëve dhe hebrejve gjatë periudhës së Holokaustit.

Ka shumë filma që tregojnë vuajtjet dhe mjerimet, që hebrejtë kanë përjetuar gjatë Luftës së Dytë Botërore, shumë dokumentarë, kronika të kohës, dëshmi të dhëna nga ata që e përjetuan atë periudhë të errët të njerëzimit. Por vështirë se mund të ketë një film, i cili të jetë krijim artistik dhe përsëri aktorë të jenë personazhet e vërtetë të ngjarjes, të jetë krijim artistik, por të mos ketë asnjë sajesë, apo devijim nga e vërteta, të jetë dokumentar dhe të ruajë një natyrë krejt artistike, të jetë një tregim i një ngjarjeje dhe tregimtarë të jenë vetë njerëzit e ngjarjes.

Në fjalën time vlerësova punën e mrekullueshme të producentëve të filmit, duke nënvizuar se sa krenar janë shqiptarët për këtë histori kaq të mrekullueshme, që tregon vlerat e tyre njerëzore.

Londër "Ditët e kujtesës", nderohet Besa Shqiptare, 16 janar 2014

Në mbrëmjen e 16 janarit 2014 në Sinangogën Pinner, në një nga zonat me numrin më të madh të banorëve hebrej në Londër, u organizua shfaqja e filmit "Besa - The Promise", vepër e regjisorit Jason Williams, me kontribut të veçantë të fotografit Norman Gershman.

Më shumë se katërqind pjesëmarrës, prej të cilëve edhe një numër i mirë shqiptarësh me banim në këtë qytet, ndoqën me vëmendje, respekt dhe emocion këtë veprimtari, e cila u hap me fjalën e zonjës Gaby Glassman, Kryetare e Këshillit Organizativ të Sinagogës Pinner. Ajo nëvizoi fisnikërinë dhe virtytet e larta të shqiptarëve, të cilat bënë

që asnjë hebre në atë vend të mos dorëzohej te nazistët.

New York, prezantim i jetës së Herman Bernsteinit në YIVO Institute of Jewish Research, 14 dhjetor 2014

Në Marsin e vitit 2014 pata rastin të vizitoja, shikoja, fotokopjoja dhe digjitalizoja arkivën e Herman Bernsteinit, të ruajtur në YIVO. Me ndihmën e një zonjë të nderuar, arkiviste e quajtur Fruma Mohrer dhe kujdesin e Drejtorit të Institutit, profesor Jonathan Brent, arrita të mblidhja materialin dhe i hyra një studimi, i cili kishte si produkt botimin e një libërthi të vogël në gjuhën angleze të quajtur "*Kontributi i Ambasadorit Amerikan në Shqipëri, Herman Bernstein (1876-1935)*".

Më 14 dhjetor 2014, pata rastin të mbaja një prezantim të ilustruar të këtij studimi në YIVO, përpara një audience të gjerë të përbërë prej hebrejsh amerikanë, amerikanësh, shqiptaro-amerikanësh, studiuesish të ndryshëm dhe studentëve, si dhe të interesuar për lidhjet historike të shqiptarëve me Amerikën dhe hebraizmin.

Pikë lidhëse më të mirë për këtë trekëndësh, sesa Ambasadori Herman Bernstein nuk do të kishte. Pas prezantimit të pranishmëve iu dorëzua libërthi prej pesëdhjetë faqësh si ilustrim i fakteve të paraqitura edhe në ekran.

Këtë libërth pata nderin t'ia dhuroja edhe historianit më të famshëm të Judaizmit, profesorit të Universitetit Columbia, New York, dhe rrëfimtarit më të shquar të kësaj historie në British Broadcast Coorporation, BC, prof. Simon Schama.

Tiranë, intervistë e prof. Jonathan Brent, dhënë Gazetës "Tirana Times"

"Ky është model për njerëzimin në mbarë botën"

Jonathan Brent, Ph.D, Drejtor Ekzekutiv dhe CEO i Institutit YIVO për kërkime hebraike, nënvizoi në një intervistë ekskluzive për gazetën "*Tirana Taims", n*ë gjuhën angleze, se "*Historia e Ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Herman Bernstein, përfaqësoi një mundësi të mrekullueshme për YIVO-n, që të demonstronte thellësinë dhe qëllimin e arkivave të saj dhe përse këto dokumente të vjetra mund të frymëzojnë njerëzit anekënd botës në ditët e sotme.*".

Akademiku, autori dhe botuesi amerikan 68-vjeçar tha se kishte ndjesinë se publiku i gjerë nuk është se di shumë për historinë shqiptaro-hebraike dhe se një aktivitet tjetër do të mbahet për t'i shkuar më në thellësi kësaj çështjeje. Ai tha se atij i kishte bërë përshtypje humanizmi, mënyra e të folurit dhe sjellja e shqiptarëve. Shumë vite më parë, fjalën "*Shqipëri*" e lidhja fillimisht me regjimin e Enver Hoxhës dhe shtetin ultra-stalinist, të cilin ai drejtoi. Por ndërsa u zgjeruan interesat e mia për Europën Lindore dhe Rusinë dhe për shkak të pozicionit tim në vitet 90-të si Drejtor Redaksional i Yale University Press pata fatin të njihesha më mirë me Shqipërinë nëpërmjet kontakteve me vetë ata.

> Nëpërmjet arkivës shumë të gjerë të Herman Bernsteinit, e cila është pjesë e koleksionit bazë të YIVO-s, Shqipëria zë një vend të veçantë. Ajo përfaqëson një bashkëjetesë të rrallë të historisë amerikane, europiane lindore dhe hebraiko-ballkanase.

Bernsteini lindi në Lituani por u rrit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Më pas, si diplomat, ai u emërua në Shqipëri ku puna e tij në emër të popullit hebre dhe Qeverisë Amerikane mori hov. Historia që Ambasadori Berisha tregoi për aktivitetin e Bernsteinit është vërtetë frymëzuese dhe duhet të jetë model për njerëzimin mbarëbotëror. Është një histori për të inkurajuar të gjithë njerëzit me vullnet të mirë në kohëra të këqija. Pas këtij aktiviteti shpresojmë të paraqesim një projekt të ri për ndërtimin e një Muzeu On-line në Institutin tonë, ku një galeri e veçantë do të jetë për Shqipërinë.

Jonathan Brent.

52 Me Profesor Jonathan Brent Drejtor i YIVO Institute of Jewish Research dhe rrëfimtarin më të famshëm të BBC World, Profesorin e Universitetit Columbia, Simon Schama.

53 Foto nga audienca në prezantimin e jetës së Herman Bernstein në YIVO Institute of Jewish Research, New York, 14 dhjetor 2014

54 Pas prezantimit, një foto me stafin e Institutit YIVO dhe shumë aktivistë Vatranë të New Yorkut.

Ambasada Shqiptare dhe ajo Amerikane në Londër organizojnë veprimtarinë me temë:
"Jeta e Ambasadorit të SHBA-ve Herman Bernstein", 4 qershor 2015

Në mbrëmjen e datës 4 qershor 2015, për herë të parë në historinë e Shqipërisë, brenda në Auditoriumin e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Londër, u shpalos flamuri shqiptar, si dhe një xhevahir i historisë së vendit tonë i titulluar: "*Jeta e Ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës Herman Bernstein dhe marrëdhëniet shqiptaro – hebraike, si model i tolerancës fetare, parë në kontekstin e ngjarjeve tragjike të ndodhura këtë vit në Francë dhe në Danimarkë".*

Ky aktivitet u zhvillua nën kujdesin e Ambasadorit të Shqipërisë në Londër, nën kujdesin e Ambasadorit të Shteteve të Bashkuara, Sh. T. Z. Matthew Barzun dhe në bashkëpunim me Ambasadorin e Shtetit të Izraelit Sh. T. Z. Daniel Taub, si dhe me Ambasadoren e Lituanisë SH.S. znj. Asta Skaisgirytė-Liauškienė.

Në Auditoriumin e Ambasadës Amerikane ishin të pranishëm ambasadorë të vendeve të tjera, diplomatë amerikanë dhe të huaj, rabinë, studiues, gazetarë, drejtues

shoqatash hebraike, gazetarë britanikë, studentë etj.

Veprimtarinë e hapi këshilltari politik i Ambasadës Amerikane në Londër, z. Eric Johnson, i cili, pasi foli për marrëdhëniet Shqipëri - SHBA, ia dha fjalën Ambasadorit Izraelit z. Daniel Taub. Ambasadori Taub nënvizoi kontributin e pashoq, që shqiptarët kanë dhënë për mbrojtjen e hebrejve, marrëdhëniet shqiptaro–izraelite, vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis dy shteteve dhe hapjen e Ambasadës izraelite në Tiranë, si dhe miqësinë e fortë që ekziston midis dy vendeve tona.

Më tej aktiviteti vijoi me fjalën e ambasadores lituaneze, e cila po ashtu nënvizoi faktin që një veprimtari e tillë e përbashkët, e iniciuar nga ambasada shqiptare, i shërben komunikimit më të mirë midis popujve tanë dhe bashkëpunimit frutdhënës ndërmjet ambasadave. Ajo nënvizoi lidhjen e Lituanisë në këtë rast me tre shtetet tjera, pasi Bernsteini ka qënë një hebre lituanez.

Në vijim paraqita një përmbledhje të studimit tim për figurën e z. Herman Bernstein, të vendosur në kontekstin e mësipërm. Modeli shqiptar i bashkë-ekzistencës fetare dhe etnike, mbrojtja e hebrejve dhe paqja fetare midis feve të ndryshme në Shqipëri, lidhjet e forta që Shqipëria ka me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kontributi i Presidentit amerikan Wilson në mbrojtjen e Shqipërisë, kontributi i Herman Bernsteinit dhe trashëgimia e tij, çimentimi i këtyre marrëdhënieve në ditët e sotme, të gjithë këto elemente bënë që prezantimi të ndiqej me mjaft interes nga të pranishmit. Aty pata nderin dhe privilegjin që në emër të Ambasadës Shqiptare në Londër të shpalos këtë histori të lavdishme të popullit tonë.

55 Ambasadorët e ShBA – së, Izraelit, Lituanisë dhe Shqipërisë në prezantimin për jetën e Herman Bernstein në auditoriumin e Ambasadës Amerikane në Londër, 4 qershor 2015.

Tiranë, Hotel “Rogner”, “Miqtë ndërkulturorë në Tiranë”, 4 maj 2016

Më 4 maj 2016, përpara një audience të gjerë të përbërë prej një grupi diplomatësh dhe

të huajsh të njohur si “Intercultural Friends in Tirana” (IFIT) u prezantua jeta e Herman Bernsteinit.

Veprimtaria u organizua në Hotel “Rogner” dhe u ilustrua me foto nga jeta e Ambasadorit Bernstein, si dhe dokumente, të cilat paqyronin veprimtarinë e tij të gjithanshme. IFIT numëron më shumë se 200 anëtarë, kryesisht të huaj që jetojnë dhe punojnë në Shqipëri, por edhe shumë partnere ambasadorësh, që shërbejnë në vendin tonë. Ajo ka si qëllim t’i njohë të huajt sa më shumë me historinë, kulturën dhe çdo gjë të mirë që ofron vendi ynë. Takimin e drejtoi Presidentja e IFIT, amerikane e “*natyralizuar*” në Shqipëri zj. Nikki Doçi.

Prezantimi mbante titullin: “*Një rr*ëfim *i shkurtër i marrëdhënieve shqiptaro – amerikane – hebraike, parë nga dritarja e zyrës së Ambasadorit Bernstein.*”

Aty theksova se Herman Bernsteini ishte gazetar i guximshëm, aktivist hebre, diplomat dhe intelektual i shquar. Ajo që la pas shkon përtej shërbimit diplomatik që Bernstein kreu në Shqipëri. Shqiptarët treguan shumë dashuri për të. Ai mbetet një figurë e rëndësishme në marrëdhëniet shqiptaro-amerikane, pasi mbështeti një vend të vogël, ndërsa mësonte dhe shkruante për historinë dhe kulturën e tij, ndihmoi në hapjen e shkollave. Ai ishte një njeri i madh, nga një komb i madh dhe një popull i madh.

“Kennedy School of Government”, në Cambridge, Massachusetts, 1 shkurt 2017,

Një mbrëmje e paharruar ishte ajo e 1 shkurtit 2017 në Harvard, Boston. Në Auditoriumin “Starr” në Belfer Building, Kennedy School of Government në Cambridge Massachusetts, u mbajt biseda e ilustruar rreth historisë së marrëdhënieve shqiptaro - hebraike me titull: *“Vendi i Besës, kodi i nderit që shpëtoi hebrejtë”.*

Në atë sallë, akademike nga më prestigjiozet, përpara një audience të mrekullueshme amerikane-hebraike-shqiptare, në moderimin e gazetarit të njohur të NPR - WBUR Christopher Lydon, u dha mundësia të shpalosim vlerat e kombit shqiptar dhe ndër to edhe trashëgiminë e marrëdhënieve të Herman Bernsteinit me Mbretin Zog të shqiptarëve.

56 Pamje nga audienca gjatë prezantimin të mbajtur më 1 shkurt 2017 në Starr Auditorium, Belfer Building, Second Floor, John F. Kennedy School of Government.

PËRMBYLLJE

Takim me Boaz Nash, stër - stërnipin e Herman Bernsteinit

Në mbrëmjen e 26 gushtit të vitit 2017, ndërsa po festoja ditëlindjen time të 65–të, mora një mesazh nga Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Republikën e Shqipërisë, Sh.T. z. Donald Lu. Ai më uronte datëlindjen dhe më tregonte se në Tiranë, një ditë më vonë do të vinte një person me emrin Boaz Nash, i cili kishte dëgjuar rreth hulumtimeve që bëja nëpërmjet YIVO-s, për stër-stërgjyshin e tij Herman Bernstein.

Ai kishte shprehur dëshirën të takoheshim, pasi ishte në kërkim të rrënjëve të tij familjare, të cilat në gjeneratën e katërt lidheshin me Herman Bernsteinin. Historia përsëritet. Njësoj si në rastin e Charles Telford Erickson, kur at Arthur Liolini i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare në Boston, më njoftoi për vajzën e Ericksonit, Grace, se ishte gjallë, në moshën 101 vjeçare dhe kishte dhe pasardhës tjerë të familjes së tyre, dukej se fati do më ndihmonte edhe kësaj

here. Nuk do ta mbyllja librin pa takuar dikë nga pasardhësit e Herman Bernsteinit–nit. Eureka!

Bëra një kërkim të shpejtë në Google dhe gjeta se Boaz Nash ishte shkencëtar në “European Synchrotron Radiation Facility”, Grenoble, Francë. Ai edhe sipas Google, edhe sipas studimeve dhe kërkimeve për këtë libër kishte lidhje direkte me Herman Bernsteinin. Gjyshja e tij, vajza e Herman Bernsteinit, Dorothy ishte martuar me gjyshin e tij Actius Nash, një student nga Franca më 17 tetor 1930. Martesa ishte bërë në Bashkinë e Tiranës, me bekimin e kryetarit të Bashkisë të asaj kohe, z. Rexhep Jella. Ajo ishte edhe bashkautore në përkthimin e veprës së Aleksandër Moisiut “I Burgosuri”, shkruar në gjermanisht dhe kushtuar Napoleon Bonapartit.

Ditën tjetër u takuam me z.Nash, në një lokal në Tiranë. Ndryshe nga ajo që prisja, ai ishte një djalë i thjeshtë, i veshur si një amerikan i shkujdesur, pa ndonjë sqimë, i qeshur dhe shumë i këndshëm. Biseduam më të gjerë e gjatë rreth historisë së familjes së tij të shpërndarë nëpër botë. Mësova se gjyshi i tij ishte një hebre nga Hungaria, i cili ishte njohur me gjyshen Dorothy në një udhëtim në Francë. Aty ranë në dashuri dhe më pas u martuan. Boazi kishte letra të korespendencës mes tyre.

Po ashtu, më tha se merrej me një degë shumë të veçantë të fizikës e cila nuk e lejonte të merrej me shkenca humane, por siç ndodh me instiktin e një hebreu, Boazi kishte filluar të mblidhte historinë e familjes, e shpërndarë nëpër botë dhe të shkruante diçka, të cilën ai tha, me modesti gati të tepruar, nuk di nëse do të arrinte ta realizonte, por do të “mundohej”. Kërkimet e kishin sjellë pikërisht në Shqipëri.

Gjatë bisedës vura re se të dy ishim në dijeni të mjaft episodeve të njejta të kësaj historie, por kishte edhe gjëra të cilat i dinte njëri por nuk i dinte tjetri. Kjo e bëri bisedën shumë të bukur. Në listën e pasardhësve të Bernsteinit unë gjeta se ishin disa emra të famshëm si, bje fjala Peter Nash, mjek i shquar dhe poet, Joyce Gitlin Sartwell Abell e bija e Herman e Bernsteinit, nëna e Crsipin Sartwell, filozof dhe gazetar amerikan dhe Joan Weber, artist i arteve pamore. Por në këtë moment Boaz Nash njeriu që kisha përballë ishe më i rëndësishmi.

Ndër reliket e stërgjyshit ai kishte një foto, ku kishin dalë bashkë me mikun e tij, Albert Ajnshtajnin. Mund të ketë aq shumë fakte që nuk kanë arritur të futen në këtë libër por ajo që më bëri të lumtur ishte se edhe kësaj here, libri nuk mbaroi pa pasur dëshmitarë të gjallë, pasardhës të familjes së heroit tim të radhës, intelektualit të madh dhe mikut të shqiptarëve, amerikano–hebreit, Herman Bernstein.

Me Boaz Nash, stër – stërnipi i Herman Bernstein

Tiranë, 27 gusht 2017

Joyce Gitlin Sartwell Abell e cila kaloi vite të fëmijërisë në Tiranë me nipin e motrës Dorothy Nash, Boaz Nash. Foto e vitit 2017

KONKULZION

Kam pasur nderin të diskutoj e komentoj me autorin materialet dhe dorëshkrimet e këtij libri, gjatë punës së tij të gjatë për ta sjellë atë në formën e botuar sot. Materialet nga arkivat e Institutit të Kërkimeve Hebraike YIVO, në New York, botimet e vetë Bernsteinit, dokumentet e arkivave të Ministrisë së Jashtme Italiane e shumë burimeve të tjera, përbënin një korpus voluminoz, nga i cili nuk ka qenë e lehtë të përzgjidheshin fragmentet më me interes për publikun e studiuesit shqiptarë.

Ky vëllim përmbledhës ka për qëllim njohjen me një figurë poliedrike intelektuale, njeri i shquar i kulturës, diplomat, përfaqësues i SHBA-ve, por edhe luftëtar i paepur për të drejtat e hebrejve dhe për vlerat universale të paqes. Duke hedhur dritë mbi personalitetin e Herman Bernsteinit, kjo përmbledhje i shërben gjithashtu historiografisë së Shqipërisë në disa aspekte:

- Plotëson fragmente të rëndësishme të procesit të brishtë të konsolidimit të shtetit shqiptar pas Pavarësisë. Një ekonomi e pamodernizuar, mungesa e infrastrukturës, e një sistemi edukimi kombëtar, e sistemit bankar, ekzistenca e një shoqërie të polarizuar, janë vetëm disa nga faktorët rrënjësorë, që e bënin vendin të dobët ndaj fqinjëve, në njerën anë, dhe anarkisë së brendshme, në tjetrën.

- Na jep një pamje të qartë të kontributit të Mbretit Zog në konsolidimin e shtetit shqiptar, si dhe të marrëdhënieve tepër të vështira me Italinë fashiste. Nga vëzhgimi i mprehtë i Bernsteinit, Mbreti rezulton të jetë politikan me një vizion largpamës për zhvillimin e vendit, që mundohet të përdorë bashkëpunimin me Italinë në funksion të këtij zhvillimi por edhe të forcimit të pushtetit të tij politik. Ai gjithashtu, nuk nguron ta mbajë pezull e refuzojë "*miqësinë*" italiane, kur ajo cënon drejtpërdrejt Pavarësinë vendimarrëse ose integritetin territorial të Shqipërisë.

- Me Herman Bernsteinin, historia e hebrejve në Shqipëri merr një kuptim akoma më të thellë, që e ka zanafillën në njerën anë, te bashkëjetesa dhe harmonia fetare paraekzistuese në vendin tonë dhe kodi i lashtë i Besës, e në anën tjetër, te një arritje e mirëfilltë diplomatike, fryt i marrëdhënieve të veçanta të ndërlidhura midis diplomatit hebre-amerikan dhe Mbretit. Bernsteini me punën, hulumtimet e tij për gjurmët hebraike në Shqipëri, vizitat e tij nëpër vende kulti, lidhjet me Zogun, qeverinë dhe intelektualët shqiptare brenda dhe jashtë vendit, si dhe respektin e thellë që ngjall dhe lë pas, e vendos hebraizmin në vëmendjen e shtetit të vogël, që mund t'i mësojë botës se bashkëjetesa paqësore e pa asnjë lloj diskriminimi ndërfetar është e mundur dhe e realizueshme.

Dr. Xhoana Papakostandini

Shënime

[1] The Soft Power (Pushteti i butë), është teoria moderne e përpunuar prej prof. Joseph Nay Jr.(Harward University, Cambridge, Massachusets, SHBA) rreth njohjes së kombeve të vogla në pafundësinë universale të vlerave shpirtërore, kulturore, historike të njerëzimit dhe mjeti për promovimin e tyre në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo teori na mëson se edhe kombe të vogla, si Shqipëria, nëse dinë të përdorin mirë trashëgiminë e tyre shpirtërore, kulturore, historike mund të bëhen interesante përpara kombeve të tjera dhe të arrijnë synimet e tyre në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ne jemi takuar dhe kemi diskutuar vlerat e "*Soft Power*" me profesorin në Kennedy School of Government (2017).

[2] Bernstein është mbiemër hebre që në do të thotë "*qelibar*", sikundër Einstein (kujto Albert) do të thotë "*një gur*". Të dyja kuptimet vijnë nga gjuha gjermane.

[3] Leonard Bernstein (1918 – 1990) kompozitor, dirigjent, autor, profesor muzike, pianist i famshëm amerikan me origjinë hebraike nga Ukraina. Sipas kritikut të madh të muzikës Donal Henahan ai ishte një prej talenteve më të mëdha dhe më të shquara në historinë e Amerikës. Dirigjimi i veprave të Bethovenit prej tij është një ndër trashëgimitë më të mëdha në historinë e muzikës së përbotëshme.

[4] Elmer Bernstein ka qenë një kompozitor i famshëm amerikan, i shquar për muzikë filmash. Ai gjatë pesëdhjetë vjetëve të veprimarisë së tij kompozoi muzikë për më shumë se pesëdhjetë filma, pa përmendur muzikën e produksioneve televizive.

[5] Adam Bernstein (1967) është regjisor i famshëm amerikan. Ai ka marrë nominime edhe për çmimin Emmy dhe është producent i serialeve të famshme filmash dhe shouve televizivë.

[6] Charles Telford Erickson, EduAlba, Tiranë 2012.

[7] Shqiptarët, Lisa mbi Truallin Ilir, National Geographic Magazine në 100 vjet, Edu Alba, 2007.

[8] Shqiptarët Europianët më të Lashtë dhe më të Rinj, EduAlba, Tiranë, 2008.

[9] Realitete Shqiptaro Britanike, EduAlba, 2015.

[10] Herman Bernstein, EduAlba, 2014, botim i shkurtuar i jetës së tij në gjuhën angleze.

[11] Henry Wadsworth Longfellow, Skënderbeu, Boston, Massachusetts, 1916, Libraria Populllore.

[12] The Albanian Struggle in the Old World and New, AMS Press, Boston, 1939.

[13] Qerim Panariti, veprimtar, patriot i shquar, i cili shkoi në SHBA në vitin 1909. Që i vogël e filloi veprimtarinë me shoqërine "*Besa-Besë*" të Bostonit. Kthehet në Shqipëri bashkë me Mehmet e Faik Konicën dhe lufton kundër osmanëve. Shkon në Amerikë në vitin 1912 dhe bëhet aktivist i shquar i Vatrës. Përsëri kthehet në Shqipëri për të luftuar dhe shkruan për gazetën "*Dielli*" me pseudonimin "*Opinga*". Në vitin 1926, u diplomua në Universitetin Clark në Massachusetts, Ai ishte redaktor i "Diellit", të cilën e drejtoi që nga viti 1940. Transmetonte shqip në Zërin e Amerikës dhe mbetet një prej patriotëve më të flaktë shqiptarë në Amerikë.

[14] John Milton Cooper Jr., Woodrow Wilson

[15] Ch. T. Erickson**,** Erickson Collection, Yale Divinity Library.

[16] M. Berisha, Ch.T.Erickson, EduAlba, Tiranë, 2012.

[17] "Liria jep rezultate", Fjalim i mbajtur nga sekretari amerikan i shtetit Bejker më 23 qershor 1991, në Tiranë.

[18] Ch.T.Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 4.

[19] Fred Williams ka lindur në Dedham, Massachusetts. Shkoi në shkollë private ku u diplomua në vitin 1868. Në1872 diplomohet në Dartmouth College. Studioi në Universitetin Heidelberg, Berlin. Vazhdoi studimet në Universitetin e Bostonit. U zgjodh anëtar i Kongresit Amerikan dhe përfaqësoi shtetin e Masachusetts. Ai u emërua ministër në Greqi dhe Mal të Zi nga Presidenti Wilson në 1913. Në vitin 1914 dha dorëheqjen pas një vizite që bëri në Shqipëri, me qëllim që të ishte i lirë të fliste kundër politikave që ndiqeshin atëherë ndaj vendit tonë.

[20] Ilir Ikonomi në librin e tij "*Pushtimi*" pasqyron pushtimin e Shqipërisë nga Italia dhe boton për herë të parë raportet e dërguara në Departamentin e Shtetit Amerikan nga Ambasadori i SHBA-ve Grant (Hugh Gladney Grant) në lidhje me pushtimin fashist të Shqipërisë, 7 Prill 1939.

[21] I. Ikonomi, Pushtimi, UET Press, Tiranë 2014.

[22] Ch. Hill, Outpost, A Diplomat at Work, Simon & Shuster, 2015.

[23] "Liria jep rezultate". Fjalim i mbajtur nga sekretari amerikan i shtetit, Bejker, 23 qershor 1991, në Tiranë, në sheshin Skënderbej.

[24] Vdekur në Shqipëri nga një sulm në zemër më datën 19 Maj 2002 në Lurë të Peshkopisë.

[25] Fjala e Bernsteinit në Ditën e Falënderimeve, Archive of YIVO Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street,

Manhattan, New York, USA, Dosja, 750.
[26] Archive of YIVO Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Manhattan, New York, USA, Dosja, 752.
[27] Herman Bernstein, The Man who brought America to the World,
[28] US Holocaust Memorial Museum,Kthimi i Anijes Transatlantike Gjermane St. Louis, 6 qershor 1939.
[29] History of the Jews in England (1066–1290), Edict of Explusion, f. 234: Në vitin 1290, Mbreti Eduard lëshoi një dekret për dëbimin e të gjithë hebrejve nga Anglia. Dekreti i dëbimit mbeti në fuqi gjatë gjithë periudhës së mesjetës. Dekreti në fakt nuk ishte një veprim i veçuar, por një kulminacion i një periudhe persekutuese ndaj hebrejve në atë vend, që kishte zgjatur dyqind vjet. Në vitin 1657, pas më se 360 vjetësh ndalimi absolut, ishte Oliver Kromuelli që i lejoi hebrejtë të hynin në Angli dhe kjo u bë me kusht që të sillnin të ardhura financiare.
[30] Ch. T. Erickson, Herbert Hoover një prej padronëve të Institutit Shqiptaro Amerikan të Bujqisisë në Kavajë.
[31] Herbert Clark Hoover (1874-1964) ishte presidenti i 31-të i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (1929-1933). Para se të zgjidhej president, ai ishte sekretar i Shtetit për tregtinë në vitet njëzet, në administratat e presidentëve Warren Harding dhe Calvin Coolidge. Ai dha ndihmë për shkollën e Kavajës nga pozita e Sekretarit të Shtetit për Tregtinë. Lidhjet dhe simpatia e tij për Shqipërinë nuk u shuan asnjëherë pas kësaj. Kur u bë president, ai emëroi gjatë periudhës së tij në detyrë ambasadorin Herman Bernstein (1930-1933), mik i ngushtë i tij dhe po ashtu ndërtoi ambasadën e SHBA-ve në Tiranë, një ndër pasuritë e vyera të Departamentit të Shtetit Amerikan jashtë vendit të vet. Simpatia dhe interesi për Shkollën Bujqësore të Kavajës shfaqen edhe më vonë tek ai. (Shënimi im M.B.)
[32] Harvey Sanver, Shpëtimi në Shqipëri, Botim i Ligës Qytetare Shqiptaro – Amerikane, 2000.
[33] Marrë nga Historia e Hebrejve në Shqipëri, Shaban Sinani.
[34] VATRA, cituar nga gazeta Dielli, Organ i Federatës Pan – Shqiptare të Amerikës VATRA, 30 mars, 1930.
[35] "Ainslee's Magazine" është një periodik letrar amerikan, që e ka filluar botimin që në vitin 1897 dhe ka vijuar deri në dhjetor të vitit 1926.
[36] Dr. Elez Biberaj, Drejtor i Divizionit të Euro-Azisë në Zërin e Amerikës, i cili transmeton në gjuhët ruse, ukrainase, shqipe, armene, boshnjake, gjeorgjiane, maqedonase dhe serbe. Ai ka gradën e doktorit në shkenca politike (Columbia University) dhe është autor i katër librave. Dr Biberaj iu bashkua VOA-s në vitin 1980 si transmetues i gjuhës shqipe, degë të cilën e ngriti në nivelet më të larta. Ai u lind më 15 nëntor1952, në një fshat të banuar me shqiptarë në Plavë të Malit të Zi. Prindërit e tij ishin detyruar të linin vendlindjen e tyre në Tropojë, Shqipëri, për të shkuar në fillim në Jugosllavi e më pas në Amerikë, si pasojë e regjimit totalitar në Shqipëri.
[37] Arkivën e YIVO-s, Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Manhattan, New York, USA.
[38] Ky dokument vetëm sa përmendet në arkivën e YIVO-s, por edhe pse gjatë hulumtimeve i kushtova rëndësi shumë të madhe, nuk arrita ta gjej në dosjet e tij. Ndoshta në të ardhmen, ky dokument kaq i rëndësishëm mund të gjendet te ndonjë pasardhës i tij (MB).
[39] "Lule", 1924, në gjermanisht. 5 vite më vonë u ribotua në pesë gjuhë të huaja. Në vitin 1930 u botua nga shtëpia botuese "*Nikaj*", përkthyer në shqip nga prof. Karl Gurakuqi. Në vitin 2001, pas një ripunimi, romani i shumëpritur "*Lule*" i Fabian Barcatës ribotohet në Shqipëri nga shtëpia botuese "*Mirdita*". Lula është personazhi kryesor nga merr titullin libri. Ajo është figurë tipike e vajzës së dëlirë me fytyrë engjëllore. Ajo u ngjan heroinave të letërsisë klasike botërore, që shkojnë në flijim pa mundur të bindin të tjerët për pafajësinë e tyre. "*Lule*" është sa roman artistik, aq edhe libër zakonesh të vjetra shqiptare. Përkthimi i saj nga Bernsteini, përbën kontribut të madh për njohjen e jetës dhe kulturës shqiptare nga ambasadori amerikan.
[40] Fjala është për Kol Kuqalin, përkthyes dhe mik i Bernsteinit.
[41] Gazeta "Baltimore Sun", 7 qershor 1935.
[42] E. Alexander Powell ishte korrespendent amerikan gjatë Luftës së Madhe (Lufta e Parë Botërore). Sjellja e tij në Shqipëri dëshmon lidhjet e Bernsteinit me emrat e mëdhenj të gazetarisë së kohës së tij. Gazetari njihej me këtë emër, por emri i tij i plotë është Edward Alexander Powell.
[43] Archive of YIVO Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Manhattan, New York, USA, Dosja nr. 170.
[44] Dr. Elez Biberaj, gazeta Dielli, Boston Massachusetts, 15 tetor 1980.
[45] William Z. Spiegelman, avokat nw New York.
[46] David Alter, Publisher and Owner of The Jewish Criterion, of Pittsburgh.
[47] Dewar, Clinton and Jeffcoat Co, Studios: 539 Wood Street Pittsburgh, PA.
[48] Këtë krahasim të Shqipërisë me New Hempshire dhe Vermontin e gjejmë thuajse te të gjithë shkrimet e udhëtarëve amerikanë në Shqipëri, përfshirë Melvile Chater, National Geographic Magazine, Albania Europe's Newest Kingdom, shkurt 1931.
[49] The Jewish Criterion, 14 shkurt, 1930, Nr. 14. E përjavshme kombëtare e përkushtuar ndaj interesave hebraike.
[50] Archive of YIVO Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Manhattan, New York, USA.
B'nai B'rith Magazine paraqet informacione dhe analiza me tema qendrore që kanë të bëjnë me çështje të bashkësive hebraike. Aty gjen që nga temat e anti-semitizmit deri te fabulat humoristike hebraike dhe shpërndahet në të katër anët e botës, tashmë jo vetëm në print por edhe online.
[51] Archive of YIVO Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Manhattan, New York, USA, Dosja nr. 720.
[52] Po aty.
[53] Henry Jackson van Dyke (1852 - 1933) amerikan, autor librash, edukator dhe klerik. Ka studiuar në Universitetin e Princtonit, mik i ngushtë i presidentit Wilson në Universitetin Princeton. Korrespondenca me Van Dyke vazhdon me kartolina dhe letra miqësore. Van Dik vdiq në, 10 prill të vitit 1933.

[54] Archive of YIVO Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Manhattan, New York, USA, Dosja nr 720.
[55] The New York Times, Times Square, 8 shkurt 1931.
[56] Jewish Journal, 2 Prill, 1930.
[57] Shkrim i Bernsteinit për Tiranën - Archive of YIVO Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Manhattan, New York, USA, Dosja,172.
[58] The American Foreign Service Association (AFSA), e themeluar në vitin 1924, është shoqatë prefesionale e Shërbimit të Jashtëm të Shteteve të Bashkuara. Ajo përfaqëson 28.000 punonjës të Departamentit të Shtetit, si dhe në agjensive të tjera, që kanë dalë në pension.
[59] H. Bernstein, Albania, A Fascinating Land, The Scribe, 20 Maj 1932, f. 5-22.
[60] Rituali i martesës u bë në datën datë 17 tetor, 1930 në Bashkinë e Tiranës.
[61] Archive of YIVO Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Manhattan, New York, USA, Dosja, 760, grupi i rregjistrimit 713. Fjalim i Ministrit Herman Bernstein, ditën e inaugurimit të Legatës Amerikane në Tiranë, datë 27 nëntor 1930.
[62] Rexhep Jella, Kryetar i Bashkisë së Tiranës nga viti 1930 – 1933. Në një dokument tjetër Rexhep Jella përmendet edhe si kryetari, i cili i vuri kurorën vajzës së Bernsteinit, Dorothy Nash në Bashkinë e Tiranës, fakt ky shumë domethenës për respektin që Ambasadori Amerikan ushqente për Shqipërinë. Ai mund ta bënte atë në SHBA, por preferoi pikërisht Tiranën. Archive of YIVO Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Manhattan, New York, USA, Dosja 720.
[63] Po aty.
[64] Arkivi i DASH, US Lagation Tiranë, Dosja nr. 367.
[65] Ilir Ikonomi, Pushtimi, Tiranë, Prill 2014.
[66] Eshtrat e këtij shenjtori gjendeshin në Elbasan që nga viti 1381 deri në vitin 1995. Pas kësaj datë ato janë vendosur në Kishën Ortodokse në Tiranë. Tani gjysma e tyre gjenden në Muzeun Kombëtar, ndërsa gjysma tjetër në Kishën Ortodokse në Shijon të Elbasanit.
[67] Arkivi i DASH, US Lagation Tiranë, Dosja nr. 367.
[68] Angelina Araniti (-20.07.1520). Sipas historianit Robert Elsie është figurë historike dhe shenjtore orthodokse. Ajo njihet edhe si Angelina Comnena, e bija e fisnikut Gjergj Arianiti, figurë kryesore politike dhe ushtarake e kohës së Skënderbeut. Motra e saj, Donika Arianiti, ishte e shoqja e Skënderbeut. Angelinën e martuan me despotin serb Stefan i Tretë Brankovic (1417 – 1476) i cili sundoi për një periudhë të shkurtër nga janari i vitit 1458 deri në mars 1459, si Despot i Serbisë. Me pushtimin e Ballkanit nga otomanët, Stefani, i cili ishte verbuar në vitin 1441, shkoi dhe u strehua në Shqipëri. Aty, në vitin 1461, u martua me Angelinën 15-vjeçare dhe patën katër fëmijë. Nga Kruja çifti shkoi në Venedik. Pas vdekjes së të shoqit në Udine, Angelina shkoi në Hungari dhe më vonë në Serbi, atje ku djali i saj Gjergj Brankoviç u bë despot dhe sundoi nga vitit 1486 – 1496. Në atë kohë ajo u mbyll në Manastirin e Krushedolit në Syrmia, ku edhe vdiq e u varros. Angelina Araniti nderohet si shenjtore e Kishës Orthodokse Serbe. Serbët e njohin atë si Mati Angelina e Përnderueme, ndërsa shqiptarët si Shën Angjelina e Krujës. Dita e saj festohet më 10 dhjetor të çdo viti, ndonëse ka edhe mendime të tjera të ndryshme për këtë datë dhe përmendin stinën e verës.
[69] George Washington-i ka lindur më 22 shkurt 1732 në Westmoreland County, Virginia, SHBA.
[70] Fjalimi i Ministrit Bernstein në 200-vjetorin e lindjes së George Washington-it, Archive of YIVO Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Manhattan, New York, USA, Dosja nr. 720.
[71] Më 5 nëntor 2012, në përkujtim të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, kjo shkollë mori emrin, Shkolla e Mesme Bujqësore "Charles Telford Erickson". Në inaugurimin e emrit të saj, morën pjesë tre nipa e mbesa të themeluesit ë saj: Paul Erickson, Jr., Don Johnson dhe Mary Morris.
[72] Herbert Clark Hoover (1874-1964) ishte presidenti i 31-të i Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga viti 1929-1933. Para se të zgjidhej president, ai ishte Sekretar i Shtetit për tregtinë në vitet njëzet, në administratat e presidentëve Warren Harding dhe Calvin Coolidge. Ai e dha atë ndihmë për shkollën e Kavajës nga pozita e Sekretarit të Shtetit për Tregtinë. Lidhjet dhe simpatia për Shqipërinë nuk u shuan asnjëherë pas kësaj. Kur u bë President, ai emëroi gjatë periudhës së tij në detyrë ambasadorin Herman Bernstein (1930-1933,) mik i ngushtë i tij dhe, po ashtu, ndërtoi ambasadën e SHBA-ve në Tiranë, një ndër pasuritë e vyera të Departamentit të Shtetit Amerikan jashtë vendit të tyre. Simpatia dhe interesi për Shkollën Bujqësore të Kavajës shfaqen edhe më vonë tek ai. (Shënimi i M.B.).
[73] Alan Welsh Dulles (1893-1969) diplomat amerikan, jurist, bankier dhe zyrtar, i cili shërbeu shumë gjatë në administratën amerikane. Ai ishte kreu i CIA-s. Bashkë me të vëllain mbajtën pozita të rëndësishme në administratat amerikane. I vëllai John Foster Dulles ishte Sekretar Shteti në administratën e presidentit Eisenhower. (Shënimi M.B.).
[74] Arkivi i DASH, Dosja nr. 367.
[75] Alan Fusine, Albanian – American School of Agriculture, Disertacion, Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 5.
[76] The Near East Foundation (NEF), i njohur më parë si American Committee for Relief in the Near East, është organizatë amerikane sociale dhe ekonomike ndihmash. Ajo është themeluar në vitin 1915 në SHBA dhe është organizata jofetare më e vjetër në SHBA, e çertifikuar nga një akt juridik i Kongresit.
[77] Është fjala për krizën ekonomike që përfshiu SHBA-të në kohën e Depresionit të Madh.
[78] Hilë Mosi (22 prill 1885 -në shkurt 1933), poet, luftëtar, publicist, patriot, demokrat, figurë politike e njohur e periudhës para e pas Pavarësisë.
[79] Archive of YIVO Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Manhattan, New York, USA, Dosja nr.172.
[80] Dëshmi e zonjës Adelina Nosi, mbesa e Lef Nosit dhënë portalit 360 gradë.

[81] Margaret Masson Hasluck, e njohur gjithashtu si Peggy Hasluck, ishte dijetare dhe antropologe skoceze. Ajo studioi në Akademinë Elgin, në Universitetin e Aberdeen-it dhe pastaj në Neuham College, Cambridge, ku përfundoi me një diplomë në historinë dhe letërsinë klasike. Nga viti 1923 e këtej, ajo kaloi pjesën më të madhe të viteve në Shqipëri dhe banoi në qytetin e Elbasanit për 13 vjet. Hasluck botoi artikuj të shumtë, duke përfshirë edhe gramatikën e parë anglisht-shqip. Për shkak të punës së saj për zbulimin britanik gjatë Luftës së Parë Botërore, ajo u detyrua të largohet nga Shqipëria për në Athinë kur italianët aneksuan vendin në vitin 1939. Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore ajo u punësua prej SOE dhe për shkak të dijenive shumë të gjera rreth Ballkanit dhe u emërua këshilltare për çështjet shqiptare nga shkurti 1942, detyrë që e mbajti deri në vitin 1944. Ajo vijoi në Qipro dhe më pas në Dublin, ku vdiq më 18 tetor 1948. Bashkia e Elbasanit, në qershor 2010, ka përkujtuar 125-vjetorin e lindjes së saj dhe ka përuruar një pllakatë përkujtimore në pronën e saj në Elbasan. Margaret Hasluck mban titullin *"Qytetare Nderi*" "për *kontributin e saj të shquar në sferën publike të qytetit të Elbasanit"*. Jeta e saj është pasqyruar në një botim të veçantë të njohur me titullin "*Një grua në Shqipëri, Jeta e Margaret Hasluck*".

[82] Archive of YIVO Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Manhattan, New York, USA, Dosja nr. 720.

[83] *Anno Domini* në latinishten mesjetare do të thoshte: Në vitin e Zotit: Nganjëherë ai përdoret *Anno Domini Nostri Iesu (Jesu) Christi,* në vitin e Zotit tonë Jezus Krishtit, bëhët fjalë për erën e re. Kalendari llogaritet nga viti i lindjes së Jezusit të Nazaretit.

[84] Pjesë nga Seyahatnamesi e Evliya Chelebisë, Volumi VIII, f. 719, rrjeshti 4, Rhanie printing Press, Stamboll, 1928, është një xhami mbretërore në katin e parë mbi atë portë. Ajo është e bërë me pllaka dhe është xhami mjaft e nderuar në një stil shumë të vjetër. Afër kësaj xhamie, gjendet një kullë sahati shumë e lartë. Nga i njëjti volum në faqe 720 rrjeshti 11 lexojmë: "…por nuk ka hebrej, europianë, apo armenë, serbë, bullgarë apo jo muhamedanë. Por ata vinë të bëjnë tregti, qëndrojnë nëpër hane dhe pastaj ikin përsëri. Që prej kohëve të lashta ata kanë ardhur thjesht dhe vetëm kështu.".

[85] Gazeta 'DIELLI", Boston, 7 prill 1933.

[86] Dramë e shkruar nga aktori i madh shqiptar i teatrit austriak Burgteater, Aleksander Moisiu.

[87] The Prisoner, dramë në pesë akte Archive of YIVO, Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Manhattan, New York, USA, Dosja nr. 720.

[88] Archive of YIVO Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Manhattan, New York, USA, Dosja nr. 720.

[89] Beteja e Adowas ose Adua shënon një humbje të pashoqe të , të cilët si shtet i ri i bashkuar kërkonin të dominionin sikundër fuqitë e tjera europiane. Beteja u zhvillua në Etiopi më 1 mars 1886 dhe përfundoi me humbjen e rëndë të italianëve. Kësaj beteje i referohet Bernstein, kur e krahason me luftën e Vlorës. (Shënimi i M.B.)

[90] Është fjala për të ashtuquajtërn Kryengritja e Fierit, e cila dështoi. Ghildardi ishte në kthim nga një vizitë në Apolloni.

[91] Mehmet Konica, i pari diplomat shqiptar i akredituar në Oborrin e Shën Xhejmsit në vitin 1922. Më vonë ai ka shërbyer edhe si Ministër i Punëve të Jashtme të Mbretërisë Shqiptare. (Shënimi M.B.)

[92] Sir Robert MacLeod Hodgson, ka qenë Ministër Fuqiplotë në Shqipëri në vitet 1928-1936.

[93]Archive of YIVO Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Manhattan, New York, USA, Dosja nr. 720.

[94] Archiduka Franc Ferdinanti është vrarë më 28 korrik të vitit 1914.

[95] "Quarto" ishte një anije unike e mbrojtur e ndërtuar nga Regia Marina Italiane (Forcat Detare Mbretërore) në vitin 1910. Ajo e hodhi spirancën në nëntor të vitit 1909. U nis në gusht 1911 dhe përfundoi në mars 1913. Ishte i pari kryqëzor italian, i pajisur me turbina me avull, që kapi shpejtësinë maksimale prej 52 km / orë, ose 32 milje në orë. Shpejtësia e lartë ishte kërkesa, që duhej të plotësonte për të shërbyer si pararoja e flotës kryesore italiane. Quarto u mbyt gjatë një prove, të bërë me motoskaf shpërthyes në nëntor 1940.

[96] King Zog Tells his Story to Herman Bernstein, former United States Minister to Albania. Typescript in the: YIVO Institute for Jewish Research, New York. Record Group 713, Folder 760.

[97] Raport i datës 31 korrik 1930 dërguar nga Herman Bernstein vetë Sekretarit të Shtetit Amerikan, të asaj kohe Henry L. Stimson. Arkiva e DASH.

[98] Është fjala pët Institutin Bujqësor të Kavajës, Shkollën e Vajzave në Kavajë dhe Shkollën Teknike të njohur me emrin e Harry Fultzit.

[99] Pakti Kellogg-Briand Pact është një marrëveshje që synonte të pushonte luftën i nënshkruar më 27 gusht 1928. Ai njihet edhe si Pakti i Parisit në nderim të qytetit, ku u nënshkrua. Pakti kishte si qëllim parandalimin e Luftës së Dytë Botërore, por pati ndikim shumë të vogël në ndalimin e militarizimit, që çoi në shpërthimin e luftës.

[100] Letër e Herman Bernstein – Arkiva e Departamentit të Shtetit Amerikan. Letra e rregjistruar si Kofidenciale më 13 gusht 1930.

[101] Kabllogram nr 84, i datë 8 tetor 1930 dërguar Departamentit të Shtetit nga Ambasada Amerikane, Tiranë.

[102] Tepër konfidencial, 31 dhjetor 1930, prot. Nr. 156

[103] Nga një bisedë me prof. Myzafer Korkuti, kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ky varr rezulton të jetë edhe sot në fshatin Fterë të Sarandës.

[104] Harvey Sarver, Rescue in Albania, Brunswick Press, Cathedral City, California, 1977.

[105] Albanian Journey, Bernard Newman Pitman & Sons, London, autori u referohet tregtarëve hebrej spanjishtfolës në Tiranë. Ndoshta ata flisnin Ladino.

[106] Sabbatai Zevi, 1626 – 1676 ka qenë rabin sefardik me origjinë romaniate, i cili pretendoi se ishte Mesia i shumëpritur, që do t'i udhëhiqte hebrejtë drejt Tokës së Shenjtë. Ai, sapo arriti në Stamboll, në vitin 1666 u burgos me urdhër të Vezirit

të Madh, Ahmet Köprülü. Zevi është themelues i Lëvizjes Sabatian dhe vlerësohet si mashtrues shumë i madh në botën hebraike.

[107] John Freely, The Lost Messiah, VIKING an imprint of Penguin Books, London, 1998, f. 203, 205, 244, 249, 251.

[108] Sarner Harvey, The Jews in Albania, 1992, Brunswick Press.

[109] Dönmeh, "Të shndërruarit" janë hebrejtë, të cilët shndërroheshin me detyrim për të fshehur identitetin e tyre. Vetë Sabbatai Zevi u shndërrua dhe jetoi pjesën tjetër pas atij momenti si mysliman.

[110] John Freely, The Lost Messiah, Penguin, London, 1998, The Lost Messiah, VIKING an imprint of Penguin Books, London, 1998, f. 244.

[111] Sipas Eduard Mantus, Bernstein kish rënë dakord me Mbretin Zog për të marrë hebrej nga Austria dhe Gjermania dhe për t'i vendosur në Shqipëri. Letër dërguar botuesit. Jewish Chronicle, 8 Qershor 1973.

[112] Ky shkrim është shkruar ditën e vdekjes së profesor Epstein, Londër 27 prill, 2014.

[113] Prof. Scarlett Epstein, Swimming Upstream, Autobiografi.

[114] Reviw of the Jewish week by Joseph Salmark, Archive of YIVO Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Manhattan, New York, USA, Dosja 760, Record group nr 713.

[115] Kjo marrëveshje u nënshkrua nga Herman Bernstein dhe Ministri i Jashtëm i Madhërisë së Tij, Mbretit të Shqiptarëve Zog I, z. Xhafer Vila. Nënshkrimi u bë më 1 mars 1933 dhe u ratifikua nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara më 21 shkurt 1934, ndërsa nga Mbreti Zog më 20 prill 1935. Marrëveshja hyri në fuqi më 14 nëntor 1935 dhe u shpall nga Presidenti Amerikan më 19 nëntor, 1935. Përpara kësaj Bernstein, më 24 janar 1931 kishte nënshkruar Marrëveshjen e Natyralizimit midis Shqipërisë dhe SHBA-ve në emër të Presidentit Herbert Hoover. Nga pala shqiptare atë e nënshkroi Kryeministri M.Evangjeli në emër të Mbretit Zog.

[116] Dragoman, fjalë e përdorur në tekstin origjinal. Dragomanë quheshin përkthyesit dhe drejtuesit zyrtarë nëpër konsullata në Lindjen e Mesme dhe në Ambasadat Europiane. Ata kishin njohuri në gjuhët arabe, perse, turke dhe natyrisht europiane.

[117] Harvey Sarner, "Rescue in Albania" Copyright C 1997 prej Brunswick Press, botuar në shqip me titull "*Shpëtimi në Shqipëri*", nën kujdesin e Lidhjes Qytetare Shqiptaro – Amerikane në New York dhe personalisht nga Presidenti i saj, ish Kongresmeni Joe DioGuardi, Shtëpia Botuese "KOHA", Tiranë, 1998.

[118] Editorial i "VATRËS", 17 shtator, 1933

[119] Reviw of the Jewish week by Joseph Salmark, Archive of YIVO Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Dosja nr. 760, Record group nr. 713, Manhattan, New York, USA,.

[120] Arkivi i "Vatrës", 19 shtator 1933, Selia në adresën e sotme, 2437 Southern Blvd. Bronx, NY 10458, USA.

[121] Nord Deutscher Lloyd (NDL) ishte një kompani detare nga më të rëndësishmet në Gjermani, e themeluar në vitin 1857. Mesa duket ajo shkruante për njerëzit e shquar që udhëtonin me të prandaj dhe ky material gjendet në dokumentet e Herman Bernstein. Archive of YIVO Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Manhattan, New York, USA, Dosja nr.172.

[122] Mbajtur në Hotel "Kontinental", 13 shtator 1933.

[123] *E Pluribus Unum,* gjendet në Stampën e Madhe të Shteteve të Bashkuara dhe përbën një prej motove të kombit në kohën, kur u krijua kjo stampë e shtetit.

[124] Në origjinal në gjuhën angleze: "*And the star spanglet banner, In triumph shall wave, O'er the land of the free, end The home of the brave".*

[125] "Long Live Zog i Parë, Long Live, The saver of the country, On the throne of Skanderbeg"

[126] Fjala e lamtumirës së Herman Bernstein, Tiranë. Archive of YIVO Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Manhattan, New York, USA, Dosja nr. 752.

[127] Kol Kuqali, lindi në Korçë më 1895. Emigroi në SHBA, studioi dhe u kthye në Shqipëri për të punuar në Legatën Amerikane në vitin 1929. Administroi një minierë në Krrabë të Tiranës në vitin 1939. I vdesin dy djem në kampet naziste në Mathauzen dhe Prishtinë. Mbas luftës kishte funksionin e zv/drejtorit të Bankës Shqiptare. U përplas me Enver Hoxhën dhe Nako Spiron, pasi ishte kundër barazimit të lekut me dinarin jugosllav. Deputet në legjislacionin e parë 1945. Arrestohet në Qershor 1947 dhe gjendet i vdekur në burgun e Tiranës në një ditë me Loni Adamin. Ambasada Amerikane në Tiranë ka ngritur një monument brenda selisë në nderim të tyre dhe jep edhe një çmim me emrin e tyre.

[128] Archive of YIVO Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Manhattan, New York, USA, Dosja nr.720, letër e datës 25 shtator 1934, shkruar nga Mehmet Konica.

[129] "The Balkan Pact" ishte një traktat i nënshkruar nga Greqia, Turqia, Rumania dhe Jugosllavia më 9 shkurt 1934 në Athinë dhe kishte si qëllim të ruante një *status quo* në rajonin e Ballkanit pas Luftës së Madhe Botërore. Ajo u regjistrua në "Serinë e Traktateve të Lidhjes së Kombeve" më datën 1 tetor 1934.

[130] Fjala është për letrën që Berstein i kishte dërguar edhe Mehmet Konicës për librin e tij "*Can we abolish War*? Fragmente të përgjigjeve të dhëna nga njerëz shumë të shquar ndaj këtyre pyetjeve dhe dërguar Bernstein janë pjesë e këtij libri.

[131] New York Times, 21 shkurt 1934.

[132] Archive of YIVO Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Manhattan, New York, USA, Dosja nr. 720,

[133] New York Times, 28 Janar 1934 - Herman Bernstein**:** Little Albania is the Pawn in a Great Diplomatic Game. **(**Shqipëria e Vogël është Pengu i Lojës së Madhe Diplomatike). Ky ishte edhe një parashikim absolutisht i saktë i asaj, që po e priste Shqipërinë, pushtimi fashist prej Musolinit.

[134] Ky shkrim i Herman Bernsteinit ka një pasaktësi. Kryetar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris nuk ka qenë Mehmet Bej Konica, por Turkhan Pasha. Ky delegacion ishte njëri prej disave, që shqiptarët dërguan atje, por i

vetmi që u njoh zyrtarisht i dalë nga Qeveria jetëshkurtër e Durrësit. Edhe kërkesën për vendosjen e Shqipërisë nën një mandat amerikan nuk e ka bërë Mehmet bej Konica. Atë e ka bërë amerikani Chales Telford Erickson, anëtari i vetëm i huaj i delegacont shqiptar në Paris (Shih: "Amerikani që i kushtoi jetën Shqipërisë", EduAlba, 2012, f. 185). Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Dosja nr. 4.

[135] Konferenca e Fshehtë e Londrës 1915.

[136]Archive of YIVO Institute for Jewish Research, 15 West 16th Street, Manhattan, New York, USA, Dosja, 172.

[137] Ky kapitull u përgatit nga dr. Xhoana Papakostandini, njohëse e mirë e gjuhës dhe historisë italiane, Doktore Shkencash në Bashkëpunim Ndërkombëtar.

138 I shkruar kështu në original.

[139] Arkiva e Ministrisë së Jashtme Italiane, Dosja Albania, f.1-41.

[140] Chimera është figurë mitologjike greke e paraqitur si një monstër, që frymon zjarr dhe ka kokë luani, trup dhije dhe bisht gjarpri, një gjë që ekziston vetëm në imagjinatë dhe jo në realitet.

[141] Kryeministria, selia e qeverisë italiane.

142 Baroni Pompeo Aloisi që prej vitit 1932 ishte shef kabineti në Ministrinë e Punëve të Jashtme italiane. Ministër i Jashtëm ishte vetë Musolini.

[143] E nënvizuar në tekstin original.

[144] Arkiva e Ministrisë së Jashtme Italiane, Dosja Albania, f. 1-41.

[145] Wheeler është Ambasadori amerikan, që do të zëvendësonte Bernstein në Shqipëri.

[146] Arkiva e Ministrisë së Jashtme Italiane, Prot. 2968/465. Përzgjodhi nga dokumentat origjinale dhe përktheu nga italishtja Xhoana Papakostandini.

[147] New York Times, 3 shtator 1935.

[148]Herman Bernstein, The Flight of Time and Other Poems, Copyright by F. Tennyson Neely, 1899, in United States of America and United Kingdom. New York Public Library, dedicated to John Clark Ridpath, LL.D, recpectfully inscribed by the author.

[149] Rain and Sunshine, f. 35, përkthyer nga M.B.

[150] Dashuria për Famën, f. 70, përkthyer nga M.B.

[151] Faqe 38, përkthyer nga MB.

[152] F. 65, përkthyer nga M.B.

[153] Herman Bernstein, The Library Company of Phiadelphia: "*In the Gates of Israel*", Stories of the Jews, Copyright 1902 J.F Taylor & Co, New York, 1902. Libri ishte botuar më parë në organet e shtypit amerikan, si The Evening Post, Ainslee's Magazine dhe ente të tjera shtypi.

[154] F. 30.

[155] Po aty, f. 55.

[156] The Man who was Afraid.

[157] Tyrtaeus ka qenë një poet lirik grek nga Sparta, i cili shkroi vjersha rrreth kohës së Luftës së Dytë Messeniane, data e së cilës nuk është shumë e sigurt, por diku nga fundi i shekullit të shtatë para erës së re.

[158] "The Sorrows of Belgium" shkruar nga Leonid Andrejev, përkthyer në anglisht nga Herman Bernstein, New York, Macmillan Co, 1915.

[159]Pale Settlement ishte një rajon i Rusisë cariste, në të cilën u lejua banimi i përhershëm i hebrenjve, por jo përtej kufijve të atij rajoni. Ajo shtrihej nga Pale, në një vijë ndarëse deri te kufiri perëndimor me Mbretërinë e Prusisë (më vonë Perandoria Gjermane) dhe Austro-Hungarinë. Fjala Pale vetë vjen nga latinishtja palus dhe do të thotë zonë e rrethuar prej një gardhi kufitar.

[160] Gerbë, gunga e kurrizos.

[161] First Edition. Varianti anglisht i Anathemas ishte botuar me përkthimin e Herman Bernstein në Macmillan, 1910. First Edition. Standard English translation.

[162] Përkthim i autorizuar nga gjuha ruse prej Herman Bernstein.

[163] The Black Hundreds, (Qindëshet e zeza) ishte një lëvizje ultra nacionaliste në Rusinë e fillimit të shekullit të 20 – të. Lëvizja ishte një mbështetëse e egër e Shtëpisë së Romanovëve dhe kundërshtare e çfarëdo lloj veprimi që nxiste largimin nga autokracia dhe sundimi monarkik.

[164] **"**Ditari i Satanit" i Leonid Andrejevit është vepra e tij e fundit, të cilën e përfundoi vetëm disa ditë para se të vdiste, në shtator të vitit 1919.

[165] The life of father Vassily

[166] The Red Laughter

[167] Anathema

[168] The Seven who were hanged

[169]Bernstein, Herman, *Satan's Diary*, Boni and Liveright, New York ,1920.

[170] Anton Pavlovich Chekhov, 1860 - 1904, dramaturg rus dhe shkrimtar tregimesh të shkurtra është konsideruar të jetë një prej shkrimtarëve më të mëdhenj i këtij zhanri në historinë e letërsisë. Ai renditet midis tre autorëve të tillë, me Ibsen dhe Stringberg. Tregimi "*Shpifësi*", i përkthyer nga Herman Bernstein, është një prej tregimeve të tij.

[171] Copyright, 1901, by the Globe and Commercial Advertiser.

[172] Copyright, 1907, by P. P. Collier & Son.

[173] Сближение, në anglisht – konvergjencë, takim midis dy gjërave, ribashkim, dy struktura të zhvilluara larg njëra-

tjetrës, por që kanë shumë cilësi të përbashkëta.

[174] Menahem Mendel Beilis; (1874 – 1934) hebre rus, i akuzuar për vrasjen rituale në Kiev. Në një gjyq famëkeq të vitit 1913 i njohur si Gjyqi i Beilis-it, apo Çështja Beilis ai u dënua për diçka që nuk e kishte kryer. Çështja mori përmasa ndërkombëtare për shkak të politikës antisemitiste të Perandorisë Ruse. Kjo çështje u bë tema e romanit të Bernard Malamudit, "*The Fixer*", e cila fitoi çmimin Pulitzer dhe Medaljen Kombëtare të Librit.

[175] Telegramet Willy-Niki janë quajtur një pako prej 65 telegramesh, të shkëmbyera mids Vilhelmit të Dytë të Perandorisë Gjermane dhe Car Nikollës së Dytë të Rusisë, në prag të Luftës së Parë Botërore. Kaizeri gjerman dhe Cari rus ishin kushërinj të tretë ndërsa e shoqja e Nikollës ishte kushërirë e parë e Kajzerit. Ata e thërrisnin njëri-tjetrin me shkurtime emrash përkëdhelie prej nga mori emrin edhe korrespondenca e tyre e botuar nga Herman Bernstein.

[176] Alexandra Feodorovna (1872 - 1918) ishte Perandore ruse, bashkëshorte e Car Nikollës II, sundimtari i fundit i Perandorisë Ruse. Ajo njihej si Alix i Hesse-sit dhe ishte mbesë e Mbretëreshes angleze Viktoria. Asaj ju dha emri Alexandra *Feodorovna* dhe *u ekzekutia* bashkë me familjen e saj nga sovjetët.

[177] Das Deutsche Weißbuch – Libri i Bardhë Gjerman ishte i ngjashëm me Librin Blu Britanik ose Librin Portokalli Rus. Aty gjenden dokumente të fshehta, të cilat përshkruajnë intrigat në ngjarje të rëndësishme, si për shembull vrasja në Sarajevë e Arkidukës Austro – Hungarez Franc Ferdinandi etj.

[178] The Alexander Palace ose Tsarskoye Selo, është pallat afër Shën Petërsburgut e njohur si rezidenca e Perandorit të fundit rus, Nikolla i Dytë.

[179] Theodore Roosevelt, (1858 - 1919) burrë shteti amerikan, autor, zbulues, ushtar, natyralist dhe reformator, i cili shërbeu si President i 26-të i SHBA-ve nga viti 1901 – 1909. Ai është fitues i Çmimit Nobel për kontributin e dhënë në pushimin e Luftës Ruso – Japoneze në vitin 1906. Ai u bë njeriu që i dha shtytje të jashtëzakonshme progresit në Shtetet e Bashkuara në fillimin e shekullit XX.

[180] Victoria Woeste "Henry Ford's War on Jews and the legal Battle against Hate Speech", Stanford University.

[181] Në buletinin J.T.A, f. 9 datë 29.8.33 është botuar ndjesa që Henry Fordi i ka kërkuar Herman Bernsteinit: "*Unë nuk kam dashur të përfshihesha në çështjet që kanë të bëjnë me Hebrejtë në "Dearbron Independent". Në asnjë moment ju nuk më keni thënë diçka që do të justifikonte arritjen në një përfundim të tillë. E kuptoj dëmin që mund t'ju kem shkaktuar juve midis njerëzve të racës tuaj, si dhe në profesionin tuaj si autor, botues dhe korrespondent gazetash dhe çmimin, në të cilin ju jeni vënë ta paguani për të mbrojtur emrin e mirë, që gëzon populli hebre dhe reputacionin kundër akuzave. Unë shpresoj se kjo ndjesë do t'ju qetësojë në këtë drejtim.*". Z. Bernstein ka deklaruar se në kohën e emërimit si Ministër në Shqipëri, kandidaturën e tij e kishte mbështetur vetë Henry Ford. (f. 1777 prej 3.500 faqesh).

[182] With Master Minds, Universal Series Publishing Co. 302 Broadway, New York, 1913.

[183] Po aty

[184] Po aty f. 7.

[185] Henry George, (1839 – 1897) filozof amerikan i ekonomisë politike, vepra e të cilit ishte jashtëzakonisht popullore në shekullin e 19. Vepra e tij njihet si filozofia e gjeorgjizmit bazuar në besimin se populli duhet të jetë në pronë të vlerës, që ata prodhojnë vetë, ndërsa vlera ekonomike që rrjedh nga pasuria tokësore duhet të ndahet në mënyrë të barabartë te të gjithë pjestarët e shoqërisë.

[186] "*Wise Thoughts For Every Day"* është një vëllim i madh shkrimesh, shkruar nga Leon Tolstoi i mbushur me ide thelbësore rreth spirituailizmit dhe ajo që quhet të jetosh një jetë të rehatshme. Aty gjenden lexime të përditshme plot me aforizma me tema rreth shpirtit, dëshirës, pasionit, thjeshtësise, pabarazisë, djallit, të vërtetës, lumturisë, faljeve, bekimeve dhe dashurisë. Ky është një libër frymëzues për ngrohtësinë njerëzore.

[187] Po aty f. 20.

[188] Po aty f. 26.

[189] Ilya Ilyich Mechnikov, zoologjist rus i njohur për studimet e tij për imunologjinë. Po aty f. 50.

[190] Po aty f. 71. Intervista është marrë në vitin 1908.

[191] Po aty f. 72. George Bernard Shaw, dramaturg anglo – irlandez, kritik dhe polemist i thekur ndikimi i të cilit në teatrin, kulturën dhe politikën perëndimore shtrihet në një hark kohor prej vitit 1880, deri kur vdiq në vitin 1950. Veprat e tij më të shquara janë: "*Zonja ime e mrekullueshme*", "*Pigmalioni*", "*Çezari dhe Kleopatra*", si dhe dhjetra tjera.

[192] *"Cashel Byron's Profession"* është novela e katërt e Bernard Shaw shkruar në vitin 1882.

[193] Po aty, f. 74.

[194] Henri-Louis Bergson, 1859 – 1941, filozof francez me influencë të madhe në gjysmën e parë të shekullit XX dhe pas luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1927 ai është lauruar me çmimin Nobel për Letërsi dhe në vitin 1930 ai është lauruar me Kryqin e Madh të Legjionit të Nderit. F. 91.

[195] Po aty, faqe 98.

[196] François Auguste René Rodin, 1840 – 1917, i njohur si Auguste Rodin ësht një nga skulptorët më të famshëm modernë. F. 107.

[197] Po aty, f. 117.

[198] Henry Havelock Ellis, 1859 – 1939, mjek anglez, shkrimtar, intelektual përparimtar dhe reformist social. Ai ka meritën se ka paraqitur nocionet e narcizmit dhe autoeroticismit e adoptuar si teoria e psikoanalizës. Ai ka qenë President i Institutit Galton dhe ka përkrahur eugenizmin, f. 132.

[199] Leonid Nikolaievich Andrejev, 1871- 1919 dramaturg, romancier, tregimtar i vlerësuar si babai i letërsisë ekspresioniste ruse. Ai është përfaqësuesi më i talentuar i periudhës së Epokës së Argjendë. Stili i tij kombinon elemente të realizmit, natyralizmit dhe simbolizmit, f. 158.

[200] Po aty f. 164.
[201] Shaiykh al-Islām, titull që përdorej në kohën klasike si një titull honorifik për studiuesit më të shquar të shkencave islamike. Më vonë ai u bë një pozicion prestigjioz në Perandorinë Otomane, i cili qeveriste çështjet fetare të myslimanëve. Në kohët moderne ky post mbahej nga kryemyftiu, i emëruar ose zgjedhur në mënyra të ndryshme, f. 223.
[202] Po aty f. 282.
[203] Po aty f. 240.
[204] "Celebrities of our time" Interviews by Herman Bernstein, New York, Joseph Lawren, 1924.
[205] Pope Benedict XV, i lindur Giacomo Paolo Giovanni Battista della Chiesa, ka qenë Papë që nga 3 shtatori 1914 deri sa vdiq në vitin 1922. Pontifikati i tij është hijezuar shumë prej ngjarjeve të Luftës së Parë Botërore dhe rrjedhojat e saj politike, ekonomike, shoqërore dhe humanitare në Europë.
[206] *Enciclica Ad Beatissimi Apostolorum*, Vatikan, 1 nëntor 1914.
[207] Kardinali Pietro Gasparri konsiderohet si njeriu që ringjalli rolin dhe rrjetin diplomatik të Vatikanit gjatë detyrës së tij si Sekretar Shteti i Vatikanit në vitet 1914-1934.
[208] "Celebrities of our time", Interviews by Herman Bernstein, New York Joseph Lawren, 1924. Letër e shkruar më 30 dhjetor 1915.
[209] "Celebrities of our time", Interviews by Herman Bernstein, New York Joseph Lawren, 1924. Letër e shkruar më 9 shkurt 1916.
[210] Leo Trocky ishte revolucionar dhe teoricien marksist, politikan sovjetik, i cili ndërmori transferimin e pushtetit politik te sovjetët me Revolucionin e Tetorit 1917. Ai ishte themeluesi i Ushtrisë së Kuqe. U vra nga agjentët e fshehtë të Stalinit në Meksikë, në mërgim, në vitin 1940.
[211] Traktati i Brest – Litovskit ishte një traktat paqeje i nënshkruar më 3 mars 1918 midis Qeverisë Bolshevike të Rusisë Sovjetike, Fuqive Qendrore (Gjermani, Austro – Hungari, Bullgari) dhe Perandorisë Osmane, i cili shënoi fundin e pjesëmarrjes së Rusisë në Luftën e Madhe.
[212] Realitete Shqiptaro – Britanike, EduAlba, tetor 2015, faqe 102. Lordi Cecil, është ai që këmbënguli më shumë se kushdo për anëtarësimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, në vitin 1920. Lobimi i fuqishëm i anglezit Aubrey Herbert, me delegacionin britanik të përbërë ose alternuar prej Lord Robert Cecil, Lordit Balfour dhe historianit M. Fisher, bëri të mundur pranimin e Shqipërisë si vendi 42-të anëtar i kësaj Lidhje në vitin 1920. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit të Asamblesë së Parë të Lidhjes së Kombeve, nr 13, datë 11 dhjetor 1920, f. 12-13.
[213]Chaim Azriel Weizmann, 1874 – 1952, udhëheqës sionist dhe burrështetas izraelit, i cili shërbeu si Presidenti i Organizatës Sioniste dhe si Presidenti i Parë i Shtetit të Izraelit. Ai u zgjodh më 16 shkurt 1949 dhe shërbeu deri sa vdiq në vitin 1952. Ishe biokimist i shquar dhe luajti rol të rëndësishëm në themelimin e Universitetit Hebraik të Jeruzalemit.
[214] Intervistë e Prillit 1921, dhënë Bernsteinit nga babai i shtetit Izraelit Chaim Weizman.
[215] Judea Capta, monedhë romake që u emetua nga Perandori romak Vaspasian, për të dëshmuar rënien e Jeruzalemit në duart e Romës. 'Judea Capta' u emetua në vitin në vitin '71 për të festuar fitoren ndaj revoltës së hebrejve. Në anën tjetër të monedhës shkruhet Ivdea Capta, që do të thotë hebrejtë u pushtuan.
[216] "Celebrities of our time", Intervistë by Herman Bernstein, New York Joseph Lawren, 1924, f. 266.
[217] Intervistë e dhënë Bernsteinit nga Albert Einstein, në New York në vitin 1921.
[218] Njeri i keq
[219]Theodore Roosevelt Jr., President i 26-të i Shteteve të Bashkuara nga viti 1901, deri në vitin 1909.
[220]Thomas Woodrow Wilson, politikan dhe akademik amerikan, i cili shërbeu si Presidenti i 28 të i Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga viti 1913 deri në vitit 1921.
[221]Aleksandër Moisiu ose *Alexander, Alessandro - Moissi ose Moisi*, lindi në 2 prill të vitit 1879 në Trieste dhe vdiq më 23 mars të vitit 1935 në Vjenë. Ishte aktor austriak me origjinë shqiptare.
[222] 7 tetor 1914.
[223] Department of Commerce, Office of Secretary, Washington, December 21, 1922.
[224] McClure's Magazine (1893-1926), September 1925, Vol. I, No 5, American Periodicals, New York Public Library, 42 Steet and 5th Ave. NY,NY 10002, f. 666,.
[225] Memorandum of Mr. Herbert Hoover send to the President of the United States of America on March 21, 1919. Herbert Hoover Collection.
[226] Letter of Herbert Hoover, dërguar Lordit Robert Cecil, 9 qershor 1919. Dokumenti gjendet në Hoover Collections.
[227] Herman Bernstein, Can we abolish War, Broadview Publishers, New York, 1935.
[228]Charles-Irénée Castel de Saint-Pierre, abbé de Saint-Pierre (18 shkurt 1658 – 29 Prill 1743), autor francez. Propozimi i tij për një organizatë ndërkombëtare, që të ruajë paqen ishte ndoshta përpjekja e parë e kësaj natyre në tërë historinë me përjashtim të Traktatit të Georgit të Padebradyit (1462 – 1464). Ai ndikoi vetë Emanual Kantin.
[229] Jeremy Benthan, filozof anglez dhe politikan radikal. Ai njihet sot për filozofinë morale, veçanërisht parimet e tij të utilitarizmit, të cilat i vlerësojnë veprimet bazuar në rrjedhojat e tyre.
[230] Pakti Kellogg–Briand është marrëveshje ndërkombëtare e vitit 1928, në të cilën palët nënshkruese u zotuan të mos e përdornin luftën si mjet për zgjidhjen e konflikteve të çfarëdo natyre, qofshin ato që mund të shpërthejnë midis tyre. Pakti mori emrat e nënshkruesve, Sekretarit Amerikan të Shtetit Frank B. Kellogg dhe Ministrit të Jashtëm Francez Aristide Briend.
[231] Herman Bernstein: Can we abolish War, Broadview Publishers, New York, 1935, f. 1-24.
[232] Carl William Ackerman (1890 – 1970), i pari dekan i Shkollës së Gazetarisë në Universitetin Columbia në New York.

Ai shërbeu në atë detyrë nga viti 1931 deri në vitin 1954.
[233] Jane Adams ishte gruaja e dytë që arriti të merrte Çmimin e Paqes. Ajo themeloi Lidhjen Ndërkombëtare të Grave për Paqe dhe Liri në vitin 1919 dhe punoi me çdo mjet për shumë e shumë vite për të çarmatosur fuqitë e mëdha dhe për të arritur marrëveshje paqeje.
[234] Po aty, f. 30.
[235] Eusebio Ayala, President i Paraguait nga 7 nëntori 1921 deri më 12 prill 1923 dhe përsëri nga 15 gushti 1932, deri më 17 shkurt 1936.
[236] Po aty, f. 31.
[237] Nicholas Murray Butler, (1862 – 1947) filozof amerikan, diplomat dhe edukator.
[238] Po aty, f. 34.
[239] Gjermania mbi çdo gjë
[240] Po aty f. 35.
[241] Po aty f. 36.
[242] Po aty, f. 43.
[243] Juan Vicente Gómez Chacón ishte gjenerali dhe sundimtari *de facto* i Venezuelës nga viti 1908 deri në vitin 1935, f 44.
[244] Po aty, f. 44.
[245] Po aty faqe 52.
[246] Luiz (Ludwig) Heinrich Mann (1871 - 1950), novelist gjerman, i cili ka shkruar vepra me tema të forta sociale. Kriticizmi i tij i ashpër ndaj nazismit ishte aq i fortë, sa ai u bë objekt sulmesh, derisa u detyrua të arratisej nga vendi i tij pas ardhjes së nazismit në pushtet në vitin 1933. Po aty f. 50.
[247] Gerald Prentice Nye, politikan amerikan, i cili e përfaqësoi Dakotën e Veriut në Senatin Amerikan nga viti 1925, deri në vitin 1945.
[248] Po aty f. 56.
[249] Panagis Tsaldaris (1868 - 1936) politikan grek dhe Kryeministër. Ai ishte udhëheqës i shquar nga viti 1922, deri në vitin 1936. Po aty, f. 63.
[250]Sir Joseph Austen Chamberlain, 1863 – 1937, politikan britanik konservator. Ai si Sekretar i Jashtëm i Britanisë së Madhe negocioi Paktin e Lukarnos (1925), arritje diplomatike për të cilën u dekorua me çmimin Nobel për Paqe, së bashku me Ministrin e Jashtëm gjerman, Gustav Stresemann dhe Ministrin e Jashtëm francez, Aristide Briand.
[251] Po aty, f. 69.
[252] Abram Isaac Elkus, Ambasador Amerikan, gjykatës, figurë publike. Ai ishte një prej hebrejve më të shquar në qeverinë amerikane. Po aty f. 70.
[253] Sigmund Freud, neurologjist austriak dhe themelues i psikanalizës, metodë klinike për trajtimin e psikopatologjisë nëpërmjet dialogut midis një pacienti dhe një psikanalist. Po aty, f. 71.
[254] Selma Ottilia Lovisa Lagerlöf (1858 – 1940), shkrimtare suedeze. Ajo është e para femër që e ka marrë Çmimin Nobel. Ajo kujtohet për librin e saj për fëmijë: *Nils Holgerssons underbara resa genom Sverige (Udhëtimi i Mrekullueshëm I Nils Holgerssons nëpër Suedi).*
[255] Po aty, f. 72.
[256] Botuar në gazetën amerikane The New York Times, datë 15 mars 1929.
[257] New York Times, 30 shtator 1934.

TREGUESI I EMRAVE

A

Abdurrahim Krosi 147
Abdyl Hamiti, Sulltan, 101, 242, 255
Abraham I. Elkus 235
Abraham Lincoln 137,138
Acheson, Archer & Allen 73
Actius Nash 53, 250

Adam Bernstein 12
Adelina Shehu (Hoxha) 9
Adolf Hitler 129, 230
Agim Rexha 9
Alan Fusine 71
Albert Ainshtajn 7, 13, 27, 32, 42, 150,197, 217, 218, 236, 237, 238
Alberto Pariani 155
Aleksandër Moisiu 13, 34, 38, 75, 79, 80,222, 250
Alexander Powell 35, 19
Alexander Thomson 17
Aleksandri i Madh 82
Alexander Arvizu 23
Alfred Cohen 43
Alfred Kerr 234
Allan Dulles 71
Andy Lee 9
Anila Kadia 9
Anton Çehov 30, 179, 180, 189
Aqif Pasha 100
Arben Manaj 9
Arkimandrid Zdruli 60
Arthur Schnitzler 42
Asta Skaisgirytė 9, 245
Aubrey Herbert 214
August Kral 100,101
August Rodin 13, 30, 42, 197, 205
Augusto Rosso 159
Austen Chamberlian 231, 235
Avni Rustemi 38, 107
Azis Çami 112

B
Bajram Curri 38
Bajron 179,180
Bardhyl Musai 9
Baron Pompeo Aloisi 87

Baron Sonino 102
Bejtullah Destani 8
Ben Barkow 239
Benes dhe Masaryk 42
Beqir Valteri 38, 107

Boaz Nash 250, 251, 252
Brian Schama 240

C
Car Nikolla II 30, 41,194
Carl William Ackerman 232, 234
Chaim Weizman 197, *216, 217*
Charles Evans Huges 150
Charles Harding 21
Charles Hart 21
Charles Schwager 43
Charles Telford Erickson 12, 17, 27, 69, 70, 71, 250
Christopher Hill 22
Christopher Lyden 9, 246
Clemenceau 153, 223
Cloyce K. Huston 133
Crispin Sartwell 251
Cyrus Adler 150

D
Daniel Taub 9, 130 239, 244, 245
David Bernstein 53
David dhe Marie Bernstein 29
David Eugene Smith 238
David Hosaflook 9
Dhimiter Berati 133, 145
Didëroi 206
Dielli 8,16, 29, 30, 35,
Djonovitch 60
Donald Lu 23, 250
Dorothy Nash (Bernstein) 34, 53
Dostojevski 182
Dovana 128
Dr. Hacketi 118

E
Edibe Delvina 149
Ekrem Libohova 133, 112, 146
Elez Biberaj 8, 22, 32
Elmer Bernstein 12
Erich W.A. Hoffmann 133
Esat Pasha 100, 104, 110
Evlija Çelebia 77

F
Fabian Barcata 34
Faik Konica 34, 146

Fan Noli 34, 35, 38, 69, 70, 107, 108, 109, 111, 143, 145, 154,
Fatmir Terziu 9
Ferit Duka 9
Frank Manuel 15
Fred Williams 21
Friedrich Nietzsche 207
Fruma Mohrer 8, 241
Fuad Asllani 133, 162

G
Gabby Glassman 9, 240
Gazi Bej 95
George Bernard Shaw 13, 30, 42, 197, 198, 203
George Brandes 142,198
George W Bush 22, 23
George Washington 67, 121
Gerald P. Nye 235
Gjeneral Juan Vicente Gomes 233
Gjeneral P. Tsaldaris 235
Gjerasim dhe Sevasti Qiriazi 17
Gjergj Fishta 34, 38, 76, 80
Gorki 30,179, 188

H
H.T. Fultz 35
Hainrih Haine 231, 207
Hans Delbrueck 42, 198
Harding, Presidenti 27, 2017
Harvey Sarner 135
Hasan Prishtina 38
Havellock Ellis 42, 206
Heinrich Man 234
Hellie Ermenie Rives 21
Henri Bergson 20, 42, 197, 198, 204
Henry Ford 30, 149, 196
Henry Van Dyke 43
Herbert Hoover, President 13, 14, 27, 40, 41, 45, 51, 69, 70, 71, 149, 225, 226, 227, 228, 231, 233
Havelock Ellis 197
Hilë Mosi 73
Hugh Gladney Grant 21

I
Ignacy Jan Paderewski 228
Ilir Ikonomi 22
Immanuel Kanti 231
Ina Musai 9
Ingrid Strati 130

Ismail Qemali 82, 98
Ivan Turgenjev 180, 182, 188, 192

J
James Baker 22
James Franklin Jeffrey 23
Jane Admas 231, 232
Jason Williams 240
Jean Bloch 231
Jeremy Benthan 231
Joan Weber 251
John Da Kayi 117
John Freely 8, 24
John L. Withers 23
Jonathan Brent 241, 241
Joseph DioGuardi 135
Joseph Eduard Lake 23
Joseph Limpreht 23
Joseph Matattiasi 123
Joyce Bernstein 146
Joyce Gitlin Sartwell Abell 251
Julius Goemboes 233

K
Kaiseri i Prusisë 30, 41
Kaiseri Vilhelm II 194, 221
Kardinali Gasparri 211, 212
Kenedët, 17
Koço Kota 16
Kol Bib Mirakaj 131
Kol Kuga – Kuqali 34, 60, 123, 133, 144, 146, 147
Kol Tromara 70
Konstandin Kristoforidhi 17
Kontesha Tolstoi 187
Konti Sergius Witte 30, 42, 198, 201, 202, 220, 221
L
Lef Nosi 75, 76, 77, 78
Lekë Dukagjini 76
Lenini 213, 214
Leo Trocki 13, 30, 42, 197, 213, 214
Leon Andrejev 13
Leon di Ghilardi 88
Leon Savage 43
Leon Tolstoi 179, 180, 182, 183, 188,197, 198, 199, 200, 201,207
Leonard Aberman 43
Leonard Bernstein 12
Leonid Andrejev 30, 178, 180, 181, 182, 183, 185, 186, 187, 188, 189, 207

Lermontov 180
Liri Berisha 239, 240
Lirim Greiçevci 9
Lloyd George 153
Longfellow 15, 17
Lord Robert Cecil 42, 87, 154, 198, 214, 215, 228, 231, 233
Lord Balfour 214, 216
Louis Barthou 88
Luigi Ugolini 78, 79, 144
Luigj Bumçi 38, 77
Lulzim Basha 240

M
M.W. Royse 15
Maika Angelika 60
Maksim Kovalovski 42, 198
Marcie B. Ries 23
Margaret Hasluck 77
Mario Alberti 110
Marisa Lino 23
Marjana Bulku 9
Mark Menahem 77
Mark Topallaj 112
Mark Twain 141
Maruqis Okuma 9,42, 198, 244
Mbreti Zog 21, 34, 35, 36, 37, 47, 48, 50, 51, 55 , 56, 57, 69, 70, 72, 87, 88, 89, 91, 92, 93, 94 -115, 133, 141, 143, 145, 147, 153, 154, 155, 156, 157, 158, 161, 246.
Mehmet Bej Konica 34, 37, 77, 89, 141, 143, 145, 147, 149, 153, 158,
Meli Lupi di Soragna 113, 114
Metchenikof *30, 202*
Michelangelo 205
Mihal Sherko 133
Mikael Turtulli 77
Mordecai Soltes 45
Morgenthaux 40
Motrat Qiriazi 16, 17
Muharrem Bajraktari 133
Musolini 37, 81, 87, 88, 89,115, 117,155, 158,
Mustafa Kruja 104
Myfid Libohova 110

N
Nana Mbretëreshë 48
Napoleon Bonaparti 80, 222 250
Nathan Natelson 45
Ndrekë Gjini 9
Nevila Nika 9

Nicholas Cannon 9
Nicholas Murray Buttler 232
Nikki Doçi 246
Nikolla Kristoferi 15
Nikolla Romanov 195
Niti, Premier Italian 153
Nok Gjeloshi 112
Nordo Nordaut Weizman 42
Norman Gershman 240

O
Otto A. Rosalsky 45

P
Papa Benedikti XV 42, 197, 211, 212
Papa Pavli i IV 124
Peter Nash 251
Petrit Kuçana 9
Pietro Santucci 162
Pjetër Kropotkin 197
Plamenac 60
Post Wheeler 21
Princ Vidi 97, 99, 100

Q
Qemal Kasaruho 145
Qerim Panariti 15
Qezari dhe Pompeu 47

R
Rexhep Jella 53, 56, 250
Ristitch 60
Robert Elsie 8
Robert Pinkerton 17
Romain Roland 197
Roosevelt 161
Rudina Hoxha 9

S
Sabatai Zevi 24, 124, 125
Sahib Molla Efendi 208
Samuel Schulman 43
Scarlett Epstein 122, 125 – 133, 239
Selma Lagherlof 236
Seymour F. Wilhelm 45

SH
Sheik - Ul - Islam 13, 42, 197, 207, 208
Shën Gjon Vladimiri 35, 59, 60, 61, 62, 64, 65, 144,146
Shën Pali 47
Shtjefën Gjeçovi 34, 76, 74, 76
Sigmund Freud 236
Simon Schama 8, 242, 243
Sinclair Lewis 45
Sir Eduard Grey 215
Sir Jocelyn Percy 155
Sir Noel Malcolm 8
Sir Robert Macleod Hodgson 36, 90, 92
Skenderbeu 13, 15, 17, 18, 46, 49, 54, 55, 56, 66, 111, 142
Sofie Bernstein 53
Sotir Peçi 16
St. Louis 26
Stalin 213, 214
Stefan J. Shuttak 133
Stepan Radicz 219

T
Tarle & Bourtseff, 195
Terenc Toci 35, 120
Teuta Starova 130
Theodore Drajzer 45, 231, 233
Theodore Herzli 2016
Theodore Roosevelt 13, 42,196, 197,198, 220, 221
Tom Lantosh 135
Turhan Pasha 77

U
Ulysses Grant Smith 21

V
Vangjel Misho 15
Vasil Marku 35,145
Vatra 9, 16, 29, 34, 70, 131, 135, 239
Verlaci 107, 108
Vernon Kelleg 71
Viktor Emanueli i Trete 59
Vilhelm Vid 83
Violet Wilhelm Bernstein 34, 53
Visarion 34, 35, 59, 60, 62, 64, 145
Visar Zhiti 9
Vokatch, 60
Vrangeli 47

Vrioni 108

W
Wallace S. Murray 159
Wellington 80
William Edwin Ryerson 22
Wilson, Woodrow 13, 25, 42, 48, 81, 87, 142, 153,198, 212, 214, 221, 222, 223, 224, 225, 227, 230, 246
Witman 207
Witold Sobkow 240

XH
Xhaferr Vila 133, 148, 158
Xhoana Papakostandini 8, 9, 130, 157, 249

Z
Sigmund Freud f 13, 32, 231